



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2022-01

Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 2 shkurt 2023

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Aktgjykimi i Apelit

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Aleks Uajting

Mbrojtjes së Hysni Gucatit:

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt:

Tobi Kadman

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	1
A. Historiku i gjykimit.....	1
B. Apelet.....	2
C. Argumentet gojore	5
II. STANDARDI I SHQYRTIMIT	6
III. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME	9
A. Kriteret formale në lidhje me apelet dhe hedhja poshtë e menjëhershme e tyre	10
B. Arsye të kufizuara për ndërhyrje të apelit.....	12
1. Mendimi i arsyetuar i Trupit Gjykses.....	12
2. Kompetenca diskrecionale e Trupit Gjykses	13
C. Siguria dhe parashikueshmëria juridike.....	14
IV. DISKUTIM.....	15
A. Pretendimet për gabime në lidhje me aspekte të gjykimit të drejtë dhe të provave	15
1. Pretendimet për gabime në lidhje me mosheqjen nga Trupi Gjykses të Kryegjykatësit të tij (Pika 2 e Apelit të Haradinajt).....	15
2. Pretendimet për gabime në lidhje me kryerjen e procesit gjyqësor dhe prezumimin e pafajësisë (Pika 1, pjesërisht, e Apelit të Haradinajt)	17
3. Pretendimet për gabime në lidhje me vendimin e Trupit Gjykses mbi mosnxjerrjen dhe/ose redaktimet e materialit (Pikat 2 (A), pjesërisht, 4 (H) pjesërisht, të Apelit të Gucatit; Pikat 1, pjesërisht, 4, 10, 16, 17 të Apelit të Haradinajt).....	23
4. Pretendimet për gabime në lidhje me pranimin e dëshmimeve të dëshmitarëve DW1250, DW1251, DW1252 dhe DW1253 (Pikat 1, pjesërisht, dhe 6 të Apelit të Haradinajt)	43
5. Pretendimet për gabime në lidhje me mbështetjen e Trupit Gjykses në dëshmi të dorës së dytë (Pika 7 e Apelit të Haradinajt).....	46
6. Pretendimet për gabime në lidhje me mosmiratimin prej Trupit Gjykses të kërkesës për përkufizimin e formave të përgjegjësisë penale dhe elementeve të veprës penale para lëshimit të Aktgjykimit (Pika 5 e Apelit të Haradinajt)	50
B. Pretendimet për gabime në lidhje me shkeljen e fshehtësisë së procedurës – informacioni i mbrojtur (Pika 5).....	52
1. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet mbi “zbulimin e paautorizuar” (Pikat 4(G)-(H) dhe 5 të Apelit të Gucatit; Pika 3, pjesërisht, e Apelit të Haradinajt)	54

2.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet mbi “informacionin e nxjerrë në procedurë zyrtare” (Pika 4(A) e Apelit të Gucatit).....	57
3.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet mbi [informata] “që sipas ligjit nuk mund të zbulohen, apo[...] janë shpallur si fshehtësi me vendim të gjykatës apo të organit kompetent” (Pika 4(B)-(F) e Apelit të Gucatit; Pika 21 e Apelit të Haradinajt) ...	61
C.	Pretendimet për gabime në lidhje me shkeljen e fshehtësisë së procedurës – persona të mbrojtur (Pika 6 e Aktakuzës).....	68
1.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet mbi “person” [të mbrojtur në procedurë penale] (Pika 8(A) e Apelit të Gucatit; Pika 22 e Apelit të Haradinajt)	70
2.	Pretendimet për gabime lidhur me konstatimet mbi [person] “të mbrojtur në procedurë penale” (Pikat 7, 8 (B) të Apelit të Gucatit; Pika 23 e Apelit të Haradinajt)....	76
3.	Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet mbi formën e rëndë të veprës penale sipas nenit 392(3) të KPK-së (Pikat 9, 10, 11 të Apelit të Gucatit; Pika 8, pjesërisht, e Apelit të Haradinajt)	81
D.	Pretendimet për gabime në lidhje me frikësimin gjatë procedurës penale (Pika 3 e Aktakuzës)	90
1.	Pretendimet për gabime në lidhje me veprimin e fajshëm sipas nenit 387 të KPK-së (Pikat 1, 2(A) pjesërisht, dhe 2(B) të Apelit të Gucatit; Pikat 8, pjesërisht, dhe 19 të Apelit të Haradinajt)	90
2.	Pretendimet për gabime lidhur me synimin kriminal sipas nenit 387 të KPK-së (Pika 3 e Apelit të Gucatit; Pika 20 e Apelit të Haradinajt)	111
E.	Pretendimet për gabime lidhur me pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë (Pika 1 e Aktakuzës).....	118
1.	Pretendimet për gabime lidhur me veprimin e fajshëm të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së (Pika 12 e Apelit të Gucatit; Pika 18 e Apelit të Haradinajt).....	118
2.	Pretendimet për gabime lidhur me synimin kriminal të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së (Pika 13 e Apelit të Gucatit)	126
F.	Pretendimet për gabime lidhur me pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përmes veprimit të përbashkët të një grupi (Pika 2).....	130
1.	Pretendimet për gabime lidhur me bashkimin e veprave penale sipas nenit 401(1) dhe (2) të KPK-së (Pika 16 e Apelit të Gucatit; Pika 3, pjesërisht, e Apelit të Haradinajt)	130
2.	Pretendimet për gabime lidhur me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal sipas nenit 401(2) të KPK-së (Pikat 14, 15 të Apelit të Gucatit)	139
G.	Pretendimet për gabime lidhur me argumentet mbrojtëse.....	140

1. Pretendimet për gabime lidhur me argumentin mbrojtës të interesit publik (Pika 4(G) dhe Pika 4(H), pjesërisht, e Apelit të Gucatit; Pika 1, pjesërisht, dhe Pika 9 e Apelit të Haradinajt)	141
2. Pretendimet për gabime lidhur me argumentin mbrojtës të sinjalizimit (Pika 5 e Apelit të Gucatit).....	151
3. Pretendimet për gabime lidhur me argumentin mbrojtës të shtytjes nga ZPS-ja për kryerje të veprës penale (Pikat 17, 18, 19 të Apelit të Gucatit; Pikat 12, 13 të Apelit të Haradinajt)	155
4. Pretendimet për gabime në lidhje me argumentin mbrojtës të nevojës ekstreme (Pika 11 e Apelit të Haradinajt).....	164
5. Pretendimet për gabime në lidhje me argumentin mbrojtës për vepra të rëndësishme të vogël (Pikat 14, 15 të Apelit të Haradinajt).....	168
H. Pretendimet për gabime në lidhje me përcaktimin e dënimit (Pika 20 e apelit të Gucatit; Pika 24 e apelit të Haradinajt)	172
1. Pretendimet për gabime në lidhje me vlerësimin e peshës së veprave penale dhe faktorëve të tjerë në përcaktimin e dënimit.....	174
2. Pretendimet për gabime lidhur me mosmarrjen parasysh prej Trupit Gjykoës të jurisprudencës përkatëse në përcaktimin e dënimit	188
V. VENDIM.....	196
VI. MENDIMI PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYKATËSIT KAI AMBOS	198
A. Parimi i ligjshmërisë, veçanërisht <i>lex stricta</i> , dhe neni 401(1) i KPK-së.....	198
B. Ndikimi në përcaktimin e dënimit	210

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹ duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 46 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 172, 176 dhe 183 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) ka marrë në shqyrtim apelet nga z. Hysni Gucati (“Gucati”) dhe z. Nasim Haradinaj (“Haradinaj”) (bashkërisht, “të akuzuarit”, të cilët janë apelues në këtë çështje gjyqësore) kundër Aktgjykimit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*, KSC-BC-2020-07 (“Aktgjykimi”) të shqiptuar dhe të dorëzuar me shkrim më 18 maj 2022 në përputhje me rregullën 159 të Rregullores. Paneli i Apelit lëshon këtë Aktgjykim së bashku me Shtojcën 1, ku jepen të dhëna mbi historikun procedural të çështjes gjyqësore, dhe Shtojcën 2, ku jepen të dhëna për shkurtesat e përdorura në këtë Aktgjykim.

I. HYRJE

A. HISTORIKU I GJYKIMIT

1. Gjykimi në këtë çështje gjyqësore filloi më 7 tetor 2021 dhe përfundoi më 17 mars 2022. Midis 18 tetorit 2021 dhe 28 janarit 2022, Trupi Gjykses dëgjoi ose mori dëshmitë dhe provat e 15 dëshmitarëve. Gjatë gjykimit, Trupi Gjykses pranoi 238 prova materiale.²

2. Trupi Gjykses konstatoi se, gjatë periudhës së Aktakuzës, të akuzuarit morën, nga burime të panjohura, tri grupe dokumentesh që përmbanin informacion konfidencial dhe jopublik që lidhej me punën dhe hetimet e TFHS-së dhe të ZPS-së. Ky material u dorëzua në selinë e OVL-UÇK-së më 7 shtator 2020, 16 shtator 2020 dhe

¹ Vendimi për Caktimin.

² Aktgjykimi, para. 2.

22 shtator 2020.³ Pas çdo dorëzimi, të akuzuarit organizuan dhe mbajtën konferencë për shtyp, ku diskutuan dhe u vunë në dispozicion gazetarëve secilën prej tri grupeve të dokumenteve.⁴ Gjatë së njëjtës periudhë, të akuzuarit, individualisht ose së bashku, dhanë një numër intervistash në media në lidhje me këtë material. Ata gjithashtu bënë komente për materialin dhe ripublikuan artikuj në mediat sociale.⁵ Çka mbetën nga grupet e dokumenteve, iu dorëzuan në vijim ZPS-së dhe u identifikuan si Paketat 1, 2, 3 dhe 4.⁶

3. Më 18 maj 2022, Trupi Gjykses shqiptoi Aktgjykimin, me të cilin e shpalli fajtor secilin prej të akuzuarve për vepra penale kundër rendit publik dhe vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. Të akuzuarit u shpallën fajtorë për pesë pika të Aktakuzës (Pikat 1, 2, 3, 5, 6) dhe të pafajshëm për një pikë (Pika 4)⁷. Trupi Gjykses e dënoi secilin të akuzuar me një dënim të njësuar prej katër vjet e gjysmë burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një gjobë prej 100 eurosh.⁸

B. APELET

4. Më 25 maj 2022, në pajtim me kërkesën e Haradinajt, Paneli i Apelit urdhëroi që çdo njoftim për apel kundër Aktgjykimit të dorëzohej brenda afatit të përshtuar në rregullën 176(2) të Rregullores, përkatësisht deri më 17 qershor 2022.⁹ Më 15 qershor 2022, në bazë të kërkesës së Haradinajt, Paneli autorizoi shtimin e numrit të

³ Aktgjykimi, para. 204.

⁴ Aktgjykimi, para. 205.

⁵ Aktgjykimi, para. 206. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, "IV. Ngjarjet në fjalë", para. 204-296.

⁶ Aktgjykimi, para. 236, 300.

⁷ Aktgjykimi, para. 794, 1012-1016.

⁸ Aktgjykimi, para. 1014, 1017.

⁹ Kërkesa e Haradinajt për Qartësimin e Afateve të Apelit; Vendimi i Apelit për Qartësimin e Afateve të Apelit, para. 6, 8.

lejuar të fjalëve për njoftimin për apel të Haradinajt dhe të Gucatit, me nga 800 fjalë për secilin.¹⁰

5. Më 17 qershor 2022, të akuzuarit dorëzuan njoftimet për apel kundër Aktgjykimit. Më të njëjtën ditë, ZPS-ja njoftoi Panelin se nuk synonte të apelonte Aktgjykimin.¹¹

6. Më 1 korrik 2022, Paneli i Apelit refuzoi kërkesën e Haradinajt për shtim të numrit të lejuar të fjalëve në dosjen e apelit kundër Aktgjykimit.¹² Gjithashtu, Paneli miratoi në vijim kërkesën e ZPS-së që të refuzohej njoftimi i apelit të Haradinaj për mospërbushje të kriterëve të nenit 47(1) të Udhëzuesit të Punës për Parashtrime.¹³ Gjithashtu, Paneli urdhëroi të akuzuarit që të dorëzonin sërish njoftimet për apel në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në vendimin e lartpërmendur.¹⁴

7. Më 5 korrik 2022, Kryegjykatësja e Panelit të Apelit mbajti konferencën para apelit në emër të Panelit.¹⁵ Po atë ditë, Paneli refuzoi kërkesën e Gucatit për shtim të numrit të lejuar të fjalëve të njoftimit të tij për apel që do ta dorëzonte sërish.¹⁶

8. Më 10 dhe 11 korrik 2022, Haradinaj dhe Gucati dorëzuan sërish njoftimet e tyre përkatëse për apel kundër Aktgjykimit.¹⁷

¹⁰ Kërkesa e Haradinajt për Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve në Njoftimin për Apel; Vendimi i Apelit për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve në Njoftimin për Apel, para. 8.

¹¹ Njoftimi për Apel i Gucatit (F00009); Njoftimi për Apel i Haradinajt (F00008); Njoftimi i ZPS-së lidhur me Apelin, para. 1.

¹² Kërkesa e Haradinajt për Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve në Dosjen e Apelit; Vendimi mbi Dosjen e Apelit dhe Njoftimin për Apel, para. 14.

¹³ Kërkesa e ZPS-së lidhur me Njoftimin për Apel të Haradinajt.

¹⁴ Vendimi i Apelit mbi Dosjen e Apelit dhe Njoftimin për Apel, para. 14.

¹⁵ Urdhri për Caktimin e Datës për Konferencën para Apelit, para. 6, 11; Transkripti, 5 korrik 2022.

¹⁶ Kërkesa e Gucatit për Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve në Njoftimin për Apel; Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e Gucatit për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 8.

¹⁷ Në këtë Aktgjykim, njoftimi për apel i ridorëzuar nga Gucati më 11 korrik 2022 përmendet si "Njoftimi për Apel i Gucatit", njoftimi për apel i ridorëzuar nga Haradinaj më 10 korrik 2022 përmendet si "Njoftimi për Apel i Haradinajt".

9. Më 5 gusht 2022, Paneli i Apelit miratoi pjesërisht kërkesën e Gucatit për shtim të numrit të lejuar të fjalëve në dosjen e apelit të tij kundër Aktgjykimit, duke autorizuar të dy të akuzuarit dhe ZPS-në të dorëzonin përkatësisht, apelet dhe përgjigjet, pa tejkalluar numrin e lejuar të fjalëve prej 18.000 fjalë për secilin.¹⁸
10. Më 19 gusht 2022, Gucati dhe Haradinaj, që të dy, dorëzuan dosjet e apeleve të tyre. Më 31 gusht 2022, Haradinaj dorëzoi versionin e korrigjuar të dosjes së apelit të tij dhe më 2 shtator 2022, versionin e korrigjuar më tej.¹⁹
11. Më 21 shtator 2022, ZPS-ja dorëzoi dosjen e përgjigjes.²⁰
12. Më 6 tetor 2022, Paneli refuzoi kërkesat e të akuzuarve për vendim zyrtar dorëzimi i përgjigjes prej ZPS-së nuk ishte bërë në përputhje me rregullën 179(5) të Rregullores.²¹
13. Më 7 tetor 2022, të akuzuarit dorëzuan dosjet e kundërpërgjigjeve dhe në të njëjtën kohë kërkuan shtim të numrit të lejuar të fjalëve në to.²² Më 12 tetor 2022, Paneli refuzoi kërkesat e të akuzuarve për shtimin e numrit të fjalëve dhe i urdhëroi që të dorëzonin sërish dosjet e kundërpërgjigjeve të tyre në përputhje me numrin e lejuar të fjalëve prej 4.000 fjalësh, sikurse përcakton Udhëzuesi i Punës për Parashtrime.²³

¹⁸ Kërkesa e Gucatit për Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve në Dosjen e Apelit; Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e Gucatit për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve në Dosjen e Apelit, para. 11, 13.

¹⁹ Në këtë Aktgjykim, dosja e apelit e ridorëzuar nga Gucati më 19 gusht 2022 përmendet si “Dosja e Apelit të Gucatit”, versioni i korrigjuar më tej i dosjes së apelit të dorëzuar nga Haradinaj më 2 shtator 2022 përmendet si “Dosja e Apelit të Haradinajt”.

²⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së.

²¹ Kërkesa e Gucatit lidhur me Mospërmbushjen e Rregullës 179 prej ZPS-së, para. 23; Kërkesa e Haradinajt lidhur me Mospërmbushjen e Rregullës 179 prej ZPS-së, para. 26; Vendimi i Apelit mbi Kërkesat e Mbrojtjes lidhur me Mospërmbushjen e Rregullës 179 prej ZPS-së, para. 16.

²² Kërkesa e Gucatit për Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve në Dosjen e Kundërpërgjigjes. Haradinaj nuk e dorëzoi kërkesën ndarazi, por kërkesa e tij u përfshi në Dosjen e Kundërpërgjigjes së tij. *Shih* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt (F00062), para. 4.

²³ Vendimi i Apelit mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve në Dosjet e Kundërpërgjigjeve, para. 7, 10.

14. Më 13 tetor 2022, Paneli refuzoi kërkesat e të akuzuarve për ndryshim të pikave të njoftimeve të tyre për apel pas nxjerrjes së intervistave të dëshmitarit W04730 dhe njoftimit për materialin 206²⁴ dhe, më 3 nëntor 2022, refuzoi kërkesat tyre për rishikim të atij vendimi.²⁵

15. Përkatësisht, më 16 dhe 17 tetor 2022, Haradinaj dhe Gucati dorëzuan sërish dosjet e kundërpërgjigjeve të tyre.²⁶

16. Në përputhje me Urdhrin për Caktimin e Datës për Aktgjykimin e Apelit të datës 16 janar 2023, Paneli vendosi të shqiptonte Aktgjykimin e Apelit të enjten, 2 shkurt 2023.²⁷

C. ARGUMENTET GOJORE

17. Sipas rregullës 72(3) të Rregullores, vendimi mbi apelet kundër një aktgjykimi të lëshuar sipas nenit 15(2) të Ligjit “mund të merret tërësisht mbi bazën e parashtrimeve me shkrim”. Megjithatë, rregulla 180 e Rregullores përcakton se, “pas përfundimit të afateve kohore për paraqitjen e dosjeve parashikuar në rregullën 179, Paneli i Gjykatës së Apelit mund të caktojë datën e seancës së apelit, nëse është e nevojshme.”

18. Më 20 tetor 2022, Paneli u bind se seanca për apel ishte e domosdoshme dhe urdhëroi mbajtjen e asaj seance për të trajtuar pikat e apeleve të të akuzuarve.²⁸ Më 7 nëntor 2022, Paneli i Apelit hodhi poshtë kërkesat e mëtejshme të të akuzuarve për

²⁴ Kërkesa e Gucatit për Ndryshim të Njoftimit për Apel; Kërkesa e Haradinajt për Ndryshim të Njoftimit për Apel; Vendimi i Apelit mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Ndryshimin e Njoftimeve për Apel, para. 16, 19.

²⁵ Kërkesa e Gucatit për Rishikim të Vendimit F00064; Kërkesa e Haradinajt për Rishikim të Vendimit F00064; Vendimi i Apelit mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Rishikim të Vendimit F00064.

²⁶ Në këtë Aktgjykim, dosja e kundërpërgjigjes e ridorëzuar nga Gucati më 17 tetor 2022 përmendet si “Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit”, dhe dosja e kundërpërgjigjes e ridorëzuar nga Haradinaj më 16 tetor 2022 përmendet si “Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt”.

²⁷ Urdhri për Caktimin e Datës për Aktgjykimin e Apelit, para. 3, 5.

²⁸ Urdhri për Caktimin e Datës për Seancën e Apelit, para. 2-3, 5.

seancë gojore apeli për trajtimin e pasojave të pretenduara të nxjerrjes së vonuar prej ZPS-së të materialit lidhur me pikat e apelit dhe urdhëroi palët që të respektonin datën e seancës të caktuar në të njëjtin urdhër.²⁹ Më 28 nëntor 2022, Paneli i Apelit refuzoi kërkesën e Haradinajt për shtyrje të seancës.³⁰

19. Në përputhje me Urdhrin për Caktimin e Datës për Seancën e Apelit, të lëshuar më 20 tetor 2022, seanca e apelit në këtë çështje gjyqësore u mbajt të enjten, 1 dhjetor 2022 dhe të premten 2 dhjetor 2022.³¹

II. STANDARDI I SHQYRTIMIT

20. Neni 46 i Ligjit përcakton standardin e shqyrtimit të apeleve kundër aktgjyqimeve dhe nuk bën dallim midis vendimeve në lidhje me krime përkatësisht, sipas neneve 13-14 të Ligjit dhe atyre sipas nenit 15 të Ligjit. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se i njëjti standard shqyrtimi vlen në të dyja rastet.³²

21. Sipas nenit 46 të Ligjit, Paneli i Apelit mund ta lerë në fuqi, prapësojë, ose ndryshojë Aktgjykimin, dhe mund të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, në bazë të arsyeve në vijim: (i) “ndonjë gabim rreth ndonjë çështjeje juridike që e shfuqizon aktgjykimin”; (ii) “ndonjë gabim fakti, i cili ka shkaktuar dështimin e drejtësisë”; ose

²⁹ Urdhri për Përgatitjen e Seancës së Apelit.

³⁰ Vendimi i Apelit në lidhje me Kërkesat e Mbrojtjes për Intervistim të Dëshmitarëve, para. 30-31. *Shih* Kërkesën e Haradinajt për Shtyrje të Seancës Gojore të Apelit.

³¹ Në një urdhër gojor në fillim të seancës, Paneli i Apelit refuzoi kërkesën e mbrojtësit të Haradinajt për shtyrje të seancës. *Shih* Urdhrin Gojor lidhur me Kërkesën e Haradinajt për Shtyrje të Seancës së Apelit.

³² *Shih*, në njëren anë, *Fatuma et al. Appeal Judgement*, para. 13; *Šešelj Appeal Judgement*, para. 24; *Nshogoza Appeal Judgement*, para. 12. Në anën tjetër, për zbatim *mutatis mutandis* të rregullave lidhur me apelet në çështje gjyqësore që kanë të bëjnë me krime ndërkombëtare deri në ato të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë, shih ICC Rules, Rule 163(1); *Bemba et al. Appeal Judgment*, para. 89; Eckelmans, F., in *Ambos Rome Statute Commentary*, Article 81, mn. 30; dhe Rregulloren e TSL-së, Rregulla 60 bis (H); *Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment*, para. 11, fn. 44.

(iii) “ndonjë gabim për sa i përket dhënies së dënimit”.³³ Sipas nenit 46(2) të Ligjit, apeli nuk është gjykim *de novo*.

22. Pala që pretendon gabim juridik duhet ta evidentojë atë, të paraqesë argumente në mbështetje të pretendimit të saj dhe të shpjegojë se si e bën të pavlefshëm gabimi atë vendim.³⁴ Gjithashtu, kur një palë pretendon gabim juridik mbi bazën e mungesës së një mendimi të arsyetuar, ajo duhet të evidentojë pikat konkrete, konstatimet faktike ose argumentet që pretendohet se Trupi Gjykes nuk i ka shqyrtuar dhe duhet të shpjegojë pse kjo mungesë e bën të pavlefshëm vendimin.³⁵ Paneli i Apelit gjykon se pretendimi për gabim juridik që nuk ka asnjë gjasë të ndryshojë rezultatin e një vendimi, mund të rrëzohet për këtë arsye.³⁶ Megjithatë, edhe nëse argumentet e palës janë të pamjaftueshme për të mbështetur pretendimin për gabimin në fjalë, Paneli mund të konstatojë gabim juridik duke u bazuar në arsye të tjera.³⁷ Paneli i Apelit do të shqyrtojë konstatimet juridike të Trupit Gjykes për të vendosur nëse janë të sakta.³⁸

23. Gjithashtu, neni 46(4) i Ligjit saktëson se:

Kur paneli i Gjykatës së Apelit përcakton se ndonjë trup gjykes ka bërë gabim juridik në ndonjë aktgjykim, që rrjedh nga zbatimi i

³³ Neni 46(1)(a)-(c), (3) i Ligjit.

³⁴ *Shih p.sh., Fatuma et al. Appeal Judgement*, para. 14; *Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment*, para. 12; *Šešelj Appeal Judgement*, para. 25; *Nshogoza Appeal Judgement*, para. 13. *Shih gjithashtu Vendimin e Apelit mbi Arrestimin dhe Paraburgimin e Gucatit*, para. 12.

³⁵ *Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment*, para. 12. *Shih gjithashtu Stanišić and Simatović Appeal Judgement*, para. 16; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgement*, para. 30; *Ngirabatware Appeal Judgement*, para. 8; *Taylor Appeal Judgment*, para. 25; Vendimin mbi Apelin e Selimit në lidhje me Lirim të Përkohshëm, para. 60.

³⁶ *Shih p.sh., Fatuma et al. Appeal Judgement*, para. 14; *Šešelj Appeal Judgement*, para. 25. *Shih gjithashtu Vendimin e Apelit mbi Arrestimin dhe Paraburgimin e Gucatit*, para. 12. Paneli i Apelit vë në dukje se jurisprudenca e GJPN-së zbatoi një interpretim të ndryshëm, sikurse mund të shihet në *Bemba et al. Appeal Judgment*, para. 90, 110 (ku zbatohet kriteri “i ndikimit juridikisht thelbësor”). *Shih gjithashtu Eckelmans, F., in Ambos Rome Statute Commentary*, Article 81, mn. 19, ku analizohet se si tribunallet penalë ndërkombëtarë e përfshinë formulimin dhe qasjen e kornizës ligjore të TPNJ-së, dhe komentini 42, në lidhje me kriterin e zbatuar nga GJPN-ja.

³⁷ *Fatuma et al. Appeal Judgement*, para. 14. *Shih gjithashtu Mladić Appeal Judgment*, para. 16; Vendimin e Apelit mbi Arrestimin dhe Paraburgimin e Gucatit, para. 12.

³⁸ *Shih p.sh., Bemba et al. Appeal Judgment*, para. 90; *Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment*, para. 14; *Šešelj Appeal Judgment*, para. 25; *Nshogoza Appeal Judgment*, para. 13.

ndonjë standardi të pasaktë ligjor, Dhoma e Gjykatës së Apelit e artikulon standardin e duhur ligjor dhe e zbaton atë standard ndaj provave të përfshira në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor për të përcaktuar nëse fajësia e apeluar duhet të konfirmohet, të pranohet apo të hidhet poshtë. Përndryshe, nëse trupi gjykues është në dispozicion dhe mund ta trajtojë çështjen në mënyrë më efikase, Paneli i Gjykatës së Apelit mund ta kthejë rastin te trupi gjykues për të rishikuar konstatimet e tij dhe provat bazuar në standardin e duhur ligjor.

24. Në rast se vetë Paneli i Apelit zbaton standardin e saktë juridik për provat që përfshihen në dokumentacionin gjyqësor dhe përcakton nëse është bindur për standardin e nevojshëm të vërtetimit në lidhje me konstatimin faktik që kundërshtohet,³⁹ ai do të marrë parasysh vetëm provat që përmenden në Aktgjykim, provat e përfshira në dokumentacionin gjyqësor të përmendura nga palët, dhe ku është e zbatueshme, prova shtesë të pranuar gjatë apelit.⁴⁰

25. Në lidhje me gabimet faktike, në nenin 46(5) të Ligjit për gabime faktike përcaktohet se:

Me rastin e shqyrtimit të konstatimeve faktike të Trupit Gjykues, Paneli i Gjykatës së Apelit vetëm i zëvendëson konstatimet e Trupit Gjykues me konstatimet e veta atëherë kur provat në të cilat është bazuar trupi gjykues nuk kanë mundur të pranohen nga asnjë gjykim i arsyeshëm i fakteve apo kur vlerësimi i provave është tërësisht i gabuar.

26. I njëjti standard zbatohet në lidhje me pretendime për gabime faktike, pavarësisht nëse konstatimi i kundërshtuar bazohet në prova të drejtpërdrejta apo rrethano. ⁴¹ Paneli prapëson vendimin e Trupit Gjykues vetëm kur gabimi faktik ka rezultuar në gabim gjyqësor⁴² dhe nuk i prapëson me lehtësi konstatimet faktike të

³⁹ *Shih p.sh., Fatuma et al. Appeal Judgement, para. 15; Bemba et al. Appeal Judgment, para. 96; Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment, para. 14.*

⁴⁰ *Shih p.sh., Fatuma et al. Appeal Judgement, para. 15; Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment, para. 14.*

⁴¹ *Shih p.sh., Fatuma et al. Appeal Judgement, para. 16; Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment, para. 16.*

⁴² Neni 46(1)(b) i Ligjit.

Trupit Gjykses, sepse është në radhë të parë detyra e këtij të fundit që të dëgjojë, shqyrtojë dhe peshojë provat e paraqitura gjatë gjykimit.⁴³

III. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

27. Gjatë shqyrtimit të Apelit, Paneli konfirmon se, duke u bazuar në nenet 6(2), 15(2), 16(3) dhe 64 të Ligjit, Trupi Gjykses zbatoi nenet 17, 28, 31, 32, 33, 35, 387, 388, 392 dhe 401 të KPK-së.⁴⁴

28. Paneli rikujton se Ligji bën të qartë se gjykatësit mund të ndihmohen nga burime të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë burime dytësore, siç janë jurisprudenca nga gjykatat ndërkombëtare *ad hoc*, GJPN-ja dhe gjykata të tjera penale.⁴⁵ Këto burime dytësore mund të orientojnë gjykatësit në rastet kur burimet parësore nuk ofrojnë orientim mbi një aspekt konkret.⁴⁶ Paneli u është referuar edhe vendimeve përkatëse të gjykatave të Kosovës, dhe ka marrë parasysh Komentarin *Salihu dhe të tjerët* si një burim informues, por jo domosdoshmërisht bindës, për interpretimin e të gjitha aspekteve përkatëse.⁴⁷

⁴³ *Shih p.sh., Fatuma et al. Appeal Judgment*, para. 16; *Bemba et al. Appeal Judgment*, paras 91-95; *Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment*, para. 15; *Šešelj Appeal Judgment*, para. 26; *Nshogoza Appeal Judgment*, para. 13. *Shih gjithashtu* Vendimin e Apelit mbi Arrestimin dhe Paraburgimin e Gucatit, para. 13; Eckelmans, F., in *Ambos Rome Statute Commentary*, Article 81, mn. 85.

⁴⁴ *Shih* Aktgjykimin, para. 65, që u referohet neneve 6(2), 15(2) dhe 16(3) të Ligjit, që i referohen KPK-së 2012. Veprat penale sipas neneve 387, 388, 392 dhe 401 të KPK-së janë analoge me veprat penale përkatëse sipas neneve 395, 396, 400 dhe 409 të KPK-së 2012.

⁴⁵ Neni 3(3) i Ligjit.

⁴⁶ *Shih* Vendimin e Apelit mbi Arrestimin dhe Paraburgimin e Gucatit, para. 11.

⁴⁷ Paneli i Apelit pati qasje të njëjtë në lidhje me Komentarin *Salihu dhe të tjerët. Shih* Aktgjykimin, para. 67.

A. KRITERET FORMALE NË LIDHJE ME APELET DHE HEDHJA POSHTË E MENJËHERSHME E TYRE

29. Paneli vë në dukje se vlerësimi prej Panelit i argumenteve të palëve varet nga paraqitja e argumenteve në mënyrë të qartë, të logjikshme dhe shteruese prej palëve.⁴⁸ Prej palës apeluese kërkohet që t'u referohet saktësisht paragrafëve përkatës në aktgjykimin e apeluar, ose faqeve të transkriptit në lidhje me të cilat është ngritur kundërshtim dhe jurisprudencës që citohet në mbështetje të tij.⁴⁹ Paneli i Apelit nuk do të shqyrtojë me hollësi parashtrimet e një pale nëse ato janë të paqarta, kundërthënëse, të vagullta ose kanë mangësi të tjera formale dhe të dukshme.⁵⁰ Një palë nuk mundet thjesht të përsërisë argumentet që ishin të pasuksesshme gjatë gjykimit, përveç nëse arrin të tregojë se rrëzimi nga Trupi Gjykses i këtyre argumenteve përbën gabim që përlligj ndërhyrjen e Panelit të Apelit.⁵¹

30. Paneli i Apelit mund të refuzojë shqyrtimin e pikave të ngritura në apel, të cilat nuk ishin përfshirë në njoftimet për apel.⁵² Në dosjen e apelit, pikat dhe argumentet e apelit paraqiten dhe numërtohen në të njëjtën renditje si në njoftimin për apel të

⁴⁸ *Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment*, para. 17; *Shih gjithashtu Stanišić and Simatović Appeal Judgment*, para. 21; Vendimin e Parë mbi Apelin në lidhje me Paraburgimin e Haradinajt, para. 28; Vendimin e Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 14; Vendimin mbi Apelin e Shalës në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, para. 7.

⁴⁹ Udhëzuesi i Punës për Parashtrimet, nenet 32(2), 47(1)(b)(2)-(3), 48(1)(b)(1)-(2). *Shih gjithashtu Udhëzuesin e Punës për Parashtrimet*, nenet 49(1)(b)(1)-(2). *Shih gjithashtu p.sh.*, Vendimin e Parë mbi Apelin në lidhje me Paraburgimin e Haradinajt, para. 29; Vendimin e Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 15; *Bemba et al. Appeal Judgment*, para. 109; *Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment*, para. 17; *Šešelj Appeal Judgment*, para. 28.

⁵⁰ *Shih p.sh.*, *Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment*, para. 17; *Šešelj Appeal Judgment*, para. 28. *Shih gjithashtu* Vendimin e Parë mbi Apelin në lidhje me Paraburgimin e Haradinajt, para. 28; Vendimin e Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 14; Vendimin mbi Apelin e Shalës në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, para. 7.

⁵¹ *Shih p.sh.*, *Fatuma et al. Appeal Judgment*, para. 18; *Bemba et al. Appeal Judgment*, para. 111; *Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment*, para. 17; *Šešelj Appeal Judgment*, para. 27; *Nshogoza Appeal Judgment*, para. 14. *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Apelin e Thaçit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, para. 60.

⁵² *Shih p.sh.*, *Marijačić and Rebić Appeal Judgment*, para. 18.

apeluesit, përveç kur ndryshohen me lejen e Panelit të Apelit.⁵³ Në parim, nëse nuk veprohet kështu, përligjet rrëzimi i menjëhershëm i tyre.

31. Paneli mund të rrëzojë menjëherë argumentet që nuk kanë gjasë të shkaktojnë prapësimin ose ndryshimin e vendimit të apeluar dhe nuk ka nevojë të shqyrtohen në lidhje me themelësinë.⁵⁴ Paneli i Apelit gëzon kompetencë diskrecionale në përzgjedhjen e parashtrimeve që meritojnë një arsyetim të hollësishëm me shkrim, dhe mund të hedhë poshtë argumente qartazi të pabaza pa dhënë arsyetim të hollësishëm.⁵⁵

32. Konkretisht, Paneli i Apelit vë në dukje se mund të rrëzohen menjëherë argumentet si në vijim:

- (i) argumente që nuk evidentojnë konstatimet faktike të apeluara, që shtrembërojnë konstatimet faktike ose provat, ose që shpërfillin konstatime faktike përkatëse të tjera;
- (ii) deklaratat që thjesht pretendojnë se dhoma gjyqësore me siguri nuk mori parasysh prova përkatëse, pa demonstruar se bazuar në prova asnjë gjykues i arsyeshem faktesh nuk do të kishte arritur në të njëjtin përfundim me dhomën gjyqësore;
- (iii) kundërshtime ndaj konstatimeve faktike që nuk janë bazë e një verdikti fajësie, dhe argumente që nuk kanë aspak lidhje, që mbështetin ose që nuk janë mospërputhëse me përfundimin e apeluar;
- (iv) argumente kundër mbështetjes ose mosmbështetjes prej dhomës gjyqësore në një provë konkrete, pa ofruar shpjegim se pse verdikti i fajësisë nuk duhet të qëndrojë bazuar në provat e tjera;
- (v) argumente kundër gjykimit të shëndoshë;

⁵³ Udhëzuesi i Punës për Parashtrimet, neni 48(2). *Shih gjithashtu* Vendimin *Boshkoski dhe Tarçulovski* në lidhje me Njoftimin e Apelit, para. 19.

⁵⁴ *Shih p.sh., Fatuma et al.* Appeal Judgment, para. 18; *Bemba et al.* Appeal Judgment, para. 110; *Al Jadeed and Al Khayat* Appeal Judgment, para. 18; *Šešelj* Appeal Judgment, para. 27; *Nshogoza* Appeal Judgment, para. 14.

⁵⁵ *Shih p.sh., Al Jadeed and Al Khayat* Appeal Judgment, para. 18; *Šešelj* Appeal Judgment, para. 29; *Nshogoza* Appeal Judgment, para. 14.

- (vi) kundërshtime ndaj konstatimeve faktike, ku relevanca e konstatimit faktik është e paqartë dhe nuk është shpjeguar nga pala apeluese;
- (vii) përsëritjet e argumenteve që rezultuan të pasuksesshëm në gjykim, pa ofruar shpjegim se rrëzimi i tyre nga dhoma gjyqësore përbënte gabim i cili përlligj ndërhyrjen e Panelit [të Apelit];
- (viii) akuza mbështetur në material që nuk është dokumentacionin gjyqësor;
- (ix) pretendime të pabazuara në ndonjë provë, pretendime të pashtjelluara, mospërshkrimi i gabimeve; dhe
- (x) pretendimet se dhoma gjyqësore nuk u dha peshën e duhur ose nuk interpretoi provat në një mënyrë të caktuar.⁵⁶

B. ARSYE TË KUFIZUARA PËR NDËRHYRJE TË APELIT

1. Mendimi i arsyetuar i Trupit Gjyqësues

33. Paneli vë në dukje se, nuk është e nevojshme që Trupi Gjyqësues të trajtojë të gjitha argumentet e ngritura nga palët ose çdo provë që ka lidhje me një konstatim konkret, për përmbushjen e detyrimit të vet për dhënie të mendimit të arsyetuar, në qoftë se ka paraqitur bazën e vendimit të vet me qartësi të mjaftueshme.⁵⁷ Merret si e mirëqenë se Trupi Gjyqësues i vlerësoi të gjitha provat e administruara, në qoftë se nuk ka ndonjë tregues se Trupi Gjyqësues ka shpërfillur krejtësisht prova konkrete; ky

⁵⁶ *Shih p.sh., Al Jadeed and Al Khayat Appeal Judgment*, para. 19; *Stanišić and Simatović Appeal Judgment*, para. 21; *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgment*, para. 35; *Ngirabatware Appeal Judgment*, para. 12. *Shih gjithashtu* Vendimin e Parë mbi Apelin në lidhje me Paraburgimin e Haradinajt, para. 29; Vendimin e Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 15; Vendimin mbi Apelin e Shalës në lidhje me Lirimën e Përkohshëm, para. 8; Vendimin mbi Apelet në lidhje me Juridiksionin në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 46; Vendimin mbi Apelin e Selimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, para. 21; Vendimin mbi Apelin e Haradinajt në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, para. 18, 27.

⁵⁷ *Bemba et al. Appeal Judgment*, para. 105. *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Apelin e Veselit në lidhje me Lirimën e Përkohshëm, para. 72; Vendimin mbi Apelet në lidhje me Juridiksionin në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 154.

supozim mund të hidhet poshtë në raste kur në arsyetimin e vet Trupi Gjykses nuk ka trajtuar prova që kanë qartësisht lidhje me konstatimet.⁵⁸

2. Kompetenca diskrecionale e Trupit Gjykses

34. Paneli i Apelit rikujton se vendimet mbi nxjerrje të materialit janë vendime diskrecionale në lidhje me të cilat duhet t'i japë përparësi Trupit Gjykses.⁵⁹

35. Paneli rikujton gjithashtu se vendimi për pranimin apo mospranimin e provave në përputhje me rregullën 138(1) të Rregullores, është vendim që përfshihet në kompetencën diskrecionale të Trupit Gjykses gjatë vlerësimit të relevancës për çështjen, të autenticitetit dhe vlerës provuese të provave të paraqitura.⁶⁰ Trupi Gjykses mund të refuzojë pranimin e provave nëse relevanca e tyre për çështjen nuk është provuar në mënyrë të arsyeshme.⁶¹ Për marrjen e vendimit mbi pranueshmërinë e provave, relevanca vlerësohet në bazë të faktit nëse provat e propozuara kanë të bëjnë me elementet e veprës (veprave) penale ose me formën (format) e përgjegjësisë penale të paraqitura në aktakuzë, ose me fakte dhe rrethana të tjera juridikisht thelbësore për provat dhe argumentet e palëve.⁶² Gjithashtu, sipas jurisprudencës tashmë të pranuar gjerësisht të tribunalëve penalë ndërkombëtarë, ndërhyrja e apelit për vendimet në lidhje me pranimin e provave përlligjet vetëm në rrethana shumë të kufizuara.⁶³

⁵⁸ *Bemba et al.* Appeal Judgment, para. 105.

⁵⁹ Vendimi mbi Apelet në lidhje me Nxjerrjen e Informacionit, para. 36.

⁶⁰ Vendimi mbi Apelin në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 14.

⁶¹ Vendimi i Apelit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 20, që i referohet Vendimit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 42-43; Vendimi për Provat Jogojore, para. 11, që citon, ndër të tjerë *Prlić et al.* Appeal Decision on Admission of Evidence, para. 17; *Bagosora et al.* Decision on Admission of Binder, para. 7; Rregullat 137(1) dhe 138(1) të Rregullores.

⁶² Vendimi i Apelit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 20, që i referohet Vendimit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 40-41, që nga ana e tij i referohet Vendimit për Provat Jogojore, para. 11-12. *Shih gjithashtu p.sh., Prlić et al.* Appeal Decision on Admission of Evidence, para. 17; *Ruto et al.* Confirmation Decision, para. 66; *Katanga and Ngudjolo* Bar Table Decision, para. 16.

⁶³ Vendimi i Apelit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 14, që i referohet *Simba* Appeal Judgment, para. 19; *Halilović* Appeal Judgment, para. 39; *Bagosora et al.* Appeal Decision on Exclusion of Evidence, para. 11.

36. Paneli rikujton gjithashtu se Trupi Gjykses ka për detyrë që të vlerësojë besueshmërinë e një dëshmitari, si dhe mbështetshmërinë në provat e paraqitura nga palët.⁶⁴ Në qoftë se dëshmia e një dëshmitari gjykohet e besueshme nuk ekziston kriter i përgjithshëm që kërkon që ajo të konfirmohet.⁶⁵

C. SIGURIA DHE PARASHIKUESHMËRIA JURIDIKE

37. Paneli vë në dukje se, në interes të sigurisë dhe parashikueshmërisë juridike, nga një panel i apelit pritet që t'u përmbahet vendimeve të veta të mëparshme dhe ai devijon nga ato vetëm për arsye bindëse në interes të drejtësisë.⁶⁶ Ky parim vlen dhe në lidhje me vendimet mbi apelet e ndërmjetme, që janë detyruese gjatë fazës së apelit të së njëjtës çështje gjyqësore si dhe për të gjitha aspektet mbi të cilat është vendosur në ato vendime, me qëllim parandalimin e "ridebatimit të pafund" nga palët të të njëjtave aspekte.⁶⁷

⁶⁴ *Popović et al.* Appeal Judgement, paras 131, 1228.

⁶⁵ *Ntaganda* Appeal Judgment, para. 782; *Milošević* Appeal Judgement, para. 215; *Ntawukulilyayo* Appeal Judgement, para. 21.

⁶⁶ Vendimi mbi Apelin e Shalës në lidhje me Juridiksionin, para. 15 dhe jurisprudenca që citohet aty.

⁶⁷ *Nyiramasuhuko et al.* Appeal Judgement, para. 127; *Mladić* Appeal Decision on Provisional Release, p. 2; *Kajelijeli* Appeal Judgement, paras 202-203. Sipas kësaj jurisprudence, kjo qasje përmbush gjithashtu qëllimin e lejimit të apeleve të ndërmjetme, që mundëson që disa aspekte të caktuara të zgjidhen përfundimisht para se të vazhdojë procesi. Ajo përcakton gjithashtu se kompetenca e brendaqenësishme e Panelit për rishikim të vendimeve të veta, pasi të jetë treguar qartësisht një gabim juridik, është përjashtim nga parimi i përgjithshëm.

IV. DISKUTIM

A. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME ASPEKTE TË GJYKIMIT TË DREJTË DHE TË PROVAVE

1. Pretendimet për gabime në lidhje me mosheqjen nga Trupi Gjykses të Kryegjykatësit të tij (Pika 2 e Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

38. Haradinaj parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që nuk hoqi Kryegjykatësin e Trupit Gjykses Çarls L. Smith, III (“Gjykatësi Smith”) nga procesi gjyqësor për arsye të anshmërisë.⁶⁸ Ai argumenton se është gabim që Kërkesa për Heqjen e Gjykatësit Smith, të cilën ai ia parashtrori Kryetares së Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), u hodh poshtë menjëherë,⁶⁹ ndonëse ishte faktuar siç duhet.⁷⁰

39. Haradinaj parashtron se vendimi i Kryetares për lejimin e pranisë së vazhdueshme të gjykatësit Smith në gjykim çoi në mungesë të paanshmërisë faktike ose të perceptuar, ishte gabim juridik dhe minoi sigurinë e verdiktit (verdikteve) të fajësisë së Haradinajt në tërësi.⁷¹

40. ZPS-ja përgjigjet se procedura për vetëtërheqje ose heqje të gjykatësve përcaktohet qartësisht në Rregullore⁷² dhe u respektua plotësisht nga Kryetarja, e cila

⁶⁸ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 40-47. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 9-10.

⁶⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 42-44, që i referohet Kërkesës për Heqjen e Gjykatësve. *Shih gjithashtu* Vendimin në lidhje me Heqjen e Gjykatësve, para. 34-36. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 73.

⁷⁰ Në lidhje me këtë, Haradinaj i referohet dëshmisë së dëshmitarit DW1250. *Shih* Kërkesën për Heqjen e Gjykatësve. Haradinaj u referohet gjithashtu një sërë mesazhesh elektronike (email) prej së paku dy ish-gjykatësve të tjerë të EULEX-it që ngritën shqetësime lidhur me gjykatësin Smith. *Shih* Kërkesën për Heqjen e Gjykatësve, para. 73. *Shih gjithashtu* Kërkesën për Rishikim të Vendimit në lidhje me Heqjen e Gjykatësve, para. 30.

⁷¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 46-47. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 10.

⁷² Rregulla 20(3)-(6) e Rregullores.

dy herë e rrëzoi menjëherë kërkesën e të akuzuarit sipas rregullës 20(3) të Rregullores.⁷³ ZPS-ja argumenton gjithashtu se, sipas rregullës 20(5) të Rregullores, apeluesi nuk mund të kërkojë ta ridebatojë këtë aspekt në fazën e apelit, dhe rrjedhimisht Pika 2 e Apelit të Haradinajt duhet rrëzuar *in limine*.⁷⁴ Gjithashtu, nëse Paneli vendos të trajtojë themelësinë e kësaj pike, ajo duhet rrëzohet.⁷⁵

41. Haradinaj kundërpërgjigjet se ai nuk kërkon të ridebatojë aspektet për të cilat tanimë është marrë vendim, sepse Vendimi në lidhje me Heqjen u mor para Aktgjykimit dhe rrjedhimisht u bazua në *gjasën* e anshmërisë.⁷⁶ Haradinaj argumenton se ai tani kërkon ndërhyrjen e Panelit, sepse ky rrezik u materializua.⁷⁷

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

42. Paneli përballet me kërkesën për rishikim të mëtejshëm të vendimit administrativ të lëshuar nga Kryetarja, e jo me një apel kundër gabimit të pretenduar të Trupit Gjykses në lëshimin e Aktgjykimit. Rrjedhimisht, Pika 2 e Apelit të Haradinajt nuk përfshihet brenda kuadrit të rishikimit prej Panelit.

43. Gjithashtu, Paneli vë në dukje se Haradinaj i dorëzoi Kryetares Kërkesën për Heqje në bazë të rregullës 20(3) të Rregullores,⁷⁸ dhe se Kryetarja vendosi ta hidhte poshtë atë.⁷⁹ Sikurse u theksua nga ZPS-ja, rregulla 20(5) e Rregullores nuk lejon rishikimin e një vendimi të nxjerrë në bazë të rregullës 20(3) të Rregullores, në këtë rast nga Kryetarja. Megjithatë, Haradinaj dorëzoi Kërkesën për Rishikim të Vendimit në lidhje me Heqjen, të cilën Kryetarja e rrëzoi gjithashtu.⁸⁰ Sipas Panelit, në Dosjen e Kundërpërgjigjes, Haradinaj përpiket të arsyetojë tentimin për kundërshtim të

⁷³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 19.

⁷⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 19.

⁷⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 20-22.

⁷⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 9, që i referohet Vendimit në lidhje me Heqjen e Gjykatësve, para. 16.

⁷⁷ Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 10.

⁷⁸ Kërkesa për Heqjen e Gjykatësve, para. 6, 30, 101(c). *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 73.

⁷⁹ Vendimi në lidhje me Heqjen e Gjykatësve, para. 34-36.

⁸⁰ *Shih* Vendimin mbi Rishikimin e Vendimit në lidhje me Heqjen e Gjykatësve, para. 21-22.

mëtejshëm të Vendimit në lidhje me Heqjen. Megjithatë, ky aspekt është shqyrtuar plotësisht dhe, sido që të jetë, nuk përfshihet në juridiksionin e Panelit. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 2 të Apelit të Haradinajt.

2. Pretendimet për gabime në lidhje me kryerjen e procesit gjyqësor dhe prezumimin e pafajësisë (Pika 1, pjesërisht, e Apelit të Haradinajt)

44. Fillimisht, Paneli vë në dukje se Haradinaj parashtron se Trupi Gjyqësor bëri gabim juridik që nuk respektoi parimet themelore të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, përfshirë barazinë e palëve, duke e favorizuar së tepërmi ZPS-në gjatë gjithë procesit gjyqësor.⁸¹ Konkretisht, Haradinaj pretendon se Trupi Gjyqësor shkeli parimin e barazisë së palëve duke “vendosur kufizime arbitrare dhe të papërligjura” gjatë paraqitjes së provave të tij.⁸² ZPS-ja përgjigjet se argumentet e Haradinajt duhen hedhur poshtë.⁸³

45. Paneli vëren se, në një pjesë të përgjithshme që pretendon shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, Haradinaj kundërshton në mënyrë fragmentare aspekte në lidhje me Aktgjykimin, vendime të mëparshme të Trupit Gjyqësor, ose zhvillimin në përgjithësi të procesit gjyqësor, pa demonstruar gabim juridik ose faktik.⁸⁴ Për këtë arsye, përligjet rrëzimi i menjëhershëm i pjesës më të madhe të Pikës 1 të Apelit të Haradinajt. Megjithatë, për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit, Paneli ka vendosur që të trajtojë Pikën 1 të Apelit të Haradinajt.

46. Paneli vë në dukje se disa argumente të ngritura nga Haradinaj kanë të bëjnë me pika të tjera të apelit, ose i përsërisin ato, dhe rrjedhimisht janë trajtuar në pjesë të

⁸¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 27. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 72, 74-75, 77.

⁸² Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 28-39. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 5-8. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 104.

⁸³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 8-18.

⁸⁴ Paneli vë në dukje se në lidhje me këtë Haradinaj pranon se: “Pika 1 e Apelit është pikë gjithëpërfshirëse e apelit që trajton drejtësinë e përgjithshme të procesit, barazinë e palëve, mosnxjerrjen e materialit dhe kufizimet shproporcionale dhe krejtësisht të panevojshme të vendosura për Mbrojtjen gjatë paraqitjes së provave të veta.” *Shih* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 5 (theksimi i shtuar).

tjera të këtij Aktgjykimi. Kjo vlen në lidhje me pretendimet e Haradinajt se: (i) ZPS-ja pati qasje shproporcionale në tërësinë e provave;⁸⁵ (ii) Trupi Gjykses nuk e lejoi që t'i referohej informacionit lidhur me bashkëpunimin e ZPS-së me Serbinë, edhe pse ky informacion ishte thelbësor për argumentet mbrojtëse të tij për sinjalizim dhe interes publik;⁸⁶ dhe (iii) Trupi Gjykses kufizoi në mënyrë të papërshtatshme dëshmi ekspertësh që ai kërkoi t'i paraqiste.⁸⁷

47. Paneli do të kryejë vlerësimin e argumenteve të tjera si në vijim: (i) kundërshtimet ndaj qasjes së Trupit Gjykses në lidhje me provat e parashtruara nga palët;⁸⁸ dhe (ii) pretendimin për shkelje të prezumimit të pafajësisë nga ZPS-ja.⁸⁹

(a) Kundërshtime ndaj qasjes së Trupit Gjykses në lidhje me prova të parashtruara nga palët

(i) Parashtrimet e palëve

48. Haradinaj argumenton se Trupi Gjykses nuk respektoi parimin e barazisë së palëve duke vendosur kufizime arbitrare dhe të papërligjura gjatë paraqitjes së provave të të akuzuarit.⁹⁰ Në mbështetje të këtij pretendimi, Haradinaj argumenton se Trupi Gjykses bëri gabim që: (i) nuk pati qasje përputhëse për pranimin e provave nga palët në lidhje me ngjarje historike, duke e lejuar ZPS-në që t'i referohej kontekstit historik të konfliktit në Kosovë, kurse Mbrojtja nuk u lejua;⁹¹ (ii) gjatë marrjes në pyetje prej palës kundërshtare, lejoi ZPS-në të dilte jashtë kuadrit të marrjes në pyetje prej saj

⁸⁵ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 33, 34(v). *Shih më poshtë*, para. 65-73. Megjithatë, Paneli konstaton se poshtëshënimi 28 i bashkëngjitur paragrafit 33 në Dosjen e Apelit të Haradinajt nuk duket se mbështet pretendimin se ZPS-së iu dha qasje shproporcionale në provat në tërësi. Shih Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 33, poshtëshënimi 28 (që i referohet Aktgjykimit, para. 7-10 lidhur me akuzat dhe format e përgjegjësisë penale, para. 14-15 lidhur me pretendimet për personat kundër të cilëve nuk janë ngritur akuza, dhe para. 22-25 lidhur me pranueshmërinë e provave).

⁸⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 34(b). *Shih më poshtë*, para. 321-340, 347-349. *Shih gjithashtu më poshtë*, para. 379-382.

⁸⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 34(d). *Shih më poshtë*, para. 93-97.

⁸⁸ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 28-33, 34(a), (c), 38-39.

⁸⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 35-37.

⁹⁰ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 28-33.

⁹¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 34(a).

të të akuzuarit dhe të dëshmitarit z. Robert Rid (dëshmitari DW1253) (“z. Rid”);⁹² dhe (iii) lejoi ZPS-në të bënte “fjalime *pothuaj* politike” të pambështetura në prova përkatëse, ndërsa Haradinaj hasi në kufizime në lidhje me referencat që i lejoheshin atij.⁹³

49. ZPS-ja përgjigjet se Pika 1 e Apelit të Haradinajt duhet rrëzuar *in limine*.⁹⁴ ZPS-ja parashtron se Haradinaj nuk arrin të evidentojë mospërputhje ose gabim në qasjen e Trupit Gjykses në lidhje me trajtimin e provave për ngjarjet historike.⁹⁵ Sipas ZPS-së, Trupi Gjykses shpjegoi qartësisht se si i trajtoi provat e kryerjes së krimeve gjatë luftës në vitet 1998-1999.⁹⁶ ZPS-ja parashtron gjithashtu se marrja në pyetje e të akuzuarit dhe e z. Rid ishte relevante dhe argumentet e Haradinajt në lidhje me rregullën 143(3) të Rregullores përbëjnë ankesë të pabazuar dhe të paarsyetuar.⁹⁷

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

50. E drejta për gjykim të drejtë që garanton neni 21 i Ligjit mbulon parimin e barazisë së palëve midis prokurorit dhe të akuzuarit gjatë gjykimit penal, që përbën thelbin e garancisë së gjykimit të drejtë. Ky parim mishëron detyrimin për të garantuar që asnjë palë të mos jetë në pozitë të pafavorshme gjatë paraqitjes së provave të veta.⁹⁸ Paneli vëren se, në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ky parim është përshkruar se “nënkupton që secilës palë t’i jepet mundësi e arsyeshme për parashtrimin e

⁹² Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 34(c).

⁹³ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 38.

⁹⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 8-10.

⁹⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 12. *Shih* Aktgjykimin, para. 30-32. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 157-158.

⁹⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 12.

⁹⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 14.

⁹⁸ *Tadić* Appeal Judgment, para. 44, 48, 50, 52. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 28-30; *Kordić and Čerkez* Appeal Judgment, para. 175; *Kayishema and Ruzindana* Appeal Judgment, para. 69.

argumenteve të veta – përfshirë të provave të veta – në kushte të cilat nuk e vënë në një situatë mjaft të pafavorshme në raport me kundërshtarin e vet”.⁹⁹

51. Sa u takon provave lidhur me ngjarje historike, Trupi Gjykses shpjegoi qëndrimin e vet kur lejoi paraqitjen ose pranimin e provave lidhur me kryerjen e krimeve gjatë luftës në vitet 1998-1999.¹⁰⁰ Në asnjë nga transkriptet të cilave u referohet Haradinaj në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk del se ai u vu në pozitë të pafavorshme kundrejt ZPS-së në lidhje me trajtimin e këtyre provave.¹⁰¹ Sikurse u theksua nga ZPS-ja, llojet e pyetjeve që u bënë nga ZPS-ja dhe Mbrojtja në të dy transkriptet të cilave u referohet Haradinaj nuk janë të krahasueshme.¹⁰² Paneli vë në dukje gjithashtu se, pas kundërshtimeve të ngritura, mbrojtësi i specializuar pati mundësinë t’i qartësonte llojet e pyetjeve të tij.¹⁰³

52. Në lidhje me marrjen në pyetje të Haradinajt dhe të z. Rid, i akuzuari nuk arrin të provojë se ZPS-ja “u lejua të dilte jashtë kuadrit të marrjes në pyetje”.¹⁰⁴ Paneli vë në dukje se qëllimi i referimeve të Haradinajt nga transkripti nuk është i qartë, sepse

⁹⁹ *Dombo Beheer B.V.* Judgment, para. 33. Paneli vë në dukje se ndonëse ky ishte proces civil, GjEDNJ-ja vlerësoi nëse parimi i barazisë së palëve që pranohet për proceset penale duhet zbatuar edhe për proceset civile. *Shih gjithashtu Kaufman Decision*, p. 115; *Delcourt Judgment*, para. 34.

¹⁰⁰ Aktgjykimi, para. 30-32.

¹⁰¹ KSC-BC-2020-07, Transkripti, 12 janar 2022, f. 2903, rreshtat 11-25, f. 2904, rreshtat 1-7; KSC-BC-2020-07, Transkripti, 14 janar 2022, f. 3039-3043.

¹⁰² *Krahaso* KSC-BC-2020-07, Transkripti, 12 janar 2022, f. 2903, rreshtat 11-25, f. 2904, rreshtat 1-7 (ku Kryegjykatësi hodhi poshtë një kundërshtim lidhur me relevancën ngritur nga Mbrojtja gjatë marrjes në pyetje të të akuzuarit nga ZPS-ja, në lidhje me një pretendim të bërë gjatë dëshmisë së tij për krimet e kryera nga anëtarë të UÇK-së gjatë luftës në vitet 1998-1999) *me* KSC-BC-2020-07, Transkripti, 14 janar 2022, f. 3039-3043 (ku Kryegjykatësi miratoi kundërshtimin e ZPS-së kur Mbrojtja u përpoq të bënte një sërë pyetjesh për të vërtetuar se disa serbë të caktuar kryen krime gjatë konfliktit në Kosovë – një aspekt i marrjes sërish në pyetje që dilte jashtë kuadrit të marrjes në pyetje). *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 12.

¹⁰³ KSC-BC-2020-07, Transkripti, 14 janar 2022, f. 3040-3042. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 12.

¹⁰⁴ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 34(c).

mungojnë shpjegimet që mbështesin pretendimin e Haradinajt dhe përpjekjet për të provuar gabime të Trupit Gjykses gjatë kryerjes së procesit gjyqësor.¹⁰⁵

53. Rrjedhimisht, kjo pjesë e Pikës 1 të Apelit të Haradinajt rrëzohet.

(b) Pretendimi për shkelje të prezumimit të pafajësisë nga ZPS-ja

(i) Parashtrimet e palëve

54. Haradinaj parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që nuk respektoi dhe zbatoi standardet e pranuar ndërkombëtarisht në lidhje me prezumimin e pafajësisë, që ndalojnë autoritetet publike të bëjnë deklarata që i referohen fajësisë së një personi, përveç nëse fajësia është vërtetuar sipas ligjit.¹⁰⁶ Haradinaj i referohet konkretisht një deklaratë të ZPS-së në seancë të hapur, ku u tha se fajësia e të akuzuarit ishte “vërtetuar”.¹⁰⁷

55. ZPS-ja përgjigjet se nuk ka asgjë që tregon se mënyra se si formuloi parashtrimet gojore ishte në kundërshtim me prezumimin e pafajësisë së Haradinajt, dhe kujton se Trupi Gjykses i hodhi poshtë kundërshtimet e Mbrojtjes për këto parashtrime.¹⁰⁸

¹⁰⁵ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 34(c), poshtëshënimi 33, që i referohet KSC-BC-2020-07, Transkripti, 12 janar 2022, f. 2903, rreshtat 11-25, f. 2904, rreshtat 1-7; KSC-BC-2020-07, Transkripti, 24 janar 2022, f. 3304-3313. Në transkriptin e parë (*shih më lart*, poshtëshënimi 102), Kryegjykatësi i Trupit Gjykses hodhi poshtë kundërshtimin e ngritur prej mbrojtësit të Haradinajt për relevancën e pyetjeve të ZPS-së në lidhje me pretendimin që Haradinaj bëri gjatë dhënies së dëshmisë së tij për krimet e kryera nga anëtarë të UÇK-së gjatë luftës së viteve 1998-1999. Në transkriptin e dytë, mbrojtësi i Haradinajt kundërshtoi vazhdimisht pyetjet e ZPS-së drejtuar dëshmitarit ekspert në lidhje me përvojën e tij në çështjet gjyqësore për Kosovën dhe frikësimin e dëshmitarëve në këto çështje gjyqësore, se ato ishin jashtë kuadrit të Aktakuzës. Kryegjykatësi i Trupit Gjykses hodhi poshtë kundërshtimet e Haradinajt dhe i gjykoi kyçe për këtë proces gjyqësor pyetjet e ZPS-së në lidhje me frikësimin e dëshmitarëve.

¹⁰⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 35, që i referohet Direktivës së BE-së për Prezumimin e Pafajësisë, neni 4. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 36-37, 39; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 4.

¹⁰⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 36-37, që i referohet KSC-BC-2020-07, Transkripti, 17 mars 2022, f. 3771; *Ramos Nunes de Carvalho e Sá* Judgment, para. 145. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 28-30; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 210.

¹⁰⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 17, që i referohet KSC-BC-2020-07, Transkripti, 17 mars 2022, f. 3771. ZPS-ja parashtron gjithashtu se jurisprudenca së cilës i referohet Haradinaj është “lehtësisht e

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

56. Paneli konstaton se prezumimi i pafajësisë nuk e detyron ZPS-në që të mos shprehë mendim, së paku në seancat gjyqësore, në lidhje me provat e administruara në mbështetje të fajësisë ose të pafajësisë së të akuzuarit.¹⁰⁹ Gjithashtu, prezumimi i pafajësisë nuk e pengon ZPS-në që të informojë publikun lidhur me hetime penale në kryerje e sipër, por kërkon nga ajo që, në deklaratat publike, të mos e paragjykojë rezultatin e gjykimit.¹¹⁰ Në këtë aspekt, GJEDNJ-ja bën dallimin midis deklaratave që përshkruajnë dyshime dhe deklaratave për fajësi.¹¹¹ Gjithashtu, kur shqyrtohet nëse një deklaratë publike e ZPS-së shkel parimin e prezumimit të pafajësisë, vendimi për të duhet marrë “në kontekst të rrethanave përkatëse në të cilat është bërë deklaratat që kundërshtohet”.¹¹²

57. Në lidhje me këtë, Paneli konstaton se Haradinaj shtrembëron deklaratat e cituara të ZPS-së. Gjatë seancës së deklaratave përmbyllëse të 17 marsit 2022, ZPS-ja iu drejtua Trupit Gjykes lidhur me çfarë konsideronte dënim të përshtatshëm për të akuzuarit në atë çështje gjyqësore.¹¹³ Ishte në atë kontekst që, kur iu referua përpjekjeve të ZPS-së për të vërtetuar fajësinë e të akuzuarit gjatë fazës së gjykimit –

dallueshme” nga rrethanat e procesit aktual dhe se Direktiva e BE-së për Prezumimin e Pafajësisë nuk është e zbatueshme në Dhomat e Specializuara dhe nuk mbështet pretendimin e tij. *Shih* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 18.

¹⁰⁹ *Gaddafi and Al-Senussi* Decision on Disqualification, para. 25.

¹¹⁰ Gjithashtu, Paneli vë në dukje se në kodet e etikës dhe standardet e ndjekjes penale në tribunalët ndërkombëtarë parashtrahet se një prokuror nuk duhet të shprehë mendim në lidhje me fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit, jashtë procesit gjyqësor. *Shih Gaddafi and Al-Senussi* Decision on Disqualification, para. 28, që citon, ndër të tjera, SCSL Code of Professional Conduct for Counsel, Article 24(A); *Sesay* Decision on Counsel Code of Conduct, paras 31-33 (ku konstatohet se Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit i GJSSL-së vlen edhe për Prokurorin); ICTY and ICTR Code of Professional Conduct for Prosecution Counsel, para. 2(k).

¹¹¹ *Shih Gaddafi and Al-Senussi* Decision on Disqualification, paras 26-28, që citon, ndër të tjerë, *Allenet de Ribemont* Judgment, paras 38-41; *Butkevičius* Judgment, paras 26-30, 49-54; *Fatullayev* Judgment, paras 36-37, 157-163.

¹¹² *Daktaras* Judgment, para. 43; *Butkevičius* Judgment, para. 49; *Karakaş and Yeşilirmak* Judgment, para. 51; *Fatullayev* Judgment, para. 160; *Filat* Judgment, para. 46; *Gaddafi and Al-Senussi* Decision on Disqualification, para. 28.

¹¹³ *Shih* KSC-BC-2020-07, Transkripti, 17 mars 2022, f. 3751, rreshtat 14-18.

me parashtrime dhe paraqitje të provave – ZPS-ja bëri deklaratën që kundërshtohet në lidhje me provat e paraqitura gjatë fazës së gjykimit.¹¹⁴

58. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Haradinaj nuk arrin të provojë se Trupi Gjykues bëri gabim juridik për sa i përket prezumimit të pafajësisë. Rrjedhimisht, kjo pjesë e Pikës 1 të Apelit të Haradinajt rrëzohet.

3. Pretendimet për gabime në lidhje me vendimin e Trupit Gjykues mbi mosnxjerrjen dhe/ose redaktimet e materialit (Pikat 2 (A), pjesërisht, 4 (H) pjesërisht, të Apelit të Gucatit; Pikat 1, pjesërisht, 4, 10, 16, 17 të Apelit të Haradinajt)

59. Gucati dhe Haradinaj kundërshtojnë vendimin e Trupit Gjykues për mosnxjerrjen dhe/ose redaktimin e disa materialeve që përmbanin Paketat.¹¹⁵ Gjithashtu, Haradinaj kundërshton vendimin e Trupit Gjykues mbi: (i) mosnxjerrjen dhe/ose redaktimin e materialit që lidhet me pretendimet e tij për shtytje për kryerje të veprës penale;¹¹⁶ dhe (ii) mosnxjerrje të materialit në lidhje me pretendimet e z. Dik Marti (“z. Marti”) se autoritetet serbe ishin përgjegjëse për kërcënime ndaj jetës së tij, me qëllim implikimin në mënyrë të rreme të shqiptarëve kosovarë.¹¹⁷ ZPS-ja përgjigjet se pikat përkatëse të apeleve të të akuzuarve duhen rrëzuar.¹¹⁸

¹¹⁴ *Shih* KSC-BC-2020-07, Transkripti, 17 mars 2022, f. 3771, rreshtat 17-20.

¹¹⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 60-79, 90-95, 199-200, 202; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 27-30, 33, 34(v), 39, 55-67; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 3-5; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 3-8, 12-14.

¹¹⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 156-161, 162-172; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 40-45.

¹¹⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 115-126; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 30-31.

¹¹⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 8-10, 16, 23-36, 44-46, 155-161.

(a) Përmbajtja e Paketave (Pikat 2(A), pjesërisht, 4(H) pjesërisht, të Apelit të Gucatit; Pikat 1, pjesërisht, 4 të Apelit të Haradinajt)

(i) Parashtrimet e palëve

60. Të akuzuarit parashtrojnë se Trupi Gjykses bëri gabim që e lejoi ZPS-në të mos nxirrte disa materiale që përmbanin Paketat, kështu që as Trupi Gjykses, as Mbrojtja, nuk patën mundësinë të gjykonin nëse klasifikimi konfidencial i secilit dokument ishte përcaktuar siç duhej.¹¹⁹ Ata argumentojnë gjithashtu se, në kundërshtim me Ligjin dhe me Rregulloren, Trupi Gjykses nuk mori parasysh dëmin e rëndë që iu shkaktua nga mosnxjerrja dhe/ose redaktimet e tepruara prej ZPS-së dhe nuk siguroi përfshirjen e faktorëve kompensues për të trajtuar këtë dëm, ose më së paku që vetë Trupi Gjykses të kishte një pasqyrë të atyre provave.¹²⁰ Sipas të akuzuarve, kjo qasje u mohoi atyre mundësinë e parashtrimeve dhe të paraqitjes së provave në një mënyrë që garanton gjykim të drejtë.¹²¹ Të dy të akuzuarit argumentojnë gjithashtu se, në kontekstin e mosnxjerrjes së materialit dhe në qoftë se asnjë masë nuk do të garantonte gjykim të drejtë, ZPS-ja duhej ta kishte tërhequr Aktakuzën ose t'i kishte kufizuar akuzat e veta në pjesët e Paketave që u pranuan si prova.¹²²

61. Gjithashtu, Gucati parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim që nuk pranoi përjashtimin e dëshmisë së znj. Zdenka Pumper (dëshmitarja W04841) ("znoj.

¹¹⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 73, 75-76, 199-200; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 33, 34(v), 55, 57-59, 62; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 52, 77-78, 80-81, 103-104. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 47, 79 (që parashtron se për Mbrojtjen nuk u nxor pjesa kryesore e Paketave 1 dhe 3 dhe e vetmja pjesë e Paketës 2 që u shqyrtua); Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 198. Sipas Haradinajt, kjo mosnxjerrje e informacionit ishte e konsiderueshme jo vetëm për shkak se konfidencialiteti i pretenduar i informacionit ishte element i qenësishëm i krimeve në lidhje me të cilat u shpall fajësia, por edhe sepse në raste të shumta nuk kishte lidhje midis çfarë thanë dëshmitarët e ZPS-së dhe çfarë u provua përfundimisht se ishte. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 60-61.

¹²⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 78; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 64, 67; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 52, 75-76, 80.

¹²¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 74; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 56, 63-64, 66; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 77, 79; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 177-179, 195, 197. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 94; Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 27-30, 39.

¹²² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 93; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 65; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 179.

Pumper”) lidhur me përmbajtjen e Paketave që nuk u nxor nga ZPS-ja.¹²³ Gucati argumenton se një hetues i Prokurorisë, sikurse znj. Pumper, nuk gëzon të drejtën për të “paraqitur mendime dhe të arrijë në përfundime” për dokumentet, ose të bëjë përmbledhje të përmbajtjes së dokumenteve që hetuesi i ka shqyrtuar në kontekst të punësimit të vet nga ajo palë, dhe se në këto rrethana, hetuesi mund të dëshmojë vetëm si dëshmitar për fakte lidhur me prejardhjen ose kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të atyre dokumenteve.¹²⁴ Gucati parashton gjithashtu se Trupi Gjykses bëri gabim që u mbështet në përmbledhjen e materialit përkatës nga znj. Pumper pa pasur mundësinë e një vlerësimi të pavarur.¹²⁵ Sipas Gucatit, Trupi Gjykses duhej ta kishte përjashtuar dëshminë “me efekt tejet dëmtues” të znj. Pumper, në bazë të rregullës 138(1)-(3) të Rregullores, që autorizon Trupin Gjykses të përjashtojë prova relevante kur vlera e tyre provuese zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.¹²⁶

62. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykses nuk i pranoi si prova pjesët e panxjerra të Paketave e as nuk u mbështet në to dhe për këtë arsye nuk mund të ketë shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë.¹²⁷ ZPS-ja parashton gjithashtu se arsyet për të mos i nxjerrë plotësisht Paketat janë të pakundërshtueshme dhe në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.¹²⁸ ZPS-ja parashton gjithashtu se Trupi Gjykses nuk kishte nevojë

¹²³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 60. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 90-92.

¹²⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 62-64, 70-72; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 51-52.

¹²⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 65-68, 70, 76-77. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 49-51.

¹²⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 61, 77-79, 95. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 4; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 184. Paneli vë në dukje se në paragrafin 79, poshtëshënimin 48 të Dosjes së Apelit, Gucati nuk përmend se cilit vendim i referohet konkretisht, gjegjësisht Vendimit mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra.

¹²⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 25-26, 30; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 158. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 24 (ku parashtrohet se argumentet e Mbrojtjes në thelb përbëjnë pretendim për keqpërdorim të kompetencës diskrecionale në lidhje me të cilën i jepet përparësi vlerësimit të Trupit Gjykses).

¹²⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 23, 28-29, 31-33, që i referohet, ndër të tjera, *M. v. The Netherlands Judgment*, para. 70-71; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 125, 162, 164.

për (më shumë) faqe nga Paketat për konstatimet e veta dhe thekson se Mbrojtja as që kërkoi leje për apelim të vendimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në të cilat u urdhërua mosnxjerrja e tyre.¹²⁹ Sipas ZPS-së, të akuzuarit nuk arritën të provonin gabim dhe argumentet e tyre përbëjnë thjesht mospajtime me konstatimet e Trupit Gjykses.¹³⁰ ZPS-ja argumenton se alternativat e propozuara nga të akuzuarit do të kishin rezultuar në gabim gjyqësor.¹³¹ ZPS-ja parashtron gjithashtu se Trupi Gjykses u mbështet në një sërë provash të ndryshme, të qasshme dhe të verifikuara nga të dyja palët, për të vërtetuar përmbajtjen dhe konfidencialitetin e Paketave, përfshirë tabelat e znj. Pumper, të cilat ofrojnë informacion të verifikuar gjatë marrjes në pyetje nga pala kundërshtare dhe ishin në vetvete një nga masat gjyqësore të urdhëruara si kompensim për mosnxjerrjen e materialit.¹³²

63. Gucati kundërpërgjigjet se çështja gjyqësore e GJEDNJ-së të cilës i referohet ZPS-ja në mbështetje të nxjerrjes së pjeshme të Paketave dallon nga çështja gjyqësore aktuale, ndër të tjera, për arsye se ankesa në atë çështje lidhej pjesërisht me mosnxjerrje të materialit që prokuroria nuk e kishte në posedim dhe informacioni i redaktuar mund të kishte qenë i padobishëm për mbrojtjen, ndërsa në çështjen aktuale, dokumentet që kundërshtohen ishin objekt i nxjerrjes së materialit sipas rregullave 102(3) ose 103 të Rregullores.¹³³ Gucati parashtron gjithashtu se, ai nuk kërkoi leje

¹²⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 27; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 161. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 125-126 (ku parashtrohet se problemi në lidhje me përmbajtjen e Paketave është nëse ato (i) kanë të bëjnë me hetime të ZPS-së, (ii) ishin konfidenciale, dhe (iii) përmbajnë emra të dëshmitarëve të mbrojtur, dhe këto fakte mund të vërtetohen në bazë të faqeve të nxjerra) dhe f. 159-160 (ku parashtrohet se tërësia e Paketës 2 ishte nxjerrë me redaktime minimale dhe se gjithashtu u nxor një numër i caktuar i faqeve të Paketave të mbetura).

¹³⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 8, 10, 16, 32, 36. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 9, 35 (ku argumentohet se një sërë vendimesh procedurale të pafavorshme për Mbrojtjen nuk është e njëjta gjë si njëanësia dhe se drejtësia e procesit në lidhje me mosnxjerrjen e materialit u konfirmua si nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ashtu edhe nga Trupi Gjykses).

¹³¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 23, 36.

¹³² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 26-27, 34. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 30; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 158-161.

¹³³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 5, që i referohet *M. v. The Netherlands Judgment*, para. 3, 68-70.

për apelim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi mosnxjerrjen, sepse padrejtësia nuk lindi nga mosnxjerrja, por nga vendimi i Trupit Gjykses për lejim të ZPS-së që të paraqiste prova në lidhje me përmbajtjen e materialit të panxjerrë.¹³⁴

64. Haradinaj kundërpërgjigjet se ZPS-ja i shtrembëron parashtrimet e tij dhe nuk trajton thelbin e tyre, sepse thjesht ekzistenca e procedurave dhe garancive nuk garanton që procedurat të kryhen në mënyrë të drejtë.¹³⁵ Haradinaj parashtron se, edhe në qoftë se Paketat nuk ishin prova, ato ishin kyçe për akuzat dhe secila prej akuzave të Aktakuzës u bazua në thelbin e përmbajtjes së tyre.¹³⁶

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

65. Paneli vëren se mosnxjerrja e dokumenteve që përbën bazën e këtyre pikave të apelit kundër Aktgjykimit u urdhërua nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, gjatë fazës së procedurës paraprake. Në këtë kontekst, Paneli vë në dukje konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se faqet e panxjerra të Paketave 1 dhe 2 nuk janë objekt i rregullës 102(1)(b)(iii) të Rregullores, duke pasur parasysh se ZPS-ja nuk synonte t'i paraqiste gjatë gjykimit, por janë objekt i nxjerrjes së materialit sipas rregullave 102(3) dhe/ose 103 të Rregullores.¹³⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi gjithashtu se faqet e panxjerra të Paketës 4, që përkojnë deri në njëfarë mase me përmbajtjen e Paketës 1, ishin objekt i nxjerrjes sipas rregullave 102(3) dhe/ose 103 të Rregullores.¹³⁸ Paneli vë në dukje gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrtoi dokumentet e panxjerra në Paketat 1, 2, dhe 4¹³⁹ dhe vendosi që mosnxjerrja e përmbajtjes së panxjerrë ishte rreptësisht e domosdoshme mbi bazën se: (i) ekzistonte rreziku, duke marrë parasysh deklaratat e të akuzuarve, se ata mund të

¹³⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 3.

¹³⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 4-7.

¹³⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 12-14.

¹³⁷ Vendimi në lidhje me Paketat 1-3, para. 29, 31.

¹³⁸ Vendimi mbi Mosnxjerrjen e Informacionit, para. 14, 16-17.

¹³⁹ Vendimi në lidhje me Paketat 1-3, para. 30; Vendimi mbi Mosnxjerrjen e Informacionit, para. 14.

tentonin ta shpërndanin atë, duke dëmtuar kështu hetime aktuale dhe të ardhshme dhe duke rrezikuar rëndë sigurinë e dëshmitarëve (të mundshëm) ose të anëtarëve të familjes së tyre; (ii) dëmi i shkaktuar ndaj hetimeve aktuale ose të ardhshme do të ishte në kundërshtim me interesin publik në përmbushjen e mandatit të Dhomave të Specializuara, ndër të tjera, përmes hetimeve dhe ndjekjeve penale efektive të krimeve dhe veprave penale nën juridiksionin e vet; dhe (iii) shpërndarja e tyre a paautorizuar do të ishte në kundërshtim me të drejtat e palëve të treta.¹⁴⁰ Sa i përket Paketës 3, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ajo nuk ishte objekt i nxjerrjes, duke qenë se: (i) nuk përfshihet në rregullën 102(1)(b)(iii) të Rregullores; (ii) përbën produkt të punës së brendshme të ZPS-së dhe rrjedhimisht përfshihet në rregullën 106 të Rregullores; dhe (iii) nuk është objekt i nxjerrjes sipas rregullës 103 të Rregullores.¹⁴¹

66. Paneli vë në dukje gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se deklaratat dhe dëshmia e znj. Pumper ishin masa kompensuese të përshtatshme lidhur me mosnxjerrjen e Paketave 1, 2 dhe 4,¹⁴² dhe se masat kompensuese nuk ishin të domosdoshme për Paketën 3.¹⁴³ Megjithatë, si masë kompensuese lidhur me mosnxjerrjen e pjesëve të caktuara të të gjitha Paketave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi që ZPS-ja të dorëzonte tabela me, ndër të tjera, tregues të konfidencialitetit të dokumenteve, përfshirë ku ishte e mundur pamje të tyre të fotografuara nga ekrani, dhe informacion nëse ato përmbanin emrat e dëshmitarëve (të mundshëm).¹⁴⁴ Pasi dëgjoji dëshminë e znj. Pumper, Trupi Gjykues konstatoi të

¹⁴⁰ Vendimi në lidhje me Paketat 1-3, para. 34-36, 38; Vendimi mbi Mosnxjerrjen e Informacionit, para. 20-22.

¹⁴¹ Vendimi në lidhje me Paketat 1-3, para. 43-44.

¹⁴² Vendimi në lidhje me Paketat 1-3, para. 39; Vendimi mbi Mosnxjerrjen e Informacionit, para. 23.

¹⁴³ Vendimi në lidhje me Paketat 1-3, para. 45.

¹⁴⁴ Vendimi në lidhje me Paketat 1-3, para. 39-40, 45; Vendimi mbi Mosnxjerrjen e Informacionit, para. 23-24.

pranueshme sipas rregullës 138(1) të Rregullores, ndër të tjera, deklaratat e znj. Pumper,¹⁴⁵ si dhe pjesët e Paketave për të cilat ajo dëshmoi se ishin autentike.¹⁴⁶

67. Sipas rregullës 108(1) të Rregullores, ZPS-ja mund t'i bëjë kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* Trupit Gjykues për mosnxjerrje të informacionit në tërësi ose pjesërisht, kur ky informacion që ajo ka nën ruajtje, nën kontroll apo në dijeninë e vet faktike është objekt i rregullës 102 ose rregullës 103 të Rregullores, por kur nxjerrja e tij mund të dëmtojë hetime aktuale ose të ardhshme, të rrezikojë rëndë sigurinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në proces ose të anëtarëve të familjeve të tyre, ose të jetë në kundërshtim me arsye të tjera të interesit publik ose me të drejta të palëve të treta. Gjithashtu, rregulla 108(4) e Rregullores përcakton se Trupi Gjykues mund të urdhërojë marrjen e masave të përshtatshme kompensuese dhe se, në qoftë se sipas mendimit të tij asnjë masë nuk do të garantonte të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë, ZPS-së i jepet mundësia që ose ta nxjerrë informacionin, ose t'i ndryshojë apo t'i tërheqë akuzat me të cilat lidhet informacioni.

68. Megjithëse Paneli pranon se dokumentet që përmbanin Paketat përbëjnë bazën e fakteve mbi të cilat bazohen akuzat kundër të akuzuarve, ato nuk janë relevante nga përmbajtja, por vetëm nga konfidencialiteti.¹⁴⁷ Në kuadër të akuzave kundër të akuzuarve, mjafton që vetëm një dokument që përmbanin Paketat të ishte konstatuar konfidencial dhe Trupi Gjykues nuk kishte nevojë të vërtetonte se të gjitha dokumentet që përmbanin Paketat ishin konfidenciale. Në lidhje me këtë, Paneli vë në dukje se Trupi Gjykues konstatoi se të akuzuarit i shpërndanë dokumentet gjerësisht, pa i mbrojtur, edhe pse ishin të vetëdijshëm se ishin konfidenciale.¹⁴⁸ Gjithashtu, sikurse konfirmuan znj. Pumper dhe z. Rid, në praktikë, i gjithë materiali

¹⁴⁵ Vendimi mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra, para. 14. Trupi Gjykues i konstatoi dhe këto dokumente të pranueshme sipas rregullës 154 të Rregullores.

¹⁴⁶ Vendimi mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra, para. 19, 33, 38.

¹⁴⁷ *Shih* Vendimin në lidhje me Paketat 1-3, para. 30. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 424.

¹⁴⁸ *Shih p.sh.*, Aktgjykimin, para. 562-564.

që është pjesë e hetimeve të papërfunduara penale konsiderohet konfidencial.¹⁴⁹ Duke qenë se dokumentet që përmbanin Paketat përbënin pjesë të hetimeve të papërfunduara të ZPS-së dhe lidheshin me çështjen gjyqësore aktuale, Paneli, vetëm në bazë të kësaj karakteristike, konstaton se urdhërimi i hetueses së ZPS-së që të konfirmonte statusin konfidencial të dokumenteve ishte masë e përshtatshme që kompensonte mosnxjerrjen e pjesëve të Paketave, sidomos duke qenë se në disa raste ajo paraqiti pamje të fotografuara nga ekrani të treguesve që provonin konfidencialitetin e dokumenteve të panxjerra.

69. Sa u përket kundërshtimeve të Gucatit për mospërjashtimin e dëshmisë së znj. Pumper,¹⁵⁰ Paneli i referohet kompetencës diskrecionale që gëzojnë trupat gjykues në lidhje me pranimin e provave.¹⁵¹ Trupi Gjykues gëzon kompetencë diskrecionale edhe sipas rregullës 138(1) të Rregullores, gjatë vlerësimit të relevancës, autenticitetit dhe vlerës provuese të provave të paraqitura.¹⁵² Gjithashtu, Paneli vë në dukje se trupi gjykues mund të refuzojë pranimin e provave, përfshirë dëshmi të dëshmitarëve, kur vlera provuese e tyre zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.¹⁵³

70. Paneli i Apelit vë në dukje se vetë Gucati gjatë gjykimit bëri me dije se nuk kishte kundërshtim që znj. Pumper të “thirrej të jepte dëshmi *per se*”.¹⁵⁴ Megjithatë, Paneli vëren gjithashtu se, në kundërshtim nga konstatimi i Trupit Gjykues se Gucati

¹⁴⁹ Aktgjykimi, para. 426, që i referohet KSC-BC-2020-07, Transkripti (dëshmitarja W04841, Zdenka Pumper), 18 tetor 2021, f. 861 dhe KSC-BC-2020-07, Transkripti (dëshmitari DW1253, Robert Rid), 24 janar 2022, f. 3277-3279, 3281-3283.

¹⁵⁰ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 60, 79, që i referohet Urdhrit Gojor për Pranimin e Provave Materiale të Paraqitura përmes W04841-shit; Vendimin mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra, para. 8; Urdhrin mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117, para. 23.

¹⁵¹ *Shih më lart*, para. 35.

¹⁵² Vendimi mbi Apelin në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 14.

¹⁵³ Rregulla 138(1) e Rregullores. *Shih gjithashtu p.sh.*, Rregulloren e TPNJ-së, Rregulla 89(D); *Milutinović et al.* Appeal Decision on Witness Evidence, para. 16-19; *Martić* Appeal Decision on Witness Evidence, paras 14-15.

¹⁵⁴ Kundërpërgjigja e Gucatit ndaj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me Kundërshtimin e Mbrojtjes mbi Pranueshmërinë, para. 40. *Shih gjithashtu* Urdhrin mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117, para. 11.

nuk “[paraqiti] bazë ligjore që të autorizonte Trupin Gjykes të miratonte masën që kërkohej në atë fazë të procesit”,¹⁵⁵ në pajtim me rregullën 138(1) të Rregullores, Gucati kundërshtoi që znj. Pumper të jepte dëshmi në lidhje me përmbajtjen e pjesëve të panxjerra të Paketave, mbi bazën se ajo dëshmi e pritshme “ka efekt tejet dëmtues” dhe zhbën çfarëdo vlere provuese që pretendon”.¹⁵⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykes bëri gabim që arriti në konstatim të ndryshëm.¹⁵⁷ Megjithatë, Paneli i Apelit konstaton se, me gjithë këtë gabim, Trupi Gjykes përfundimisht gjykoj se Mbrojtja pati mundësinë të pyeste dëshmitaren, të kundërshtonte vlerën provuese dhe mbështetshmërinë në provat e paraqitura nga ajo, dhe të kundërshtonte pranueshmërinë e provave materiale gjatë dëshmisë së saj.¹⁵⁸ Sipas mendimit të Panelit, ky vlerësim përfshin edhe peshimin nëse dëshmia e znj. Pumper do të kishte efekt dëmtues për Mbrojtjen.

71. Gjithashtu, Paneli i Apelit vë në dukje se Dhomat e Specializuara nuk kanë rregulla që të ndalojnë ose kufizojnë dëshminë e një hetuesi të ZPS-së.¹⁵⁹ Paneli i Apelit vë në dukje gjithashtu se një hetues mund të dëshmojë konkretisht, në lidhje me produktin e punës së vet,¹⁶⁰ dhe për aspekte të cilat i ka parë, dëgjuar ose përjetuar

¹⁵⁵ Vendimi mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra, para. 8. *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra, para. 9.

¹⁵⁶ Kundërpërgjigja e Gucatit ndaj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me Kundërshtimin e Mbrojtjes mbi Pranueshmërinë, para. 36, 39, 41. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07, Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1673-1676; Mocioni i Gucatit për Kundërshtimin e Pranueshmërisë së Provave, para. 40-41 (argumentohet se znj. Pumper mund të dëshmojë, në parim, vetëm si dëshmitare që dëshmon për faktet lidhur me prejardhjen dhe kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të dokumenteve dhe duke qenë se ajo nuk mori pjesë në sekuestrimin e Paketave, nuk mund të japë dëshmi të tillë).

¹⁵⁷ Urdhri mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117, para. 11; Vendimi në lidhje me Rishikimin e Urdhrit mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117, para. 23-25. *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra, para. 8-9.

¹⁵⁸ Vendimi mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra, para. 8. *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra, para. 9.

¹⁵⁹ *Shih gjithashtu* *Perišić* Decision on Witness Testimony, para. 13; *Milošević* Appeal Decision on Admissibility, para. 21; *Popović et al.* Decision on Admissibility of Testimony, p. 2-3.

¹⁶⁰ *Kanyarukiga* Decision on OTP Witness List, para. 18; *Milutinović et al.* Decision on Certification of Appeal of Decision on Admission of Expert Witness, para. 11; *Nyiramasuhuko et al.* Oral Decision on Defence Expert Witness, paras 6-7, 10; *Katanga and Ngudjolo* Decision on Postponement of Hearings, para. 17.

vetë.¹⁶¹ Paneli nuk gjykon se jurisprudenca së cilës i referohet Gucati mbështet argumentet e tij,¹⁶² sepse ajo ka të bëjë me rrethana mjaft të ndryshme, ku nga hetuesit e prokurorisë që u ftuan për të dëshmuar pritej të përmbledhnin një “sasi voluminoze” të dokumenteve duke përzgjedhur pjesët që ishin relevante për gjykatësit¹⁶³ ose deklarata me shkrim të dëshmitarëve të mundshëm të dhëna hetueseve të prokurorisë,¹⁶⁴ ose të përpilonin një raport me mendimet e tyre në lidhje me ngjarje të caktuara pa pasur dijeni të drejtpërdrejtë për to.¹⁶⁵ Në çështjen gjyqësore aktuale, dëshmia që dha znj. Pumper bazuar në shqyrtimin prej saj të Paketave dhe të tabelave që ajo përpiloi u përqendrua në: (i) informacionin faktik që përmbanin ato, përfshirë nëse ishin konfidenciale dhe/ose përmbanin emra të dëshmitarëve; dhe (ii) autenticitetin e tyre.¹⁶⁶ Konkretisht, në lidhje me tabelat, informacioni faktik që dha znj. Pumper u kufizua në çfarë kërkoi Gjykatësi i Procedurës Paraprake.¹⁶⁷ Sipas mendimit të Panelit, ky kuadër i kufizuar nuk la hapësirë për mendime personale dhe nuk krahasohet me përmbledhje të dokumenteve, ku zgjedhja se cili informacion të përfshihet i mbetet vetvetiu gjykimit të vetë personit.

72. Paneli gjithashtu vëren se Mbrojtja pati mundësinë t’i bënte pyetje znj. Pumper dhe të kundërshtonte besueshmërinë e saj dhe mbështetshmërinë në dëshminë e saj,¹⁶⁸

¹⁶¹ *Karemera et al.* Decision on Witness Withdrawal, para. 4; *Ndindiliyimana et al.* Decision on Defence Witness Testimony, para. 9.

¹⁶² *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 62-72, që i referohet *Perišić* Decision on Witness Testimony, paras 12, 15; *Milošević* Appeal Decision on Admissibility, para. 3(c), 23-24 and *Bizimungu et al.* Transcript, p. 31.

¹⁶³ *Perišić* Decision on Witness Testimony, paras 12, 15 (Megjithatë, Dhoma Gjyqësore e TPNJ-së pranoi se një hetues i prokurorisë mund të dëshmojë si dëshmitar që dëshmon për fakte vetëm në lidhje me prejardhjen dhe kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të dokumenteve).

¹⁶⁴ *Milošević* Appeal Decision on Admissibility, para. 15, 18-22.

¹⁶⁵ *Bizimungu et al.* Transcript, p. 4-5, 21.

¹⁶⁶ *Shih* P00086; P00088; P00089; P00090; P00091; KSC-BC-2020-07, Transkriptet (dëshmitarja W04841, Zdenka Pumper), 18-21, 25-26 tetor 2021.

¹⁶⁷ P00090; P00091.

¹⁶⁸ KSC-BC-2020-07, Transkripti, 19 tetor 2021, f. 1015-1032; KSC-BC-2020-07, Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1040-1091, 1092-1099 (seancë private), 1100-1158; KSC-BC-2020-07, Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1165-1168, 1169 (seancë private), 1170-1215, 1216 (seancë private), 1217-1218, 1219-1244 (seancë private), 1246-1251; KSC-BC-2020-07, Transkripti, 25 tetor 2021, f. 1304-1315, 1316-1339 (seancë private), 1340-1342, 1343-1344 (seancë private), 1345-1347, 1348 (seancë private), 1349, 1350-1351 (seancë private),

si dhe të kundërshtonte pranueshmërinë e deklaratave të saj dhe të provave materiale të tjera që u paraqitën përmes dëshmisë së saj.¹⁶⁹ Trupi Gjykues gjithashtu i bëri pyetje znj. Pumper dhe kreu një vlerësim të gjerë të besueshmërisë dhe të mbështetshmërisë në dëshmisë e saj sa i përket përmbajtjes, autenticitetit dhe konfidencialitetit të materialit të sekuestruar.¹⁷⁰ Për vërtetimin e konfidencialitetit të Paketave, Trupi Gjykues mori parasysh jo vetëm dëshminë e znj. Pumper, por edhe: (i) faqet e Paketave që u pranuan si prova;¹⁷¹ (ii) deklarata bashkëkohëse dhe dëshmi të të akuzuarve që konfirmonin llojin e dokumenteve që përmbanin Paketat dhe që tregonin konfirmimin e autenticitetit dhe konfidencialitetit të dokumenteve; (iii) lajme në media; dhe (iv) dëshminë e z. Halil Berisha (dëshmitari W04866) (“z. Berisha”) në lidhje me Paketën 4, që është relevante për Paketën 1.¹⁷² Rrjedhimisht, Paneli i Apelit bindet se pranimi i dëshmisë së znj. Pumper nuk i shkaktoi asnjë dëm Mbrojtjes, që do të përligjte përrjashtimin e saj sipas rregullës 138(1) të Rregullores.

73. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Gucati dhe Haradinaj nuk arrijnë të demonstrojnë gabim në shqyrtimin prej Trupit Gjykues të dokumenteve të panxjerra dhe/ose të redaktuara të Paketave. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit hedh poshtë

1352-1364, 1365-1366 (seancë private), 1367-1385, 1386-1390 (seancë private), 1391-1392, 1393-1407 (seancë private); KSC-BC-2020-07, Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1414-1427, 1428-1429 (seancë private), 1430-1434, 1435 (seancë private), 1436-1438, 1439 (seancë private), 1440-1466, 1467-1469 (seancë private), 1489-1490. Gjithashtu, Trupi Gjykues e lejoi Mbrojtjen që të merrte në pyetje më tej znj. Pumper mbi bazën se disa dokumente u nxorën për Mbrojtjen pas përfundimit të paraqitjes së provave prej ZPS-së dhe rrjedhimisht Mbrojtja nuk mundi t’i përdorte gjatë marrjes fillestare në pyetje. *Shih* Urdhrin Gojor mbi Kërkesën për Marrje të Mëtejshme në Pyetje të W04841-shit dhe W048420-s; KSC-BC-2020-07, Transkripti, 15 dhjetor 2021, f. 2622-2626 (seancë private). *Shih gjithashtu më lart*, para. 70.

¹⁶⁹ *Shih* në veçanti, në lidhje me pranueshmërinë, KSC-BC-2020-07, Transkriptin, 28 tetor 2021, f. 1654-1686. *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra.

¹⁷⁰ Aktgjykimi, para. 50-51, 331-381 (lidhur me përmbajtjen e Paketave), 382-423 (lidhur me autenticitetin e Paketave), 424-458 (lidhur me konfidencialitetin e informacionit që përmbanin Paketat). *Shih* KSC-BC-2020-07, Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1472-1488.

¹⁷¹ *Shih* Aktgjykimin, para. 339, 349, 354, 387, 391, 394, 429, 437. Trupi Gjykues pranoi njëmbëdhjetë faqe nga Paketa 1 (P00093-P00097, P00139-P00144), krejt Paketën 2, konkretisht 937 faqe me redaktime në gjashtë faqe (P00104), shtatëmbëdhjetë faqe nga Paketa 3 (P00106-P00119), dhe gjashtë faqe nga Paketa 4 (P00145-P00150).

¹⁷² Aktgjykimi, para. 333-334, 340, 343, 357-378, 383, 397-422, 425, 439-445, 449-457. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 300-301 (ku përmendet se të akuzuarit u kishin dhënë mediave 70-80% të materialit dhe se ZPS-ja sekuestroi pjesën e mbetur).

Pikën 2(A) të Apelit të Gucatit në pjesën përkatëse¹⁷³ dhe 4(H) të Apelit në pjesën përkatëse,¹⁷⁴ dhe Pikën 1 të Apelit, në pjesën përkatëse dhe Pikën 4 të Apelit të Haradinajt.

(b) Materiali në lidhje me pretendimin për shtytje për kryerje të veprës penale (Pikat 16, 17 të Apelit të Haradinajt)¹⁷⁵

(i) Parashtrimet e palëve

74. Haradinaj parashtron se Trupi Gjykses bëri konstatime faktike duke u bazuar në materialin që nuk u nxor për të akuzuarit, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën e tyre për gjykim të drejtë, edhe pse nuk mund të demonstrohej dëm ndaj tij.¹⁷⁶ Sipas Haradinajt, ndonëse Trupi Gjykses mbajti seanca *ex parte* pa Mbrojtjen për të vlerësuar se cili material duhej t'i nxirrej Mbrojtjes, e drejta për proces ballafaques përfshin të drejtën që të gjitha palët të jenë në dijeni të të gjitha provave të paraqitura ose vërejtjeve të parashtruara me qëllim që të ndikojnë në vendimin e gjykatës, dhe se i takon palës përkatëse e jo gjykatës që të gjykojë nëse për një dokument nevojiten vërejtje.¹⁷⁷

75. Gjithashtu, Haradinaj argumenton se mosmiratimi prej Trupit Gjykses i nxjerrjes së materialit relevant për argumentet e tij mbrojtëse për shtytje për kryerje të

¹⁷³ Paneli i ka trajtuar kundërshtimet e tjera të Pikës 2(A) të Apelit të Gucatit në pjesën lidhur me veprimin e fajshëm të veprës penale sipas Pikën 3 të Aktakuzës. *Shih më poshtë*, para. 239-250.

¹⁷⁴ Paneli i ka trajtuar kundërshtimet e tjera të Pikës 4(H) të Apelit të Gucatit në pjesën lidhur me interesin publik. *Shih më poshtë*, para. 321-340.

¹⁷⁵ Paneli vëren se argumentet e Haradinajt në Pikat 16 dhe 17 të Apelit të tij u paraqitën si alternativë e Pikave 12 dhe 13, ku pretendohet gabim nga ana e Trupit Gjykses në hetimin e pretendimeve lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 156. Duke pasur parasysh konstatimet e Panelit në lidhje me Pikat 12 dhe 13 të Apelit të Haradinajt (*shih më poshtë*, para. 361-374), Paneli do t'i trajtojë këto pika të apelit si pjesë të kundërshtimeve të të akuzuarit për gjykim të drejtë.

¹⁷⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 156-157, 159, 161; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 43. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 160 (ku parashtrohet se kjo është veçanërisht shqetësuese, për shkak, ndër të tjera, të faktit që argumentet mbrojtëse lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale bazoheshin në pretendimet për parregullsi procedurale dhe politike dhe anësi nga ZPS-ja/Dhomat e Specializuara dhe nga anëtarë të Trupit Gjykses).

¹⁷⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 157-159, 161.

veprës penale shkeli nenin 6(1) të GJEDNJ-së, që kërkon që autoritetet e prokurorisë të nxjerrin për mbrojtjen të gjitha provat materiale në zotërim të tyre, në dobi apo kundër të akuzuarit.¹⁷⁸ Haradinaj parashtron gjithashtu se çdo masë që ia kufizon Mbrojtjes këtë të drejtë duhet të jetë absolutisht e domosdoshme dhe të kompensohet në mënyrë të mjaftueshme,¹⁷⁹ dhe se vendimi i Trupit Gjykes për urdhërim të masave kompensuese në lidhje me dokumente të caktuara që ishin juridikisht thelbësore për paraqitjen e provave prej Mbrojtjes nuk garantoj mjaftueshëm të drejtat e të akuzuarit për gjykim të drejtë.¹⁸⁰

76. ZPS-ja përgjigjet se Haradinaj nuk arrin të evidentojë: (i) as materialin në lidhje me të cilin ai pretendon gabimin nga ana e Trupit Gjykes që nuk autorizoi nxjerrjen e materialit, me gjithë relevancën e këtij materiali për pretendimin për shtytje të kryerjes së veprës penale; dhe (ii) as një rast kur Trupi Gjykes ka bërë konstatim juridikisht thelbësor faktik në bazë të ndonjë dokumenti të panxjerrë.¹⁸¹ Sipas ZPS-së, ai gjithashtu nuk arrin të evidentojë se si do ta kishte ndihmuar materiali i redaktuar ose i panxjerrë.¹⁸² ZPS-ja argumenton gjithashtu se Mbrojtjes nuk iu ndalua kundërshtimi i dokumenteve të pranuar si prova dhe se në çdo seancë *ex parte* pa Mbrojtjen u synua posaçërisht evidentimi i masave të efektshme kompensuese që do t'i mundësonin Mbrojtjes të paraqiste plotësisht pretendimin e saj.¹⁸³ ZPS-ja parashtron gjithashtu se argumentet e Haradinajt në lidhje me faktin se Trupi Gjykes pati qasje në materiale të caktuara e ai jo, është kundërshtim sipas rregullës 108 të

¹⁷⁸ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 162-164, 172. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 123-124.

¹⁷⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 165-166.

¹⁸⁰ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 167-172.

¹⁸¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 155-156.

¹⁸² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 160.

¹⁸³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 157, 161; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 122, 164.

Rregullores, dhe se Haradinaj nuk vërteton asnjë padrejtësi të brendaqenësishme në procedurën e kësaj rregulle ose në zbatimin e saj prej Trupit Gjykses.¹⁸⁴

77. Në kundërpërgjigje, Haradinaj parashtron se argumentet e tij nuk zhvlerësohen nga mospërmendja e konstatimeve konkrete të bëra nga Trupi Gjykses gjatë seancave *ex parte*, dhe se e drejta e tij për gjykim të drejtë u shkel nga mospjesëmarrja e tij në këto seanca, pavarësisht nëse iu ndalua ose nuk iu ndalua të bënte komente në lidhje me të gjitha materialet e pranuar si prova.¹⁸⁵ Në fund, Haradinaj parashtron se nuk mund të fajësohet që nuk mundi të tregonte se si do ta ndihmonte informacioni që u redaktua ose nuk u nxor për të, sepse aftësia e tij për ta bërë këtë u kufizua pikërisht për shkak të këtyre redaktimeve/kufizimeve.¹⁸⁶

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

78. Paneli vë në dukje se, në të dy çështjet gjyqësore të GJEDNJ-së të cilave u referohet Haradinaj për të mbështetur argumentet e tij se të gjitha palët kanë të drejtë të jenë në dijeni dhe të komentojnë lidhur me provat e paraqitura dhe vërejtjet e parashtruara,¹⁸⁷ parashtrimet që nuk u nxorën për të akuzuarit lidheshin me themelësinë e çështjeve para gjykatave kompetente.¹⁸⁸ Sipas mendimit të Panelit, situata ku prokuroria bën parashtrime *ex parte* pa praninë e Mbrojtjes, lidhur me aspekte të nxjerrjes së materialit, është e ndryshme. Sikurse konfirmon Haradinaj, GJEDNJ-ja pranon se në disa raste mosnxjerrja e provave të caktuara për mbrojtjen mund të jetë e domosdoshme, me qëllim ruajtjen e të drejtave themelore të një personi

¹⁸⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 158, 161; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 164. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 159.

¹⁸⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 40, 42. Haradinaj sqaron se ai është i gatshëm të pranojë se diskutimet gjatë seancave *ex parte* mund të mos kenë pasur lidhje me konstatimet materiale të fakteve, por mund të kenë qenë relevante për konstatime materiale juridike. *Shih* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 41.

¹⁸⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 45. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 44.

¹⁸⁷ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 157, që i referohet *Brandstetter Judgment*, para. 67; *Bajić Judgment*, para. 59.

¹⁸⁸ *Brandstetter Judgment*, paras 34, 64-69; *Bajić Judgment*, paras 56-60.

tjetër ose garantimin e një interesi publik të rëndësishëm, si për shembull kur është fjala për sigurinë kombëtare, ose nevojën për t'i mbajtur të fshehta metodat e përdorura prej policisë për hetimin e krimeve.¹⁸⁹

79. Në këto rrethana, seancat *ex parte* janë procedurë standarde, sidomos në situata sikurse kjo aktuale, ku nga materiali në fjalë është e qartë se, në këndvështrimin praktik, çdo parashtrim lidhur me përmbajtjen e dokumenteve do të ishte i pamundur pa zbuluar vetë informacionin që prokuroria kërkon të mos nxjerrë.¹⁹⁰ Kjo përputhet gjithashtu me kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara, pasi rregulla 108(1) e Rregullores i jep ZPS-së mundësinë që t'i kërkojë trupit gjykues, në mënyrë konfidenciale dhe *ex parte*, mosnxjerrjen e informacionit që është objekt i nxjerrjes sipas rregullës 102 dhe 103 të Rregullores, nëse, ndër të tjera, ajo nxjerrje mund t'u shkaktojë dëm hetimeve aktuale ose të ardhshme, ose të shkaktojë rrezik të madh për sigurinë e dëshmitarëve, viktimave ose anëtarëve të familjeve të tyre.¹⁹¹

80. Paneli vë në dukje se Trupi Gjykues në fakt mbajti seanca *ex parte* me qëllim që të kërkonte informacion shtesë nga ZPS-ja lidhur me: (i) hapa për t'i mundësuar Mbrojtjes që të ngrinte pretendime për shtytje për kryerje të veprës penale në mënyrë të efektshme dhe të plotë; dhe (ii) masa kompensuese efektive që do të mund të miratoheshin në rast se mosnxjerrja do të merrej parasysht.¹⁹² Trupi Gjykues vuri në dukje gjithashtu se një nga qëllimet parësore gjatë vlerësimit të vet ishte që të garantohej se Mbrojtjes nuk do t'i shkaktohej dëm ose padrejtësi si rrjedhojë e këtyre

¹⁸⁹ *Paci* Judgment, paras 84-85; *Rowe and Davis* Judgment, paras 60-61. *Shih gjithashtu Jasper* Judgment, para. 52, që citohet në Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 165.

¹⁹⁰ *Brđanin and Talić* Decision on Oral Hearing, para. 4. *Shih gjithashtu Ntaganda* Appeal Judgment, para. 122 (ku Dhoma e Apelit e GJPN-së konstatoi se nuk do të thotë se një vendim që autorizon, në seancë *ex parte*, mosnxjerrjen e materialit për mbrojtjen rezulton automatikisht në dëm ndaj saj).

¹⁹¹ *Shih gjithashtu* Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese mbi Referimin e Rregullores, para. 168, 183 (ku nuk pati koment lidhur me mospërputhje të mundshme të kësaj rregulloreje me Kushtetutën e Kosovës). *Shih gjithashtu* Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese mbi Referimin e Rregullores, para. 135-138, 177-178, 180 (ku Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese pranoi, ndër të tjera, se e drejta për nxjerrje të provave përkatëse nuk është e drejtë absolute).

¹⁹² *Shih* Aktgjykimin, para. 844.

seancave *ex parte*.¹⁹³ Gjithashtu, Trupi Gjykues kreu një vlerësim rrënjësor dhe të bazuar në informacion të të gjitha materialeve objekt i rregullës 102(3) të Rregullores dhe në disa raste, pavarësisht nga kundërshtimet e ZPS-së, e urdhëroi atë që, ndër të tjera: (i) të nxirrte për Mbrojtjen materialin që u evidentua se kishte lidhje me pretendime të shtytjes për kryerje të veprës penale, pasi i kishte shqyrtuar të gjitha aspektet përkatëse; ose (ii) t'i dorëzonte Mbrojtjes njoftime të hollësishme, të redaktuara dhe të përditësuara lidhur me materialin që *prima facie* dukej relevant.¹⁹⁴ Trupi Gjykues gjithashtu i dha ZPS-së udhëzime të rrepta në lidhje me materialin e rregullës 102(3) të Rregullores.¹⁹⁵ Paneli gjykon se kjo procedurë, përmes së cilës Trupi Gjykues vlerësoi relevancën e materialit për çështjen gjyqësore me qëllim nxjerrjen e tij, është në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së.¹⁹⁶

81. Në lidhje me kundërshtimet e Haradinajt ndaj redaktimeve në materiale konkrete,¹⁹⁷ Paneli vë në dukje konstatimin e vet se procedura e zbatuar nga Trupi Gjykues gjatë vlerësimit të kërkesës së ZPS-së sipas rregullës 108 të Rregullores, përmbushi standardet e gjykimit të drejtë,¹⁹⁸ dhe se Trupi Gjykues zbatoi të njëjtat konsiderata të gjykimit të drejtë kur vlerësoi këto materiale.¹⁹⁹ Gjithashtu, Trupi

¹⁹³ Aktgjykimi, para. 844.

¹⁹⁴ Aktgjykimi, para. 843-844.

¹⁹⁵ *Shih p.sh.*, Vendimin mbi Nxjerrjen e Përditësuar sipas Rregullës 102(3), para. 42, 48; Urdhrin lidhur me Njoftimin e Përditësuar sipas Rregullës 102(3), para. 14.

¹⁹⁶ *Shih Jasper Judgment*, para. 56 (ku GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se fakti që nevoja për nxjerrje të materialit ishte gjatë gjithë kohës në shqyrtim nga gjykatësi vendor shërbeu si garanci e rëndësishme). Paneli vë në dukje se parashtrimi i Haradinajt se argumenti i tij mbrojtës lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale bazohej gjithashtu në pretendime për parregullsi dhe anësi nga anëtarë të Trupit Gjykues (*shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 160) nuk u ngrit asnjëherë gjatë gjykimit, çka përlligj rrjedhimisht rrëzimin e menjëhershëm të tij (*Shih* Vendimin e Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 15). Sido që të jetë, argumentet e tij në lidhje me heqjen e Kryegjykatësit të Trupit Gjykues janë hedhur poshtë. *Shih më lart*, para. 42-43.

¹⁹⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 168-172, që u referohet materialeve 191, 195-201.

¹⁹⁸ *Shih më lart*, para. 78-80.

¹⁹⁹ Konkretisht, Trupi Gjykues urdhëroi nxjerrjen e një pjese të materialit 19 edhe pse përbënte produkt të punës së brendshme sipas rregullës 106 të Rregullores dhe pavarësisht se nuk përmbante informacion të qartë që do të ndihmonte pretendimin e Mbrojtjes ose hetimin prej saj të shtytjes për kryerje të veprës penale, dhe urdhëroi masa kompensuese që ishin më shumë se çfarë propozoi ZPS-ja. *Shih* Vendimin mbi Nxjerrjen e Përditësuar sipas Rregullës 102(3), para. 64, 67-68. Në lidhje me materialet 195-200, Trupi Gjykues konstatoi se, edhe pse ato në vetvete nuk e ndihmonin Mbrojtjen në

Gjykues urdhëroi masa kompensuese në lidhje me këto dokumente, pasi konstatoi se nxjerrja e plotë e tyre do të dëmtonte hetimet në kryerje e sipër të ZPS-së.²⁰⁰ Në lidhje me këtë, Paneli vë në dukje se vlerësimi nëse masat kompensuese janë të përshtatshme dhe cilat nga to janë të përshtatshme për garantimin e të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë, përfshihen në kompetencën diskrecionale të Trupit Gjykues.²⁰¹ Rrjedhimisht, Paneli gjykon se qasja e Trupit Gjykues lidhur me nxjerrjen e këtyre materialeve garantoj në mënyrë të përshtatshme të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë.

82. Duke u bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Haradinaj nuk ka arritur të demonstrojë gabim në vendimin e Trupit Gjykues për miratimin e mosnxjerrjes ose redaktimin e materialit që u pretendua se ishte relevant për pretendimet e të akuzuarit për shtytje të kryerjes së veprës penale. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikat 16 dhe 17 të Apelit të Haradinajt.

pretendimet ose hetimet e saj lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale, dhe në formatin e papërpunuar të tyre nuk informonin për hapat hetimorë të ndërmarrë nga ZPS-ja për përjashtimin e mundësisë së rrjedhjes së qëllimshme, ai megjithatë vendosi që të nxirrte përmbledhje të tyre, duke mbajtur parasysh se Mbrojtja mund të organizonte të bënte analizën e vet dhe të nxirrte përfundimet e veta në lidhje me çdo hap hetimor të ndërmarrë nga ZPS-ja për përjashtimin e mundësisë së shtytjes për kryerje të veprës penale. *Shih* Vendimin mbi Nxjerrjen e Përditësuar sipas Rregullës 102(3), para. 71-74. Në lidhje me materialin, Trupi Gjykues, duke pranuar se Mbrojtja nuk kishte qasje në material dhe rrjedhimisht nuk ishte në gjendje të bënte parashtrime të bazuara në informacion lidhur me rëndësinë materiale dhe redaktimet e propozuara, i kushtoi kujdes të veçantë shqyrtimit të materialit me qëllim ruajtjen e efektivitetit të të drejtave të të akuzuarve në këtë çështje. *Shih* Vendimin në lidhje me Materialin 201 të Njoftimit, para. 14, 24.

²⁰⁰ Vendimi mbi Nxjerrjen e Përditësuar sipas Rregullës 102(3), para. 66-68, 72-74, 76-78, 95(b)-(c); Vendimi në lidhje me Materialin 201 të Njoftimit, para. 24, 26.

²⁰¹ *Shih* rregullën 108(4) të Rregullores (që përcakton se paneli mund të urdhërojë marrjen e masave të përshtatshme kompensuese dhe në qoftë se, sipas mendimit të panelit, asnjë masë nuk do të garantonte të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë, ZPS-së i jepet mundësia që, ose ta nxjerrë informacionin, ose t'i ndryshojë ose tërheqë akuzat me të cilat lidhet informacioni).

(c) Materiali në lidhje me pretendimet e z. Marti (Pika 10 e Apelit të Haradinajt)

(i) Parashtrimet e palëve

83. Haradinaj argumenton se Trupi Gjykses bëri gabim juridik kur refuzoi kërkesën e Mbrojtjes për parashtrime sipas rregullës 136(2) të Rregullores në lidhje me pretendimet e z. Marti se autoritetet serbe ishin përgjegjëse për sajimin dhe manipulimin e provave që implikonin shqiptarët kosovarë, mbi bazën se ato nuk ishin relevante dhe rrjedhimisht, konstatoi se nuk ishte përmbushur kriteri për nxjerrje të materialit.²⁰² Sipas Haradinajt, në qoftë se në këtë çështje gjyqësore do të konstatohej një rast i manipulimit të provave prej autoriteteve serbe për diskreditimin e shqiptarëve kosovarë, kjo do të cenonte në masë të konsiderueshme konstatimet e fajësisë, veçanërisht duke pasur parasysh mungesën e provave në lidhje me rrjedhën e ngjarjeve prej marrjes së dokumenteve të ZPS-së deri te dorëzimi i tyre në zyrat e OVL-UÇK-së, ose do të ishte së paku relevant për vlerësimin nëse ZPS-ja shkeli detyrimin e moskryerjes së veprimeve që me gjasë do të ndikonin negativisht në besimin të pavarësia dhe integriteti i saj.²⁰³ Haradinaj parashtron gjithashtu se fakti nëse këto pretendime janë të paverifikuara ose jo, nuk ndikon në aspektin nëse ato janë juridikisht thelbësore për përgatitjen e mbrojtjes.²⁰⁴

84. ZPS-ja përgjigjet se Haradinaj thjesht përsërit argumente që ishin të pasuksesshme gjatë gjykimit dhe që nuk arrijnë të vërtetojnë gabim që mund të zhvlerësojë Aktgjykimin.²⁰⁵ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se Mbrojtja nuk ka arritur të përmbushë kriteret e rregullës 136(2) të Rregullores, se informacioni dukej që ishte i disponueshëm për publikun dhe se Trupi Gjykses konstatoi me të drejtë se ky

²⁰² Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 115-119, 122, 125-126, që i referohet Vendimit mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Parashtrime të Mëtejshme, para. 16, 19, 22.

²⁰³ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 121-124. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 30 (argumentohet se ZPS-ja nuk ka marrë parasysh paralelen midis këtyre pretendimeve dhe çështjes gjyqësore aktuale).

²⁰⁴ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 120.

²⁰⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 44, 46.

informacion nuk ishte relevant për çështjen gjyqësore, dhe se aspekti që ato pretendime ishin të paverifikuara nuk ishte kyç në vendimin e Trupit Gjykses.²⁰⁶

85. Haradinaj kundërpërgjigjet se, në kundërshtim me çfarë pretendon ZPS-ja, Trupi Gjykses u mbështet në argumentin se ky informacion ishte i paverifikuar për të arritur në konstatimin se nuk ishte relevant, edhe pse ky informacion nuk ishte i paverifikuar dhe ishte bazë për një aspekt kyç gjatë gjykimit.²⁰⁷

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

86. Trupi Gjykses konstatoi, ndër të tjera, se i akuzuari nuk arriti të vërtetonte se publikimi i pretendimeve të z. Marti përbën rrethana të veçanta, sikurse përcaktohet nga rregulla 136 e Rregullores, për lejimin e parashtrimeve të mëtejshme pas mbylljes së çështjes gjyqësore, mbi bazën se: (i) pretendimet e z. Marti nuk janë relevante për çështjen gjyqësore; (ii) materiali nuk do të përbente material me gjasë shfajësues sipas rregullës 103 të Rregullores dhe, meqë nuk ishte relevant për procesin gjyqësor, nuk do të ishte objekt i kriterëve të rregullës 102(3) të Rregullores; dhe (iii) ZPS-ja mund të lirohet nga detyrimi për nxjerrje të materialit nëse ekzistenca e provave përkatëse dihet dhe provat janë të disponueshme për Mbrojtjen.²⁰⁸

87. Paneli vë në dukje se parashtrimet e Haradinajt se pretendimet e z. Marti janë relevante për çështjen gjyqësore janë thjesht përsëritje të argumenteve tashmë të trajtuara prej Trupit Gjykses, pa demonstruar nëse rrëzimi i tyre prej Trupit Gjykses përbën gabim që përlligj ndërhyrjen e Panelit të Apelit.²⁰⁹ Rrjedhimisht, Paneli i hedh poshtë menjëherë këto argumente.²¹⁰ Sido që të jetë, Paneli nuk konstaton gabim në përfundimin e Trupit Gjykses se Mbrojtja nuk ka demonstruar lidhjen midis atyre

²⁰⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 44-45.

²⁰⁷ Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 31, që i referohet Dosjes së Përgjigjes së ZPS-së, para. 45.

²⁰⁸ Vendimi mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Parashtrime të Mëtejshme, para. 16-19.

²⁰⁹ *Krahaso* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 121-125 me Kërkesën e Gucatit për Parashtrime të Mëtejshme, para. 3-4, 14 dhe Kërkesën e Haradinajt për Parashtrime të Mëtejshme, para. 4.1-4.9.

²¹⁰ *Shih p.sh.*, Vendimin mbi Apelin e Thaçit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, para. 60.

aspekteve dhe fakteve mbi të cilat bazohen argumentet e saj në procesin aktual,²¹¹ pasi, edhe në qoftë se materiali do të tregonte parregullsi të kryera nga autoritetet serbe, kjo nuk do të ndikonte në çështjen gjyqësore aktuale.²¹²

88. Sa i përket argumentit të Haradinajt se Trupi Gjygues gaboi që u mbështet në llojin e paverifikuar të pretendimeve kur arriti në përfundimin se nuk ishin relevante për çështjen gjyqësore, Paneli vë në dukje se Trupi Gjygues konstatoi në pjesën përkatëse se pretendimet e z. Marti “kanë të bëjnë me pretendime të paverifikuara të parregullsive nga ana e autoriteteve serbe, që duket se nuk kanë lidhje me bashkëpunimin e ZPS-së me autoritete të tilla ose me çfarëdo pretendimi parregullsie nga ZPS-ja të ngritura nga Mbrojtja në procesin aktual” dhe për këtë arsye, Trupi Gjygues nuk u bind se ato ishin relevante për çështjen gjyqësore.²¹³ Sipas mendimit të Panelit, Haradinaj shtrembëron konstatimin e Trupit Gjygues, meqë në këtë përfundim çoi qartësisht fakti se përmbajtja e pretendimeve “nuk lidhej me bashkëpunimin e ZPS-së me autoritete të tilla ose çfarëdo pretendimi të parregullsisë nga ZPS-ja të ngritur prej Mbrojtjes gjatë procesit aktual”, jo karakterizimi i tyre si të “paverifikuara”.

89. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Haradinaj nuk arrin të demonstrojë gabim në refuzimin prej Trupit Gjygues të nxjerrjes së materialit lidhur me pretendimet e z. Marti. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 10 të Apelit të Haradinajt.

²¹¹ Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Parashtrime të Mëtejshme, para. 16.

²¹² *Shih* Vendimin e Apelit mbi Kërkesën e ZPS-së në lidhje me Materialin 206, para. 38. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 124. Përmendja prej Haradinajt e detyrimit të ZPS-së për moskryerjen e veprimeve të papajtuashme me funksionet ose mandatin e vet ose që ndikojnë negativisht në besimin të pavarësia dhe integriteti i saj sipas Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtës dhe Prokurorë para Dhomave të Specializuara të Kosovës (*shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 124, që i referohet Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtës dhe Prokurorë para Dhomave të Specializuara të Kosovës, neni 31(c)) nuk është relevante, sepse ka të bëjë me vendosjen e sanksioneve disiplinore. *Shih* Kodin e Etikës Profesionale për Mbrojtës dhe Prokurorë para Dhomave të Specializuara të Kosovës, Kapitulli V.

²¹³ Vendimi mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Parashtrime të Mëtejshme, para. 16. Fjala “paverifikuar” del vetëm në këtë fjali.

4. Pretendimet për gabime në lidhje me pranimin e dëshmime të dëshmitarëve DW1250, DW1251, DW1252 dhe DW1253 (Pikat 1, pjesërisht, dhe 6 të Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

90. Haradinaj parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim juridik dhe/ose faktik që refuzoi të dëgjonte dëshmitë e dëshmitarëve DW1250 dhe DW1251 dhe që e kufizoi papërligjshëm kuadrin e dëshmime të ekspertëve znj. Ana Majers (dëshmitarja DW1252) (“znj. Majers”) dhe z. Rid, duke shkelur rrjedhimisht drejtpërdrejt të drejtën e të akuzuarit për të thirrur dëshmi logjikisht relevante dhe të domosdoshme për paraqitjen e mbrojtjes së tij.²¹⁴ Haradinaj argumenton konkretisht se, dëshmitarët DW1250 dhe DW1251, për arsye të pozitive profesionale të tyre të mëparshme, do të ishin në gjendje të dëshmonin për ekzistencën e ndërhyrjes politike, korrupsionit të përhapur gjerësisht dhe bashkëpunimit me autoritetet serbe në radhët e Shërbimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian (EEAS), dhe rrjedhimisht të mbështesnin “parimin qendror” të mbrojtjes së të akuzuarit se nxjerrja e informacionit përligjej prej interesit publik.²¹⁵ Haradinaj argumenton gjithashtu se Trupi Gjykses kufizoi pjesë kyçe të dëshmime të dëshmitarëve ekspertë, të znj. Majers dhe z. Rid, që lidheshin drejtpërdrejt me argumentin e tij mbrojtës të sinjalizimit dhe zbatimin e tij për faktet e çështjes gjyqësore dhe me kronologjinë e mbajtjes në ruajtje nga ZPS-ja të dokumenteve që u sekuestruan në zyrat e OVL-UÇK-së dhe përmbushjen e standardeve hetimore prej saj.²¹⁶

²¹⁴ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 72, 78-79, 84. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 83 (që parashtron se “këto konstatime në rastin më të mirë injoronin realitetin e çështjes gjyqësore kundër [të akuzuarit], ose në rastin më të keq tentonin të pengonin dhënien e dëshmime që lidheshin drejtpërdrejt me pretendime për anshmëri, ndërhyrje politike, parregullsi procedurale dhe padrejtësi”).

²¹⁵ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 73-77. Sipas Haradinajt, dëshmitari DW1250 do të ishte në gjendje gjithashtu që të dëshmonte për anshmëri dhe parregullsi gjyqësore të Kryegjykatësit të Trupit Gjykses. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 76. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 43. *Shih gjithashtu më lart*, poshtëshënimin 70.

²¹⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 34(d), 79-82.

91. ZPS-ja përgjigjet se Haradinaj thjesht përsërit argumentet që ishin të pasuksesshme para Trupit Gjykses dhe/ose Panelit të Apelit, pa shtjelluar se si këto vendime të cilat ishin në përputhje të plotë me Ligjin, Rregulloren dhe jurisprudencën e GjEDNJ-së, minuan në tërësi drejtësinë e procesit dhe zhvlerësuan Aktgjykimin.²¹⁷ Sipas ZPS-së, aspekti i relevancës së dëshmime të propozuara të DW1250-s dhe DW1251-shit për çështjen gjyqësore aktuale tashmë është zgjidhur në një apel të ndërmjetëm dhe nuk jepet asnjë arsytim për rishikimin e atij vendimi.²¹⁸ ZPS-ja parashtron gjithashtu se Haradinaj nuk artikulon asnjë gabim kur pretendon se Trupi Gjykses kufizoi papërligjshëm kuadrin e dëshmime të znj. Majers dhe z. Rid, dhe se kufizimet ishin të qarta dhe u zbatuan në mënyrë të drejtë për të dyja palët.²¹⁹

92. Haradinaj kundërpërgjigjet se ZPS-ja shtrembëron pikëpamjen e tij dhe nuk trajton thelbin e argumenteve të tij, si dhe parashtron se ai nuk tenton të kërkojë rishqyrtimin e çështjeve, por të theksojë gabimet e Trupit Gjykses.²²⁰

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

93. Fillimisht, Paneli i Apelit rikujton se pranueshmëria e provave është kryesisht aspekt që përfshihet në kompetencën diskreionale të Trupit Gjykses dhe se Paneli ndërhyt vetëm në rrethana të kufizuara.²²¹

94. Sikurse pranon Haradinaj, Paneli i Apelit tashmë ka dhënë një vendim ku konfirmohet vendimi i Trupit Gjykses për mospranimin e dëshmime të propozuara të dëshmitarëve DW1250 dhe DW1251, mbi bazën se nuk lidhen me akuzat dhe nuk mbështesin argumentin mbrojtës të Haradinajt të interesit publik, meqë nuk përbëjnë dëshmi që do të sugjeronin se disa nga materialet që pretendohet se u nxorën nga i

²¹⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 41.

²¹⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 42-43.

²¹⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 15. ZPS-ja parashtron gjithashtu se kufizimet ndaj dëshmisë së z. Rid ishin tërësisht në përputhje me vendimin përkatës të apelit. *Shih* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 15, që i referohet Vendimit të Apelit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 25, 27-30.

²²⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 17-18.

²²¹ *Shih më lart*, para. 35.

akuzuari përmbanin tregues të parregullsive që do të ndikonin në pavarësinë, paanësinë ose integritetin e hetimeve të ZPS-së/TFHS-së.²²² Po ashtu, Paneli i Apelit tanimë ka marrë vendim mbi pranueshmërinë e dëshmisë së z. Rid, ku ka konstatuar se mendimi i z. Rid lidhur me praktikën e ZPS-së, bazuar në njohuritë dhe përvojën e tij me praktikën e TPNJ-së dhe praktikën e hetimeve penale ndërkombëtare, do të ndihmonte gjykesin e fakteve për të kuptuar provat e administruara dhe kërkon ekspertizë përtej asaj që ka tashmë Trupi Gjykes.²²³ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit prapësoi vendimin e Trupit Gjykes për të mos dëgjuar dëshminë e z. Rid, por vetëm në qoftë se dëshmia e tij synonte të kundërshtonte dëshminë e dëshmitares së ZPS-së, znj. Pumper.²²⁴

95. Paneli rikujton se paneli i apelit mund të devijojë nga vendimet e veta të mëparshme për arsye bindëse në interes të drejtësisë.²²⁵ Haradinaj nuk ka arritur të demonstrojë gabim të qartë që përlligj rishikimin, ose të paraqesë arsye bindëse që do ta çonin Panelin në një konstatim të ndryshëm në lidhje me mospranimin e dëshmive të dëshmitarëve DW1250 dhe DW1251 dhe me kufizimet e vendosura për pranueshmërinë e dëshmisë së z. Rid. Haradinaj thjesht përsërit argumentet e ngritura më parë para Trupit Gjykes dhe Panelit të Apelit.

96. Sa i përket dëshmisë së znj. Majers, Paneli vëren se Trupi Gjykes e pranoi dëshminë e saj me pak kufizime, që kishin të bënin vetëm me komentet dhe konstatimet e saj në lidhje me statusin e të akuzuarve si “sinjalizues” dhe ligjshmërinë e sjelljes së tyre.²²⁶ Gjithashtu, Trupi Gjykes urdhëroi palët që të mos parashtronin pyetje që do të kërkonin nga znj. Majers të komentonte mbi provat e paraqitura në

²²² Vendimi i Apelit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 19-21, 31. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 78.

²²³ Vendimi i Apelit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 27-29.

²²⁴ Vendimi i Apelit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 29-31. *Shih* Aktgjykimin, para. 64, që i referohet Aktgjykimit, para. 577-578, 646.

²²⁵ *Shih më lart*, para. 37.

²²⁶ Vendimi i Apelit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 98, 101. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 63, që i referohet Aktgjykimit, para. 827, 830, 848, 867.

këtë proces, ose mbi aspektin se si analiza ligjore e saj do të vlente për faktet e çështjes gjyqësore aktuale, mbi bazën se këto aspekte përfshihen drejtpërdrejt në kompetencat e Trupit Gjyqësor dhe do të përbënin uzurpim të funksioneve dhe përgjegjësi ekskluzive të Trupit Gjyqësor.²²⁷ Paneli i Apelit gjykon se konstatimi i Trupit Gjyqësor në lidhje me këtë është në përputhje me jurisprudencën e pranuar.²²⁸ Gjithsesi, Haradinaj nuk arrin të demonstrojë se si ndikoi në Aktgjykim përjashtimi i kësaj pjese të kufizuar të dëshmisë së propozuar të znj. Majers.

97. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Haradinaj nuk arrin të demonstrojë gabim në konstatimin e Trupit Gjyqësor në lidhje me pranimin e dëshmive të dëshmitarëve DW1250 dhe DW1251, dhe të znj. Majers dhe z. Rid. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 1 në pjesën përkatëse²²⁹ dhe Pikën 6 të Apelit të Haradinajt.

5. Pretendimet për gabime në lidhje me mbështetjen e Trupit Gjyqësor në dëshmi të dorës së dytë (Pika 7 e Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

98. Haradinaj parashtron se Trupi Gjyqësor bëri gabim juridik pasi as përcaktoi se deri në cilën shkallë u mbështet në dëshmitë e dorës së dytë të ZPS-së, as saktësoi peshën që i atribuoi secilit material për përcaktimin e fajësisë së të akuzuarve.²³⁰ Ai argumenton se Trupi Gjyqësor duhet të shqyrtojë (i) nëse ekzistojnë arsye të vlefshme për pranimin e dëshmive anonime të dorës së dytë, duke mbajtur parasysh se duhen bërë përpjekje të arsyeshme për garantimin e pranisë së dëshmitarit, dhe (ii) nëse ato ishin bazë kryesore ose vendimtare për verdikt fajësie.²³¹ Sipas mendimit të tij, kur

²²⁷ Vendimi i Apelit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 99, 101.

²²⁸ *Shih* Vendimin e Apelit në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 26-27, që i referohet *Ntaganda Decision on Expert Witnesses*, para. 8; *Ruto and Sang Decision on Expert Report*, para. 12; *Popović et al. Appeal Judgement*, para. 79; *Taylor Decision on Exclusion of Evidence*, para. 22.

²²⁹ Paneli ka trajtuar kundërshtimet e tjera të Pikës 1 të Apelit të Haradinajt në pjesën lidhur me interesin publik. *Shih më poshtë*, para. 321-340.

²³⁰ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 85, 99.

²³¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 86-89.

dëshmia e dorës së dytë është vendimtare, Trupi Gjykses duhet të vlerësojë mjaftueshmërinë e garancive.²³²

99. Në këtë kontekst, Haradinaj ka kundërshtim për faktin që dëshmitë e atyre që pretendohet se u ndikuan nga deklaratat e të akuzuarit u dhanë nga punonjësi i ZPS-së, z. Miro Jukiq, (dëshmitari W04842) ("z. Jukiq") nëpërmjet paraqitjes së dëshmimeve anonime të dorës së dytë nga individë që nuk mund të identifikoheshin ose të merreshin në pyetje.²³³ Ai mendon se – përkundër dëshmimeve *viva voce* të kufizuara, të vjetruara dhe jo të saktësuara të dëshmitarëve të tjerë – dëshmitë anonime të dorës së dytë ishin vendimtare, sepse lidheshin me elementet e frikësimit, hakmarrjes dhe pengimit.²³⁴

100. Haradinaj argumenton se, ndonëse Trupi Gjykses përjashtoi disa dëshmi të dorës së dytë dhe ishte i vetëdijshëm për peshën që do t'u kushtohej dëshmimeve anonime të dorës së dytë, (i) ishte e paqartë nëse faktikisht vlerësoi nevojën për dëshminë e z. Jukiq, duke pasur parasysh se ZPS-ja mund të kishte kërkuar masa mbrojtëse për dëshmitarët në të cilët u mbështet, që do të përfshinte kryerjen e vlerësimeve individuale dhe (ii) Trupi Gjykses nuk arriti të saktësonte peshën dhënë secilës prej deklaratave bazë, pavarësisht nga ndryshimi i mundshëm për sa i përket besueshmërisë dhe vlerës provuese.²³⁵

101. ZPS-ja përgjigjet se argumentet e Haradinajt duhen rrëzuar si mospërputhëse dhe se janë në kundërshtim me gjykimin e shëndoshë.²³⁶ Si alternativë, ZPS-ja parashtron se Haradinaj nuk arrin të vërtetojë se u përdorën vetëm dëshmi të dorës së dytë dhe se ato ishin vendimtare për verdiktin e fajësisë së tij, duke mbajtur parasysh se z. Jukiq u mor në pyetje gjerësisht, dëshmia e tij në lidhje me masat e marra për

²³² Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 87, 90, 94.

²³³ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 91; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 19-20.

²³⁴ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 92-93, 98; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 21.

²³⁵ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 95-98; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 21.

²³⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 52.

dëshmitarët që u ndikuan nga kjo çështje nuk ishte e dorës së dytë, dhe Trupi Gjykses nuk u mbështet në kujtesën e tij për deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, të bëra gjatë vlerësimit të pasojave për dëshmitarë, se ndiheshin të kërcënuar dhe të frikësuar.²³⁷ ZPS-ja thekson se pasojat mbi dëshmitarë nuk ishin element i frikësimit dhe tentimit për pengim dhe se Haradinaj u shpall i pafajshëm për hakmarrje.²³⁸ Gjithashtu, ZPS-ja kujton se shumica e shënimeve për kontakte me dëshmitarë u shpallën të papranueshme, dhe ato që u pranuan në numër të kufizuar nuk shërbyen si bazë për përcaktimin se dëshmitarët pësuan pasoja të rënda.²³⁹ Së fundi, ajo parashtron se pretendimi i Haradinajt se Trupi Gjykses nuk arriti të saktësonte peshën që iu dha dëshmime të dorës së dytë, nuk evidenton gabim dhe është qartazi i pabazë.²⁴⁰

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

102. Paneli rrëzon menjëherë Pikën 7 të Apelit të Haradinajt, për arsyet e shtjelluara më poshtë. Së pari, Paneli rrëzon menjëherë argumentet e Haradinajt kur ato lidhen me hakmarrjen, duke marrë parasysh se ai u shpall i pafajshëm për këtë akuzë.²⁴¹

103. Së dyti, Paneli vë në dukje gjithashtu se ka mospërputhje midis formulimit të Haradinajt të kësaj pike të apelit (pretendimi se Trupi Gjykses nuk “përcaktoi se deri në cilën shkallë u mbështet në dëshmi të dorës së dytë”, as “saktësoi peshën që iu dha” dëshmime të dorës së dytë)²⁴² dhe argumenteve përkatëse (kur pretendoi se Trupi

²³⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 53-55.

²³⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 55.

²³⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 56.

²⁴⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 57. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 52.

²⁴¹ Aktgjykimi, para. 1016. *Shih më lart*, para. 31. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 92-93, ku Haradinaj sqaron se argumentet e tij në Pikën 7 të Apelit kundërshtojnë përdorimin e dëshmime të dorës së dytë, ndër të tjera, në lidhje me akuzën për hakmarrje. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 21. Paneli vë në dukje gjithashtu se, duke marrë parasysh shpalljen e pafajësisë për këtë Pikë, dëshmitë e dorës së dytë nuk mund të ishin përdorur vetëm dhe në mënyrë vendimtare për shpalljen e fajësisë së të akuzuarit në lidhje me këtë akuzë. *Shih Dimović Judgment*, para. 38. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 89-93, 98-99.

²⁴² Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 85. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 52. Paneli vë në dukje gjithashtu se janë bërë ndryshime materiale lidhur me këtë pikë të Apelit në Dosjen e Apelit të Haradinajt në krahasim me Njoftimin për Apel, gjë që përlligj rrezimin e menjëhershëm të pjesëve të

Gjykues përdori në mënyrë të papërshtatshme dëshmitë e dorës së dytë si bazë e vetme dhe vendimtare për shpalljen e fajësisë së akuzuarit,²⁴³ që do të përlligjte rrëzimin e menjëhershëm të kësaj pike të Apelit.²⁴⁴ Sidoqoftë, Haradinaj pranon se dëshmitë e dorës së dytë janë të pranueshme në gjykim dhe mund të mbështetesh në to²⁴⁵ dhe se Trupi Gjykes e shtjelloi qasjen e vet në lidhje me dëshmi të dorës së dytë.²⁴⁶

104. Së treti, megjithëse argumentet e Haradinajt përqendrohen në përdorimin e dëshmisë së z. Jukiq në lidhje me akuzat e frikësimit dhe pengimit,²⁴⁷ ai nuk përmend asnjë paragraf në Aktgjykim ku Trupi Gjykes faktikisht veproi në këtë mënyrë. Paragrafët nga Aktgjykimi që Haradinaj në fakt i citon në Njoftimin për Apel dhe në Dosjen e Apelit, nuk kanë aspak lidhje me argumentet e tij,²⁴⁸ ose u referohen konstatimeve paraprake të përgjithshme të Trupit Gjykes mbi pranimin dhe peshën atribuar dëshmive të dorës së dytë (dhe të tjera) në çështjen gjyqësore, ose dëshmive lidhur me atmosferën e përgjithshme të frikësimit në Kosovë (të cilat nuk duket se Haradinaj i kundërshton në vetvete në këtë pikë të Apelit).²⁴⁹ Rrjedhimisht, Haradinaj nuk përmbush kriteret formale të përcaktuara në nenin 47(1)(b)(2) të Udhëzuesit të Punës për Parashtrimet.²⁵⁰

kësaj pike të Apelit. *Shih* Njoftimin e Haradinajt për Apel, para. 11; Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 85.

²⁴³ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 86-99. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 52.

²⁴⁴ *Shih më lart*, para. 30-31.

²⁴⁵ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 87-90.

²⁴⁶ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 95.

²⁴⁷ Argumentet e Haradinajt lidhen gjithashtu me akuzën për hakmarrje, të cilat Paneli refuzon t'i marrë parasysh për arsyet e paraqitura më lart, në para. 102.

²⁴⁸ Aktgjykimi, para. 15, 251, 383, 518, që citohen në Dosjen e Apelit të Haradinajt, poshtëshënimet 92-93.

²⁴⁹ Aktgjykimi, para. 24-26, 33, 38-45, 577, që citohen në Njoftimin për Apel të Haradinajt, poshtëshënimet 92-95.

²⁵⁰ *Shih gjithashtu më lart*, para. 29.

105. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Haradinaj nuk arrin të demonstrojë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses. Për këto arsye, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 7 të Apelit të Haradinajt.

6. Pretendimet për gabime në lidhje me mosmiratimin prej Trupit Gjykses të kërkesës për përkufizimin e formave të përgjegjësisë penale dhe elementeve të veprës penale para lëshimit të Aktgjykimit (Pika 5 e Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

106. Haradinaj parashton se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që përkufizoi “format e përgjegjësisë penale dhe elementeve të veprës penale” vetëm pas përfundimit të gjykimit, duke mos i kërkuar ZPS-së që të evidentonte me konkretësi të mjaftueshme format konkrete të përgjegjësisë penale dhe synimin kriminal mbi të cilat bazohen akuzat në Aktakuzë.²⁵¹

107. Haradinaj parashton konkretisht se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që i udhëzoi palët të bënin parashtrime lidhur me elementet dhe format e përgjegjësisë penale, dhe që më pas zgjodhi të “shtynte” çdo vendim deri në shpalljen e Aktgjykimit.²⁵² Haradinaj argumenton se kjo donte të thoshte që për Mbrojtjen ishte e paditur se çfarë duhej të provonte ZPS-ja për çdo vepër penale, që “ndikoi negativisht” te të akuzuarit “në përgatitjen e mbrojtjes së tyre të drejtë, të bazuar në informacion, dhe strategjike”.²⁵³

108. ZPS-ja përgjigjet se kjo pikë e Apelit duhet të rrëzohet *in limine*, duke qenë se Haradinaj nuk jep arsyetim në mbështetje të pretendimit të tij, as “nuk shpjegon se si

²⁵¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 68.

²⁵² Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 70. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 69, që i referohet KSC-BC-2020-07, Transkripti, 8 shtator 2021, f. 710; Parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me Elementet e Veprave Penale dhe Format e Përgjegjësisë Penale. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 16.

²⁵³ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 70. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 16.

qëndrimi i Trupit Gjykses" e ka dëmtuar atë.²⁵⁴ ZPS-ja parashtron gjithashtu se për Mbrojtjen nuk ishte "e paditur" se çfarë duhej të provonte ZPS-ja për çdo veprë penale, dhe se format konkrete të përgjegjësisë penale dhe synimit kriminal mbi të cilat bazohen akuzat në Aktakuzë "ishin konkretizuar mjaftueshëm".²⁵⁵ Sipas ZPS-së, palëve iu dhanë mundësi të barabarta dhe të shumta gjatë gjykimit për të dhënë mendimet e tyre në lidhje me elementet e veprave penale dhe format e përgjegjësisë penale, dhe se ky vendim merret në aktgjykim në fund të gjykimit.²⁵⁶

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

109. Paneli i referohet jurisprudencës së vet se kundërshtimet ndaj kontureve ose elementeve të një veprë penale ose formës së përgjegjësisë penale janë aspekte që duhen trajtuar gjatë gjykimit.²⁵⁷ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit pajtohet me Trupin Gjykses se këto janë aspekte juridike dhe të provave që paraqiten dhe argumentohen si duhet gjatë fazës së gjykimit²⁵⁸ dhe faktikisht janë aspekte që duhen trajtuar gjatë fazës së hartimit të aktgjykimit për çështjen gjyqësore.²⁵⁹ Sikurse vuri në dukje Trupi Gjykses me të drejtë në vendimin e vet në lidhje me rregullën 130 të Rregullores:

Në këtë fazë Trupi Gjykses nuk do të shtjellojë elemente të veprave penale mbi të cilat janë ngritur akuzat, sepse kjo ka të bëjë me përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së të akuzuarve, në kuadër të vendimit të gjykimit. Rrjedhimisht, në kontekst të vendimit aktual, Trupi Gjykses i ka vlerësuar provat kundrejt elementeve të veprave penale për të cilat janë ngritur akuzat, sikurse i ka evidentuar Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Këto elemente kanë qenë të njohura për Mbrojtjen që nga nxjerrja e Vendimit të Konfirmimit. [...]

²⁵⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 37.

²⁵⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 38. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 39, që i referohet Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Rrëzimin e Akuzave, para. 26.

²⁵⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 39-40.

²⁵⁷ Vendimi mbi Apelet në lidhje me Juridiksionin në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 98, 100, 236; Vendimi mbi Mangësitë në Aktakuzë në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, para. 56, 177; Vendimi mbi Mangësitë në Aktakuzë në Çështjen Gjyqësore *Shala*, para. 32.

²⁵⁸ *Shih gjithashtu Tolimir* Appeal Decision on Jurisdiction, para. 10; *Gotovina et al.* Appeal Decision on Jurisdiction, paras 15, 18.

²⁵⁹ *Kordić and Čerkez* Decision on Judgement for Acquittal, para. 36; *Karadžić* Transcript, p. 28735, lines 12-13.

ZPS-ja është mbështetur në to si bazë normative relevante për paraqitjen e provave të saj. Ndonëse Mbrojtja natyrisht lejohet të kundërshtojë ato elemente si pjesë e paraqitjes së argumenteve të saj, ajo nuk pëson asnjë dëm nëse Trupi Gjykes vendos mbi ato kundërshtime në fund të çështjes gjyqësore.²⁶⁰

110. Paneli i Apelit vë në dukje se të dyja palët kanë paraqitur parashtrime të shumta me gojë dhe me shkrim, jo vetëm lidhur me provat por edhe me dispozitat ligjore përkatëse.²⁶¹ Gjithashtu, duke marrë parasysh se Haradinaj u informua qartazi se ZPS-ja u mbështet në dispozitat ligjore të shtjelluara në Vendimin e Konfirmimit,²⁶² Paneli është i mendimit se Haradinaj ishte në dijeni “se çfarë duhej të provonte ZPS-ja për secilën prej veprave penale” dhe nuk u “ndikua negativisht” gjatë përgatitjes për gjykim.²⁶³

111. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Haradinaj nuk arrin të vërtetojë se qëndrimi i Trupit Gjykes ishte i gabuar në aspektin juridik, ose se e ka dëmtuar atë. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 5 të Apelit të Haradinajt.

B. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME SHKELJEN E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS –
INFORMACIONI I MBROJTUR (PIKA 5)

112. Gucati dhe Haradinaj kundërshtojnë konstatimet e Trupit Gjykes lidhur me veprimin e fajshëm mbi të cilin mbështetet verdikti i fajësisë në lidhje me Pikën 5 të Aktakuzës (“Pika 5 e Aktakuzës”) për shkelje të fshehtësisë së procedurës nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, e

²⁶⁰ Vendimi mbi Mocionet e Mbrojtjes për Rrëzimin e Akuzave, para. 26.

²⁶¹ KSC-BC-2020-07, Transkripti, 8 shtator 2021, f. 647-683, 710; Parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me Elementet e Veprave Penale dhe Format e Përgjegjësisë Penale; Mocioni i Mbrojtjes sipas Rregullës 130, para. 11.

²⁶² Vendimi mbi Mocionet e Mbrojtjes për Rrëzimin e Akuzave, para. 26; Parashtrimet e ZPS-së lidhur me Dispozitat Ligjore Përkatëse, para. 1.

²⁶³ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 70.

ndëshkueshme sipas nenit 392(1) të KPK-së.²⁶⁴ ZPS-ja përgjigjet se pikat e Apeleve të të akuzuarve në lidhje me Pikën 5 të Aktakuzës duhen rrëzuar.²⁶⁵

113. Paneli kujton se vepra penale e shkeljes së fshehtësisë së procedurës nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, në nenin 392(1) të KPK-së përkufizohet si vijon:

Kushdo që pa autorizim zbulon informata për të cilat është njoftuar në procedurën zyrtare, që sipas ligjit nuk mund të zbulohen apo ato informata janë shpallur si fshehtësi me vendim të gjykatës apo të organit kompetent, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

114. Sikurse konstatoi Trupi Gjykses, për veprën penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës, brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së, nevojitet këto elemente materiale (*veprimi i fajshëm*): (i) zbulimi i paautorizuar i (ii) informacionit të nxjerrë në procedura zyrtare (iii) që sipas ligjit nuk duhet zbuluar dhe që është shpallur si i fshehtë me vendim të gjykatës apo të një autoriteti kompetent.²⁶⁶ Trupi Gjykses gjithashtu nënvizoi se, në mënyrë që informacioni të jetë objekt i nenit 392(1) të KPK-së, ai duhet të përmbushë njërin nga dy kriteret alternative: (i) zbulimi i tij duhet të jetë i ndaluar me ligj; ose (ii) duhet të jetë i shpallur i fshehtë nga gjykata ose autoriteti kompetent.²⁶⁷

²⁶⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 135-189; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 54, 188-193; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 31-46; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 54-56. *Shih gjithashtu* Aktakuzën, para. 33, 48. Paneli rikujton se sipas para. 48 të Aktakuzës, vepra penale “shkelje e fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedurë zyrtare” është e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 31, 32(1)-(2), 33 dhe 35 të KPK-së, të zbatueshme në bazë të neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

²⁶⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 77-86, 88. *Shih gjithashtu* Përgjigjen e ZPS-së, para. 47-51.

²⁶⁶ Aktgjykimi, para. 69.

²⁶⁷ Aktgjykimi, para. 76, 465.

115. Trupi Gjykes konstatoi se informacioni i mbrojtur²⁶⁸ u zbulua “pa autorizim”;²⁶⁹ se hetimet e prokurorisë përfshiheshin në kuadrin e “procedurës zyrtare”;²⁷⁰ se informacioni jo domosdoshmërisht duhej t’i bëhej i ditur drejtpërdrejt “kryesit”;²⁷¹ dhe se informacioni i mbrojtur i përmbushte kriteret e informacionit të shpallur të fshehtë nga autoriteti kompetent brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së.²⁷² Duke qenë se konstatoi se ishte përmbushur njëri nga dy kriteret alternative sipas nenit 392(1) të KPK-së, nuk ishte e nevojshme që Trupi Gjykes të verifikonte përmbushjen e tjetrit, por prapëseprapë vendosi që ta bënte këtë.²⁷³ Në fund, Trupi Gjykes u bind se informacioni i mbrojtur përfshihej brenda kuadrit të dy kriterëve alternative të përcaktuara në nenin 392(1) të KPK-së.²⁷⁴

116. Paneli i Apelit do t’i shqyrtojë kundërshtimet lidhur me konstatimet e Trupit Gjykes mbi veprimin e fajshëm të nenit 392(1) të KPK-së si vijon: (i) zbulimi i paautorizuar i (ii) informacionit të nxjerrë në procedurë zyrtare dhe (iii) që sipas ligjit nuk duhet të zbulohet, ose që është shpallur si i fshehtë me vendim të gjykatës apo të një autoriteti kompetent.

1. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet mbi “zbulimin e paautorizuar” (Pikat 4(G)-(H) dhe 5 të Apelit të Gucatit; Pika 3, pjesërisht, e Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

117. Gucati i referohet konstatimit të Trupit Gjykes se zbulimi i informacionit është “pa autorizim” nëse nuk lejohet me ligj dhe në Pikën 4(G)-(H) të Apelit të tij

²⁶⁸ Si informacion të mbrojtur, Trupi Gjykes përkufizoi kërkesat e TFHS-së dhe Përgjigjet e PSKL-së që përmbanin Paketat 1, 2 dhe 4 dhe dokumentet në Paketën 3. *Shih* Aktgjykimin, para. 473. *Shih gjithashtu* Shtojcën 2 të Aktgjykimit, f. 6.

²⁶⁹ Aktgjykimi, para. 73, 486-489.

²⁷⁰ Aktgjykimi, para. 74, 477-479.

²⁷¹ Aktgjykimi, para. 75.

²⁷² Aktgjykimi, para. 473.

²⁷³ Aktgjykimi, para. 474.

²⁷⁴ Aktgjykimi, para. 76-79, 465-476.

argumenton se nxjerrja e informacionit konfidencial me interes publik lejohet me ligj.²⁷⁵ Gjithashtu, në kuadër të Pikës 5 të Apelit të tij, Gucati argumenton se nxjerrja e informacionit konfidencial prej një sinjalizuesi lejohet me ligj dhe se ZPS-ja nuk arriti të vërtetonte se burimi i rrjedhjes së informacionit nuk ishte një sinjalizues.²⁷⁶

118. Haradinaj argumenton se Trupi Gjykses gaboi që mori parasysh Aktgjykimin *Hartman* të TPNJ-së në mbështetje të konstatimit të vet se, në qoftë se çfarëdo zbulimi i mëhershëm i paautorizuar i informacionit të mbrojtur do të kishte efektin e shfuqizimit të statusit të mbrojtur, kjo do të zhvlerësonte ose cenonte vetë qëllimin e nenit 392(1) të KPK-së.²⁷⁷ Haradinaj argumenton se në vend të kësaj, Trupi Gjykses duhej të ishte mbështetur në jurisprudencën e gjykatave të Kosovës.²⁷⁸ Për mendimin e Haradinajt, ky gabim cenon vlefshmërinë juridike të verdikteve të fajësisë.²⁷⁹

119. ZPS-ja i përgjigjet Gucatit se interesi publik do të përjashtonte përgjegjësinë penale, por nuk do të ndryshonte apo hidhte poshtë veprimin e fajshëm të veprës penale, dhe se ky interpretim është e vetmja mënyrë për të shmangur cenimin e vetë qëllimit të nenit 392(1) të KPK-së. Krahas kësaj, ZPS-ja parashton se Trupi Gjykses nuk gaboi që hodhi poshtë pretendimet e të akuzuarve në lidhje me interesin publik.²⁸⁰

120. ZPS-ja i përgjigjet Haradinajt se, edhe pse jurisprudenca e gjykatave të Kosovës nuk ishte detyruese për Trupin Gjykses, Trupi Gjykses e shqyrtoi me kujdes atë në Aktgjykim.²⁸¹

²⁷⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 190-202. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 46.

²⁷⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 203-208.

²⁷⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 54, poshtëshënimi 61.

²⁷⁸ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 54.

²⁷⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 54, poshtëshënimi 61. Haradinaj vë në dukje, por nuk kundërshton, konstatimin e Trupit Gjykses se çfarëdo zbulimi i mëhershëm i paautorizuar i informacionit të mbrojtur nuk do të kishte efektin e heqjes së statusit të mbrojtur, duke i bërë kështu zbulimet e mëvonshme të "autorizuara". *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 153.

²⁸⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 88.

²⁸¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 47-51.

(c) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

121. Paneli i Apelit fillimisht vëren se Trupi Gjykues konstatoi saktë se zbulimi i informacionit është “pa autorizim” nëse nuk është i lejuar me ligj apo me vendim të gjykatës apo të autoritetit kompetent.²⁸² Rrjedhimisht pyetja që shtrohet është nëse, në këtë çështje gjyqësore, zbulimi i informacionit ishte i lejuar.

122. Gucati parashtron se në disa rrethana nxjerrja e informacionit konfidencial mund të jetë e lejuar me ligj.²⁸³ Paneli vëren se Gucati mbështetet në nenin 200(2) të KPK-së, por konstaton se kjo dispozitë është në përputhje me konstatimet e Trupit Gjykues se në pajtim me nenin 200(2) dhe (4) të KPK-së, në qoftë se vërtetohet, interesi publik në rrethana të posaçme do të përjashtonte përgjegjësinë penale, por nuk do të ndikonte në veprimin e fajshëm të veprës penale sipas nenit 392(1) të KPK-së.²⁸⁴ Rrjedhimisht, argumentet e Gucatit nuk janë relevante në këtë kontekst, i cili ka të bëjë me veprimin e fajshëm të veprës penale në Pikën 5 të Aktakuzës. I njëjti arsyetim vlen edhe për pretendimin e Gucatit se nxjerrja e informacionit konfidencial prej një sinjalizuesi lejohet me ligj. Gjithsesi, Paneli i Apelit i ka shqyrtuar Pikat 4(G)-4(H) dhe 5 të Apelit të Gucatit në pjesën për argumentet mbrojtëse në këtë Aktgjykim.²⁸⁵

123. Paneli gjithashtu vëren se Haradinaj kundërshton mbështetjen e Trupit Gjykues në Aktgjykimin *Hartman* të TPNJ-së.²⁸⁶ Megjithatë, Haradinaj nuk

²⁸² Aktgjykimi, para. 73, 486.

²⁸³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 190-212. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 46-48.

²⁸⁴ Aktgjykimi, para. 487. Gjithashtu, Trupi Gjykues konstatoi se: “[n]ë rastet kur faktorët e interesit publik kanë më shumë peshë se interesi për mbrojtjen e informacionit, ata mund të përjashtojnë përgjegjësinë penale të personit *pavarësisht nga kryerja e veprës penale*”. *Shih* Aktgjykimin, para. 487. Paneli i Apelit rikujton se nocioni i arsyeve që përjashtojnë përgjegjësi penale nuk nënkupton që nuk është kryer veprë penale në rrethana kur janë vërtetuar si veprimi i fajshëm ashtu edhe synimi kriminal. Ky nocion thjesht do të thotë që, edhe pse është përmbushur elementi i veprimit të fajshëm të veprës penale, një i akuzuar nuk është penalisht përgjegjës për atë veprë penale, meqenëse përgjegjësia e tij përjashtohet në bazë të arsyes ose arsyeve përkatëse. *Shih më poshtë*, para. 323.

²⁸⁵ *Shih më poshtë*, para. 321-340, 347-349. Paneli i Apelit tashmë ka shqyrtuar argumentet e Gucatit të paraqitura në Pikën 4(H) të Apelit të tij në lidhje me mosnxjerrjen e Paketave. *Shih më lart*, para. 65-73.

²⁸⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 54, poshtëshënimi 61. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 488.

kundërshton thelbin e vetë përfundimeve të Trupit Gjykses, por thjesht faktin që Trupi Gjykses u mbështet në jurisprudencën e TPNJ-së dhe jo në jurisprudencën e Kosovës.²⁸⁷ Paneli rikujton se Ligji përcakton qartë se gjykatësit mund të mbështeten në burime të së drejtës ndërkombëtare, ku përfshihen edhe burimet dytësore, si për shembull jurisprudenca e tribunalëve ndërkombëtarë të përkohshëm, e Gjykatës Penale Ndërkombëtare dhe e gjykatave të tjera penale.²⁸⁸ Rrjedhimisht, Paneli konstaton se mbështetja e Trupit Gjykses në jurisprudencën e TPNJ-së, në vetvete, nuk mund të përbëjë gabim juridik.

124. Në bazë të sa më lart, Paneli konstaton se të akuzuarit nuk arritën të provonin gabim në konstatimin e Trupit Gjykses se zbulimi i informacionit të mbrojtur ishte i paautorizuar. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon pjesën përkatëse të Pikës 3 të Apelit të Haradinajt.²⁸⁹

2. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet mbi “informacionin e nxjerrë në procedurë zyrtare” (Pika 4(A) e Apelit të Gucatit)

(a) Parashtrimet e palëve

125. Gucati parashtron se, sipas nenit 392(1) të KPK-së, informacioni duhet t’i jetë bërë i ditur kryesisht në një procedurë zyrtare.²⁹⁰

²⁸⁷ Paneli vëren se Haradinaj kundërshton konstatimin se çfarëdo zbulimi i mëhershëm i paautorizuar i informacionit të mbrojtur nuk do të kishte efektin e heqjes së statusit të mbrojtur, duke i bërë kështu zbulimet e mëvonshme të “autorizuara” brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së. Megjithatë, ai nuk e ka shtjelluar këtë kundërshtim në lidhje me Pikën 5 të Aktakuzës. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 153.

²⁸⁸ Neni 3(3) i Ligjit. *Shih gjithashtu* Vendimin e Apelit mbi Arrestimin dhe Paraburgimin e Gucatit, para. 11.

²⁸⁹ Kundërshtimet e tjera të paraqitura në Pikën 3 të Apelit të Haradinajt, Paneli i ka shqyrtuar në pjesën për bashkimin e veprave penale sipas Pikës 2 të Aktakuzës. *Shih më poshtë*, para. 301-310.

²⁹⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para.135. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 147. Gucati argumenton se, nga ana tjetër, informacioni i mbrojtur që një person e dëgjon rastësisht, për shembull në tren, nuk është informacion “i nxjerrë në ndonjë procedurë zyrtare”. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 136.

126. Gucati gjithashtu parashtroi se, në kundërshtim me konstatimet e Trupit Gjykses, kryes i kësaj veprë penale mund të jetë vetëm “marrësi i parë i informacionit”, të cilit i është bërë i ditur ai informacion gjatë një procedure zyrtare.²⁹¹ Sipas Gucatit, një person i cili dëgjon ose rastësisht vihet në zotërim të një informacioni që nuk duhet të nxirret në bazë të një vendimi të gjykatës, nuk mund të jetë “cak” i veprës penale sipas nenit 392(1) të KPK-së.²⁹² Për mendimin e Gucatit, ky interpretim nuk do të thotë që një person të tillë “nuk e kap ligji”, duke qenë se vepra penale të tjera, si për shembull ato të nenit 393 të KPK-së, mund të jenë ende të zbatueshme në lidhje me atë person.²⁹³

127. Gucati më tej parashtroi se shkëmbimi i informacionit brenda TFHS-së/ZPS-së, ose informacioni që TFHS-ja/ZPS-ja dhe homologët e tyre kanë shkëmbyer në kuadër të bashkëpunimit për qëllime hetimore, mund të cilësohet si “nxjerrje” brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së vetëm kur kryesi i pretenduar përfshihet në njërin prej këtyre dy kategorive (TFHS/ZPS ose homologët e tyre).²⁹⁴ Meqenëse ai vetë nuk përfshihej në asnjërin prej këtyre dy kategorive, Gucati argumenton se nuk ishte bërë “nxjerrje në çfarëdo procedure zyrtare” e informacionit që zbuloi ai.²⁹⁵ Gucati i referohet nenit 2(3) të KPK-së dhe argumenton se çdo paqartësi në KPK duhet të interpretohet në mënyrën më të favorshme për të akuzuarit.²⁹⁶

128. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykses nuk bëri gabim dhe se, sipas formulimit të qartë të nenit 392(1) të KPK-së, nuk është e domosdoshme që informacioni t’i nxirret drejtpërdrejt dhe vetëm kryesit në procedurë zyrtare.²⁹⁷

²⁹¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 137, 142; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 31-32. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 143.

²⁹² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 137.

²⁹³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 138-141. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 34.

²⁹⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 144.

²⁹⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 144-145.

²⁹⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 33.

²⁹⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 77-78.

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

129. Paneli vëren se Gucati nuk kundërshton përkufizimin prej Trupit Gjykues të nocionit “procedurë zyrtare”, as konstatimin përkatës se, në përputhje me KPK-në dhe KPrPK-në, hetimet e prokurorisë janë pjesë e “procedurës penale”, e cila përfshihet në përkufizimin e “procedurës zyrtare”.²⁹⁸

130. Megjithatë, Gucati kundërshton konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me cakun e veprës penale, sepse, për mendimin e tij, kryes i veprës penale sipas nenit 392(1) të KPK-së mund të jenë vetëm TFHS-ja/ZPS-ja ose homologët e tyre të cilëve u është bërë i ditur informacioni i nxjerrë në një procedurë zyrtare.²⁹⁹

131. Paneli nuk gjykon se neni 392(1) i KPK-së duhet interpretuar në mënyrë aq të ngushtë. Përkundrazi, Paneli vëren se në nenin 392(1) i KPK-së thuhet “[k]ushdo që pa autorizim zbulon informata” dhe, në bazë të kuptimit të qartë dhe të drejtpërdrejtë të fjalës “kushdo”, kjo përfshin *çdo person*, pavarësisht nëse personi është pjesë e procedurave zyrtare të Dhomave të Specializuara.³⁰⁰ Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë interpretimin e Gucatit dhe pajtohet me konstatimin e Trupit Gjykues se neni 392(1) i KPK-së nuk kërkon specifikisht që informacioni duhet t’i jetë nxjerrë drejtpërsëdrejti kryesit të veprës penale dhe se një interpretim i ndryshëm do të ishte në kundërshtim me kuptimin e drejtpërdrejtë të dispozitës, si dhe me vetë qëllimin e kësaj dispozite që është mbrojtja e fshehtësisë së procedurës.³⁰¹

132. Duke qenë se Paneli konfirmoi se neni 392(1) i KPK-së nuk kërkon specifikisht që informacioni duhet t’i jetë nxjerrë drejtpërsëdrejti kryesit të veprës penale, nuk është e nevojshme që Paneli të shqyrtojë argumentet e mbetura të Gucatit se neni 392(1) i KPK-së nuk është i zbatueshëm në lidhje me një person i cili rastësisht dëgjon

²⁹⁸ Aktgjykimi, para. 74.

²⁹⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 137-146.

³⁰⁰ *Shih* Komentarin *Salihu dhe të tjerët*, nenin 400(1) të KPK-së të vitit 2012, komentet 4, 11, f. 1142-1143.

³⁰¹ Aktgjykimi, para. 75.

ose vihet në zotërim të një informacioni që është objekt i një vendimi të gjykatës për mosnxjerrje informacioni, por se mund të jenë të zbatueshme nene të tjera të KPK-së.³⁰²

133. Gjithashtu, Paneli nuk pajtohet me argumentin e Gucatit se, që një veprim të mund të cilësohet si “nxjerrje informacioni” brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së, kryesi i pretenduar duhet të jetë TFHS-ja/ZPS-ja ose homologët e tyre.³⁰³ Edhe në lidhje me këtë, Paneli konstaton se kuptimi i thjeshtë ose i drejtpërdrejtë i fjalës “nxjerrje informacioni” nuk sugjeron një interpretim aq të ngushtë. Në këtë kontekst, Paneli rikujton jurisprudencën përkatëse të TPNJ-së, sipas së cilës fjala “nxjerrje informacioni” :

[...] duhet interpretuar këtu në kuptimin e vet të drejtpërdrejtë, që është zbulimi i diçkaje që më parë ka qenë konfidenciale. Si rrjedhojë, kalimi i informacionit një personi të tretë do të përbënte nxjerrje informacioni, sikurse edhe vetë publikimi i atij informacioni në gazetë.³⁰⁴

134. Kur zbatohet në rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore, nxjerrja e informacionit mbulon sjelljen e kryesit të drejtpërdrejtë të veprës penale – domethënë, personin që ia kaloi informacionin konfidencial Gucatit dhe Haradinajt – si dhe shpërndarjen e mëpasshme të atij informacioni nga ana e të akuzuarve, sikurse paraqitet në Aktakuzë.³⁰⁵

135. Paneli gjithashtu konstaton se, në kundërshtim me pretendimin e Gucatit,³⁰⁶ formulimi i nenit 392(1) të KPK-së nuk përlligj në asnjë rrethanë zbatimin e nenit 2(3) të KPK-së, sipas të cilit, në rast paqartësie, përkufizimi i një veprë penale interpretohet në favor të të akuzuarit (kriteri *lex mitior*). Pasi ka konstatuar se nuk ka paqartësi në

³⁰² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 137-141. Në bazë të konstatimit të vet, Paneli gjykon se hipoteza e Gucatit për një zbulim informacioni që mund të ndodhte në tren nuk është relevante në kontekstin e kësaj çështjeje gjyqësore dhe nuk ndikon në konstatimet e Trupit Gjyqësor. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 136.

³⁰³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 144.

³⁰⁴ *Marijačić and Rebić Trial Judgment*, para. 17.

³⁰⁵ Aktakuza, para. 6.

³⁰⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 33.

interpretimin e nenit 392(1) të KPK-së, Paneli nuk ka nevojë të mbështetet në nenin 2(3) të KPK-së.

136. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Gucati nuk ka arritur të provojë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses mbi “informacionin e nxjerrë në procedurë zyrtare”. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 4(A) të Apelit të Gucatit.

3. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet mbi [informata] “që sipas ligjit nuk mund të zbulohen, apo[...] janë shpallur si fshehtësi me vendim të gjykatës apo të organit kompetent” (Pika 4(B)-(F) e Apelit të Gucatit; Pika 21 e Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

137. Alternativa e parë e nenit 392(1) të KPK-së penalizon zbulimin e paautorizuar të informacionit “i cili, sipas ligjit, nuk duhet të zbulohet”. Sipas Gucatit, konstatimi i Trupit Gjykses se ishte përmbushur edhe ky kriter bazohet në interpretimin e gabuar të rregullës 106 të Rregullores dhe nenit 62(1) të Ligjit, të cilët nuk ndalojnë shprehimisht zbulimin e një produkti të punës së brendshme të ZPS-së.³⁰⁷

138. Në lidhje me alternativën e dytë të nenit 392(1) të KPK-së për informacionin e “shpallur si fshehtësi me vendim të gjykatës apo të organit kompetent”, Gucati argumenton se “sekreti” përkufizohet në Ligjin e Kosovës për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, dhe se KPK-ja duhet të interpretohet në përputhje me legjislacionin e Kosovës.³⁰⁸ Gucati nënvizon se, sipas këtij përkufizimi, informacioni mund të shpallet “sekret” vetëm në kushte të caktuara dhe se në këtë

³⁰⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 156-166; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 40.

³⁰⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 147-149, 151-153. Gucati shton se Ligji i Kosovës për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë zbatohet në lidhje me “të gjitha institucionet publike në Kosovë që ushtrojnë kompetenca ekzekutive dhe gjyqësore”. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 150; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 41.

çështje gjyqësore nuk kishte asnjë provë për ndonjë informacion të shpallur konkretisht “sekret” nga ZPS-ja/TFHS-ja në bazë të ligjit të lartpërmendur.³⁰⁹

139. Megjithëse pajtohet se Ligji i Kosovës për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë nuk është i përfshirë në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara, Gucati argumenton se neni 392(1) i KPK-së duhet të interpretohet në kontekstin e legjislacionit të Kosovës në tërësi.³¹⁰ Haradinaj paraqet argumente të ngjashme dhe parashtron se Trupi Gjyqësor nuk mori parasysh dhe nuk zbatoi përkufizimin konkret të “informacionit sekret” sipas Ligjit të Kosovës për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.³¹¹

140. Gucati gjithashtu thekson se sipas nenit 392(1) të KPK-së, ZPS-ja duhet të vërtetojë ligjshmërinë e çfarëdo vendimi dhe/ose deklarate se informacioni për të cilin ngrihen kundërshtime, ishte me të vërtetë i fshehtë.³¹² Gucati argumenton se Trupi Gjyqësor gaboi që konstatoi se ishte e mjaftueshme që ZPS-ja thjesht e trajtoi ose shënoi informacionin si konfidencial, pavarësisht nga formulimet në Ligjin e Kosovës për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë dhe dispozitat përkatëse të Rregullores të cilat përcaktojnë kritere specifike, si procedurale ashtu edhe juridikisht thelbësore për vendime dhe deklarata mbi klasifikimin.³¹³

141. Për më tepër, Gucati pretendon se ZPS-ja duhej të vërtetonte se informacioni ishte klasifikuar si i fshehtë në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë.³¹⁴ Megjithatë, Gucati argumenton se, me përjashtim të gjashtë “dëshmitarëve/dëshmitarëve të mundshëm”

³⁰⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 149, 152-155; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 38-39. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 167-171.

³¹⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 34-35.

³¹¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 188-193; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 54-56. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 95-97; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 198-199.

³¹² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 167, 178, 180. Gucati argumenton se kriteret e nenit 392(1) të KPK-së “kërkojnë vendim të vijuar me deklaratë” (theksimi në origjinal). *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 167, 174.

³¹³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 167-179; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 41.

³¹⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 180-182. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 43.

të identifikuar, ZPS-ja nuk paraqiti prova në lidhje me identitetet e personave prej të cilëve kërkoi të merrte informacion.³¹⁵ Sipas tij, ZPS-ja nuk paraqiti asnjë provë se çfarë informacioni kërkonte të merrte prej “dëshmitarëve/dëshmitarëve të mundshëm”, dhe as arsytet pse.³¹⁶ Rrjedhimisht, Gucati pretendon se Trupi Gjykses nuk pati mundësi të shqyrtonte përmbajtjen e materialit të kundërshtuar dhe të verifikonte vetë nëse informacioni i kundërshtuar në atë material duhej të klasifikohet si konfidencial, dhe nëse klasifikimi ishte bërë në mënyrë abuzive.³¹⁷

142. Sipas Gucatit, Trupi Gjykses gjithashtu gaboi dhe ia kaloi Mbrojtjes detyrimin e vërtetimit kur konstatoi se nuk iu paraqitën prova se TFHS-ja/ZPS-ja trajtoi si konfidencial informacion që lidhej me këtë çështje gjyqësore në mënyrë abuzive.³¹⁸

143. Haradinaj argumenton se akuzohet vetëm sipas alternativës së dytë të nenit 392(1) të KPK-së, që është “zbulimi i paautorizuar i informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare”, dhe se, rrjedhimisht, nuk akuzohet në lidhje me “informacion që sipas ligjit nuk duhet të zbulohet”.³¹⁹

144. ZPS-ja argumenton se në Aktakuzë përfshihej qartë edhe alternativa tjetër e nenit 392(1) të KPK-së, dhe se Trupi Gjykses bëri konstatime lidhur me të dy alternativat e nenit 392(1) të KPK-së, i cili penalizon zbulimin e informacionit “që sipas ligjit nuk mund të zbulohet” ose që është “shpallur si sekret”.³²⁰

³¹⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 183.

³¹⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 183.

³¹⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 183-184, 187; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 43-45. Argumentet e Gucatit në lidhje me mosnxjerrjen e Paketave janë shqyrtuar në pjesën për nxjerrjen e informacionit. *Shih më lart*, para. 65-73. Gucati gjithashtu argumenton se dëshmia e znj. Pumper nuk ndihmoi në lidhje me procedurën e klasifikimit. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 185-186. Kundërshtimet ndaj dëshmisë së znj. Pumper janë shqyrtuar në pjesë të tjera të këtij Aktgjykimi. *Shih më lart*, para. 66-72; *Shih më poshtë*, para. 239-242.

³¹⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 188-189; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 44-45.

³¹⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 189-191. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 147. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 97.

³²⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 80. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 139.

145. Në lidhje me alternativën e parë, ZPS-ja parashtron se argumentet e Gucatit mbi moszbatueshmërinë e rregullës 106 të Rregullores dhe të nenit 62 të Ligjit duhet të rrëzohen sepse pavarësisht nga kjo, Trupi Gjykues konstatoi se informacioni ishte shpallur i fshehtë edhe brenda kuptimit të alternativës së dytë të nenit 392(1) të KPK-së. Sipas ZPS-së, këto pika të Apelit mund të rrëzohen menjëherë, me rrëzimin e pikave të Apelit sipas alternativës së dytë.³²¹

146. ZPS-ja gjithashtu argumenton se, gjithsesi, argumentet e Gucatit lidhur me alternativën e parë të nenit 392(1) të KPK-së janë të pathemelta, meqenëse dispozitat ku u mbështet Trupi Gjykues (rregulla 106 e Rregullores ose neni 62 i Ligjit) janë brenda kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara.³²²

147. Në lidhje me alternativën e dytë, ZPS-ja parashtron se Trupi Gjykues konstatoi me të drejtë se ZPS-ja është “autoriteti kompetent” brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së dhe se termi “sekret” duhet të interpretohet në përputhje me kuptimin e tij të drejtpërdrejtë, dhe thekson se Ligji i Kosovës për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë nuk përfshihet përmes referencave as në nenin 392(1) të KPK-së, as në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara.³²³ ZPS-ja gjithashtu parashtron, ndër të tjera, se provat që u pranuan në gjykim tregojnë se materiali i nxjerrë ishte konfidencial dhe se Gucati nuk arrin të vërtetojë se asnjë panel i arsyeshëm nuk do të mund të arrinte në përfundimin se informacioni i fshehtë u shpall si i tillë në mënyrë të ligjshme.³²⁴

³²¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 81.

³²² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 82.

³²³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 79-80, 83-84. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 139-140.

³²⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 85-86.

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

148. Paneli do ta fillojë vlerësimin me kundërshtimet ndaj alternativës së dytë të nenit 392(1) të KPK-së lidhur me informacionin që “është shpallur si fshehtësi me vendim të gjykatës apo të organit kompetent”.

149. Megjithëse Ligji i Kosovës për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë mund të shërbejë si burim informacioni për interpretimin e dispozitave të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara, ai nuk është i zbatueshëm në këtë çështje gjyqësore. Paneli rikujton se ky ligj i Kosovës nuk është përfshirë në Ligj përmes referencave dhe rrjedhimisht, në përputhje me nenin 3(4) të Ligjit, nuk është i zbatueshëm në juridiksionin e Dhomave të Specializuara.³²⁵ Paneli pajtohet me konstatimet e Trupit Gjyqësor dhe parashtrimet e ZPS-së³²⁶ se në nenin 392(1) të KPK-së, termi “fshehtësi” përdoret në kuptimin e tij të përgjithshëm, që do të thotë se informacioni nuk mund t’u jepet personave të paautorizuar.³²⁷ Rrjedhimisht, Paneli gjykon se termat “fshehtësi” dhe “konfidencial” nuk duhen kuptuar ndryshe nga njëri-tjetri dhe nga kuptimi i përgjithshëm i fjalës “fshehtësi” në kontekstin aktual. Rrjedhimisht, informacioni i trajtuar si konfidencial nga ZPS-ja duhet konsideruar si “fshehtësi” brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së.

150. Paneli vëren se Gucati nuk kundërshton konstatimin se ZPS-ja i përmbush kriteret e autoritetit kompetent brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së, por parashtron se ZPS-ja nuk arriti të vërtetonte se klasifikimi i informacionit nuk u bë në mënyrë abuzive.³²⁸ Paneli e ka të qartë se këtu Gucati i referohet konstatimit të Trupit Gjyqësor se “nuk i janë paraqitur prova se TFHS-ja ose ZPS-ja e ka bërë këtë në mënyrë

³²⁵ Sipas nenit 3(4) të Ligjit: “[ç]do ligj, rregullorë, rregullorë dytësore, rregull ose zakon tjetër dhe praktikë e Kosovës, që nuk janë përfshirë shprehimisht në këtë ligj, nuk zbatohen për organizimin, administrimin, funksionet apo juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.”.

³²⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 83.

³²⁷ Aktgjykimi, para. 78.

³²⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 180-189.

abuzive apo të panevojshme sa i përket çfarëdo informacioni që është relevant për këtë proces".³²⁹

151. Paneli vëren se Ligji dhe Rregullorja i lejojnë ZPS-së që me nismën e vet të marrë masa mbrojtëse, ndër të tjera, në bazë të neneve 35(2)(f) dhe 54(8) të Ligjit dhe rregullave 30(2)(a), 82, 106 dhe 107(1) të Rregullores.³³⁰ Kompetenca e ZPS-së për marrjen e masave mbrojtëse konfirmohet gjithashtu nga neni 61(4) i Ligjit. Sipas këtyre dispozitave, ZPS-ja ka kompetencë të marrë masat e nevojshme për të garantuar, në veçanti, konfidencialitetin e informacionit dhe mbrojtjen e cilitdo personi. Asnjë nga këto dispozita nuk kërkon nga paneli që të mbikëqyrë ligjshmërinë apo drejtësinë e veprimeve të ZPS-së. Kjo buron nga parimi më i përgjithshëm sipas të cilit ZPS-ja është e pavarur në kryerjen e funksioneve të veta. Në përputhje me këtë, masat mbrojtëse të miratuara nga ZPS-ja përmbushin kushtin e informacionit të shpallur të fshehtë nga autoriteti kompetent dhe për to nuk duhet vendimi i panelit. Pretendimi i Gucatit se ZPS-ja duhet të vërtetojë ligjshmërinë e deklaratës dhe vendimit³³¹ është rrjedhimisht i pabazë.³³² Në fakt, Trupi Gjykyes nuk bëri konstatime nëse informacioni ishte shpallur i fshehtë me një vendim gjykate, por shqyrtoi vetëm nëse informacioni i mbrojtur i përmbushte kushtet e informacionit të shpallur të fshehtë nga një autoritet kompetent, brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së.³³³

152. Paneli i Apelit vëren se Gucati gjithashtu kundërshton nxjerrjen e kufizuar prej ZPS-së të informacionit të mbrojtur,³³⁴ por kujton se këto kundërshtime i ka trajtuar në

³²⁹ Aktgjykimi, para. 472.

³³⁰ *Shih* Aktgjykimin, para. 78.

³³¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 167, 178.

³³² *Shih më poshtë*, para. 183-185. Përmendja nga Gucati e Komentarit *Salihu dhe të tjerët* në mbështetje të argumenteve të tij është e pavend. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 180, poshtëshënimi 103, që i referohet Komentarit *Salihu dhe të tjerët*, nenit 400(1) të KPK-së të vitit 2012, komenti 10, f. 1142-1143 sipas të cilit, nëse informacioni është shpallur konfidencial me vendim të kundërligjshëm të gjykatave apo institucioneve, për shembull, kur në mënyrë të kundërligjshme është përjashtuar publiku nga shqyrtimi gjyqësor, atëherë kjo vepër penale nuk do të konsumohej.

³³³ Aktgjykimi, para. 473.

³³⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 183-184.

pjesë të tjera të këtij Aktgjykimi.³³⁵ Paneli në veçanti konstatoi se në lidhje me akuzat kundër të akuzuarve, mjafton që vetëm një dokument që përmbanin Paketat të ishte konstatuar konfidencial dhe Trupi Gjykses nuk kishte nevojë të vërtetonte se të gjitha dokumentet që përmbanin Paketat ishin konfidenciale.³³⁶ Paneli i Apelit më tej vë në dukje se Trupi Gjykses konstatoi se informacioni që përmbanin Paketat ishte konfidencial.³³⁷

153. Sido që të jetë, meqenëse Paneli i Apelit tashmë ka konstatuar se ZPS-ja nuk kishte detyrimin për të vërtetuar se informacioni i mbrojtur ishte klasifikuar ligjërisht dhe drejtësisht si konfidencial, ai gjykon se sasia e materialit të nxjerrë nga ZPS-ja nuk është relevante për vlerësimin e kundërshtimeve ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me Pikën 5 të Aktakuzës.

154. Bazuar në sa më lart, Paneli rrëzon argumentet e Mbrojtjes se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se informacioni i mbrojtur konsiderohej si informacion i shpallur i fshehtë nga autoritetet kompetente brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së.³³⁸

155. Duke qenë se hodhi poshtë kundërshtimet lidhur me njërin nga dy alternativat e nenit 392(1) të KPK-së, Paneli nuk ka nevojë të shqyrtojë kundërshtimet lidhur me përmbushjen e alternativës tjetër, përkatësisht nëse informacioni i mbrojtur gjithashtu përmbushte kriterin e informacionit “i cili, sipas ligjit, nuk duhet të zbulohet”. Kjo për arsye se, edhe nëse do të ishin të suksesshme, këto kundërshtime nuk do të ndikonin aspak në Aktgjykimin e Trupit Gjykses sa i përket shpalljes së fajësisë së të akuzuarve sipas nenit 392(1) të KPK-së, sepse për përmbushjen e veprimit të fajshëm të veprës penale mjafton të jetë përmbushur njëra nga dy alternativat e kësaj dispozite. Rrjedhimisht është i zbatueshëm parimi i përgjithshëm se argumentet që nuk kanë

³³⁵ *Shih më lart*, para. 65-73.

³³⁶ *Shih më lart*, para. 68.

³³⁷ Aktgjykimi, para. 424-458.

³³⁸ Aktgjykimi, para. 473.

gjasa të çojnë në shfuqizimin e një vendimi të kundërshtuar mund të rrëzohen menjëherë dhe nuk ka nevojë të shqyrtohet themelësia e tyre.³³⁹ Për të njëjtat arsye, Paneli rrëzon menjëherë argumentin e Haradinajt se, sipas Pikës 5 të Aktakuzës, ai nuk akuzohet në lidhje me “informacion, i cili sipas ligjit, nuk duhet të zbulohet”.³⁴⁰

156. Në përputhje me sa më lart, Paneli rrëzon pjesën e mbetur të Pikës 4 të Apelit të Gucatit dhe Pikën 21 të Apelit të Haradinajt.

C. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME SHKELJEN E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS – PERSONA TË MBROJTUR (PIKA 6 E AKTAKUZËS)

157. Gucati dhe Haradinaj kundërshtojnë konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me veprimin e fajshëm mbi të cilin bazohet shpallja e fajësisë së tyre sipas Pikës 6 të Aktakuzës (“Pika 6 e Aktakuzës”) për zbulimin e paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, e ndëshkueshme në bazë të neneve 392(2) dhe (3) të KPK-së.³⁴¹ ZPS-ja përgjigjet se pikat e apeleve të të akuzuarve në lidhje me Pikën 6 të Aktakuzës duhen hedhur poshtë.³⁴²

158. Paneli rikujton se vepra penale e shkeljes së fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur dhe forma e rëndë e veprës penale brenda kuptimit të nenit 392(2) dhe (3) të KPK-së, përkufizohen si vijon:

2. Kushdo që pa autorizim zbulon të dhëna për identitetin apo të dhënat personale të personit të mbrojtur në procedurë penale apo në

³³⁹ *Shih më lart*, para. 31.

³⁴⁰ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 189-191.

³⁴¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 214-278; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 103-107, 194-208; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 49-69. *Shih gjithashtu*, Aktakuzën, para. 34-35, 48. Paneli rikujton se sipas para. 48 të Aktakuzës, vepra penale “shkelje e fshehtësisë së procedurës, përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur” është e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33 dhe 35 të KPK-së, të zbatueshme në bazë të neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

³⁴² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 89-104.

programin e veçantë të mbrojtjes, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me pasoja të rënda për personin e mbrojtur ose procedura penale bëhet e pamundur ose vështirësohet në masë të madhe, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

159. Trupi Gjykses theksoi se neni 392(2) i KPK-së përbën një formë të zbulimit të paautorizuar të informacionit të mbrojtur sipas nenit 392(1) të KPK-së dhe nënvizoi se konstatimet e tij sipas nenit 392(1) të KPK-së për këtë nënkategori zbatohen *mutatis mutandis*, përveç nëse Trupi Gjykses vendos ndryshe.³⁴³

160. Trupi Gjykses konstatoi se “informacioni për identitetin ose të dhënat personale” të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm që përmbante informacioni i mbrojtur, u zbulua “pa autorizim” dhe se dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm përkatës ishin “person[a] të mbrojtur në procedurë penale” brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së.³⁴⁴ Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se zbulimi i paautorizuar çoi në pasoja të rënda për personat e mbrojtur sipas nenit 392(2) të KPK-së, dhe se për pasojë forma e rëndë e kësaj veprë penale, e ndëshkueshme në bazë të nenit 392(3) të KPK-së, ishte përmbushur në lidhje me dëshmitarët e rrezikuar.³⁴⁵

161. Paneli do t’i shqyrtojë kundërshtimet në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm të veprës penale në nenin 392(2) të KPK-së si vijon: (i)

³⁴³ Aktgjykimi, para. 92, që i referohet Vendimit të Konfirmimit, para. 43. Në Pikën 6 të Apelit të tij, Gucati argumenton se sipas neneve 392(1) dhe 392(2) të KPK-së, vepra penale kryhet vetëm kur zbulimi i informacionit për identitetin ose të dhënat personale të një personi të mbrojtur në procedura penale bëhet “pa autorizim”. Në bazë të kësaj, ai argumenton se parashtrimet e tij në lidhje me: (i) klasifikimin e kërkesave të TFHS-së dhe përgjigjeve të PSKL-së si konfidenciale, dhe (ii) bazën e ligjshme për zbulimin e materialit të kundërshtuar në lidhje me Pikën 5 të Aktakuzës, vlejné *mutatis mutandis* edhe në lidhje me Pikën 6 të Aktakuzës. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 215-216. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 89. Konstatimet e Panelit mbi këto aspekte në lidhje me Pikën 5 të Aktakuzës vlejné *mutatis mutandis* edhe në lidhje me Pikën 6 të Aktakuzës.

³⁴⁴ Aktgjykimi, para. 89, 94-99, 509-527. Trupi Gjykses vuri në dukje se ZPS-ja nuk pretendoi se të akuzuarit zbuluan informacionin për identitetin apo të dhënat personale të një personi në një program special të mbrojtjes, dhe për rrjedhojë nuk e shqyrtoi këtë element alternativ. *Shih* Aktgjykimin, para. 508.

³⁴⁵ Aktgjykimi, para. 100, 534-547, 552.

“person” [i mbrojtur në procedurë penale], dhe (ii) [person] “i mbrojtur në procedurë penale”. Më pas, Paneli do të shqyrtojë kundërshtimet në lidhje me formën e rëndë të kësaj veprë penale sipas nenit 392(3) të KPK-së.

1. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet mbi “person” [të mbrojtur në procedurë penale] (Pika 8(A) e Apelit të Gucatit; Pika 22 e Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

162. Gucati argumenton se përkufizimi i termave “dëshmitar” dhe “dëshmitar i mundshëm” që zbatoi Trupi Gjykses ishte i gabuar në aspektin juridik dhe nuk u njoftua paraprakisht.³⁴⁶ Gucati nënvizon se ZPS-ja kufizoi kuadrin e Pikës 6 të Aktakuzës vetëm në “të gjithë personat që me gjasë kanë informacion për vepra penale, kryes apo rrethana të rëndësishme në lidhje me procedurat e [Dhomave të Specializuara].³⁴⁷ Sipas Gucatit, Trupi Gjykses në mënyrë të padrejtë zgjeroi kuadrin e Pikës 6 të Aktakuzës duke përfshirë të gjithë personat të cilët TFHS-ja/ZPS-ja kishte takuar dhe nga të cilët kishte marrë informacion, ose nga të cilët ZPS-ja kishte kërkuar të merrte informacion, ndër të tjera, edhe përmes organizatave të tjera.³⁴⁸ Sipas tij, duke vepruar në këtë mënyrë Trupi Gjykses gaboi që e lejoi ZPS-në t’i shmangej vërtetimit të standardit penal se çdo person që pretendohet se ishte dëshmitar ose dëshmitar i mundshëm (i) kishte dhënë, ose (ii) kishte të ngjarë të jepte informacion në lidhje me një veprë penale ose rrethana të tjera të rëndësishme në lidhje me proceset gjyqësore të Dhomave të Specializuara.³⁴⁹ Gucati gjithashtu argumenton se në dokumentacionin e çështjes gjyqësore nuk ka asnjë provë se dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm

³⁴⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 232. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 228-230; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 52-53.

³⁴⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 225.

³⁴⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 226.

³⁴⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 226-227, 232.

të pretenduar kishin ose kishte të ngjarë të kishin informacion relevant për proceset e Dhomave të Specializuara.³⁵⁰

163. Haradinaj parashtrohet se Trupi Gjykoës bëri gabim juridik që konstatoi se “person i mbrojtur në procedurën penale” sipas nenit 392(2) të KPK-së ishte “çdo person lidhur me të cilin ekziston kusht ligjor, urdhër ose masë mbrojtëse e lëshuar ose zbatuar në procedurë penale” dhe mund të jetë “një person identiteti ose të dhënat personale të të cilit gjenden në dokumentet ose materialet e [Dhomave të Specializuara] ose ZPS-së, nxjerrja e të cilave nuk është autorizuar”.³⁵¹

164. ZPS-ja përgjigjet se është i gabuar pretendimi i Gucatit se Trupi Gjykoës zgjeroi përkufizimin e termit “dëshmitar” të përkufizuar në Aktakuzë, dhe se, gjithsesi, ZPS-ja paraqiti prova të shumta që tregojnë se përmbajtja e Paketave përfshinte të dhëna të personave që kishin informacion për një veprë penale, kryes ose rrethana të rëndësishme në lidhje me proceset e Dhomave të Specializuara.³⁵² Në mbështetje të argumentit të saj, ZPS-ja i referohet Pjesës V(B) të Aktgjykimit.³⁵³ ZPS-ja gjithashtu parashtrohet se argumentet e Haradinajt duhet të rrëzohen menjëherë.³⁵⁴

165. Në kundërpërgjigje, Gucati konkretisht pretendon se askund në Pjesën V(B) të Aktgjykimit nuk përcaktohet se për cilën veprë penale, kryes, apo rrethana në lidhje me proceset e Dhomave të Specializuara mund të ketë pasur informacion një individ, dhe pse ato rrethana ishin të rëndësishme për proceset e Dhomave të Specializuara.³⁵⁵

³⁵⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 227, 231-232. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 54; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 177.

³⁵¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 194-195, i referohet Pikës 4 të Apelit të Haradinajt; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 57.

³⁵² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 92-93.

³⁵³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 93, poshtëshënimi 230.

³⁵⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 103.

³⁵⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 65.

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

166. Paneli vëren se në Aktakuzë, ZPS-ja nuk iu referua “personit të mbrojtur në procedurën penale” por thjesht “dëshmitarit/dëshmitarëve”, dhe e përkufizoi termin “dëshmitar” si “të gjithë personat që me gjasë kanë informacion për vepra penale, kryes apo rrethana të rëndësishme në lidhje me procedurat [e Dhomave të Specializuara]”.³⁵⁶ Trupi Gjykues gjithashtu shqyrtoi dhe përkufizoi termin “dëshmitar”, dhe jo termin “person i mbrojtur”.³⁵⁷ Trupi Gjykues gjykoi se përkufizimi i ZPS-së i termit “dëshmitar” ishte shumë i gjerë.³⁵⁸ Në vend të këtij përkufizimi, Trupi Gjykues u mbështet në përkufizimet e znj. Pumper, të cilat ai i gjykoi të sakta dhe të arsyeshme, dhe pranoi përkufizimin e saj të “dëshmitarit” si “person të cilin TFHS-ja/ZPS-ja e kishte takuar dhe prej të cilit kishte marrë informacion, ndër të tjera, edhe në formën e intervistës” (që në Aktgjykimin e Trupit Gjykues përmendet si “dëshmitarët”).³⁵⁹ Trupi Gjykues gjithashtu pranoi përkufizimin e znj. Pumper të “dëshmitarit të mundshëm” si dikush “prej të cilit ZPS-ja donte të merrte informacion, përfshirë përmes organizatave të tjera, ndër të tjera, edhe në formën e intervistës” (që në Aktgjykimin e Trupit Gjykues përmendet si “dëshmitarë të mundshëm”).³⁶⁰ Trupi Gjykues konstatoi se dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të TFHS-së/ZPS-së të përmendur me emër në informacionin e mbrojtur i përmbushnin kriteret si dëshmitarë dhe dëshmitarë të mundshëm.³⁶¹ Trupi Gjykues gjithashtu konstatoi se në kuadër të Pikës 6 të Aktakuzës, termi “person” brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së mbulonte dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm sipas përkufizimit të znj. Pumper.³⁶²

³⁵⁶ Aktakuza, para. 4. *Shih gjithashtu* Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të ZPS-së, para. 18.

³⁵⁷ Aktgjykimi, para. 509-512.

³⁵⁸ *Shih* Aktgjykimin, para. 512.

³⁵⁹ Aktgjykimi, para. 511-512.

³⁶⁰ Aktgjykimi, para. 511-512.

³⁶¹ Aktgjykimi, para. 513.

³⁶² Aktgjykimi, para. 512-513.

167. Paneli i Apelit vëren se Gucati kundërshton përkufizimin e pranuar nga Trupi Gjykses, i cili, sipas tij, zgjeron kuadrin e Pikës 6 të Aktakuzës sepse i lejon ZPS-së të mos vërtetojë se cilido person që pretendohet se është dëshmitar ose dëshmitar i mundshëm kishte dhënë, ose kishte të ngjarë të jepte, informacion në lidhje me një vepër penale ose rrethana të tjera të rëndësishme që kanë lidhje me procesin gjyqsor.³⁶³ Është e vërtetë që përkufizimi i Trupit Gjykses nuk përfshin asnjë referencë të kriterit që një dëshmitar ose dëshmitar i mundshëm të jetë në gjendje të japë informacion në lidhje me një vepër penale ose rrethana të tjera të rëndësishme në lidhje me proceset.³⁶⁴ Megjithatë, Trupi Gjykses mori parasysh dëshminë e znj. Pumper në mbështetje të përkufizimit të dhënë prej tij. Në këtë kontekst, Paneli i Apelit vëren se, megjithëse dëshmia e znj. Pumper pasqyrohet vetëm pjesërisht në Aktgjykimin e Trupit Gjykses, një shqyrtim i transkripteve të dëshmisë së saj që u mor parasysh nga Trupi Gjykses tregon se znj. Pumper shprehimisht theksoi se, për mendimin e saj, dëshmitar është “dikush që TFHS-ja kishte takuar dhe prej të cilit ne donim të merrnim informacion që kishte lidhje me mandatin tonë, me hetimin”.³⁶⁵

168. Fakti që Trupi Gjykses kuptoi dhe pranoi se përkufizimi prej znj. Pumper përfshinte këtë kriter, pasqyrohet edhe në vlerësimin e Trupit Gjykses se përkufizimet e znj. Pumper janë “të krahasueshme me ato të Gjykatësit të Procedurës Paraprake”, i cili iu referua konkretisht personave që i japin (ose ka të ngjarë t’i japin) informacion TFHS-së dhe/ose ZPS-së “për çfarëdo krimi ose vepre penale që përfshihet në juridiksionin [e Dhomave të Specializuara]”.³⁶⁶ Kjo pasqyrohet edhe në konstatimin e Trupit Gjykses se përkufizimi i znj. Pumper “përputhet” me përkufizimin e “dëshmitarit” të përcaktuar në Ligjin e Kosovës për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe është “përgjithësisht në përputhje me” përkufizimin e nocionit të dëshmitarit të

³⁶³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 226, 232.

³⁶⁴ Aktgjykimi, para. 511-512.

³⁶⁵ Aktgjykimi, para. 511, poshtëshënimet 1072-1073, i referohen KSC-BC-2020-07, Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1080.

³⁶⁶ Aktgjykimi, para. 511. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit, para. 44, 61.

miratuar në instrumente të tjera.³⁶⁷ Trupi Gjykses gjithashtu vlerësoi se përkufizimet e znj. Pumper i përshkruajnë nocionet e dëshmitarit dhe dëshmitarit të mundshëm “në hetime penale”,³⁶⁸ çka tregon se Trupi Gjykses mori parasysh se kuadri i përkufizimeve të znj. Pumper përfshinte vetëm aspekte që kishin të bënin me vepra penale ose rrethana të tjera relevante për proceset gjyqësore të Dhomave të Specializuara.

169. Përdorimi prej ZPS-së i termit “dëshmitar” u qartësua më tej në gjykim, me kërkesë të Trupit Gjykses. ZPS-ja theksoi se e barazonte termin “persona të mbrojtur” në Pikën 6 të Aktakuzës me “dëshmitarë të mbrojtur”, dhe se “dëshmitar” ishte përdorur si formë e shkurtuar e termit për të përshkruar nëngrupin e njerëzve që kishin pasur pasoja prej krimeve të paraqitura në Aktakuzë.³⁶⁹ Ky përkufizim është në përputhje me qëllimin e dispozitës së nenit 392(2) të KPK-së, që është mosnxjerrja, në bazë të së drejtës penale, e identiteteve të “dëshmitarëve”, ose “pjesëmarrësve në proces”.³⁷⁰

170. Në përputhje me sa më lart, Paneli konstaton se Gucati nuk arrin të demonstrojë se përkufizimi i “dëshmitarit” dhe “dëshmitarit të mundshëm” që pranoi Trupi Gjykses zgjeronte kuadrin e Pikës 6 të Aktakuzës, përbënte gabim juridik, ose nuk u njoftua paraprakisht.³⁷¹

171. Paneli gjithashtu vëren se ZPS-ja i referohet Pjesës V(B) të Aktgjykimit të Trupit Gjykses³⁷² në mbështetje të pretendimit të saj se dokumentacioni i çështjes gjyqësore përmban prova të shumta që tregojnë se “përmbajtjet e Paketave përfshinin persona që kishin informacion për një vepër penale, kryes, ose rrethana të rëndësishme në

³⁶⁷ Aktgjykimi, para. 511. *Shih gjithashtu* Ligjin e Kosovës për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, neni 3(1.3).

³⁶⁸ Aktgjykimi, para. 512.

³⁶⁹ Parashtrimet e ZPS-së lidhur me termin “dëshmitar”, para. 9-10.

³⁷⁰ *Shih* Komentarin *Salihu dhe të tjerët*, neni 400(2) të KPK-së të vitit 2012, komentet 2, 4, f. 1143-1144.

³⁷¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 226, 232.

³⁷² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 93, poshtëshënimi 230. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 231.

lidhje me proceset [e Dhomave të Specializuara]”.³⁷³ Megjithatë, ZPS-ja nuk jep ndonjë shembull konkret. Sidoqoftë, analiza e kësaj pjese tregon se znj. Pumper përmendi që Paketa 1 faktikisht përmbante 35 deklarata ose pjesë të deklaratave të viktimave dhe dëshmitarëve, të marra nga autoritetet serbe, të cilat përfshinin të dhëna personale dhe informacion të hollësishëm për “krime të rënda”.³⁷⁴ Rrjedhimisht, Paneli është bindur se dokumentacioni i çështjes gjyqësore përmban prova në të cilat përmenden persona që dhanë informacion për vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

172. Së fundi, Paneli konstaton se Pika 22 e Apelit të Haradinajt është e pabazuar dhe se në të thjesht përsëriten argumentet e paraqitura në lidhje me Pikën 4 të Apelit të tij, ku kundërshtohet vendimi i Trupit Gjyqësor për t’i lejuar ZPS-së mosnxjerrjen e materialit që Haradinaj nxori në mënyrë të paligjshme.³⁷⁵ Për këtë arsye, Paneli rrëzon menjëherë Pikën 22 të Apelit të Haradinajt.

173. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Gucati dhe Haradinaj nuk arrijnë të demonstrojnë gabim në konstatimet e Trupit Gjyqësor lidhur me nocionin “person” brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 8(A) të Apelit të Gucatit dhe Pikën 22 të Apelit të Haradinajt.

³⁷³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 93.

³⁷⁴ *Shih* Aktgjykimin, para. 345, poshtëshënimi 711 dhe provat e cituara aty.

³⁷⁵ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 194-195. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 55-67. Paneli i Apelit rikujton se argumentet e Haradinajt, të paraqitura në Pikën 4 të Apelit të tij, i ka shqyrtuar në pjesën për nxjerrjen e informacionit. *Shih më lart*, para. 65-68, 73.

2. Pretendimet për gabime lidhur me konstatimet mbi [person] “të mbrojtur në procedurë penale” (Pikat 7, 8 (B) të Apelit të Gucatit; Pika 23 e Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

174. Gucati kundërshton konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me “të mbrojtur në procedurë penale” brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së.³⁷⁶ Gucati e cilëson vlerësimin e Trupit Gjykses si mundësim i “mbrojtjes tërësore” dhe argumenton se neni 62(2) i Ligjit u referohet konkretisht mbrojtjeve që i “jepin” një personi, në dallim nga thjesht përmendja e emrit të një individi në një dokument të ZPS-së.³⁷⁷ Gucati gjithashtu argumenton se Trupi Gjykses gaboi kur arsyetoi se çdo dëshmitar ose dëshmitar i mundshëm të cilin TFHS-ja/ZPS-ja e konsideronte si konfidencial, ishte person i mbrojtur, dhe në këtë mënyrë as vlerësoi, e as dëgjoi dëshmi në lidhje me dhënien e pëlqimit ose mendimin e personave të mbrojtur.³⁷⁸ Rrjedhimisht, sipas Gucatit, *veprimi i fajshëm* i Pikës 6 të Aktakuzës nuk u vërtetua.³⁷⁹

175. Gucati mbështetet në nenin 35(2)(f) të Ligjit - sipas të cilit përgjegjësitë e Prokurorit të Specializuar përfshijnë marrjen e masave të domosdoshme për të siguruar konfidencialitetin e informacionit ose mbrojtjen e personave përkatës - dhe argumenton se Trupi Gjykses nuk shqyrtoi nëse masa të tilla në të vërtetë u morën dhe ishin të domosdoshme, dhe në vend të kësaj konsideroi si të mirëqenë se të gjithë personat e përmendur në dokumente të TFHS-së/ZPS-së ishin të mbrojtur *ipso facto*.³⁸⁰ Gucati gjithashtu argumenton se mbrojtja nuk mbulon personat që bashkëpunuan me

³⁷⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 217-224, 243.

³⁷⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 218-219. Gucati i referohet konkretisht z. Vladimir Vukçeviq (“z. Vukçeviq”) si shembull i një personi identiteti ose të dhënat personale të të cilit gjenden në dokumente të Dhomave të Specializuara/ZPS-së, por që nuk është *person i mbrojtur në procedura penale*. Shih Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 219.

³⁷⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 220-224. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 49-51.

³⁷⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 224. Shih gjithashtu Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 243.

³⁸⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 234-238, 243. Shih gjithashtu Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 55-57.

ZPS-në, por - në bazë të rregullës 30(2)(a) të Rregullores - vetëm personat e rrezikuar për shkak të dhënies së informacionit ZPS-së.³⁸¹ Sipas Gucatit, megjithëse neni 35(2)(f) i Ligjit dhe rregulla 30(2)(a) e Rregullores kërkojnë vlerësimin e rrezikut dhe të domosdoshmërisë së masave mbrojtëse për individët përkatës, Trupi Gjykses nuk dëgjoi asnjë dëshmi të këtij lloji në lidhje me asnjë “dëshmitar” apo “dëshmitar të mundshëm” të pretenduar, të identifikuar në informacionin e mbrojtur, së paku deri pas periudhës që mbulon Aktakuza.³⁸²

176. Sipas Haradinajt, ZPS-ja gjithashtu duhej të paraqiste prova lidhur me rrethanat dhe kuadrin e mbrojtjes që iu ofrua këtyre individëve.³⁸³ Në këtë kontekst, Haradinaj argumenton se ZPS-ja duhej të kishte ndjekur një procedurë me dy hapa (së pari, identifikimin e çdo dëshmitari, dhe së dyti, arsyet për mbrojtjen e secilit individ).³⁸⁴ Haradinaj argumenton se konstatimi i Trupit Gjykses se neni 392(2) i KPK-së nuk synon të mbrojë identitetet e personave *si të tillë*, por identitetet e tyre si dëshmitarë, është “dallim i gabuar” sepse “ky dallim në fakt është hapi i dytë që duhet ndërmarrë”.³⁸⁵

177. Haradinaj më tej parashton se ZPS-ja nuk paraqiti prova në lidhje me: (i) vendimet që u akordojnë këtyre individëve status si persona të mbrojtur; (ii) datën e akordimit të një statusi të tillë; (iii) periudhën për të cilën ishte miratuar mbrojtja; (iv) rrezikun për t’u menaxhuar; dhe (v) bazën ligjore të procedurave me të cilat ka lidhje secili prej individëve të mbrojtur.³⁸⁶ Haradinaj argumenton se Trupi Gjykses bëri gabim juridik sepse nuk i lejoi Mbrojtjes mundësinë që të kundërshtonte argumentet e ZPS-së.³⁸⁷

³⁸¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 239-240.

³⁸² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 241-242; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 58-59.

³⁸³ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 196-200.

³⁸⁴ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 203-206.

³⁸⁵ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 203-204, i referohen Aktgjykimit, para. 98.

³⁸⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 196, 206.

³⁸⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 196-200, 207-208.

178. ZPS-ja përgjigjet se Gucati shtrembëron konstatimet e Trupit Gjykues kur argumenton se personat janë të mbrojtur vetëm në lidhje me nenin 62 të Ligjit, sepse ky nen është vetëm një prej bazave të ndryshme ligjore mbi të cilat mund t'i akordohet mbrojtje një personi.³⁸⁸ ZPS-ja gjithashtu parashtron se argumentet e Gucatit se dhënia e pëlqimit është parakusht për mbrojtjen e personave, janë të mangëta, sepse (i) neni 392(2) i KPK-së nuk përcakton një kusht të tillë, dhe (ii) korniza ligjore e Dhomave të Specializuara nuk përcakton një kusht të tillë për masat mbrojtëse të parashikuara në të.³⁸⁹

179. Gjithashtu, ZPS-ja nuk pajtohet me interpretimin e Gucatit lidhur me marrjen e masave të domosdoshme për garantimin e konfidencialitetit sipas nenit 35(2)(f) të Ligjit dhe nënvizon se neni 392(2) i KPK-së nuk parashikon kushtin e kryerjes së vlerësimit të individualizuar të rreziqeve për secilin person të mbrojtur.³⁹⁰ Gjithashtu, për mendimin e ZPS-së, Aktakuza nuk përmban asnjë pretendim për ndonjë individ specifik si person i mbrojtur në kuadër të Pikës 6 të saj.³⁹¹

180. Në përgjigjen e vet, ZPS-ja më tej shton se Haradinaj përpiqet të kundërshtojë Aktakuzën në mënyrë të palejueshme dhe se ai nuk arrin të demonstrojë “paqartësi të pashfaqur” nga ana e Trupit Gjykues në lidhje me akuzat.³⁹²

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

181. Trupi Gjykues konstatoi se formulimi “i mbrojtur në procedurë penale” nuk kërkon domosdoshmërisht urdhër gjyqësor; ai mund të nënkuptojë edhe masat që zbatojnë autoritetet prokuroriale gjatë hetimeve të tyre.³⁹³ Trupi Gjykues gjithashtu konstatoi se person “i mbrojtur në procedurë penale” mund të jetë edhe një person

³⁸⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 90.

³⁸⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 91.

³⁹⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 94-95.

³⁹¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 95.

³⁹² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 104.

³⁹³ Aktgjykimi, para. 95.

identiteti ose të dhënat personale të të cilit gjenden në dokumentet ose materialet e Dhomave të Specializuara ose ZPS-së, nxjerrja e të cilave nuk është autorizuar.³⁹⁴

182. Sa i përket “identitetit” të personave të parashikuar në nenin 392(2) të KPK-së, Trupi Gjykses nënvizoi se neni 392(2) i KPK-së nuk synon të mbrojë identitetet e personave *si të tillë*, por identitetet e tyre si dëshmitarë, viktima, persona për të cilët ka interes ose pjesëmarrës të tjerë në procedurën penale.³⁹⁵

183. Paneli i Apelit rikujton se në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara, mbrojtja në procedurë penale mund të nënkuptojë një urdhër për masa mbrojtëse të lëshuar nga një panel kompetent në përputhje me, ndër të tjera, nenet 23, 39(11), 40(6)(f) dhe 58 të Ligjit dhe rregullat 80, 81, 105 dhe 108 të Rregullores.³⁹⁶ Megjithatë, Paneli pajtohet me Trupin Gjykses se shprehja “i mbrojtur në procedurë penale” nuk kërkon domosdoshmërisht urdhër gjyqësor, dhe mund të përfshijë gjithashtu masat mbrojtëse të miratuara nga ZPS-ja gjatë hetimeve në përputhje me, ndër të tjera, nenin 35(2)(f) të Ligjit dhe rregullën 30(2)(a) të Rregullores.³⁹⁷ Në këtë kontekst, dispozitat lidhur me masat mbrojtëse që merr ZPS-ja gjatë hetimeve të saj për të garantuar sigurinë e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm nuk duhen ngatërruar me kompetencën e një paneli për të urdhëruar masa mbrojtëse në bazë të, ndër të tjera, rregullës 80 të Rregullores. Vetëm kjo e fundit kërkon përmbushjen e kushteve shtesë të përmendura nga të akuzuarit, siç janë urdhri gjyqësor që “miraton” mbrojtjen, identifikimi i personave përkatës, ose dhënia e pëlqimit prej personit në lidhje me të cilin kërkohen masa mbrojtëse.³⁹⁸

³⁹⁴ Aktgjykimi, para. 95.

³⁹⁵ Aktgjykimi, para. 98.

³⁹⁶ *Shih* Aktgjykimin, para. 95.

³⁹⁷ Aktgjykimi, para. 95.

³⁹⁸ *Shih* Rregullën 80 të Rregullores. Paneli vëren se Gucati i referohet konkretisht z. Vukçeviq si shembull i një personi identiteti ose të dhënat personale të të cilit gjenden në dokumente të Dhomave të Specializuara/ZPS-së, por që nuk është *person i mbrojtur në procedura penale*. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 219. Megjithatë, Paneli rikujton konstatimin e Trupit Gjykses se z. Vukçeviq nuk i

184. Sa i përket nenit 35 të Ligjit, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese theksoi se ZPS-ja ka përgjegjësinë për hetimin dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës për veprat penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, dhe se ZPS-ja ka jo vetëm përgjegjësinë por edhe kompetencën për të kryer këto funksione.³⁹⁹ Këto funksione përfshijnë, sipas nenit 35(2)(f) të Ligjit, marrjen e masave të nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e informacionit ose mbrojtjen e personave. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese gjithashtu u pajtua se në përmbushjen e përgjegjësisë për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, ZPS-ja duhet të ketë njëfarë lirie dhe të drejtë gjykimi të brendaqenësishme. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese gjithashtu theksoi se ZPS-ja është e autorizuar të ndërmarrë një sërë masash hetimore që në vetvete nuk kërkojnë autorizim gjyqësor paraprak.⁴⁰⁰

185. Paneli i referohet pretendimit të Gucatit se Trupi Gjykses mundësoi një “mbrojtje tërësore” ose bëri një “analizë tërësore”,⁴⁰¹ por në argumentet e tij Gucati nuk i referohet asnjë pjese të Aktgjykimit, dhe Paneli nuk është në gjendje të identifikojë se cilës “analizë tërësore” i referohet. Sido që të jetë, Gucati nuk arrin të demonstrojë se masat hetimore të marra nga ZPS-ja në bazë të nenit 35(2)(f) të Ligjit ose rregullës 30(2)(a) të Rregullores të cilat nuk kërkojnë autorizim gjyqësor paraprak, duhet të verifikohen ose vlerësohen nga Trupi Gjykses.

186. Sa u përket argumenteve të Haradinajt, Paneli konstaton se ai nuk arrin të demonstrojë se konstatimi i Trupit Gjykses – se neni 392(2) i KPK-së nuk synon të mbrojë identitetet e personave *si të tillë*, por identitetet e tyre si dëshmitarë⁴⁰² – përbën

përmbush kriteret e dëshmitarit ose dëshmitarit të mundshëm meqë bashkëpunimi i tij me TFHS-në ishte bërë publik nga kryeprokurori i mëparshëm i saj. *Shih* Aktgjykimin para. 514.

³⁹⁹ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese mbi Rregullat e Rishikuara, para. 17.

⁴⁰⁰ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese mbi Rregullat e Rishikuara, para. 18.

⁴⁰¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 218, 236, 238.

⁴⁰² Aktgjykimi, para. 98.

“dallim të gabuar”.⁴⁰³ Paneli pajtohet me Trupin Gjykses se fakti që identiteti i një personi dihet publikisht nuk mund të barazohet me zbulimin e identitetit të tij ose të saj si “person i mbrojtur në procedurë penale”.⁴⁰⁴ Ky konstatim konfirmohet edhe nga fakti se dispozitat ligjore përkatëse të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara nuk synojnë të mbrojnë identitetet e personave, por vetëm të mundësojnë mbrojtjen e viktimave, dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.⁴⁰⁵ Krahas kësaj, argumentet e Haradinajt se ZPS-ja duhej të kishte ndjekur një procedurë me dy hapa,⁴⁰⁶ nuk evidentojnë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses. Për më tepër, këto argumente janë të pambështetura dhe nuk përmendin e as pasqyrojnë dispozitat përkatëse të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara.

187. Në bazë të sa më lart, Paneli konstaton se Gucati dhe Haradinaj nuk arrijnë të demonstrojnë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me formulimin “të mbrojtur në procedurë penale” brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikat 7 dhe 8(B) të Apelit të Gucatit dhe Pikën 23 të Apelit të Haradinajt.

3. Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet mbi formën e rëndë të veprës penale sipas nenit 392(3) të KPK-së (Pikat 9, 10, 11 të Apelit të Gucatit; Pika 8, pjesërisht, e Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

188. Gucati rikujton se neni 392(3) i KPK-së përcakton një formë më të rëndë të veprës penale, kur ajo sjell si rezultat “pasoja të rënda” për personin e mbrojtur.⁴⁰⁷ Gucati argumenton se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se standardi i “pasojeve të rënda” ishte përmbushur me “cenimin thelbësor të sigurisë, mbrojtjes, mirëqenies,

⁴⁰³ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 204.

⁴⁰⁴ Aktgjykimi, para. 98.

⁴⁰⁵ *Shih, p.sh.* nenet 23, 53(1)(e) të Ligjit.

⁴⁰⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 203-206.

⁴⁰⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 244.

jetës private ose dinjitetit të personave të mbrojtur ose familjeve të tyre”.⁴⁰⁸ Sipas Gucatit, Trupi Gjykues pa të drejtë e “zbuti” standardin e nenit 392(3) të KPK-së, dhe konstatimet e Trupit Gjykues mbi “pasoja të rënda” zhvlerësohen nga vetë barasvlerësimi i “pasojeve të rënda” me “cenimin thelbësor”.⁴⁰⁹

189. Gucati gjithashtu pretendon se Trupi Gjykues gaboi që: (i) u mbështet më shumë se sa duhej në pohimin jo të besueshëm dhe në vetvete kontradiktor të z. Jukiq se dy zhvendosjet e pretenduara të personave të mbrojtur u bënë si pasojë e veprimeve të Gucatit;⁴¹⁰ (ii) u bazua në “vlerësimin individual të rrezikut të lartë” ndaj dy personave të cilët u pretendua se u zhvendosën, vlerësim ky që u bë vetëm nga ZPS-ja dhe ishte i pambështetur;⁴¹¹ (iii) konstatoi se pasojat negative që lidheshin me zhvendosjen përbënin “pasoja të rënda” për këta dy persona;⁴¹² (iv) konstatoi se fakti që personat – të cilët ishin objekt i planifikimit urgjent prej ZPS-së për shkak të rrezikut – “ishin të vetëdijshëm se si rezultat” rrezikoheshin të dëmtoheshin ose të zhvendoseshin menjëherë, përbënte “pasoja të rënda”;⁴¹³ dhe (v) konstatoi se “frika dhe shqetësimi si rezultat i përmendjes publikisht të emrit si dëshmitar” përbënin “pasoja të rënda” për personin e identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit të Trupit Gjykues.⁴¹⁴

190. Në një nga pikat e Apelit ku kundërshton vlerësimin e Trupit Gjykues lidhur me besueshmërinë e disa dëshmitarëve,⁴¹⁵ Haradinaj kundërshton faktin që Trupi

⁴⁰⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 245.

⁴⁰⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 246-248; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 60-62.

⁴¹⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 249-262; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 63. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 64.

⁴¹¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 263-266. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 64.

⁴¹² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 267-270; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 65.

⁴¹³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 271-273.

⁴¹⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 274-278; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 66-69; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 64. *Shih* Aktgjykimin para. 538.

⁴¹⁵ Paneli e ka të qartë se qëllimi i Pikës 8 të Apelit të Haradinajt është, ndër të tjera, të kundërshtojë vlerësimin e Trupit Gjykues të dëshmitarëve të znj. Pumper, z. Jukiq dhe z. Daniel Moberg (dëshmitari W04876). *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 100, 107. ZPS-ja përgjigjet se kjo pikë apeli duhet të

Gjykues u mbështet në dëshminë e z. Jukiq.⁴¹⁶ Sipas Haradinajt, z. Jukiq “demonstroi që ai vetë, si dhe njohuritë e tij për çështjen, janë të pambështetshme dhe me besueshmëri të dyshimtë”.⁴¹⁷ Konkretisht, Haradinaj argumenton se z. Jukiq nuk mundi të konfirmonte se sa dëshmitarë kishte takuar dhe në vend të kësaj dha “vlerësime të përafërta tejet të pasakta”.⁴¹⁸ Sipas mendimit të tij, Trupi Gjykues megjithatë ishte i gatshëm t’i “justifikonte dhe përligjte plotësisht këto mangësi” dhe arriti në përfundime të cilat asnjë vendimmarrës i arsyeshëm nuk do të mund t’i nxirrte.⁴¹⁹

191. ZPS-ja përgjigjet se Gucati nuk arrin të vërtetojë se: (i) Trupi Gjykues përkufizoi gabimisht termin “pasoja të rënda”;⁴²⁰ (ii) asnjë trup gjykues i arsyeshëm nuk do të mund të konstatonte se dëshmia e z. Jukiq lidhur me zhvendosjet ishte e besueshme;⁴²¹ (iii) Trupi Gjykues gaboi që pranoi - në bazë të dëshmisë së z. Jukiq - vlerësimet e rreziqeve të kryera nga ZPS-ja lidhur me dy individët e zhvendosur;⁴²² (iv) Trupi Gjykues gaboi që u mbështet në dëshminë e z. Jukiq në lidhje me “pasoja negative” që pësuan dëshmitarët e zhvendosur;⁴²³ dhe se (v) asnjë trup gjykues i arsyeshëm nuk

hidhet poshtë menjëherë dhe se, sido që të jetë, Trupi Gjykues shpjegoi me hollësi se si i vlerësoi tre dëshmitarët. *Shih* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 58-59. Megjithëse ka shqyrtuar disa prej argumenteve të Haradinajt në këtë pjesë si dhe sipas Pikës 3 të Aktakuzës, Paneli vëren se Haradinaj i paraqet argumentet në mënyrë të paqartë dhe nuk identifikon në to asnjë gabim të Trupit Gjykues dhe as mjetin juridik që kërkon. Paneli refuzon ta shqyrtojë më tej këtë pikë. Pjesa e mbetur e Pikës 8 të Apelit të Haradinajt është shqyrtuar në pjesën për veprimin e fajshëm sipas Pikës 3 të Aktakuzës. *Shih më poshtë*, para. 243, 250.

⁴¹⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 100, 103-107. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 101-102.

⁴¹⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 103.

⁴¹⁸ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 103-104. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 26.

⁴¹⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 105-107. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 22-26.

⁴²⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 96.

⁴²¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 98.

⁴²² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 99.

⁴²³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 100.

do të mund të mbështetej në dëshminë e z. Jukiq për nxjerrjen e konstatimeve mbi “sistemin e menaxhimit të rrezikut në raste urgjente”.⁴²⁴

192. Në lidhje me personin e identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit të Trupit Gjykses,⁴²⁵ ZPS-ja argumenton se konstatimet e Trupit Gjykses bazohen në prova të pranuar në këtë çështje gjyqësore dhe se Gucati thjesht shpreh mospajtimin e tij me këto konstatime dhe nuk arrin të vërtetojë se asnjë trup gjykses i arsyeshëm nuk do të mund të nxirrte këto konstatime.⁴²⁶

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

193. Paneli së pari do të shqyrtojë kundërshtimet lidhur me besueshmërinë e z. Jukiq dhe më pas do të vlerësojë nëse ka gabime në përkufizimin dhe vlerësimin e Trupit Gjykses të “pasojave të rënda” sipas nenit 392(3) të KPK-së.⁴²⁷

194. Sa u përket kundërshtimeve të Gucatit dhe Haradinajt lidhur me dëshminë e z. Jukiq, Paneli thekson se ishte detyrë e Trupit Gjykses që të vlerësonte besueshmërinë e dëshmitarit, si dhe mbështetshmërinë në dëshminë e dhënë.⁴²⁸

195. Paneli thekson se Pika 10 e Apelit të Gucatit, ku ai kundërshton dëshminë e z. Jukiq, nuk i referohet askund Aktgjykimit të Trupit Gjykses⁴²⁹ dhe për këtë arsye mund të hidhet poshtë menjëherë sepse nuk identifikon konstatimet e kundërshtuara.⁴³⁰ Gjithashtu, Paneli konstaton se Gucati dhe Haradinaj thjesht nuk

⁴²⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 101.

⁴²⁵ Aktgjykimi, para. 538.

⁴²⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 102.

⁴²⁷ Paneli vëren se në kuadër të Pikës 23 të Apelit të tij, Haradinaj bën gjithashtu një parashtrim të përgjithshëm se Trupi Gjykses gaboi “që zbatoi formën e rëndë të veprës penale të paraparë në nenin 392(1) të KPK-së”. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 196. Paneli e ka të qartë se përmendja e nenit 392(1) të KPK-së është gabim shtypi dhe se Haradinaj në fakt i referohet nenit 392(3) të KPK-së. Gjithashtu, Paneli vëren se Haradinaj nuk shtjellon argumente në mbështetje të këtij pretendimi, i cili rrjedhimisht hidhet poshtë si i pabazë. *Shih më lart*, para. 29, 32.

⁴²⁸ *Shih më lart*, para. 36.

⁴²⁹ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 249-273. Paneli vëren se Gucati i referohet Aktgjykimit vetëm një herë në Pikën 10(A)-(D) të Apelit të tij. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 255, poshtëshënimi 137.

⁴³⁰ *Shih më lart*, para. 29, 32.

pajtohen me konstatimet e Trupit Gjykses, pa vërtetuar ndonjë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses.

196. Paneli vëren se gjatë gjykimit, Mbrojtja kundërshtoi vërtetësinë e disa aspekteve të dëshmisë së z. Jukiq dhe dëshminë e tij lidhur me numrin e dëshmitarëve të zhvendosur. Trupi Gjykses i trajtoi shprehimisht këto kundërshtime në Aktgjykimin e vet.⁴³¹ Trupi Gjykses nënvizoi se Mbrojtja pati “mundësi të shumta që të verifikonte saktësinë dhe mbështetshmërinë e këtyre provave”.⁴³² Trupi Gjykses konstatoi se dëshmia e z. Jukiq ishte provuese dhe përgjithësisht e përputhshme në thelb. Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se mospërputhjet në dëshminë e dëshmitarit, nëse kishte të tilla, nuk ishin rezultat i pavërtetësisë dhe njëanshmërisë, dhe konstatoi se dëshmia e z. Jukiq ishte e mbështetshme.⁴³³

197. Paneli gjithashtu vëren se para se të bëhej shef i ekipit për sigurinë dhe kontaktimin e dëshmitarëve, z. Jukiq ishte punonjës i ZPS-së për sigurinë e dëshmitarëve. Në këtë cilësi, ai u përfshi në përgatitjen e planeve për menaxhimin e rrezikut në raste urgjente dhe ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me të gjithë dëshmitarët e ZPS-së.⁴³⁴ Edhe pse dëshmia e tij nuk u konfirmua nga prova të tjera, për shkak të detyrave profesionale të tij, ai ishte në pozitën e duhur për të dëshmuar në lidhje me këtë aspekt dhe, sikurse u theksua më herët, gjatë gjykimit Mbrojtja e vuri shumë herë në pikëpyetje besueshmërinë e tij.⁴³⁵ Gjithashtu, Paneli rikujton se nuk ekziston një kriter i përgjithshëm që dëshmia e një dëshmitari të konfirmohet nga prova të tjera, në qoftë se ajo konsiderohet e besueshme.⁴³⁶ Për këto arsye, Mbrojtja

⁴³¹ Aktgjykimi, para. 536. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 52-53, 507.

⁴³² Aktgjykimi, para. 541.

⁴³³ Aktgjykimi, para. 58, 536, 540.

⁴³⁴ KSC-BC-2020-07, Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1690, 1707-1708. *Shih gjithashtu* Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të ZPS-së, para. 125, 132.

⁴³⁵ Aktgjykimi, para. 52, 536, 540.

⁴³⁶ *Shih më lart*, para. 36.

nuk arrin të evidentojë gabim në vlerësimin prej Trupit Gjykses të dëshmisë së z. Jukiq.

198. Në lidhje me përkufizimin dhe vlerësimin e shprehjes “pasoja të rënda” sipas nenit 392(3) të KPK-së, Paneli rikujton, sikurse theksoi Trupi Gjykses, se neni 392(3) i KPK-së penalizon dy lloje formash të rënda të veprës penale bazë sipas nenit 392(2) të KPK-së: (i) pasoja të rënda për personat e mbrojtur sipas nenit 392(2) të KPK-së; dhe (ii) procedura penale pengohet në masë të madhe, ose pamundësohet.⁴³⁷ Sa i përket formës së dytë të rëndë të veprës penale bazë, Trupi Gjykses konstatoi se ZPS-ja nuk arriti të vërtetonte se zbulimi nga të akuzuarit i identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm i pamundësoi ose pengoi në masë të madhe hetimet e ZPS-së brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së.⁴³⁸

199. Sa i përket formës së parë të rëndë të veprës penale bazë, Trupi Gjykses konstatoi se “pasoja të rënda mund të përfshijnë cenimin thelbësor të sigurisë, mbrojtjes, mirëqenies, jetës private ose dinjitetit të personave të mbrojtur ose familjeve të tyre”.⁴³⁹ Paneli mban parasysh argumentin e Gucatit se në këtë konstatim, Trupi Gjykses në mënyrë të gabuar “zbuti” standardin e nenit 392(3) të KPK-së nga “të rëndë” në “thelbësor”.⁴⁴⁰ Megjithatë, Gucati nuk arriti të faktonte pse dhe si përmendja nga Trupi Gjykses e “cenimit thelbësor” në fakt do të “zbuste” standardin, ose do të ndikonte në llojin e pasojave që mund të përbëjnë formën e rëndë të veprës penale.

200. Paneli vëren se Trupi Gjykses përmend “cenimin thelbësor” vetëm në pjesën e Aktgjykimit të vet ku shtjellon dispozitat ligjore përkatëse.⁴⁴¹ Gucati i pranon konstatimet e Trupit Gjykses, por prapëseprapë argumenton se këto konstatime sa i përket “cenimit thelbësor” zhvlerësohen nga vetë barazimi i “pasojave të rënda” me

⁴³⁷ *Shih* Aktgjykimin, para. 100, 534.

⁴³⁸ *Shih* Aktgjykimin, para. 551. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin para. 548-550.

⁴³⁹ Aktgjykimi, para. 100. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 535-547.

⁴⁴⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 246.

⁴⁴¹ Aktgjykimi, para. 100.

“cenimin thelbësor”.⁴⁴² Paneli konstaton se pretendimi i Gucatit është i pabazë, meqenëse Trupi Gjykses shprehimisht iu referua “pasojave të rënda” në vlerësimin e vet të nenit 392(3) të KPK-së.⁴⁴³

201. Paneli gjithashtu thekson se konstatimet e sakta të Trupit Gjykses nuk barazojnë “pasojat e rënda” me “cenimin thelbësor”. Përkundrazi, Trupi Gjykses konstatoi se “pasojat e rënda mund të përfshijnë cenimin thelbësor të sigurisë, mbrojtjes, mirëqenies, jetës private ose dinjitetit të personave të mbrojtur ose familjeve të tyre”.⁴⁴⁴

202. Paneli thekson se, kur shtjelloi kuptimin e shprehjes “pasoja të rënda” në lidhje me një pikë tjetër të Aktakuzës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në këtë çështje gjyqësore i dha edhe më shumë konkretësi kuptimit të “pasojave të rënda”, dhe theksoi se “është fakti se ‘pasojat e rënda’ kanë ndodhur dhe jo përmbajtja konkrete e tyre’ ajo që përbën formën e rëndë të veprës penale në Pikën 2”, dhe konstatoi se hollësitë shtesë lidhur me format përmes së cilave janë materializuar pasoja të tilla të rënda mund të shqyrtohen në gjykim.⁴⁴⁵ Sa i përket materializimit të këtyre pasojave, Paneli i Apelit nuk identifikon asnjë gabim në konstatimin e Trupit Gjykses se rreziku i lartë që e bëri të domosdoshme zhvendosjen e dy dëshmitarëve dhe pasojat negative të lidhura me një masë të tillë, përbënte pasoja të rënda brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së.⁴⁴⁶

203. Paneli vëren se Trupi Gjykses pranoi se, me përjashtim të dy zhvendosjeve, z. Jukiq nuk saktësoi sa prej masave të sigurisë ose masave mbrojtëse që u miratuan si rezultat i zbulimit të informacionit ishin plane për menaxhimin e rrezikut në raste urgjente.⁴⁴⁷ Rrjedhimisht, referenca e përgjithshme e Trupit Gjykses “dëshmitarë që

⁴⁴² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 247.

⁴⁴³ Aktgjykimi, para. 547.

⁴⁴⁴ Aktgjykimi, para. 100 (theksimi i shtuar).

⁴⁴⁵ Vendimi mbi Mocionet Paraprake, para. 58. Paneli gjithashtu vëren se Gucati nuk e apeloj këtë konstatim. *Shih* Vendimin e Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake.

⁴⁴⁶ Aktgjykimi, para. 536.

⁴⁴⁷ Aktgjykimi, para. 537, poshtëshënimi 1115.

ishin objekt i planifikimit urgjent për shkak të rrezikut” nuk është e konkretizuar,⁴⁴⁸ dhe Paneli gjykon se kjo referencë në fakt vlen vetëm për dy dëshmitarët që u zhvendosën. Në lidhje me këtë, megjithëse argumenton se nuk kishte “asnjë provë për përfshirjen e ndonjë dëshmitari në planet për menaxhimin e rrezikut në raste urgjente nga ana e ZPS-së”, Gucati prapëseprapë pranon se këto plane për menaxhimin e rrezikut në raste urgjente u zbatuan së paku në lidhje me dy personat të cilët (pretendohej se) u zhvendosën.⁴⁴⁹ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi që konstatoi se u shkaktuan pasoja të rënda brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së për dy dëshmitarët që u zhvendosën dhe ishin objekt i planifikimit urgjent për shkak të rrezikut.

204. Së fundi, Gucati argumenton se nuk ka prova që personi i identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit të Trupit Gjykses – i cili e kishte bërë publik bashkëpunimin e tij me prokurorë që po hetonin pretendime për vepra penale të kryera nga anëtarë të UÇK-së – kishte frikë nga përmendja publikisht e emrit të tij si dëshmitar.⁴⁵⁰ Në lidhje me personin e identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit të Trupit Gjykses, Trupi Gjykses konstatoi se:

në kontekstin e Kosovës, ku çështjet që kanë të bëjnë me pretendimet për krime të kryera nga anëtarët e UÇK-së janë dëmtuar dhe dihet se janë dëmtuar nga rastet e frikësimit të dëshmitarëve, frika dhe shqetësimi si rezultat i përmendjes publikisht të emrit si dëshmitar, në vijim të deklaratave nënçmuese të mëhershme, përbëjnë pasoja të rënda brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së [...].⁴⁵¹

205. Analiza e dokumentacionit të çështjes gjyqësore tregon se dihej publikisht që ky person bashkëpunonte me hetuesit në lidhje me vepra penale të pretenduara të kryera nga anëtarë të UÇK-së.⁴⁵² Paneli vëren se ai nuk u thirr si dëshmitar i ZPS-së në

⁴⁴⁸ Aktgjykimi, para. 547.

⁴⁴⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 271-272.

⁴⁵⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 274-278. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 538.

⁴⁵¹ Aktgjykimi, para. 538 (poshtëshënimi nuk është përfshirë).

⁴⁵² KSC-BC-2020-07, Transkripti, 25 tetor 2021, f. 1315. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 274; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 245; Aktgjykimi, para. 505.

këtë çështje dhe, për këtë arsye, konstatimet e mësipërme të Trupit Gjykses bazohen në dëshminë e z. Jukiq, i cili nuk e kontaktoi personalisht personin e identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit të Trupit Gjykses, por thjesht dinte se ky person “ankohej për publikimin e rrjedhjeve të dokumentacionit” dhe se ZPS-ja nuk mori asnjë masë për mbrojtjen e këtij personi.⁴⁵³ Paneli i Apelit gjykon se konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me “frikën dhe shqetësimin si rezultat i përmendjes publikisht të emrit si dëshmitar” nuk bazohen në provat e administruara në këtë çështje gjyqësore. Trupi Gjykses nuk dha shpjegim në mbështetje të këtij konstatimi të vet, nuk nxori përfundim e as shpjegoi më tej nëse një ankesë lidhur me publikimin e rrjedhjes së dokumenteve të rrjedhura përbënte “pasoje të rëndë” brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së.

206. Për rrjedhojë, Paneli i Apelit pajtohet me argumentin e Gucatit se Trupi Gjykses bëri gabim në lidhje me këtë konstatim konkret dhe rrjedhimisht miraton Pikën 11 të Apelit të Gucatit, ku ai kundërshton konstatimet e Trupit Gjykses mbi nenin 392(3) të KPK-së në lidhje me personin e identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit të Trupit Gjykses, i cili ishte përmendur publikisht me emër si dëshmitar. Megjithatë, duke qenë se nuk konstatoi gabim në konstatimin e Trupit Gjykses se dy dëshmitarë u zhvendosën dhe ishin objekt i planifikimit urgjent për shkak të rrezikut, dhe se këto raste përbënin “pasoja të rënda” brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së, Paneli i Apelit konstaton se gabimi i Trupit Gjykses në lidhje me personin e identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit të Trupit Gjykses nuk ka ndikim në përfundimin e përgjithshëm të Trupit Gjykses se në këtë çështje gjyqësore ishte vërtetuar veprimi i fajshëm i veprës penale sipas nenit 392(3) të KPK-së.⁴⁵⁴

⁴⁵³ KSC-BC-2020-07, Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1904-1905. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 276.

⁴⁵⁴ Aktgjykimi, para. 538. Ndikimi i këtij konstatimi, nëse ka, mbi dënimin e të akuzuarve, do të shqyrtohet në Pjesën H më poshtë.

207. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Gucati dhe Haradinaj nuk arrijnë të provojnë gabim në konstatimin e Trupit Gjykses se ishte vërtetuar forma e rëndë e veprës penale sipas nenit 392(3) të KPK-së. Rrjedhimisht, Paneli rrezon Pikat 9 dhe 10 të Apelit të Gucatit dhe pjesën përkatëse të Pikës 8 të Apelit të Haradinajt.

D. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME FRIKËSIMIN GJATË PROCEDURËS PENALE (PIKA 3 E AKTAKUZËS)

1. Pretendimet për gabime në lidhje me veprimin e fajshëm sipas nenit 387 të KPK-së (Pikat 1, 2(A) pjesërisht, dhe 2(B) të Apelit të Gucatit; Pikat 8, pjesërisht, dhe 19 të Apelit të Haradinajt)

208. Gucati dhe Haradinaj kundërshtojnë konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me veprimin e fajshëm ku bazohet shpallja e fajësisë së tyre sipas Pikës 3 të Aktakuzës (“Pika 3 e Aktakuzës”) për përdorimin e kërcënimeve të rënda për të nxitur ose për të tentuar të nxisnin dëshmitarët që të mos jepnin deklaratat për ZPS-në dhe/ose Dhomat e Specializuara, i ndëshkueshëm në bazë të nenit 387 të KPK-së.⁴⁵⁵ ZPS-ja përgjigjet se pikat përkatëse të apeleve të të akuzuarve duhet të rrezohen.⁴⁵⁶

209. Paneli rikujton se në nenin 387 të KPK-së, vepra penale e frikësimit gjatë procedurës penale përkufizohet si vijon:

Kushdo që përdor forcën apo kanosjen serioze apo ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit, premtion dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për të nxitur personin tjetër të përmbahet nga dhënia e deklaratës ose për të dhënë deklaratë të rreme, ose për të mos dhënë informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit, kur informacionet e tilla ndërliiden me pengimin e procedurës penale, dënohet me gjobë deri në njëqind e njëzet e pesëmijë (125.000) Euro dhe me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

⁴⁵⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 10-59, 80-89, 96-108; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 100-101, 104-107, 178-181; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 2, 15-24; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 22-26, 47-49. *Shih gjithashtu* Aktakuzën, para. 29-30, 48. Paneli rikujton se sipas para. 48 të Aktakuzës, vepra penale e “frikësimit gjatë procedurës penale” është e ndëshkueshme sipas neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35, dhe 387 të KPK-së, të zbatueshme në bazë të neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

⁴⁵⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 60-71.

210. Trupi Gjykses konstatoi se për veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale duhet të ekzistojnë këto elemente materiale: (i) përdorimi i forcës, kërcënimit të rëndë apo i ndonjë mënyre tjetër detyrimi, premtimit të një dhurate, apo i ndonjë forme tjetër përfitimi, (ii) kundër një personi që jep ose ka të ngjarë t'i japë deklaratë ose informacion policisë, prokurorit apo gjykatësit.⁴⁵⁷ Trupi Gjykses theksoi se ZPS-ja nuk pretendoi se të akuzuarit përdorën forcën, ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit, premtimin e ndonjë dhurate apo ndonjë përfitimi tjetër – dhe për këtë arsye nuk i shqyrtoi këto elemente alternative. Trupi Gjykses rrjedhimisht vlerësoi nëse të akuzuarit përdorën kërcënimin e rëndë kundër ndonjë personi që kishte dhënë ose kishte gjasa të jepte deklaratë ose t'i jepte informacion policisë, prokurorit ose gjykatësit.⁴⁵⁸ Trupi Gjykses u bind se kërcënimet e rënda të shkaktuara nga veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve do t'u kenë krijuar frikë dhe shqetësime të rënda shumë dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm, që përbënte një faktor të fortë shkurajues për dhënien e informacioneve (të mëtejshme) nga këta persona lidhur me krimet që përfshihen në juridiksionin e Dhomave të Specializuara.⁴⁵⁹

(a) Pretendimet për gabime në lidhje me përkufizimin e elementeve materiale të veprës penale sipas nenit 387 të KPK-së (Pika 1 e Apelit të Gucatit)

(i) Parashtrimet e palëve

211. Së pari, Gucati argumenton se Trupi Gjykses bëri gabim juridik në konstatimin mbi veprimin e fajshëm sipas nenit 387 të KPK-së.⁴⁶⁰ Konkretisht, ai argumenton se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se pjesa e fundit e nenit 387 të KPK-së ("kur informacione të tilla ndërliken me pengimin e procedurës penale") cilëson vetëm

⁴⁵⁷ Aktgjykimi, para. 109.

⁴⁵⁸ Aktgjykimi, para. 557.

⁴⁵⁹ Aktgjykimi, para. 585-586. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin para. 558-584.

⁴⁶⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 19-20. Paneli vëren se në Dosjen e vet të Apelit, Haradinaj duket se ka hequr dorë nga një pikë e ngjashme për apel, që ishte përfshirë fillimisht në Njoftimin e tij për Apel. *Shih* Njoftimin për Apel të Haradinajt, Pika 19, para. 25, ku parashtrori se Trupi Gjykses bëri gabim juridik në lidhje me nenin 387 të KPK-së "në interpretimin se çfarë përfshihet në frazën 'kur informacionet e tilla ndërliken me pengimin e procedurës penale'".

alternativën e tretë të asaj dispozite, përkatësisht “për të mos dhënë informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit”.⁴⁶¹ Sipas Gucatit, kjo pjesë iu referohet të tri alternativave, domethënë, edhe dy alternativave të para (“të përmbahet nga dhënia e deklaratës ose për të dhënë deklaratë të rreme”), dhe se interpretimi i Trupit Gjykues, i cili lë jashtë këtë cilësim, krijon një dallim të pathemeltë midis tri alternativave.⁴⁶² Gucati argumenton se veprimi i fajshëm nuk u vërtetua meqenëse nuk u paraqitën prova për përdorimin e kërcënimit të rëndë brenda kuptimit të nenit 387 të KPK-së *në lidhje me pengimin e procedurës penale*.⁴⁶³

212. Për më tepër, Gucati parashtron se, megjithëse konstatoi se pjesa “pengim” e cilësimit do të vlente vetëm për alternativën e tretë të nenit 387 të KPK-së, Trupi Gjykues më pas shpërfilli plotësisht pjesën e “pengimit” kur konstatoi se veprimi i fajshëm ishte vërtetuar në lidhje me rastet kur kërcënimi i rëndë ishte përdorur kundër personave që kishte gjasa “të jepnin informacion (të mëtejshëm) për çfarëdo vepre penale brenda juridiksionit [të Dhomave të Specializuara]”.⁴⁶⁴ Gjithashtu, sipas Gucatit, Trupi Gjykues nuk konstatoi që kërcënimi i rëndë ishte përdorur kundër

⁴⁶¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 12-13, 18-20. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 16-17, 21. Gucati parashtron se “përfshirja dhe formulimi” i cilësimit “kur informacione të tilla ndërliken me pengimin e procedurës penale” në nenin 387 të KPK-së është bërë sipas cilësimit të njëjtë “kur informacionet e tilla ndërliken me kryerjen e krimit të organizuar” në nenin 310 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, që Trupi Gjykues duket se e ka pranuar se përshkruan çdonjërin prej tri alternativave. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 14-16; Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 37-39.

⁴⁶² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 10-13, 17-18; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 22-34. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 16-17. Gjatë seancës së apelit, Gucati qartësoi më tej se pjesa e fundit e nenit 387 “kur informacione të tilla” nuk lidhet vetëm me shprehjen “informacione të vërteta” në alternativën e tretë, sepse sipas pretendimit të tij, hartuesit e nenit 387 të KPK-së pranojnë se nuk kanë ndonjë dallim material midis “deklaratës” dhe “dhënies së informacioneve” në kontekstin e procedurave ligjore; për këtë arsye, sipas Gucatit, të dy alternativat e para (përkatësisht, mosdhënia e deklaratës ose dhënia e një deklaratë të rreme) gjithashtu “përmbajnë informacion”. *Shih* Transkriptin 1 dhjetor 2022, f. 36-40.

⁴⁶³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 21-23, 25; Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 28-29, 34-36. Gucati gjithashtu parashtron se qasja e Trupit Gjykues lidhet më shumë me një verdikt fajësie për veprë penale në bazë të nenit 386(1) të KPK-së, se sa në bazë të nenit 387 të KPK-së. *Shih* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 34-35; Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 24; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 15.

⁴⁶⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 52-55, 58-59. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 18.

personave që kishin dhënë ose kishte të ngjarë të jepnin “deklaratë”, por iu referua në mënyrë të gabuar personave që kishin dhënë “informacion” ose “dëshmi”.⁴⁶⁵

213. Gucati gjithashtu argumenton se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që konstatoi se “kërcënimi i rëndë” në nenin 387 të KPK-së përfshinte kërcënimin për të shkaktuar dëmtim të rëndë të shëndetit, mirëqenies, sigurisë apo privatësisë së një personi.⁴⁶⁶ Sipas Gucatit, “kërcënimi i rëndë” duhet të interpretohet duke mbajtur parasysh përdorimin pararendës të fjalës “forcë”.⁴⁶⁷ Gjithashtu, ai argumenton se, sido që të jetë, nuk u bë asnjë konstatim – dhe nuk u paraqit asnjë provë – për përdorim të forcës, të kërcënimit të rëndë për përdorimin e forcës, ose të kërcënimit për të shkaktuar dëmtim të rëndë të shëndetit të një personi në këtë çështje gjyqësore, edhe në qoftë se një kërcënim i tillë mund të përbëjë “ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit”.⁴⁶⁸ Sipas Gucatit, Trupi Gjykses “më së shumti” konstatoi se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin “një faktor të fortë shkurajues” për dhënien e informacioneve nga këta persona, por argumenton se një faktor i tillë shkurajues “nuk është i njëjtë me shtrëngimin”.⁴⁶⁹

214. Gjithashtu, Gucati parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që konstatoi se veprimet dhe/ose deklaratat që shkaktojnë frikë dhe shqetësime të rënda, ose nga të cilat “buron” kërcënimi i rëndë, në vetvete përbëjnë kërcënim të rëndë sipas nenit 387 të KPK-së.⁴⁷⁰ Konkretisht, Gucati argumenton se: “kërcënimi i rëndë” nënkupton kërcënimin për të “shkaktuar” dëmtim të rëndë “në të ardhmen”;

⁴⁶⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 56-57. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 115-116.

⁴⁶⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 26-29; Shtojca 2 e Dosjes së Apelit të Gucatit; Shtojca 1 e Dosjes së Apelit të Gucatit, f. 2.

⁴⁶⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 26; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 54-55, 59-61, ku Gucati gjithashtu parashtron se neni 181 i KPK-së, në të cilin kërcënimi përkufizohet si vepër penale, “bën të qartë se kërcënimi i rëndë i referohet kërcënimit ndaj jetës dhe paprekshmërisë fizike të një personi”.

⁴⁶⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 30-32; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 55-56, 59-60.

⁴⁶⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 31.

⁴⁷⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 34-37, 42. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 20.

se konstatimet e Trupit Gjykses e lanë jashtë këtë element,⁴⁷¹ dhe se Trupi Gjykses nuk shpjegoi se çfarë kuptonte me kërcënim të rëndë që “buron” nga veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve.⁴⁷²

215. Së fundi, Gucati parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që konstatoi se neni 387 i KPK-së nuk kërkon që të provohet se “kërcënimi i rëndë” faktikisht *nxiti*⁴⁷³ persona që të mos i jepnin deklaratë, t’i jepnin deklaratë të rreme apo të mos i jepnin informacion të vërtetë policisë, prokurorit apo gjykatësit.⁴⁷⁴ Sipas tij, në lidhje me veprat penale të shpërfilljes, dispozitat përkatëse të TPNJ-së dhe GJPN-së nuk kërkojnë vërtetimin e pasojës, por i japin rëndësi sjelljes kriminale, ndërkohë që nenet 386 dhe 387 të KPK-së përqendrohen në pasojën e sjelljes.⁴⁷⁵ Në fund, Gucati parashtron se Trupi Gjykses nuk konstatoi që ndonjë person faktikisht *u nxit*.⁴⁷⁶

216. ZPS-ja përgjigjet se, në qoftë se pjesa e “pengimit” në nenin 387 të KPK-së do të interpretohej si cilësim i përgjithshëm i të tri alternativave të nenit 387, kjo do të çonte në një interpretim absurd sipas të cilit vetëm dëshmitarë që kanë informacion për pengimin mund të jenë objekt i frikësimit, dhe shton se as gjykatat e Kosovës nuk e interpretojnë kështu nenin 387 të KPK-së.⁴⁷⁷ Rrjedhimisht, sipas ZPS-së, nuk ishte e

⁴⁷¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 33, 36-37, 40-41. Gucati gjithashtu parashtron se ishin të pamjaftueshme konstatimet e Trupit Gjykses se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve shkaktuan, kontribuuan, shtuan ose zmadhuan frikën dhe shqetësimin. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 34, 37.

⁴⁷² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 38-39.

⁴⁷³ Gucati gjithashtu argumenton se nuk ka dallim domethënës midis formulimit në nenin 387 (“për të nxitur”) dhe atij në nenin 386 (“nxitjes”) të KPK-së. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 44-45, 47; Vendimin e Konfirmimit, para. 62; Parashtrimet e ZPS-së lidhur me Dispozitat Ligjore të Zbatueshme, para. 20.

⁴⁷⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 43-47, 50-51; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 41-46.

⁴⁷⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 46-50, i referohen rregullës 77(A)(iv) të Rregullores së TPNJ-së; neni 70(1)(c) të Statutit të Romës; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 44-46.

⁴⁷⁶ *Shih* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 51.

⁴⁷⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 61, i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, Kosovë, 10 qershor 2020; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Kosovë, 12 shkurt 2021. *Krahaso* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 19, ku Gucati parashtron se të dy vendimet që citon ZPS-ja janë vendime të shkallës së parë. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 133-135, ku ZPS-ja parashtron

nevojshme që Trupi Gjykses të bënte konstatim se informacioni lidhej me pengimin e procedurës penale.⁴⁷⁸ ZPS-ja gjithashtu përgjigjet se argumentet e Gucatit në lidhje me Pikën 1(E) të Apelit të tij, bazohen në interpretimin e gabuar që i bën ligjit në Pikën 1(A) dhe për këtë arsye duhet të hidhen poshtë.⁴⁷⁹

217. Gjithashtu, ZPS-ja përgjigjet se nga neni 387 i KPK-së është e qartë se “kërcënimi”, i cili është thjesht një nga format e sjelljes të përmendura në këtë nen, duhet të jetë vetëm “i rëndë” dhe nuk ka nevojë të jetë “për përdorimin e forcës”.⁴⁸⁰

218. ZPS-ja gjithashtu argumenton se “kërcënimi i rëndë” në nenin 387 të KPK-së është cilësim ligjor i sjelljes së të akuzuarve.⁴⁸¹ ZPS-ja parashton se as Gucati e as Haradinaj⁴⁸² nuk kundërshtojnë vlerësimet e Trupit Gjykses mbi bazën e të cilave u konstatua se sjellja e të akuzuarve përbënte “kërcënim të rëndë”, por thjesht paraqesin “pretendime se Trupi Gjykses nuk u dha peshën e duhur provave”.⁴⁸³ ZPS-ja më tej parashton se të akuzuarit nuk arrijnë të demonstrojnë se Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e vet faktik se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin “kërcënim të rëndë”.⁴⁸⁴

219. Së fundi, ZPS-ja përgjigjet se konstatimi i Trupit Gjykses se neni 387 i KPK-së nuk kërkon që të provohen pasojat, në fakt është në përputhje me interpretime të ngjashme të dhomave gjyqësore të TPNJ-së dhe GJPN-së në lidhje me vepra penale të

se kishte edhe dallime të tjera midis nenit 310 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, pararendësit të nenit 387 të KPK-së, dhe versionit aktual të KPK-së, krahas atyre që vë në dukje Gucati; për shembull, titulli i nenit 310 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ishte “Frikësimi gjatë procedurës penale për krimin e organizuar”, formulim i cili nuk u përsërit i njëjtë në nenin 387 të KPK-së aktuale, ku titulli është “Frikësimi gjatë procedurës penale”.

⁴⁷⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 60, 62; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 135-136.

⁴⁷⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 62.

⁴⁸⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 63. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 136-137.

⁴⁸¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 64.

⁴⁸² *Shih më poshtë*, para. 234, 237.

⁴⁸³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 64-65.

⁴⁸⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 66.

krahasueshme.⁴⁸⁵ ZPS-ja gjithashtu nuk pajtohet me “interpretimin kontekstual” prej Gucatit të neneve 386 dhe 387 të KPK-së, dhe argumenton se neni 386 dallon nga neni 387 në atë se në lidhje me të kërkohen “pasoja konkrete”.⁴⁸⁶

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

220. Së pari, Paneli i Apelit thekson se nga konstatimet e Trupit Gjykes del qartë se të akuzuarit u shpallën fajtorë në bazë të alternativës së parë të nenit 387 të KPK-së, përkatësisht se përdorën kërcënime të rënda për të nxitur persona që “të mos jepnin deklaratat”.⁴⁸⁷

221. Paneli i Apelit fillimisht do të shtjellojë se çfarë përfshin cilësimi “kur informacione të tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale” në nenin 387 të KPK-së, sikurse është ngritur nga Gucati.⁴⁸⁸ Paneli i Apelit gjykon se shprehja “informacione të tilla” në cilësimin e nenit 387 të KPK-së i referohet shprehjes “informacione të vërteta” në alternativën e tretë, d.m.th., personit që nuk jep “informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit”, për shkak të vendit ku është vendosur cilësimi dhe formulimit të tij. Paneli vëren së pari se cilësimi u referohet “informacione të tilla” dhe rrjedhimisht “informacioneve të vërteta” të përmendura në alternativën e tretë, dhe, së dyti, cilësimi është vendosur menjëherë pas alternativës së tretë.⁴⁸⁹

⁴⁸⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 67-68, i referohen Aktgjykimit *Beqaj*, para. 21; Aktgjykimi *Haraqija dhe Morina*, para. 18; Statuti i Romës, neni 70(1)(c); *Bemba et al.* Trial Judgment, para. 43, 48; *Bemba et al.* Appeal Judgment, para. 737. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 136.

⁴⁸⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 69, i referohet Vendimit të Konfirmimit, para. 62, poshtëshënimi 40, cituar në Aktgjykim, para. 115.

⁴⁸⁷ *Shih* Aktgjykimin para. 585-586, 604 (“[t]ë gjitha veprimet dhe deklaratat e lartpërmendura të të akuzuarve ishin pjesë e vetëdijshme dhe thelbësore e kërcënimit të rëndë që ata përdorën për t’i nxitur dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të mos jepnin dëshmi (të mëtejshme) për [Dhomat e Specializuara]/ZPS-në, 605.

⁴⁸⁸ *Shih* Pikën 1(A) të Apelit të Gucatit.

⁴⁸⁹ *Shih* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 36-38; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 133-134. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 114.

222. Për më tepër, kur krahason nenin 387 të KPK-së me nenin 310 të KPPK-së – neni pararendës i nenit 387 të KPK-së me titull “Frikësimi gjatë procedurës penale për krimin e organizuar” – Paneli i Apelit nuk pajtohet me interpretimin e Gucatit se Trupi Gjykses pranoi që vendosja dhe formulimi i cilësimit (“kur informacione të tilla ndërlidhen me krimin e organizuar”) nënkuptonte se cilësimi vlente për të tri alternativat e nenit 310 të KPPK-së.⁴⁹⁰ Në poshtëshënimin përkatës, Trupi Gjykses thjesht vuri në dukje dallimin në formulimin e titullit dhe tekstit të këtyre dy dispozitave, por nuk bëri një konstatim të tillë. Për më tepër, në kundërshtim me sugjerimin e Gucatit, Paneli i Apelit nuk gjykon se synimi i mundshëm i hartuesve të legjislacionit në formulimin e nenit 310 të KPPK-së është përcaktues për interpretimin e nenit 387 të KPK-së prej Panelit të Apelit.⁴⁹¹ Duke qenë se pjesa e “pengimit” nuk vlen për alternativën e parë të nenit 387 të KPK-së, Paneli i Apelit gjykon se Trupi Gjykses nuk gaboi që nuk nxori konstatime se të akuzuarit përdorën kërcënimin e rëndë në lidhje me pengimin e procedurës penale.

223. Paneli i Apelit vëren se pjesa më e madhe e argumenteve të Gucatit në Pikën 1(E) të Apelit të tij lidhen në mënyrë të pandashme me Pikën 1(A) të Apelit dhe duhen rrëzuar.⁴⁹² Sa i përket përdorimit të gabuar, sikurse pretendohet, të termave “dëshmi” (“që nuk është në nenin 387 [të] KPK-së”)⁴⁹³ dhe “informacione” në vend të termit “deklaratë”, Paneli nuk është bindur nga argumentet e Gucatit. Paneli vëren se Gucati nuk kundërshton konstatimin se, në përputhje me KPK-në dhe KPrPK-në, hetimet e prokurorisë përfshihen në kuadrin e “procedurës penale”.⁴⁹⁴ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit pajtohet me konstatimin e Trupit Gjykses në lidhje me Pikën 3 të

⁴⁹⁰ *Shih* Aktgjykimin, para. 114, poshtëshënimi 186. *Contra* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 14-16; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 38.

⁴⁹¹ *Shih* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 25-27, 36-41; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 133-134. *Contra* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 14-16; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 37-39.

⁴⁹² Pjesa më e madhe e argumenteve të Gucatit në Pikën 1(E) mbështeten në interpretimin e pasaktë të tij se neni 387 i KPK-së kufizon informacionin përkatës në informacion në lidhje me “pengimin e procedurës penale”. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 52-55, 58-59.

⁴⁹³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 57.

⁴⁹⁴ Aktgjykimi, para. 74, 113. *Shih gjithashtu* më lart, para. 129.

Aktakuzës, se ishte vërtetuar veprimi i fajshëm, duke qenë se u bënë kërcënime të rënda kundër personave, ku përfshihen dëshmitarë dhe dëshmitarë të mundshëm, të cilët i dhanë “dëshmi” ose “informacione” – dhe jo “deklarata” – Dhomave të Specializuara ose ZPS-së.⁴⁹⁵

224. Paneli i Apelit në vijim do të shqyrtojë kundërshtimin e Gucatit në lidhje me përkufizimin e “kanosjes serioze/kërcënimit të rëndë” në nenin 387 të KPK-së, dhe argumentin e tij se kjo duhet të interpretohet duke mbajtur parasysh fjalën “forcë” që i paraprin.⁴⁹⁶ Fillimisht, Paneli thekson se ky aspekt, dhe në veçanti kundërshtimi i Gucatit lidhur me përkufizimin e kërcënimit të rëndë në nenin 401(1) të KPK-së, do të shtjellohen më tej në pjesën e mëposhtme në lidhje me Pikën 1 të Aktakuzës.⁴⁹⁷ Paneli vëren se pararendësi i nenit 387 të KPK-së, që është neni 310 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, përmban formulimin “[k]ushdo që përdor forcë, kërcënim për përdorimin e forcës ose ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit duke i premtuar dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër”.⁴⁹⁸ Megjithatë, fraza “kërcënim për përdorimin e forcës” u hoq si në KPK-në e vitit 2012, ashtu edhe në KPK-në aktuale (të vitit 2019).⁴⁹⁹ Paneli i Apelit gjykon se fshirja e frazës “kërcënim për përdorimin e forcës” në KPK-në e vitit 2012 dhe në KPK-në aktuale pasqyron synimin e hartuesve të legjislacionit për të zgjeruar fushëveprimin e nenit 387 të KPK-së, në mënyrë që të përfshijë jo vetëm kërcënimin për përdorimin e forcës, por edhe çdo kërcënim të rëndë ose veprim të dëmshëm.⁵⁰⁰

225. Për më tepër, Paneli i Apelit gjykon se kërcënimin mund të jetë i rëndë edhe në qoftë se nuk ka të bëjë me përdorimin e forcës, dhe në këtë kontekst vëren se edhe

⁴⁹⁵ *Shih* Aktgjykimin, para. 113, 581, 585-587.

⁴⁹⁶ Pika 1(B) e Apelit të Gucatit. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 26-32; Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 54-55, 59-61.

⁴⁹⁷ *Shih më poshtë*, para. 278-280.

⁴⁹⁸ Theksimi i shtuar. *Shih* Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, neni 310.

⁴⁹⁹ *Shih* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 59-61. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 136.

⁵⁰⁰ *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 144; *Shih më poshtë*, para. 278.

gjykatat në Kosovë kanë përdorur këtë interpretim.⁵⁰¹ Gjithashtu, Paneli i Apelit e gjykon relevant faktin që Trupi Gjykses mbajti parasysht edhe dispozita të tjera të KPK-së, në të cilat ose përdoret termi “kërcënim” për të përshkruar një veprim të dëmshëm që nuk është përdorimi i forcës,⁵⁰² ose është e qartë kur “kërcënimi” i referohet përdorimit të forcës ose dhunës.⁵⁰³

226. Argumenti i Gucatit se Trupi Gjykses gaboi që nuk bëri konstatim në lidhje me përdorimin e forcës, kërcënimin e rëndë për përdorimin e forcës, ose kërcënimin për të shkaktuar dëmtim të rëndë të shëndetit të një personi në këtë çështje gjyqësore, gjithashtu duhet rrëzuar.⁵⁰⁴ Së pari, sikurse u theksua më lart, Trupi Gjykses vlerësoi siç duhet veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve në kuadër të përkufizimit më të gjerë të “kërcënit të rëndë” si një nga mënyrat e kryerjes së veprës penale të renditura në nenin 387 të KPK-së, i cili jo domosdoshmërisht lidhet me përdorimin e forcës.⁵⁰⁵ Gjithashtu, kur vlerësoi nëse veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë dhe nëse ato do t’u kishin shkaktuar frikë dhe shqetësime të rënda shumë dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm,⁵⁰⁶ Trupi Gjykses u bazua në përkufizimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake të kërcënit të rëndë, i cili përfshinte vlerësimin e dëmit të rëndë të shkaktuar për shëndetin, mirëqenien,

⁵⁰¹ *Shih* Aktvendimin e Gjykatës Themelore, Kosovë, 12 shkurt 2021, i përmendur në Shtojcën 2 të Dosjes së Përgjigjes së ZPS-së, f. 2-12, në të cilin gjykata e cilësoi si kërcënim të rëndë, sipas nenit 395 të KPK-së të vitit 2012, kërcënimin e të akuzuarit se do t’i tregonte familjes së gruas së viktimës që kishte pasur lidhje dashurie me një grua. *Shih gjithashtu* KPK, neni 181; Komentarin *Salihu dhe të tjerët*; nenin 185(1) të KPK-së të vitit 2012, komentet 2-3, f. 497, ku pranohet një përkufizim më i gjerë i “kërcënit të rëndë” se ai që sugjeron Gucati. *Contra* Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 54-55, 59-61 (ku Gucati parashtron se neni 181 i KPK-së “e bën të qartë se kërcënimi i rëndë i referohet kërcënit ndaj jetës dhe paprekshmërisë fizike të personit”). *Shih gjithashtu* më lart, poshtëshënimin 467.

⁵⁰² *Shih* Aktgjykimin, para. 144, poshtëshënimi 233, i referohet KPK-së, neneve 160(2.7), 161(2.5), 167(4), 168(4), 169, 170(6.5), 171, 181, 227(3.2), 229(2.2).

⁵⁰³ *Shih* Aktgjykimin, para. 144, poshtëshënimi 234, i referohet KPK-së, neneve 114, 118, 121, 158(1), 160(2.1), 161(2.1), 227(3.1), 229(2.1), 247(3). *Shih gjithashtu* më lart, para. 278.

⁵⁰⁴ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 30-32; Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 55-56, 59-60.

⁵⁰⁵ *Shih* Aktgjykimin, para. 557 (ku Trupi Gjykses theksoi se nuk do të trajtonte përdorimin e forcës ose të ndonjë mënyre tjetër të përmendur në nenin 387 të KPK-së, sepse nuk ishin pretenduar në këtë çështje gjyqësore).

⁵⁰⁶ *Shih* Aktgjykimin, para. 585-586.

sigurinë apo privatësinë e një personi.⁵⁰⁷ Paneli i Apelit gjykon se, sikurse shtjellohet më poshtë dhe duke qenë se neni 387 i KPK-së nuk kërkon që sjellja të ketë pasur pasojë konkrete mbi personin, Trupi Gjykses bëri më shumë se çfarë kërkohet në nenin 387 të KPK-së kur konstatoi se zbulimi i identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm nga të akuzuarit shkaktoi pasoja të rënda për dëshmitarët e rrezikuar, si konfirmim të shkallës së rëndë të kërcënimit.⁵⁰⁸

227. Në lidhje me kuadrin kohor të “kërcënimit të rëndë” që ngre Gucati, edhe nëse me të drejtë argumenton se “kërcënimi” nënkupton që do të shkaktohet njëfarë dëmi në të ardhmen,⁵⁰⁹ Paneli vëren se në të vërtetë kjo pasqyrohet në konstatimet e Trupit Gjykses.⁵¹⁰ Faktikisht, kur vlerësoi nëse sjellja e të akuzuarve përbënte kërcënim të rëndë, Trupi Gjykses mori parasysh provat që tregonin se personat *do të* pësonin dëm. Konkretisht, Trupi Gjykses mori parasysh: (i) deklaratat e të akuzuarve në lidhje me disa nga pasojat e zbulimit të informacionit, përkatësisht se dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të përfshirë në informacionin e mbrojtur “diheshin” dhe nuk mund të mbroheshin nga Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja, dhe rrjedhimisht ishin të cenueshëm;⁵¹¹ (ii) mënyrën në të cilën u zbulua informacioni i mbrojtur dhe veçanërisht faktin që të akuzuarit vunë në dukje numrin e madh të dëshmitarëve të

⁵⁰⁷ *Shih* Aktgjykimin, para. 112 (poshtëshënimi 182), 558 (poshtëshënimi 1173), i referohet Vendimit të Konfirmimit, para. 60.

⁵⁰⁸ *Shih* Aktgjykimin, para. 582-583, i referohet nenit 392(3) të KPK-së në lidhje me Pikën 6 të Aktakuzës. Trupi Gjykses konstatoi se “[m]jegjithatë, çdo ndikim i tillë, nëse vërtetohet, mund të shërbejë si bazë për përcaktimin e nivelit dhe peshës së kërcënimit si rezultat i veprimeve dhe deklaratave të të akuzuarve”. *Shih* Aktgjykimin, para. 582. *Shih gjithashtu* më poshtë, para. 229.

⁵⁰⁹ Pika 1(C) e Apelit të Gucatit. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 36, 40.

⁵¹⁰ *Contra* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 37.

⁵¹¹ Aktgjykimi, para. 565-568. *Shih*, në veçanti, Aktgjykimin, poshtëshënimi 1190, ku citohet Gucati (“Se ata e kanë çu Gjykatës Speciale në Hagë, pra e kanë hjek prej Kosove në Hagë për shkak të sigurisë e kanë çu, unë e dim, për ti mbrojt dëshmitarët, për ti mbrojt t’gjith. Edhe sot kush i mbron ndoshta këta dëshmitar, kush i mbron t’gjith këto dokumentacione?” (theksimi i shtuar)), i referohet P00009, f. 5; 1193, ku citohet Haradinaj (“Materiali i parë që për me kallxu [...] o qyqona, u budallë, o spiuna të lind, o spiuna, mos mendoni që ju mbron kush, veç çka t’u shfrytëzon, se kurrë në botë nuk mbahet mend që e ka mbrojt dikush spiunin mbasi e ka shfrytëz. Përkundrazi, o e ka vra, o e ka diskretitu, o e ka bo kare. Tash të presësh ti, ta tradhtosh popullin tënd, ushtrinë tënde, të rrejsh, të shpifësh, me fakte të armikut?” (theksimi i shtuar)), i referohet P00008, f. 26.

cilët i identifikuan dhe “u betuan në mënyrë të përsëritur se do të bënin publike çfarëdo dokumentesh të tjera të [Dhomave të Specializuara] /ZPS-së që do të merrnin, pa bërë dallim sa i takon përmbajtjes së atyre dokumenteve”,⁵¹² dhe se (iii) në kontekstin specifik të Kosovës, deklaratat të tilla do të kishin efekt frikësues të dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm.⁵¹³

228. Paneli i Apelit gjithashtu i referohet konstatimit të Trupit Gjyqësor se të akuzuarit nuk vepruan në cilësinë e tyre si individë, por se veprimet dhe deklaratat e tyre për publikimin e materialeve të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së u miratuan nga kryesia e OVL-UÇK-së.⁵¹⁴ Me këtë konstatim, Trupi Gjyqësor në mënyrë të arsyeshme përfshiu edhe një faktor tjetër në vlerësimin e vet, i cili vuri në pah nivelin e rritur të rrezikut për shkak të llojit të veprimeve, të cilat nuk ishin thjesht veprime individuale, por të miratuara nga kryesia e OVL-UÇK-së. Gjithashtu, Trupi Gjyqësor shpjegoi qartë se çfarë kuptonte me “kërcënim të rëndë ‘të shkaktuar’ nga veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve”.⁵¹⁵ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit nuk konstaton gabim në përfundimin e Trupit Gjyqësor se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve do t’u kenë krijuar “frikë dhe shqetësime të rënda shumë personave që i dhanë dëshmi ose kishin të ngjarë t’i jepnin dëshmi [Dhomave të Specializuara]/ZPS-së”.⁵¹⁶

229. Sa i përket argumentit të Gucatit në lidhje me vërtetimin e shkaktimit të pasojës,⁵¹⁷ Paneli i Apelit vë në dukje konstatimin e Trupit Gjyqësor se neni 387 i KPK-së nuk kërkon që të provohet se forca apo kërcënim i rëndë faktikisht nxitën persona që të mos jepnin deklaratë, të jepnin deklaratë të rreme apo të mos jepnin informacion të vërtetë.⁵¹⁸ Paneli i Apelit vëren se neni 387 i KPK-së përqendrohet në sjelljen

⁵¹² Aktgjykimi, para. 562. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin para. 559-561, 563-564.

⁵¹³ Aktgjykimi, para. 578. *Shih gjithashtu*, Aktgjykimin para. 576-577, 579-581.

⁵¹⁴ *Shih* Aktgjykimin, para. 580.

⁵¹⁵ Aktgjykimi, para. 582, 586. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin para. 558-581, 583-584. *Contra* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 38-39.

⁵¹⁶ Aktgjykimi, para. 585. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin para. 560, 564, 568, 575.

⁵¹⁷ *Shih* Pikën 1(D) të Apelit të Gucatit; Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 41-46.

⁵¹⁸ Aktgjykimi, para. 115.

kriminale, domethënë, përdorimit të kërcënimit të rëndë, kur përcakton se “[k]ushdo që përdor forcën apo kanosjen serioze [...] për të nxitur personin tjetër”,⁵¹⁹ kurse neni 386 i KPK-së përqendrohet te rezultati, domethënë, në faktin se kryesi “detyron” ose “nxit” një person të japë deklaratë të rreme, të fshehtë ndonjë fakt material ose të refuzojë të japë deklaratë.⁵²⁰ Për mendimin e Panelit të Apelit, Trupi Gjykses konstatoi me të drejtë se interpretimi që përdori, i cili ishte ai i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, është në përputhje me vetë formulimin e nenit 387 të KPK-së.⁵²¹ Në këtë kontekst, Trupi Gjykses konstatoi se ky interpretim është plotësisht në pajtim me qëllimin e dispozitës, që është mbrojtja e të dhënave të dëshmitarëve dhe të dhënësve të tjerë të informacionit dhe, më në përgjithësi, mbrojtja e integritetit të procedurës penale përmes penalizimit të kryesit që synon të ushtrojë ndikim mbi një dëshmitar.⁵²² Ky interpretim është gjithashtu në përputhje me qasjen dhe interpretimin e veprave penale të ngjashme nga ana e TPNJ-së dhe GJPN-së.⁵²³

230. Bazuar në sa më lart, Paneli gjykon se Gucati nuk arrin të demonstrojë gabim në konstatimet e Trupit Gjykses mbi përkufizimin e elementeve materiale të veprës

⁵¹⁹ Theksimi i shtuar.

⁵²⁰ Sipas nenit 386(1) të KPK-së, “[k]ushdo që me anë të detyrimit apo rryshfetit, me qëllim të: (1.1) nxitjes së ndonjë personi që të jep deklaratë të rreme, të ofrojë dokument të rremë apo të fshehtë ndonjë fakt material në procedurë zyrtare; [...] [ose] (1.7) nxitjes së dëshmitarit apo ekspertit për të refuzuar dhënien e dëshmisë ose për të dhënë dëshmi të rreme në procedurë gjyqësore [...]” është fajtor për veprën penale të pengimit të provave apo procedurës zyrtare. *Shih* Aktgjykimin, para. 115; Vendimin e Konfirmimit, para. 62. *Contra* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 45.

⁵²¹ Aktgjykimi, para. 115, i referohet Vendimit të Konfirmimit, para. 62.

⁵²² Aktgjykimi, para. 115.

⁵²³ *Shih* Rregulloren e TPNJ-së, rregulla 77(A)(iv), sipas së cilës TPNJ-ja mund të mbajë përgjegjësi për shpërfillje ndaj gjykatës këdo që me vetëdije dhe qëllimisht, ndërhyr në ushtrimin e drejtësisë, duke përfshirë çdo person, i cili “kërcënon, frikëson, shkakton dëm ose i ofron shpërblim një dëshmitari, ose ndryshe ndërhyr ndaj një dëshmitari i cili është duke dhënë, ka dhënë ose do të japë dëshmi në një proces para Dhomës ose një dëshmitari të mundshëm”; Statutin e Romës, neni 70(1)(c), sipas të cilit “[n]dikimi korruptues” mbi një dëshmitar përbën veprën penale kundër administrimit të drejtësisë prej GJPN-së. *Shih* Piragoff, D. K., në *Ambos Rome Statute Commentary*, Article 70, mns 19-24; *Shih gjithashtu Ambos Treatise ICL II*, pp. 282-289; Aktgjykimi *Haraqija dhe Morina*, para. 18; *Margetić Trial Judgment*, para. 64; Aktgjykimi *Beqaj*, para. 21; *Bemba et al. Appeal Judgment*, para. 737; *Bemba et al. Trial Judgment*, paras 43, 48.

penale sipas nenit 387 të KPK-së. Rrjedhimisht, Paneli rrezon Pikën 1 të Apelit të Gucatit.

(b) Pretendimet për gabime në lidhje me pranimin e provave lidhur me vërtetimin e *veprimit të fajshëm* të veprës penale sipas nenit 387 të KPK-së (Pika 2(A), pjesërisht, dhe Pika 2(B) e Apelit të Gucatit; Pika 8, pjesërisht, dhe Pika 19 e Apelit të Haradinajt)

(i) Parashtrimet e palëve

231. Gucati parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim juridik dhe faktik që u mbështet në dëshminë e znj. Pumper për të konstatuar se të akuzuarit zbuluan identitetet dhe/ose të dhënat personale të qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm që përmbanin Paketat, dhe që në fund konstatoi se ishte vërtetuar veprimi i fajshëm i veprës penale sipas nenit 387 të KPK-së.⁵²⁴

232. Gucati argumenton se deklaratat e znj. Pumper në lidhje me numrin e dëshmitarëve (të mundshëm) të përmendur në informacionin e mbrojtur nuk mund të kundërshtoheshin siç duhet dhe duket se janë të gabuara, meqenëse faktikisht vetëm gjashtë individë u identifikuan si dëshmitarë (të mundshëm).⁵²⁵ Sipas Gucatit, kjo ishte arsyeja pse Trupi Gjykses nuk mund të mbështetej në “shkallën e zbulimit të [informacionit]” për të vlerësuar nëse sjellja e të akuzuarve përbënte ose përfshinte kërcënimin e rëndë sipas nenit 387 të KPK-së,⁵²⁶ dhe logjikisht nuk mund të kishte arritur në përfundimin se “numri i madh i identiteteve të zbuluara” do t’u ketë “shkaktuar frikë dhe shqetësime shumë prej atyre që i dhanë dëshmi [Dhomave të Specializuara]/ZPS-së, ose që kishin gjasë ta bënë këtë”.⁵²⁷

⁵²⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 80-84.

⁵²⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 80-83, 88. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 48-49.

⁵²⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 84-87. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen e Gucatit, para. 2.

⁵²⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 88-89; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 48-49, 52-53. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 178-180.

233. Gucati më tej parashtron se Trupi Gjykues me të drejtë nuk nxori konstatime në lidhje me dëshmitarë prej të cilëve nuk kishte dëgjuar dëshmi – dhe të cilët Mbrojtja nuk mund t'i merrte në pyetje – në lidhje me frikën dhe shqetësimet e rënda të shkaktuara nga veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve.⁵²⁸ Megjithatë, ai argumenton se Trupi Gjykues gaboi që u mbështet në “shqetësimet e shprehura nga dëshmitarët si rezultat i zbulimit të [informacionit]” – të përfshirë në prova të cilat Trupi Gjykues deklaroi se nuk do t'i merrte parasysh – kur vlerësoi nëse kërcënimet ishin të rënda brenda kuptimit të nenit 387 të DHSK-së.⁵²⁹ Sipas Gucatit, Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se *shumë* persona kishin frikë dhe shqetësime të rënda, kur vetëm për një dëshmitar u konstatua se kishte pësuar frikë dhe shqetësim që do të mund të përshkruhej si “cenim thelbësor i sigurisë, mirëqenies, privatësinë ose dinjitetit të personave të mbrojtur ose familjeve të tyre”.⁵³⁰

234. Haradinaj argumenton se Trupi Gjykues e ushtroi në mënyrë të gabuar kompetencën e vet diskrecionale gjatë nxjerrjes së përfundimeve në lidhje me përmbajtjen e Paketave, duke marrë parasysh metodologjinë e “përzgjedhjes” të përdorur prej znj. Pumper në analizimin e listave të sekuestruara të dëshmitarëve.⁵³¹ Haradinaj më tej parashtron se Trupi Gjykues gaboi që u mbështet në komentet e tij për të konstatuar se ZPS-ja vërtetoi që ai kishte përdorur “kërcënime të rënda” për të nxitur ose për të tentuar të nxiste personat sipas Pikës 3 të Aktakuzës.⁵³² Haradinaj argumenton se përfundimi më i afërt dhe i arsyeshëm që mund të nxirret nga komentet e bëra prej tij në kohën e nxjerrjes së informacionit ishte “kundërshtimi i

⁵²⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 96-99, 105.

⁵²⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 100, 103, 105, 108; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 22-24.

⁵³⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 102, 104, 106. Gucati gjithashtu parashtron se informacioni për masa mbrojtëse të përdorura për dëshmitarët vetëm nga ZPS-ja, ishte i pamjaftueshëm për të mbështetur në mënyrë të arsyeshme konstatimin e Trupit Gjykues. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 101.

⁵³¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 100-101; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 22, 24-26. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 104-107; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 23.

⁵³² Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 178-181; Njoftimi për Apel i Haradinajt, Pika 20, para. 26.

pranuar dhe publik i tij ndaj *mënyrës së veprimit të ZPS-së dhe [Dhomave të Specializuara]*”, jo ekzistenca e kërcënimeve, sikurse konstatoi Trupi Gjykses.⁵³³

235. ZPS-ja i përgjigjet Gucatit se Trupi Gjykses u mbështet në shqetësimet e shprehura nga dëshmitarët të cilët Gucati i kundërshton, vetëm për të konfirmuar konstatimin e vet se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë dhe do të kenë krijuar frikë dhe shqetësime të rënda.⁵³⁴ Sipas ZPS-së, Gucati nuk shpjegon pse verdiktet e fajësisë në bazë të Pikës 3 të Aktakuzës nuk do të ishin të vlefshme pavarësisht nga konstatimet faktike të kundërshtuara.⁵³⁵ Për më tepër, ZPS-ja parashton se Gucati shtrembëron arsyetimin e Trupit Gjykses kur argumenton se konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me “shumë dëshmitarë” që pësuan frikë dhe shqetësime të rënda u bazuan në prova të cilat Mbrojtja nuk pati mundësinë t’i kundërshtonte gjatë gjykimit, meqenëse z. Jukiq dha dëshmi në lidhje me këtë dhe Mbrojtja pati mundësinë t’i bënte pyetje.⁵³⁶

236. ZPS-ja përgjigjet se argumenti i Haradinajt në lidhje me metodologjinë e znj. Pumper duhet të rrëzohet menjëherë sepse nuk tregon se si do ta zhvlerësonte kjo konstatimin e Trupit Gjykses, dhe se, gjithsesi, Trupi Gjykses shpjegoi se si e vlerësoi dëshminë e znj. Pumper dhe u mbështet në dëshmi të tjera të shumta për të vërtetuar se Paketat përmbanin informacion për persona të mbrojtur.⁵³⁷

237. Së fundi, ZPS-ja përgjigjet se Haradinaj thjesht argumenton se Trupi Gjykses nuk u dha peshë të mjaftueshme provave, pa kundërshtuar saktësinë e konstatimeve të Trupit Gjykses.⁵³⁸ Gjithashtu, ZPS-ja shton se të akuzuarit nuk arritën të vërtetonin

⁵³³ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 179-181; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 47-49.

⁵³⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 70.

⁵³⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 70.

⁵³⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 71.

⁵³⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 58-59.

⁵³⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 64-65.

se Trupi Gjykses bëri gabim në vlerësimin e vet faktik se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin “kërcënim të rëndë”.⁵³⁹

238. Në lidhje me Pikën 2(B) të Apelit të tij, Gucati kundërpërgjigjet se, kur konstatoi se shumë dëshmitarë kishin frikë dhe shqetësime të rënda, Trupi Gjykses u mbështet në dëshmi për “shqetësime të shprehura nga dëshmitarë”, të cilat mund të gjendeshin vetëm në shënimet e ZPS-së për kontaktet me dëshmitarët – material ky për të cilin Trupi Gjykses shprehimisht theksoi se nuk do ta merrte parasysh për konstatimet e veta.⁵⁴⁰

(ii) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

239. Paneli i Apelit do të vlerësojë fillimisht argumentet e Gucatit lidhur me dëshminë e dhënë nga znj. Pumper për shkallën e zbulimit të informacionit.⁵⁴¹

240. Paneli i Apelit e ka trajtuar tashmë aspektin e mosnxjerrjes së Paketave dhe rikujton konstatimin e vet se të akuzuarit nuk demonstuan se Trupi Gjykses bëri gabim që shqyrtoi dokumentet e panxjerra dhe/ose të redaktuara që përmbanin Paketat, si dhe se pranimi i dëshmisë së znj. Pumper nuk i shkaktonte Mbrojtjes asnjë dëm që do të përlligjte përjashtimin e saj sipas rregullës 138(1) të Rregullores.⁵⁴²

241. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit gjykon se Trupi Gjykses nuk gaboi që u mbështet në dëshminë e znj. Pumper për të konstatuar se të akuzuarit zbuluan identitetet dhe/ose të dhënat personale të qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm në informacionin e mbrojtur.⁵⁴³ Sipas mendimit të Panelit, fakti se të akuzuarit identifikuan publikisht me emër vetëm gjashtë individë⁵⁴⁴ nuk e zvogëlon “shkallën e zbulimit”, sepse është vërtetuar se të akuzuarit “zbuluan” identitetet dhe/ose të

⁵³⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 66.

⁵⁴⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 22-24.

⁵⁴¹ *Shih* Pikën 2(A) të Apelit të Gucatit.

⁵⁴² *Shih më lart*, para. 65-73.

⁵⁴³ Aktgjykimi, para. 345-346, 350, 355, 379-381, 559.

⁵⁴⁴ *Shih* Aktgjykimin, para. 345, 355, 372, 625-627.

dhënat personale të dëshmitarëve (të mundshëm) duke ua shpërndarë tri grupet e dokumenteve gazetarëve gjatë tri konferencave për shtyp dhe duke u lejuar atyre të shihnin emrat dhe deklaratat e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.⁵⁴⁵

242. Gjithsesi, Paneli vëren se “shkalla e zbulimit” nuk është veçse një prej faktorëve që u shqyrtuan nga Trupi Gjykses për të vlerësuar nëse sjellja e të akuzuarve përbënte “kërcënim të rëndë” sipas Pikës 3 të Aktakuzës.⁵⁴⁶ Rrjedhimisht, edhe sikur të akuzuarit të kishin zbuluar identitetet dhe/ose të dhënat personale të vetëm gjashtë dëshmitarëve (të mundshëm), do të vërtetohej gjithsesi veprimi i fajshëm i frikësimit gjatë procedurës penale sipas nenit 387 të KPK-së.

243. Paneli i Apelit do të trajtojë tani kundërshtimin e Haradinajt ndaj metodologjisë së përdorur nga znj. Pumper. Paneli vëren fillimisht se Haradinaj nuk jep asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij se znj. Pumper përdori metodologjinë e “përzgjedhjes” gjatë analizimit të listave të dëshmitarëve.⁵⁴⁷ Gjithashtu, ai nuk jep asnjë provë për pretendimin se kjo metodologji ishte e pamjaftueshme në ato rrethana, veçanërisht duke pasur parasysh se konstatimet e Trupit Gjykses mbi përmbajtjen e Paketave u mbështetën edhe në prova të tjera, sidomos në deklaratat e bëra nga vetë të akuzuarit në atë kohë dhe në vijim.⁵⁴⁸ Duke pasur parasysh përparësinë që u jepet konstatimeve faktike të Trupit Gjykses,⁵⁴⁹ Paneli i Apelit nuk është bindur se ka

⁵⁴⁵ Aktgjykimi, para. 561-564. Paneli vëren se, ndonëse argumenton se në “standardin” që përdori znj. Pumper për t’i llogaritur këta numra kishte një “gabim të dukshëm”, Gucati nuk e përkufizon këtë gabim. *Shih* Apelin e Gucatit, para. 83.

⁵⁴⁶ Aktgjykimi, para. 558, ku Trupi Gjykses u shpreh se do të mbante parasysh këta faktorë: “(i) mënyrën se si u zbulua informacioni i mbrojtur; (ii) deklaratat e të akuzuarve lidhur me disa nga pasojat e zbulimit të tij; (iii) deklaratat e të akuzuarve lidhur me emrat e zbuluar; (iv) kontekstin në të cilin u zbulua informacioni dhe u dhanë deklaratat e të akuzuarve; dhe (v) shkallën e ndonjë kërcënimi pasues.” *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 559-584.

⁵⁴⁷ Paneli vëren se Haradinaj citon dëshminë e znj. Pumper lidhur me procesin e konfirmimit të autenticitetit, por nuk pajtohet me pretendimin e Haradinajt për përzgjedhjen. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, poshtëshënimi 96, ku i referohet KSC-BC-2020-07; Transkriptin, [20 tetor 2021], f. 1068-1070. Paneli vëren se data e dhënë nga Haradinaj për referencën e transkriptit ishte e pasaktë.

⁵⁴⁸ Aktgjykimi, para. 331-381. *Shih gjithashtu më lart*, para. 72.

⁵⁴⁹ *Shih më lart*, para. 33.

ndonjë gabim në vlerësimin që Trupi Gjykses i bëri analizës së listës së dëshmitarëve nga znj. Pumper. Për këto arsye, Paneli i Apelit i rrëzon argumentet e Haradinajt në këtë aspekt.

244. Sa i takon argumentit të Gucatit lidhur me provat ku u mbështet Trupi Gjykses për të vlerësuar nëse ndonjë kërcënim ishte i rëndë,⁵⁵⁰ Paneli vëren se Gucati i keqinterpretonte konstatimet e Trupit Gjykses për elementin “frikë dhe shqetësime të rënda” në nenin 387 të KPK-së. Siç thuhet më lart, dhe siç konstatoi saktë Trupi Gjykses,⁵⁵¹ neni 387 i KPK-së nuk kërkon që të jepen prova lidhur me pasojat e kërcënimit. Trupi Gjykses konstatoi se shkalla e rëndë e kërcënimit ishte vërtetuar përmes veprimeve dhe deklaratave të të akuzuarve,⁵⁵² dhe, për më tepër, për të konfirmuar shkallën e rëndë të kërcënimit, Trupi Gjykses mori parasysh në mënyrë të arsyeshme provat për masat mbrojtëse të marra nga ZPS-ja dhe shqetësimet e shprehura nga dëshmitarët që u kundërshtuan nga Gucati.⁵⁵³

245. Gjithsesi, Paneli vëren se Trupi Gjykses i lidhi këto konstatime edhe me konstatimet e veta mbi nenin 392(3) të KPK-së, lidhur me një numër të kufizuar dëshmitarësh të cilët patën “pasojat të rënda” nga veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve dhe vëren se ato konstatime u mbështetën në dëshminë e z. Jukiq, të cilit Mbrojtja pati mundësi t’i bënte pyetje.⁵⁵⁴ Gjithashtu, pasi nuk konstatoi asnjë gabim në përkufizimin dhe vlerësimin e Trupit Gjykses të “pasojave të rënda” brenda kuptimit

⁵⁵⁰ *Shih* Pikën 2(B) të Apelit të Gucatit; Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 100-108; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 22-24.

⁵⁵¹ *Shih më lart*, para. 229.

⁵⁵² *Shih* Aktgjykimin, para. 558-581.

⁵⁵³ Aktgjykimi, para. 582, ku Trupi Gjykses shprehet se “frika dhe shqetësimet e rënda që shkaktuan veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve konfirmohen më tej nga provat lidhur me masat mbrojtëse që u detyrua të merrte ZPS-ja si dhe nga shqetësimet e shprehura nga dëshmitarët si rezultat i zbulimit të informacionit të mbrojtur.” *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 584.

⁵⁵⁴ Aktgjykimi, para. 583, ku i referohet Aktgjykimit, para. 547. *Shih më lart*, para. 196-197.

të nenit 392(3) të KPK-së,⁵⁵⁵ Paneli i Apelit konstaton se përmendja e atyre konstatimeve nga Trupi Gjykses ishte e duhur.

246. Më tej, Paneli i Apelit do të trajtojë argumentin e Haradinajt se deklaratat e tij, të cilave iu referua Trupi Gjykses, nuk ishin kërcënime të shprehura apo të nënkuptuara, por tregojnë kundërshtimin e mirënjohur publik të Haradinajt ndaj ZPS-së dhe Dhomave të Specializuara.⁵⁵⁶

247. Fillimisht, Paneli vëren se Pika 19 e Njoftimit për Apel të Haradinajt trajton aspekte të tjera, konkretisht gabime juridike që lidhen si me veprimin e fajshëm, ashtu dhe me synimin kriminal të veprës penale sipas nenit 387 të KPK-së.⁵⁵⁷ Argumentet e trajtuara në Pikën 19 të Apelit të Haradinajt janë në fakt pjesë e Pikës 20 të Njoftimit për Apel të Haradinajt.⁵⁵⁸ Paneli rikujton se të akuzuarit duhet t'i kërkojnë leje Panelit të Apelit për të bërë ndryshime në njoftimet për apel, duke treguar "arsye të vlefshme" dhe, gjithashtu, dosjet e apelit duhen strukturuar dhe numërtuar sipas të njëjtit rend me njoftimet për apel, përveç nëse Paneli lejon ndryshe.⁵⁵⁹ Në parim, kjo justifikon rrëzimin e menjëhershëm të Pikës 19 të Apelit të Haradinajt. Meqenëse duket se Haradinaj ka hequr dorë nga argumentet fillestare të paraqitura në Pikën 19 të Njoftimit për Apel dhe thjesht i ka kaluar argumentet e tij në Pikën 20 të Apelit të tij dhe këto nuk janë argumente të reja të ngritura pas dorëzimit të Njoftimit për Apel, Paneli, për hir të drejtësisë, do të bëjë përjashtim dhe do të trajtojë këtu themelësinë e argumenteve të Haradinajt.

⁵⁵⁵ *Shih më lart*, para. 198-202, 207.

⁵⁵⁶ Pika 19 e Apelit të Haradinajt. *Shih* Apelin e Haradinajt, para. 178-181; Njoftimin për Apel të Haradinajt, para. 26.

⁵⁵⁷ *Shih* Njoftimin për Apel të Haradinajt, Pika 19, para. 25, ku Haradinaj parashtroi se "Trupi Gjykses bëri gabim juridik në lidhje me [nenin] 387 [të] KPK-së, kur konstatoi se vepra penale e përkufizuar aty mund të kryhet me synim eventual dhe kur interpretoi se çfarë përfshihet në frazën 'kur informacione të tilla ndërliken me pengimin e procedurës penale'".

⁵⁵⁸ *Shih* Njoftimin për Apel të Haradinajt, Pika 20, para. 26, ku Haradinaj parashtroi se "Trupi Gjykses bëri gabim faktik që konstatoi se ZPS-ja ka vërtetuar se apeluesi përdori kërcënime të rënda për të nxitur ose për të tentuar të nxiste personat, në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës[...]"

⁵⁵⁹ *Shih më lart*, para. 30.

248. Në këtë aspekt, Paneli vëren se Haradinaj nuk kundërshton konstatimet faktike përkatëse të Trupit Gjykses se ai: (i) zbuloi identitetet dhe/ose të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm;⁵⁶⁰ (ii) zbuloi dhe shpërndau tri grupet e dokumenteve në tri konferencat për shtyp, duke vënë në dukje publikisht dhe në mënyrë të përsëritur se në to ishin emrat/të dhënat e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm dhe duke i ftuar personat e pranishëm t'i shikonin dhe të merrnin kopje të atyre dokumenteve;⁵⁶¹ (iii) deklaroi se publiku e dinte se kush ishin dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm dhe se Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja nuk ishin në gjendje të garantonin privatësinë dhe sigurinë e tyre;⁵⁶² dhe (iv) i përshkroi dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm, ndër të tjera, si spiunë, tradhtarë, bashkëpunëtorë, kriminelë dhe gjakpirës.⁵⁶³ Në fakt, të gjitha këto konstatime bazohen në deklaratat e vetë Haradinajt.

249. Bazuar në këto konstatime të pakundërshtuara, Paneli gjykon se Haradinaj nuk arrin të provojë se, mbi bazën e provave, asnjë gjykses i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte arritur në të njëjtin përfundim si Trupi Gjykses, pra, që veprimet dhe deklaratat e të akuzuarit përbënin “kërcënim të rëndë”.⁵⁶⁴ Rrjedhimisht, Paneli e rrëzon Pikën 19 të Apelit të Haradinajt.

250. Mbështetur në sa më lart, Paneli konstaton se Gucati dhe Haradinaj nuk arrijnë të provojnë se ka pasur gabim në konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm të veprës penale sipas nenit 387 të KPK-së. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon pjesën e

⁵⁶⁰ Aktgjykimi, para. 559. Paneli vëren se Haradinaj kundërshton vetëm shkallën e zbulimit të informacionit dhe argumenton se, faktikisht, për një numër individësh dihej publikisht në Kosovë se ishin dëshmitarë ose dëshmitarë të mundshëm në kohën që mbulon Aktakuza dhe se Trupi Gjykses nuk mund të kishte qenë i sigurt për numrin, statusin, apo cënueshmërinë faktike të këtyre individëve. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, Pika 14, para. 147(a), (c). *Shih gjithashtu* më poshtë, para. 390-391.

⁵⁶¹ Aktgjykimi, para. 561.

⁵⁶² Aktgjykimi, para. 565-567.

⁵⁶³ Aktgjykimi, para. 570-574.

⁵⁶⁴ *Shih më lart*, para. 29, 32.

mbetur të Pikës 2 të Apelit të Gucatit,⁵⁶⁵ pjesën e mbetur të Pikës 8 të Apelit të Haradinajt⁵⁶⁶ dhe Pikën 19 të Apelit të Haradinajt.

2. Pretendimet për gabime lidhur me synimin kriminal sipas nenit 387 të KPK-së (Pika 3 e Apelit të Gucatit; Pika 20 e Apelit të Haradinajt)

251. Gucati dhe Haradinaj kundërshtojnë gjithashtu konstatimet e Trupi Gjykses lidhur me synimin kriminal mbi të cilat u bazua verdikti i fajësisë për Pikën 3 të Aktakuzës, për përdorimin e kërcënimeve të rënda për të nxitur ose për të tentuar të nxisnin dëshmitarët që të mos i jepnin deklarata ZPS-së dhe/ose Dhomave të Specializuara, në bazë të nenit 387 të KPK-së.⁵⁶⁷ ZPS-ja përgjigjet se pikat përkatëse të apeleve të të akuzuarve duhen rrëzuar.⁵⁶⁸

252. Trupi Gjykses vendosi, me shumicë, se vepra penale e parashikuar në nenin 387 të KPK-së kërkon ose synim të drejtpërdrejtë, ose synim eventual (*dolus eventualis*),⁵⁶⁹ dhe përfundimisht konstatoi se të akuzuarit vepruan me synim të drejtpërdrejtë, pra “me vetëdije dhe dëshirë për t’i nxitur dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të identifikuar në informacionin e mbrojtur, që të mos i jepnin dëshmi (të mëtejshme) [Dhomave të Specializuara]/ZPS-së”.⁵⁷⁰

(a) Parashtrimet e palëve

253. Gucati parashtron se Trupi Gjykses nuk përcakttoi kriteret konkrete për synimin e drejtpërdrejtë në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës.⁵⁷¹ Sipas tij, Trupi Gjykses

⁵⁶⁵ Paneli e rrëzoi pjesën tjetër të kundërshtimeve të Pikës 2(A) të Apelit të Gucatit në pjesën ku trajtohet nxjerrja e informacionit. *Shih më lart*, para. 65-73.

⁵⁶⁶ Paneli e rrëzoi pjesën tjetër të kundërshtimeve të Pikën 8 të Apelit të Haradinajt në pjesën ku trajtohet forma e rëndë e veprës penale në Pikën 6 të Aktakuzës. *Shih më lart*, para. 193-197, 207.

⁵⁶⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 109-134; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 182-196; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 25-30; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 50-53. *Shih gjithashtu* Aktakuzën, para. 29-30, 48.

⁵⁶⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 72-76.

⁵⁶⁹ Aktgjykimi, para. 124.

⁵⁷⁰ Aktgjykimi, para. 605, 960.

⁵⁷¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 109, 114, 122.

bëri gabim juridik që konstatoi se mjaftonte që të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për t'i nxitur dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm.⁵⁷² Gucati parashtron gjithashtu se, gjithsesi, Trupi Gjykses nuk bëri asnjë konstatim se të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për të nxitur konkretisht ndonjë person që të mos jepte “deklaratë”, por në vend të kësaj gabimisht iu referuan personave që japin “informacion” ose “dëshmi”, ndërkohë që neni 387 i KPK-së nuk e përmban këtë term.⁵⁷³ Gucati parashtron sërish se Trupi Gjykses “thjesht e shpërfilli” cilësimin “kur informacione të tilla ndërliidhen me pengimin e procedurës penale” gjatë shqyrtimit të synimit kriminal.⁵⁷⁴

254. Gjithashtu, Gucati argumenton se Trupi Gjykses nuk arriti të vërtetonte se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se informacioni në fjalë ishte “i vërtetë”, që, sipas tij, është një kriter i nenit 387 të KPK-së.⁵⁷⁵ Në seancën e apelit, Gucati theksoi më tej se “deklarata” e përmendur në alternativën e parë të nenit 387 të KPK-së (“të përmbahet nga dhënia e deklaratës”) duhet të jetë e vërtetë, sepse nuk mund të ketë dallim ndërmjet kushtit që kryesi të nxisë dikë të mos japë informacion të vërtetë (në alternativën e tretë) dhe “pastaj të mos kërkohet i njëjti synim për vërtetësi në lidhje me deklaratën” në alternativën e parë.⁵⁷⁶

⁵⁷² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 110-114. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 56.

⁵⁷³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 115-116; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 25.

⁵⁷⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 117-118; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 30. *Shih gjithashtu më lart*, para. 211-212.

⁵⁷⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 119-121; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 26-29; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 56-57. Paneli vëren se Gucati mbështetet në interpretimin e nenit 388(1) të KPK-së nga Trupi Gjykses se, ndër të tjera, të akuzuarit duhet të jenë të vetëdijshëm se informacioni nga dëshmitarët ishte, më së paku deri në një farë mase, i vërtetë. *Shih* Aktgjykimin, para. 621, 623, të cituar në Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 120-121.

⁵⁷⁶ Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 39-41, 57.

255. Gucati parashtron më tej se Trupi Gjykues bëri gabim juridik që konstatoi se vepra penale sipas nenit 387 të KPK-së mund të kryhet, si alternativë, me synim eventual.⁵⁷⁷

256. Haradinaj parashtron se Trupi Gjykues bëri gabim faktik që deduktoi synim të drejtpërdrejtë nga veprimet dhe deklaratat e tij.⁵⁷⁸ Sipas tij, veprimet dhe deklaratat e tij dhe konstatimet faktike të Trupit Gjykues në këtë aspekt, nuk tregojnë “dëshirën [e tij] për të ndryshuar” atë që dëshmitarët (e mundshëm) mund t’u thonë Dhomave të Specializuara dhe/ose ZPS-së.⁵⁷⁹ Haradinaj parashtron se, përkundrazi, deklaratat e tij “kishin për qëllim vetëm të tregonin dështimet dhe paaftësinë e ZPS-së/[Dhomave të Specializuara] dhe, rrjedhimisht, të diskreditonin dhe kundërshtonin legjitimitetin e saj”.⁵⁸⁰ Haradinaj argumenton se e vetmja provë që mund të mbështeste “në pamje të parë” ekzistencën e synimit kriminal të kërkuar, është e pamjaftueshme.⁵⁸¹

257. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykues faktikisht i përcaktoi kriteret konkrete për synimin e drejtpërdrejtë të frikësimit gjatë procedurës penale sipas nenit 387 të KPK-së, dhe qartazi bëri konstatimet e nevojshme.⁵⁸² Në lidhje me argumentin e Gucatit për informacionin në lidhje me pengimin e procedurës penale, ZPS-ja parashtron se Gucati ngatërron kriteret e veprimit të fajshëm me kriteret e synimit kriminal.⁵⁸³ Gjithashtu, ZPS-ja përgjigjet se neni 387 i KPK-së përcakton si vepër penale nxitjen e dikujt që “të përmbahet nga dhënia e deklaratës”, dhe se Trupi Gjykues bëri konstatim

⁵⁷⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 123-134. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 57-58. Paneli vëren se në Dosjen e Apelit të tij, Haradinaj duket se ka hequr dorë nga një pikë apeli të ngjashme, që fillimisht e kishte përfshirë në Njoftimin për Apel. *Shih* Njoftimin për Apel të Haradinajt, Pika 19, para. 25. *Shih gjithashtu më lart*, para. 247.

⁵⁷⁸ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 182-184, 187.

⁵⁷⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 183-184.

⁵⁸⁰ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 184.

⁵⁸¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 185-186, ku i referohet P00008, f. [30]-31, cituar në Aktgjykimin, para. 601.

⁵⁸² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 72.

⁵⁸³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 73.

për synimin e drejtpërdrejtë mbi këtë bazë.⁵⁸⁴ Sipas ZPS-së, Trupit Gjykues nuk i kërkohet të bënte konstatim mbi vërtetësinë e informacionit në fjalë.⁵⁸⁵

258. ZPS-ja përgjigjet gjithashtu se, duke qenë se nuk kishte gabim në konstatimet e Trupit Gjykues lidhur me synimin e drejtpërdrejtë, argumentet e Gucatit mbi synimin eventual duhen rrëzuar menjëherë.⁵⁸⁶

259. Gjithashtu, ZPS-ja përgjigjet se Haradinaj vetëm shpreh mospajtim me interpretimin e provave nga Trupi Gjykues ndërkohë që pranon se ka disa prova që e mbështesin atë interpretim.⁵⁸⁷

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

260. Paneli i Apelit do ta fillojë vlerësimin me kundërshtimet e të akuzuarve në lidhje me synimin e drejtpërdrejtë.

261. Paneli i Apelit vëren fillimisht se, në kundërshtim me çfarë pretendon Gucati, Trupi Gjykues faktikisht i përcaktoi kriteret konkrete të synimit të drejtpërdrejtë për veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale sipas nenit 387 të KPK-së.⁵⁸⁸ Konkretisht, Trupi Gjykues konstatoi se synimi i drejtpërdrejtë është “të dëshirojë të nxisë një person” të mos japë deklaratë ose të japë deklaratë të rreme, ose të mos i japë informacione të vërteta policisë, prokurorit apo gjykatësit, kur informacione të tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale.⁵⁸⁹

262. Gjithashtu, Paneli i Apelit gjykon se përkufizimi dhe konstatimet përkatëse të Trupit Gjykues dëshmojnë se të akuzuarit kishin synimin e drejtpërdrejtë të përdornin kërcënim të rëndë për t'i bërë dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm që të mos u

⁵⁸⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 74.

⁵⁸⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 74. ZPS-ja argumenton në veçanti se përmendja nga Gucati e interpretimit të Trupit Gjykues të nenit 388(1) të KPK-së është krejt pa vend.

⁵⁸⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 75.

⁵⁸⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 76.

⁵⁸⁸ Aktgjykimi, para. 121-122. *Contra* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 109.

⁵⁸⁹ Aktgjykimi, para. 122. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 588.

jepnin dëshmi Dhomave të Specializuara ose ZPS-së.⁵⁹⁰ Konkretisht, Trupi Gjykses konstatoi, ndër të tjera, se të akuzuarit: (i) donin t'i shpërndanin sa më gjerë tri grupet e dokumenteve; (ii) nuk morën masa për të kufizuar zbulimin e emrave të renditur në informacionin e mbrojtur; dhe (iii) bënë deklaratat nënçmuese kundër dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm, duke thënë se "ata që u zbuluan se kishin "bashkëpunuar" me [Dhomat e Specializuara]/ZPS-në, tani rrezikoheshin të dëmtoheshin".⁵⁹¹ Më tej, Trupi Gjykses konstatoi se deklaratat e të akuzuarve se Dhomat e Specializuara/ZPS-ja nuk mund t'i mbronin dëshmitarët e tyre, "të ndërthurura me komentet nënçmuese dhe kërcënuese të shprehura nga të akuzuarit, synonin t'i bënin dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të ndiheshin të cenueshëm".⁵⁹² Paneli i Apelit gjykon se konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin e drejtpërdrejtë për veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale sipas nenit 387 të KPK-së janë të arsyeshme.

263. Paneli i Apelit vëren se Gucati paraqet dy argumente konkrete, gjatë shqyrtimit të synimit kriminal, se Trupi Gjykses gaboi që: (i) iu referua personave që japin "informacion" ose "dëshmi" – ndërkohë që fjala "dëshmi" nuk është në nenin 387 të KPK-së, si dhe e shpërfilli cilësimin "kur informacione të tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale";⁵⁹³ dhe (ii) nuk bëri konstatim lidhur me vërtetësinë e informacionit të dhënë prej dëshmitarëve sipas nenit 387 të KPK-së.⁵⁹⁴ Sa i takon argumentit të parë, Paneli i Apelit vlerëson se Gucati përsërit të njëjtat argumente që

⁵⁹⁰ *Shih* Aktgjykimin, para. 121-122, 588-605. *Shih gjithashtu* Përgjigjen e ZPS-së, para. 72. *Contra* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 114.

⁵⁹¹ *Shih* Aktgjykimin, para. 589-590, 596, 603. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 591-595, 597-602.

⁵⁹² *Shih* Aktgjykimin, para. 604.

⁵⁹³ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 115-118. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 25, 30.

⁵⁹⁴ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 119-121. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 26-29.

paraqiti në lidhje me veprimin e fajshëm. Pasi i ka rrëzuar argumentet mbi veprimin e fajshëm më lart,⁵⁹⁵ Paneli i rrëzon po kështu edhe këto argumente të përsëritura.

264. Paneli do të trajtojë tani argumentin e dytë të Gucatit, sipas të cilit duhej që konstatimi për synimin kriminal të merrte parasysh vërtetësinë e informacionit që do të jepej nga dëshmitarët sipas nenit 387 të KPK-së.⁵⁹⁶ Paneli rikujton se mosdhënia e “informacioneve të vërteta” është vetëm pjesë e njërës prej tri alternativave të nenit 387 të KPK-së, dhe, më e rëndësishmja, të akuzuarit nuk u shpallën fajtorë në bazë të kësaj alternative;⁵⁹⁷ pra, në rrethanat aktuale nuk ngrihet problemi i kriterit të mundshëm të synimit kriminal.⁵⁹⁸ Orvatja e Gucatit që interpretimin që Trupi Gjykses i bëri synimit kriminal në kuadër të nenit 388(1) të KPK-së – konkretisht se kriteri i synimit kriminal përfshin elementin e (vetëdijes për) vërtetësinë e informacionit – ta zbatonte edhe për nenin 387 të KPK-së, është rrjedhimisht e papërshtatshme.

265. Mbështetur në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Gucati nuk arrin të demonstrojë gabim në vlerësimin e synimit të drejtpërdrejtë nga Trupi Gjykses. Bazuar në faktin se synimi i drejtpërdrejtë u vërtetua, Paneli i Apelit konstaton se argumentet e Gucatit se synimi eventual nuk është i mjaftueshëm për të mbështetur shpalljen fajtor sipas nenit 387 të KPK-së⁵⁹⁹ janë hipotetike dhe nuk do të kishin asnjë ndikim mbi Aktgjykimin e apeluar.⁶⁰⁰ Rrjedhimisht, Paneli rrëzon menjëherë argumentet e Gucatit në këtë aspekt.

266. Sa u përket argumenteve të Haradinajt lidhur me synimin e drejtpërdrejtë, Paneli vëren se Haradinaj nuk i kundërshton konstatimet faktike lidhur me deklaratat e të akuzuarit, prej të cilave Trupi Gjykses arriti në përfundimin se ai veproi “me

⁵⁹⁵ *Shih më lart*, para. 221-223.

⁵⁹⁶ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 119-121.

⁵⁹⁷ *Shih më lart*, para. 220-222. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 114, 604-606.

⁵⁹⁸ *Shih* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 39-41.

⁵⁹⁹ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 123-134.

⁶⁰⁰ Argumentet të cilat nuk kanë potencialin për prapësimin apo rishikimin e vendimit të apeluar mund të rrëzohen menjëherë dhe nuk është e nevojshme të shqyrtohet themelësia e tyre. *Shih më lart*, para. 31.

vetëdije dhe dëshirë për t'i nxitur dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të identifikuar në informacionin e mbrojtur, që të mos i jepnin dëshmi (të mëtejshme) [Dhomave të Specializuara]/ZPS-së".⁶⁰¹ Haradinaj madje pranon se Trupi Gjykses mund të deduktonte nga konstatimet e veta se ai [Haradinaj] ishte "armiqësor me dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm, se ai e kuptonte se ata mund të dëmtoheshin dhe se ai synonte shpërbërjen e ZPS-së/[Dhomave të Specializuara] dhe mbrojtjen e anëtarëve të OVL-UÇK-së nga shpallja fajtor".⁶⁰² Haradinaj pranon gjithashtu se, një koment i caktuar i tij, "në pamje të parë", mund të konsiderohej se përmbushte kriterin e synimit.⁶⁰³ Megjithatë, ai përsëri sugjeron se deklaratat e tij mund të interpretoheshin vetëm si orvatje për të diskredituar ZPS-në dhe Dhomat e Specializuara dhe për të dëmtuar legjitimitetin e tyre.⁶⁰⁴

267. Paneli i Apelit thekson se Trupi Gjykses e shqyrtoi konkretisht interpretimin alternativ të provave nga Haradinaj, por konstatoi se deklaratat e Haradinajt synonin t'i bënin dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të ndiheshin të cenueshëm dhe se ato "ishin pjesë e vetëdijshme dhe thelbësore e kërcënimit të rëndë" të përdorur prej tij për t'i bërë ata të mos jepnin dëshmi (të mëtejshme) për Dhomat e Specializuara dhe ZPS-së.⁶⁰⁵ Sipas mendimit të Panelit të Apelit, Haradinaj thjesht shpreh mospajtimin e tij me konstatimet e Trupit Gjykses, pa vërtetuar ndonjë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses.⁶⁰⁶

268. Mbështetur në sa më lart, Paneli konstaton se Gucati dhe Haradinaj nuk vërtetojnë se ka gabim në konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal të

⁶⁰¹ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 183-184; Aktgjykimin, para. 605.

⁶⁰² *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 184.

⁶⁰³ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 185, lidhur me komentin e mëposhtëm të bërë nga Haradinaj gjatë një interviste më 20 shtator 2020: "[Dhomat e Specializuara/ZPS-ja] ka me u rrëxu krejt. Çka lexova ... në bazë të cilave dëshmi u bo. Ka me u rrëxu krejt. Sepse tash edhe dëshmitarët që po e dinë që po dihen. [...]" *Shih* P00008, f. 30-31.

⁶⁰⁴ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 184. *Shih gjithashtu, më lart*, para. 234, 248-249.

⁶⁰⁵ *Shih* Aktgjykimin, para. 604. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 603, 605; *shih më lart*, para. 262.

⁶⁰⁶ *Shih* Aktgjykimin, para. 589-604.

veprës penale sipas nenit 387 të KPK-së. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 3 të Apelit të Gucatit dhe Pikën 20 të Apelit të Haradinajt.

E. PRETENDIMET PËR GABIME LIDHUR ME PENGIMIN E PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE PËRMES KËRCËNIMIT TË RËNDË (PIKA 1 E AKTAKUZËS)

1. Pretendimet për gabime lidhur me veprimin e fajshëm të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së (Pika 12 e Apelit të Gucatit; Pika 18 e Apelit të Haradinajt)

269. Gucati dhe Haradinaj kundërshtojnë konstatimet e Trupit Gjykses për veprimin e fajshëm mbi të cilat u bazua shpallja fajtor për Pikën 1 të Aktakuzës (“Pika 1 e Aktakuzës”) lidhur me pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, e ndëshkueshme sipas nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së.⁶⁰⁷ ZPS-ja përgjigjet se apelet e të akuzuarve për veprimin e fajshëm të Pikës 1 duhen rrëzuar.⁶⁰⁸

270. Paneli rikujton se neni 401(1) i KPK-së përcakton se:

Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

271. Gjithashtu, neni 401(5) i KPK-së përcakton se:

Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i [nenit 401 të KPK-së] kryhet ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë apo personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria, zyrtarit policor, zyrtarit doganor, zyrtarit ushtarak apo zyrtarit të shërbimit korrektues gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

⁶⁰⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 279-291; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 173-177; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 46. *Shih gjithashtu* Aktakuzën, para. 25-28, 48. Paneli rikujton se sipas para. 48 të Aktakuzës, vepra penale e “pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare” është e ndëshkueshme sipas neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 401(1) dhe (5) të KPK-së, të zbatueshme nëpërmjet neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

⁶⁰⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 105-110.

272. Trupi Gjykses u bind se të akuzuarit përmbushën një prej elementeve të veprimit të fajshëm të veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, sipas nenit 401(1) të KPK-së, përmes tentimit, pasi konstatoi, ndër të tjera, se: (i) kërcënimi i rëndë mund të drejtohet edhe kundër një personi ose objekti tjetër, jo vetëm kundër personit zyrtar; (ii) veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë, sepse do t'u kenë shkaktuar frikë dhe shqetësime të rënda atyre që dhanë ose kishin gjasa t'i jepnin dëshmi Dhomave të Specializuara/ZPS-së; dhe (iii) kërcënimi i rëndë kundër një apo më shumë dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm, në parim, mund të pengonte zyrtarë të Dhomave të Specializuara/ZPS-së në kryerjen e punës së Dhomave të Specializuara/ZPS-së, sepse mund të bëhej pengesë ose t'i krijonte vështirësi ZPS-së për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet, ose t'u pamundësonte paneleve të Dhomave të Specializuara që të dëgjonin dëshmi në lidhje me ato krime.⁶⁰⁹

(a) Parashtrimet e palëve

273. Gucati parashtron se “kërcënimi i rëndë” në kontekstin e nenit 401(1) të KPK-së nënkupton kërcënim të rëndë për përdorim të forcës.⁶¹⁰ Sipas mendimit të tij, përkufizimi i “kërcënimit” në KPK nuk përfshin askund interesa të gjera të tilla si mirëqenia, siguria apo privatësia, siç i ka përdorur Trupi Gjykses në kontekstin e këtij neni.⁶¹¹ Sipas Gucatit, duke qenë se neni 401(1) i KPK-së bën pjesë në kategorinë e “veprave penale kundër rendit publik”, në dallim nga neni 387 i KPK-së, “mënyra të tjera detyruese” nuk janë të mjaftueshme.⁶¹² Ai argumenton gjithashtu se ky zhvillim nga neni 316(1) i KPPK-së në nenin 401(1) të KPK-së, tregon vetëm theksim të shtuar nga ligjvënësi se kërcënimi duhet të jetë i rëndë.⁶¹³ Gucati parashtron gjithashtu se në këtë çështje gjyqësore nuk ka prova që të mbështesin konstatime për përdorim të

⁶⁰⁹ Aktgjykimi, para. 639-643, 647, 657-658.

⁶¹⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 279-280.

⁶¹¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 283, ku i referohet Dosjes së Apelit të Gucatit, para. 27-29.

⁶¹² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 284-285.

⁶¹³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 281.

forcës, kërcënimin të rëndë për përdorimin e forcës, ose për kërcënim për t'i shkaktuar dëm të rëndë shëndetit të personave.⁶¹⁴

274. Gjithashtu, dy të akuzuarit parashtrojnë se përdorimi i forcës ose i kërcënimit të rëndë duhet të jetë drejtuar ndaj personit që kryen detyra zyrtare.⁶¹⁵ Sipas Gucatit, qëllimi i nenit 401 të KPK-së është që të mbrojë personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nga veprime të dhunshme ose kërcënuese,⁶¹⁶ ndërsa sipas Haradinajt, teksti i nenit nuk përmban asnjë formulim që sugjeron se qëllimi i nenit është të parandalojë edhe pengimin e tërthortë të detyrave zyrtare.⁶¹⁷ Gjatë seancës së apelit, të akuzuarit sqaruan më tej se nuk ka mospërputhje midis argumentit se në shënjestër të kërcënimit duhet të jetë personi zyrtar, nga njëra anë, dhe atij se vepra penale mund të kryhet nëpërmjet orvatjes për pengim, nga ana tjetër.⁶¹⁸

275. Gjithashtu, Gucati parashtron se neni 401(1) i KPK-së kërkon që pengimi të ndodhë gjatë kohës që zyrtari është duke kryer detyrat zyrtare dhe se, për rrjedhojë, ZPS-ja duhet të përcaktojë veprimin zyrtar që është penguar dhe me të cilin ndodhin paralelisht ose njëkohësisht përdorimi i forcës ose kërcënimi i rëndë.⁶¹⁹ Gucati parashtron gjithashtu se nuk ka prova për të mbështetur konstatimin se përdorimi i

⁶¹⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 286.

⁶¹⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 287-289; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 173, 177.

⁶¹⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 288; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 114. Gucati argumenton gjithashtu se kjo është në përputhje me nenin 401(5) të KPK-së, që, sipas tij, demonstroi se kjo veprë penale mund të kryhet vetëm kundër personave gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 290.

⁶¹⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 176. Haradinaj argumenton gjithashtu se burimet e cituara nga Trupi Gjyqësor në mbështetje të konstatimit të vet për të kundërtën "mund të kuptohen ndryshe". *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 176, poshtëshënimi 171, ku i referohet Aktgjyqimit, para. 146, poshtëshënimi 239, ku citon Komentarin *Salihu dhe të tjerët*; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 91-92. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 46.

⁶¹⁸ Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 109-114; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 196. *Shih* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 94 (ku, ndonëse pajtohet me sugjerimin se kërcënim i një dëshmitari privat me synim dhe orvatja për të penguar një person zyrtar është një interpretim i mundshëm, mbrojtësi i Haradinajt argumenton se nuk ka prova për ta mbështetur këtë).

⁶¹⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 287.

forcës ose i kërcënimit të rëndë u drejtua ndaj një personi gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.⁶²⁰

276. ZPS-ja përgjigjet se orvatjet për të përfshirë një kriter shtesë në interpretimin e nenit 401(1) të KPK-së, konkretisht që kërcënimi i rëndë duhet të jetë kërcënim për përdorim të forcës, nuk kanë bazë ligjore dhe bien ndesh me kuptimin e zakonshëm të “kërcënimit” dhe me qëllimin e përgjithshëm të dispozitës për garantimin e kryerjes së papenguar të detyrave zyrtare.⁶²¹ Gjithashtu, ZPS-ja parashton se, duke qenë se u konstatua që kërcënimi ishte i njëkohshëm me detyrat zyrtare, Gucati nuk ka arritur të artikulojë ndonjë gabim.⁶²² Së fundi, ZPS-ja argumenton se në formulimin tekstual të këtij neni nuk thuhet askund se kërcënimi i rëndë duhet të drejtohet vetëm kundër zyrtarit në fjalë dhe se të akuzuarit “shpërfillin parimet bazë të shkakësisë, duke qenë të verbër ndaj faktit se kërcënimi i rëndë i dëshmitarëve (të mundshëm) mund të pengojë” punën e Dhomave të Specializuara/ZPS-së.⁶²³

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

277. Së pari, Paneli vëren se Gucati nuk evidenton se cilat pjesë të Aktgjykimit të Trupit Gjykses kundërshton në këtë pikë të apelit. Megjithatë, Paneli do të orientohet në bazë të pjesëve të Aktgjykimit të Trupit Gjykses të evidentuara nga Gucati në Njoftimin për Apel.⁶²⁴

278. Lidhur me kundërshtimin e Gucatis ndaj përkufizimit të “kërcënimit të rëndë” në nenin 401(1) të KPK-së, Paneli pajtohet me konstatimin e Trupit Gjykses se heqja

⁶²⁰ Dosja e Apelit të Gucatis, para. 291.

⁶²¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 105-107.

⁶²² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 109. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 108.

⁶²³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 110; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 141-142, 147-148. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 142-143 (ku parashtrohet se: (i) synimi konkret i argumentuar nga Mbrojtja lidhur me drejtimin e pengimit nuk përputhet me burimet e cituara prej saj; dhe (ii) në qoftë se mbrojtësi i Haradinajt pranon se, sipas dispozitës, është i mundshëm kërcënim i qëllimshëm i një dëshmitari dhe tentativa për të penguar një person zyrtar, atëherë e gjithë pika e apelit duhet rrëzuar për shkak se aty pretendohet gabim juridik).

⁶²⁴ Njoftimi për Apel i Gucatis, poshtëshënimet 31-33, ku i referohet Aktgjykimi, para. 144, 148.

nga KPK-ja e vitit 2012 dhe nga KPK-ja aktuale e termit “kanosje për përdorim të atëçastshëm të forcës”, e përdorur në dispozitën gjegjëse për të njëjtën veprë penale në KPPK,⁶²⁵ është tregues i qartë se ligjvënësi synonte që termi “kërcënim i rëndë” të përfshinte çdo kërcënim të rëndë për veprim të dëmshëm, jo vetëm kërcënimin për përdorimin e forcës.⁶²⁶ Nëse synimi i ligjvënësit do të kishte qenë vetëm që të sqaronte se kërcënimin për përdorim të menjëhershëm të forcës duhej të ishte i rëndë, siç sugjeron Gucati,⁶²⁷ atëherë ligjvënësi do të kishte shtuar fjalën “i rëndë” në vend që të hiqte frazën “për përdorim të atëçastshëm të forcës.” Në lidhje me këtë, Paneli vëren se Trupi Gjykses përmend edhe dispozita të tjera të KPK-së në të cilat përdoret termi “kanosje” për të përshkruar veprime të dëmshme të ndryshme nga përdorimi i forcës⁶²⁸ ose ku përcaktohet qartë se kur “kanosja” ka lidhje me përdorimin e forcës ose të dhunës.⁶²⁹ Paneli vëren gjithashtu se neni 401(4) i KPK-së e parashikon specifikisht kërcënimin për përdorimin e forcës me armë ose me sende të rrezikshme si faktor rëndues për të cilin jepet dënim më i rëndë.⁶³⁰

279. Ky interpretim i “kërcënimin të rëndë” në kontekstin e nenit 401(1) të KPK-së, që nuk kufizohet vetëm me kërcënimin për përdorim të forcës, është në përputhje edhe me interpretimin që i kanë bërë këtij termi gjykatat në Kosovë.⁶³¹ Paneli nuk bindet nga krahasimi që përpiqet të bëjë Gucati midis kësaj dispozite dhe nenit 387 të

⁶²⁵ *Shih* KPPK-në, neni 316(1).

⁶²⁶ Aktgjykimi, para. 144.

⁶²⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 281.

⁶²⁸ Aktgjykimi, para. 144, poshtëshënimi 233, ku i referohet KPK-së, nenet 160(2.7), 161(2.5), 167(4), 168(4), 169, 170(6.5), 171, 181, 227(3.2), 229(2.2).

⁶²⁹ Aktgjykimi, para. 144, poshtëshënimi 234, ku i referohet KPK-së, nenet 114, 118, 121, 158(1), 160(2.1), 161(2.1), 227(3.1), 229(2.1), 247(3).

⁶³⁰ *Shih gjithashtu* KPK-në, neni 401(6).

⁶³¹ *Shih* Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, 7 dhjetor 2017, para. 108, 112-113; Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, Kosovë, 21 nëntor 2016, f. 39-40 (ku një trup gjykses i EULEX-it u shpreh se, megjithëse thelbi i nenit 409(1) të KPK-së të vitit 2012, i cili përsërit fjalë për fjalë nenin 401(1) të KPK-së, dhe i nenit 316(1) të KPPK-së është i njëjtë, si Trupi Gjykses, ashtu edhe Paneli i Apelit, në përfundim: (i) pranuan se asnjëri prej dy të pandehurve nuk kishte përdorur ndonjë lloj force, dhe (ii) vlerësuan nëse veprimet e vërtetuara të të pandehurve mund të cilësoheshin si kërcënim për përdorim të menjëhershëm të forcës *apo* si kërcënim të rëndë). *Shih gjithashtu* nenin 181 të KPK-së (ku përkufizimi i kërcënimin si veprë penale më vete është më i përgjithshëm dhe nuk kufizohet në përdorimin e forcës).

KPK-së, i cili lejon mundësinë që vepra penale e frikësimit gjatë procedurës penale të vërtetohet jo vetëm përmes përdorimit të forcës ose kërcënimit të rëndë, por edhe përmes mënyrave të tjera detyruese.⁶³² Sipas mendimit të Panelit, fakti se vepra penale e parashikuar në nenin 401(1) të KPK-së bën pjesë në kategorinë e veprave penale kundër rendit publik, ndërsa neni 387 i KPK-së trajton kategorinë e veprave penale kundër administrimit të drejtësisë, nuk luan ndonjë rol në interpretimin e “kërcënimit të rëndë” në kontekst të nenit 401(1) të KPK-së. Një interpretim sistematik i tillë, duke marrë parasysh kategorinë ombrellë të veprave penale, sikurse sugjeron Mbrojtja, mund të jetë relevant vetëm në qoftë se nuk është i qartë kuptimi tekstual i disa termave. Në këtë rast nuk është kështu. Paneli mund të bazohet në kuptimin e zakonshëm të termave të përdorura dhe në objektin dhe qëllimin e Ligjit, sipas parimeve të përgjithshme të interpretimit.⁶³³

280. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton konstatimin e vet se nuk ka asnjë gabim në konstatimin e Trupit Gjykses se sjella e të akuzuarve përbën “kërcënim të rëndë” në kontekstin e nenit 387 të KPK-së.⁶³⁴ Duke pasur parasysh këtë interpretim, Paneli bindet se Trupi Gjykses e ka interpretuar saktë termin “kërcënim i rëndë” në kontekstin e nenit 401(1) të KPK-së, se nuk ka të bëjë vetëm me kërcënim për të përdorur forcë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi me të drejtë se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë dhe do të kenë krijuar frikë dhe shqetësime të rënda tek ata që i dhanë dëshmi ose kishin të ngjarë t’i jepnin dëshmi Dhomave të Specializuara/ZPS-së.⁶³⁵

281. Sa u përket kundërshtimeve lidhur me drejtimin e kërcënimit të rëndë, Paneli u referohet konstatimeve të Trupit Gjykses se: (i) në kontekstin e nenit 401(1) të KPK-së “kërcënimi i rëndë” mund të drejtohet kundër një personi zyrtar, një personi tjetër

⁶³² *Contra* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 284-285.

⁶³³ Vendimi mbi Apelet në lidhje me Juridiksionin në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 139.

⁶³⁴ *Shih më lart*, para. 244-250.

⁶³⁵ Aktgjykimi, para. 144, 640, 643. *Shih gjithashtu* Vendimin e Konfirmimit, para. 68.

apo një objekti;⁶³⁶ dhe (ii) nuk është e nevojshme të ndodhë pikërisht në atë moment kur personi zyrtar është duke kryer aktivisht një detyrë të caktuar, në qoftë se ka për qëllim pengimin e kryerjes së një detyre zyrtare të ardhshme ose që po kryhet në vijimësi.⁶³⁷ Gjithashtu, sipas Trupit Gjykses, termat “detyra zyrtare” dhe “funsione zyrtare” brenda kuptimit të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së, përdoren në shumës, që do të thotë se nuk është e nevojshme të përcaktohet forma dhe lloji i detyrës konkrete që është penguar, në qoftë se detyrat ose funksionet e penguara janë pjesë e kompetencave të personit zyrtar.⁶³⁸ Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara, “detyrat zyrtare” dhe “funsionet zyrtare” të ushtruara nga “personi zyrtar” lidhen edhe me përgjegjësitë dhe punën e zyrtarëve të Dhomave të Specializuara apo ZPS-së në kontekstin e procedurave zyrtare, ku përfshihen edhe hetimet e ZPS-së.⁶³⁹

282. Paneli, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Ambos, pajtohet me konstatimin e Trupit Gjykses se në formulimin e kësaj dispozite nuk kërkohet që kërcënimi i rëndë të drejtohet konkretisht kundër personit zyrtar.⁶⁴⁰ Për ta përfshirë këtë element, do të duhej që kjo dispozitë të formulohej në mënyrë të tillë që kërkon shprehimisht që forca ose kërcënimi i rëndë të drejtohen kundër personit zyrtar apo personave zyrtarë. Faktikisht, ndonëse objektiv i pengimit janë shprehimisht personi zyrtar ose personat zyrtarë, dispozita nuk i lidh termat “forcë ose kërcënim i rëndë” me personin zyrtar ose personat zyrtarë. Në këtë aspekt, Paneli i Apelit gjykon se Trupi Gjykses me të drejtë e ka interpretuar nenin 401(1) të KPK-së në përputhje me arsyen e ekzistencës së dispozitës, që është të sigurojë mospengimin e detyrave zyrtare, drejtpërdrejt ose tërthorazi.⁶⁴¹ Me fjalë të tjera, kjo dispozitë nuk është hartuar

⁶³⁶ Aktgjykimi, para. 146.

⁶³⁷ Aktgjykimi, para. 148.

⁶³⁸ *Shih* Aktgjykimin, para. 147, ku i referohet Komentarit *Salihu dhe të tjerët*, nenit 409(1) të KPK-së të vitit 2012, komenti 5, f. 1166.

⁶³⁹ Aktgjykimi, para. 147, 637-638.

⁶⁴⁰ Aktgjykimi, para. 146, 639.

⁶⁴¹ Aktgjykimi, para. 146.

për të mbrojtur personat zyrtarë në vetvete, siç sugjeron Gucati, por për t'i mbrojtur ata në ushtrimin e papenguar të detyrave zyrtare.⁶⁴² Kjo mbrojtje nuk ofrohet përmes dispozitave të tjera të KPK-së. Ajo që ka rëndësi për vërtetimin e veprimit të fajshëm të veprës penale, sipas mendimit të shumicës së Panelit, është kushti që veprimi i të akuzuarve të ketë pasur kapacitetin për të penguar persona zyrtarë. Në rrethanat e kësaj çështjeje, kërcënimi ndaj dëshmitarëve (të mundshëm) e kishte kapacitetin për ta bërë këtë.⁶⁴³ Rrjedhimisht, Paneli, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Ambos, nuk konstaton asnjë gabim në përfundimin e Trupit Gjykues se vepra penale sipas nenit 401(1) të KPK-së vërtetohet edhe në rastet kur kërcënimi i rëndë drejtohet ndaj një personi tjetër, që, në këtë rast, janë ata që i dhanë dëshmi ose kishin të ngjarë t'i jepnin dëshmi Dhomave të Specializuara/ZPS-së.⁶⁴⁴

283. Sa i përket kohës së kërcënimit të rëndë, Paneli i Apelit vëren konstatimet e Trupit Gjykues se forca ose kërcënimi i rëndë duhet të synojë pengimin e kryerjes së detyrave të personit zyrtar përpara ose gjatë kohës kur ato kryhen ose pritet të kryhen, dhe se ato mund të ndodhin në një moment të ndryshëm nga momenti kur personi zyrtar është duke kryer aktivisht një detyrë zyrtare, me qëllim pengimin e kryerjes së një detyre zyrtare të ardhshme apo të një detyre zyrtare që është duke u kryer.⁶⁴⁵ Paneli

⁶⁴² *Shih* Komentarin *Salihu dhe të tjerët*, nenin 409(1) të KPK-së të vitit 2012, komenti 2, f. 1165 (ku komentohet se “objekt primar i mbrojtur është detyra [zyrtare], përkatësisht ushtrimi i papenguar i veprimeve zyrtare nga ana e personit zyrtar, ndërsa tërthorazi sigurohet edhe mbrojtja e vetë personit zyrtar”). *Contra* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 288. Fakti që kjo dispozitë zbatohet edhe për situatat ku dikush e detyron një person zyrtar të kryejë detyra zyrtare nuk e ndryshon këtë përfundim, duke qenë se edhe në këtë rast, dispozita garanton mbrojtjen e kryerjes së ligjshme të detyrave zyrtare. *Contra* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 288.

⁶⁴³ *Shih* Aktgjykimin, para. 640-642.

⁶⁴⁴ Aktgjykimi, para. 146, 639-640. *Shih gjithashtu* Komentarin *Salihu dhe të tjerët*, nenin 409(1) të KPK-së të vitit 2012, komenti 4, f. 1165-1166. Paneli nuk pajtohet me interpretimin që i bën Haradinaj Komentarit *Salihu dhe të tjerët* se kërcënimi mund të drejtohet njëherazi si kundër një personi zyrtar, ashtu edhe kundër një personi ose objekti tjetër (*shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 176, poshtëshënimi 171, ku i referohet Aktgjykimit, poshtëshënimi 239), sepse autorët kanë bërë qartë dallimin midis rastit kur forca ose kërcënimi përdoret si kundër një personi zyrtar, ashtu edhe kundër personave të tjerë, dhe rastit kur forca ose kërcënimi përdoret kundër një personi që nuk është zyrtar, dhe kanë përmendur shembuj në të cilët dhuna është drejtuar vetëm ndaj objekteve që përdoren për kryerjen e një veprimi zyrtar konkret. *Shih* Komentarin *Salihu dhe të tjerët*, nenin 409(1) të KPK-së të vitit 2012, komentet 3-4, f. 1165-1166.

⁶⁴⁵ Aktgjykimi, para. 148.

pajtohet me këtë interpretim. Të kërkosh që përdorimi i forcës ose kërcënimi i rëndë të jetë i njëkohshëm me ushtrimin e detyrave zyrtare do të binte ndesh me mbrojtjen që synon të ofrojë kjo dispozitë për sigurinë e kryerjes së detyrave zyrtare. Në fakt, sipas mendimit të Panelit, kjo dispozitë nuk e kufizon shprehimisht zbatimin e kësaj dispozite vetëm për situatat ku përdorimi i forcës ose kërcënimi i rëndë ushtrohet njëherazi me ushtrimin e detyrave zyrtare.

284. Për sa u përket konstatimeve të veta lidhur me formën bazë të nenit 401(1) të KPK-së, frazën “gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare” në formën e rëndë të veprës penale në nenin 401(5), Paneli e kupton si *në lidhje me* ushtrimin e funksioneve të tyre zyrtare, pra jo vetëm – në kuptimin e ngushtë kohor të fjalës “gjatë” – si të kufizuar në periudhën e ushtrimit të këtyre funksioneve. Gjithsesi, nëse merret parasysh që një kërcënim i rëndë ndaj dëshmitarëve (të mundshëm) mund të pengojë hetimet në kryerje e sipër,⁶⁴⁶ ky kërcënim i rëndë konsiderohet se ka ndodhur njëherazi me ushtrimin e detyrave zyrtare.

285. Mbështetur në sa më lart, Paneli i Apelit, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Ambos, konstaton se të akuzuarit nuk kanë arritur të vërtetojnë gabim në vlerësimin që Trupi Gjykses i ka bërë veprimit të fajshëm të veprës penale sipas nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së. Rrjedhimisht, shumica e Panelit e rrëzon Pikën 12 të Apelit të Gucatit dhe Pikën 18 të Apelit të Haradinajt.

2. Pretendimet për gabime lidhur me synimin kriminal të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së (Pika 13 e Apelit të Gucatit)

286. Gucati kundërshton konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me synimin kriminal mbi të cilat u bazua shpallja e tij fajtor sipas Pikës 1 të Aktakuzës për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, e

⁶⁴⁶ Aktgjykimi, para. 204, 379-381, 421, 637, 647.

ndëshkueshme sipas nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së.⁶⁴⁷ ZPS-ja përgjigjet se kjo pikë e apelit të Gucatit duhet rrëzuar.⁶⁴⁸

287. Sipas Trupit Gjykues, për veprën penale sipas nenit 401(1) të KPK-së si dhe formën e rëndë të saj sipas nenit 401(5) të KPK-së, është i nevojshëm ose synimi i drejtpërdrejtë, ose ai eventual.⁶⁴⁹ Përfundimisht, Trupi Gjykues konstatoi se të akuzuarit vepruan me vetëdijen dhe dëshirën për të penguar zyrtarët e Dhomave të Specializuara/ZPS-së në kryerjen e punës së Dhomave të Specializuara/ZPS-së,⁶⁵⁰ domethënë, me synim të drejtpërdrejtë, sipas përkufizimit të tij prej Trupit Gjykues.⁶⁵¹

(a) Parashtrimet e palëve

288. Gucati parashtron se Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se të akuzuarit kishin synim të drejtpërdrejtë mbi bazën se kishin vepruar me vetëdijen dhe dëshirën për të penguar zyrtarët e Dhomave të Specializuara/ZPS-së në kryerjen e punës së Dhomave të Specializuara/ZPS-së, ndonëse kishte konstatuar saktë se për synimin e drejtpërdrejtë në kuadër të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së kryesi duhet të ketë “vepruar me vetëdijen dhe dëshirën për përdorimin e forcës ose të kërcënimit të rëndë për ta penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”.⁶⁵² Sipas Gucatit, nuk kishte asnjë konstatim apo provë që Gucati ishte i vetëdijshëm se veprimet dhe deklaratat e tij përbënin kërcënim të rëndë dhe se ai kishte dashur që kjo të ndodhte.⁶⁵³ Gucati argumenton gjithashtu se vetëm synimi i drejtpërdrejtë do të kishte qenë i mjaftueshëm për tentativën për pengim, sepse fakti që vepra penale e parashikuar në

⁶⁴⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 292-298. *Shih gjithashtu* Aktakuzën, para. 25-28, 48.

⁶⁴⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 111-112.

⁶⁴⁹ Aktgjykimi, para. 152, 155.

⁶⁵⁰ Aktgjykimi, para. 671.

⁶⁵¹ Aktgjykimi, para. 153.

⁶⁵² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 292-294 (theksimi si në origjinal).

⁶⁵³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 295, 297.

këto dispozita konsiderohet e kryer edhe kur është tentativë për pengim, tregon “qëllim konkret” ose “veprimtari me qëllim”.⁶⁵⁴

289. ZPS-ja përgjigjet se Gucati nuk pretendon gabim juridik, por gabim lidhur me aspektin nëse Trupi Gjykses kishte fakte të mjaftueshme për ta zbatuar ligjin lidhur me faktet ashtu siç e zbatoi, dhe se Trupi Gjykses faktikisht i bëri ato konstatime që Gucati pretendon se mungojnë.⁶⁵⁵ Sipas ZPS-së, Gucati qartazi nuk arrin të provojë se asnjë trup gjykses i arsyeshëm nuk mund të kishte nxjerrë të njëjtat përfundime lidhur me synimin e drejtëpërdrejtë.⁶⁵⁶

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

290. Paneli vëren se Trupi Gjykses e përkufizoi *in abstracto* standardin juridik të synimit të drejtëpërdrejtë në kuadër të nenit 401(1) të KPK-së, konkretisht që kryesi duhet të ketë “vepruar me vetëdijen dhe dëshirën për përdorimin e forcës ose të kërcënimit të rëndë për ta penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”.⁶⁵⁷ Kur e zbatoi këtë standard për faktet e çështjes, Trupi Gjykses arriti në përfundimin se të akuzuarit vepruan “me vetëdijen dhe dëshirën për të penguar zyrtarët e [Dhomave të Specializuara]/ZPS-së në kryerjen e punës së [Dhomave të Specializuara]/ZPS-së”.⁶⁵⁸ Megjithatë, Paneli i Apelit mendon se, megjithëse Trupi Gjykses nuk e përsëriti fjalë për fjalë standardin juridik në përfundimin që nxori lidhur me synimin e të akuzuarve, ai bëri konstatimet e duhura në vlerësimin e vet, gjegjësisht se të akuzuarit synuan përdorimin e kërcënimit të rëndë si mjet për pengimin e zyrtarëve në kryerjen e detyrave zyrtare.

⁶⁵⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 296, 298; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 115-116.

⁶⁵⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 111-112.

⁶⁵⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 112. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 141-142.

⁶⁵⁷ Aktgjykimi, para. 153, ku i referohet Vendimit të Konfirmimit, para. 72. Gucati gjithashtu pajtohet me përkufizimin që i bën Trupi Gjykses synimit të drejtëpërdrejtë për Pikën 1 të Aktakuzës. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 292, ku i referohet Aktgjykimi, para. 15[3].

⁶⁵⁸ *Shih* Aktgjykimin, para. 671, 960.

291. Në këtë aspekt, Paneli i Apelit vëren se aktgjykimi duhet interpretuar si tërësi.⁶⁵⁹ Trupi Gjykses iu referua konstatimit të vet lidhur me Pikën 3 të Aktakuzës, se synimi i të akuzuarve për të frikësuar dëshmitarët (e mundshëm) ishte mjet për të arritur qëllimin e pengimit të ndjekjes penale dhe gjyqimit të ish-anëtarëve të UÇK-së nga Dhomat e Specializuara/ZPS-ja, ose për të dëmtuar efektivitetin e këtyre përpjekjeve, dhe se të akuzuarit përdorën kërcënimin e rëndë për t'i bërë dëshmitarët (e mundshëm) që të mos u jepnin dëshmi (të mëtejshme) Dhomave të Specializuara/ZPS-së.⁶⁶⁰ Gjithashtu, në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës, Trupi Gjykses konstatoi se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve “ishin pjesë e vetëdijshme dhe thelbësore e kërcënimit të rëndë që ata përdorën për t'i nxitur dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të mos jepnin dëshmi (të mëtejshme) për [Dhomat e Specializuara]/ZPS-në”.⁶⁶¹ Në lidhje me Pikën 1 të Aktakuzës, Trupi Gjykses konkretisht vlerësoi nëse këto deklarata dhe veprime përbënin synim për të penguar zyrtarët e Dhomave të Specializuara/ZPS-së në kryerjen e punës së Dhomave të Specializuara/ZPS-së.⁶⁶² Rrjedhimisht, Paneli i Apelit gjykon se përfundimi i Trupit Gjykses për synimin kriminal të të akuzuarve në lidhje me Pikën 1 të Aktakuzës përfshinte, në përputhje me përkufizimin ligjor të përcaktuar të synimit kriminal, se të akuzuarit synonin drejtpërdrejt të përdornin kërcënim të rëndë kundër dëshmitarëve (të mundshëm) për të penguar zyrtarët e Dhomave të Specializuara/ZPS-së në kryerjen e punës së Dhomave të Specializuara/ZPS-së.

292. Po kështu, Paneli nuk bindet as nga argumenti i Gucatit se fakti që vepra penale konsiderohet e kryer kur tentohet pengimi “përforon kushtin e përpjekjes për arritjen e qëllimit”.⁶⁶³ Vetë Gucati parashtron se “qëllimi konkret” ose “veprimtaria me qëllim” kërkon synim të drejtpërdrejtë të cilin ai e përkufizon si “vetëdije dhe dëshirë

⁶⁵⁹ *Shih p.sh., Stanišić and Župljanin Appeal Judgement*, para. 138; *Orić Appeal Judgement*, para. 38.

⁶⁶⁰ Aktgjykimi, para. 661, ku i referohet Aktgjyqimit, para. 603.

⁶⁶¹ Aktgjykimi, para. 604. *Shih gjithashtu Aktgjyqimin*, para. 639-643.

⁶⁶² Aktgjykimi, para. 661.

⁶⁶³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 296.

për pengimin e një personi zyrtar që kryen detyra zyrtare”.⁶⁶⁴ Paneli vëren se, faktikisht, kjo përkon me përkufizimin e synimit të drejtpërdrejtë nga Trupi Gjykses,⁶⁶⁵ të cilin ai e zbatoi për të akuzuarit në këtë çështje gjyqsore.⁶⁶⁶ Pra, në thelb, as vetë Gucati nuk bën interpretimin se neni 401(1) të KPK-së përmban kushtin e qëllimit konkret në formën e tentativës të kryerjes së veprës penale dhe, faktikisht, në këtë dispozitë nuk ka asnjë bazë për një interpretim të tillë. Për më tepër, përkufizimi i përgjithshëm i tentativës në nenin 28 të KPK-së nuk parashikon kushtin e ekzistencës së synimit konkret, por i referohet vetëm konceptit të përgjithshëm të synimit.

293. Mbështetur në sa më lart, Paneli konstaton se Gucati nuk arrin të provojë gabim në vlerësimin që Trupi Gjykses i ka bërë synimit kriminal të veprës penale sipas nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 13 të Apelit të Gucatit.

F. PRETENDIMET PËR GABIME LIDHUR ME PENGIMIN E PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE, PËRMES VEPRIMIT TË PËRBASHKËT TË NJË GRUPI (PIKA 2)

1. Pretendimet për gabime lidhur me bashkimin e veprave penale sipas nenit 401(1) dhe (2) të KPK-së (Pika 16 e Apelit të Gucatit; Pika 3, pjesërisht, e Apelit të Haradinajt)

294. Gucati dhe Haradinaj kundërshtojnë shpalljen e tyre fajtorë nga Trupi Gjykses për Pikën 2 të Aktakuzës (“Pika 2 e Aktakuzës”) për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përmes veprimit të përbashkët të një grupi, e ndëshkueshme sipas nenit 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së, mbi bazën se ndëshkimi si për këtë vepër penale, ashtu edhe për veprën penale të Pikës 1 të Aktakuzës, nuk është “i

⁶⁶⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 296.

⁶⁶⁵ Aktgjykimi, para. 153.

⁶⁶⁶ *Shih* Aktgjykimin, para. 671, 960.

pranueshëm”.⁶⁶⁷ ZPS-ja përgjigjet se pikat përkatëse të apeleve të të akuzuarve duhen rrëzuar.⁶⁶⁸

295. Paneli rikujton se neni 401(2) i KPK-së përcakton se:

Kushdo që merr pjesë në një grup të personave që me veprim të përbashkët pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

296. Gjithashtu, neni 401(3) i KPK-së përcakton se:

Udhëheqësi apo organizatori i grupit që kryen veprë penale nga paragrafi 2 [i nenit 401 të KPK-së], dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

297. Trupi Gjykses i shpalli fajtorë të akuzuarit si për Pikën 1, ashtu edhe për Pikën 2 të Aktakuzës, pasi konstatoi se kryesi mund t’i përmbushë kriteret e të dyja veprave penale të parashikuara në nenin 401(1) dhe (2) të KPK-së dhe të shpallet fajtor në lidhje me to.⁶⁶⁹ Trupi Gjykses u shpreh në këtë aspekt se: (i) formulimi i këtyre dispozitave nuk sugjeron që dy format e kësaj veprë penale përjashtojnë reciprokisht njëra-tjetrën; dhe (ii) elementet e tyre janë të ndryshme.⁶⁷⁰ Trupi Gjykses zbatoi standardin e fajësisë së shumëfishtë që zbatohet në tribunalët ndërkombëtarë, pasi konstatoi se baza e teorisë së bashkimit të veprave penale e zbatuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, 28 maj 2014, në çështjen gjyqësore *M.I. dhe të tjerët* është e paqartë dhe se palët

⁶⁶⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 325-331; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 48-53; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 6-14; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 11. *Shih gjithashtu* Aktakuzën, para. 25-28, 48. Paneli rikujton se sipas paragrafit 48 të Aktakuzës, vepra penale “Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi” është e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së, të zbatueshëm nëpërmjet neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

⁶⁶⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 47-51.

⁶⁶⁹ Aktgjykimi, para. 170, 1012(a)-(b), 1015(a)-(b). Koncretisht, Gucati u shpall fajtor në bazë të nenit 401(1)-(3) dhe (5) të KPK-së, ndërsa Haradinaj në bazë të nenit 401(1)-(2) dhe (5) të KPK-së.

⁶⁷⁰ Aktgjykimi, para. 165, 169.

nuk identifikuan asnjë bazë tjetër ligjore që të përcaktonte zbatimin e një standardi tjetër.⁶⁷¹

(a) Parashtrimet e palëve

298. Dy të akuzuarit parashtrojnë se Trupi Gjykses gaboi që nuk mori parasysh Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, 28 maj 2014, në çështjen gjyqësore *M.I. dhe të tjerët*, ku Gjykata e Apelit e Kosovës konstatoi se vepra penale e pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes veprimit të përbashkët ishte subsidiare ndaj veprës së pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes forcës ose kërcënimit të rëndë dhe, rrjedhimisht, personi nuk mund të shpallet fajtor në bazë të të dy dispozitave.⁶⁷² Sipas Gucatit, Trupi Gjykses, ashtu si dhe Paneli i Apelit, ishin të detyruar ta respektonin këtë vendim, duke qenë se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit janë pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës në bazë të nenit 3(1) të Ligjit dhe kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me “sjellje që mbulohet prej legjislacionit të Kosovës”.⁶⁷³ Sipas Haradinajt, ndonëse nuk përbën precedent me fuqi ligjore detyruese, ky vendim ka forcë bindëse për interpretimin e KPK-së.⁶⁷⁴ Haradinaj argumenton gjithashtu se Trupi Gjykses nuk veproi drejt që shpërfilli interpretimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, që e ka bazën në doktrinën e së drejtës civile, dhe në vend të saj parapëlqeu të zbatonte standardin e “fajësisë së shumëfishtë”, që u krijua nga tribunalët penalë ndërkombëtarë.⁶⁷⁵

299. ZPS-ja përgjigjet se nuk ekziston ndonjë detyrim ligjor që korniza ligjore e Dhomave të Specializuara të interpretohet në përputhje me vendimet e mëparshme të

⁶⁷¹ Aktgjykimi, para. 165-168.

⁶⁷² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 328-329, 331; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 48, 50-51. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 6; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 11.

⁶⁷³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 325-327, 329-330; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 7-13.

⁶⁷⁴ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 49.

⁶⁷⁵ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 52-53.

gjykatave të zakonshme të Kosovës.⁶⁷⁶ ZPS-ja argumenton gjithashtu se Trupi Gjykses e shqyrtoi me hollësi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, 28 maj 2014, kur paraqiti arsyet se pse gjykonte që standardi i fajësisë së shumëfishtë i zbatuar në tribunalët ndërkombëtarë ishte standardi më i përshtatshëm.⁶⁷⁷ Gjithashtu, sipas ZPS-së, arsyetimi në atë aktgjykim dallon qartë nga çështja gjyqësore aktuale, sepse ka të bëjë me interpretimin e dispozitës së KPPK-së, i cili përkon me nenin 401(1) të KPK-së që përmban kriterin e kërcënimit të rëndë për *përdorimin e forcës*, ndryshe nga pararendësi i nenit 401(2) të KPK-së.⁶⁷⁸ Gjatë seancës së apelit, ZPS-ja dorëzoi një aktgjykim të Gjykatës së Apelit, Kosovë, dhe argumentoi se ai mbështet standardin e fajësisë së shumëfishtë.⁶⁷⁹

300. Në kundërpërgjigje, Gucati parashtron se përpjekja e ZPS-së për të bërë dallimin midis Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Kosovë, 28 maj 2014 dhe çështjes gjyqësore nën shqyrtim është e pabazë⁶⁸⁰ dhe se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Kosovë që u përmend nga ZPS-ja gjatë seancës së apelit, nuk demonstroi se mund të shpallen verdikte fajësie në lidhje me nenin 401(1) dhe (2) të KPK-së në kuadër të së njëjtës aktakuzë.⁶⁸¹

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

301. Paneli vëren se, ndonëse jurisprudenca e gjykatave në Kosovë mund të ofrojë njëfarë orientimi, ajo nuk është detyruese për Dhomat e Specializuara. Paneli pranon

⁶⁷⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 47-48, 51.

⁶⁷⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 49, 51, ku i referohet Aktgjykimit, para. 165-170; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 144-145, 149-153, 202-203.

⁶⁷⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 50, ku i referohet KPPK-së, nenet 316(1), 318(1); Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 143-144.

⁶⁷⁹ Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 149, 202, ku i referohet Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Kosovë, 25 prill 2013; F00113, Memorandum lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Rasti numër PAKR 1122/2012, Kosovë, 25 prill 2013, 1 shkurt 2023. *Shih gjithashtu* CRSPD14, mesazhe elektronike ndërmjet ZPS-së, NJAGJ-së dhe Panelit të Apelit lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, 12 janar 2023 (konfidencial), ku i referohen Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, Kosovë, 24 maj 2012.

⁶⁸⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 14, ku i referohet Dosjes së Përgjigjes të ZPS-së, para. 50 dhe Apelit të Gucatit, para. 279-283.

⁶⁸¹ Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 204-205.

gjithashtu se, siç u shpreh Trupi Gjykses, neni 76 i KPK-së, i cili trajton dënimin e bashkimit të veprave penale, nuk është i përfshirë shprehimisht në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara.⁶⁸² Megjithatë, Paneli pajtohet me Mbrojtjen se, nëse veprat penale të përfshira në aktakuzë janë vepra penale sipas KPK-së, bashkimi i tyre duhet të gjykohet në bazë të teorisë juridike të bashkimit të veprave penale që zbatohet në kontekstin shtetëror.⁶⁸³

302. Standardi i fajësisë së shumëfishtë, mbi të cilin u mbështet Trupi Gjykses, është zbatuar nga tribunalët penalë ndërkombëtarë *ad hoc*,⁶⁸⁴ të cilët nga ana e tyre janë mbështetur në “standardin Blockburger” të Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.⁶⁸⁵ Sikurse u shpreh Trupi Gjykses, standardi i fajësisë së shumëfishtë lejon dhënien e vendimeve të fajësisë në bazë të dispozitave të ndryshme ligjore vetëm në qoftë se secila dispozitë ligjore ka një element materialisht të ndryshëm të cilin nuk e përmban tjetra, dhe, kur ky standard nuk përmbushet, shqiptohet verdikt fajësie sipas dispozitës më konkrete.⁶⁸⁶ Sipas mendimit të Panelit, zbatimi i standardit të fajësisë së shumëfishtë në tribunalët penalë ndërkombëtarë është rezultat i një numri faktorësh të ndryshëm, ndër të cilët, karakteristikat faktike të sjelljes penale përkatëse të përshkruar si makrokriminalitet, si dhe i faktit që përgjithësisht përkufizimet e veprave penale në të drejtën penale ndërkombëtare nuk kanë kaluar në një proces kodifikimi rigoroz sistematik.⁶⁸⁷ Megjithatë, Paneli nuk është bindur se standardi i

⁶⁸² *Shih* Aktgjykimin, para. 166. *Shih gjithashtu* nenin 3(2)(c) dhe (4) të Ligjit.

⁶⁸³ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 52-53, ku i referohet Aktgjykimin, para. 166-170. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, Mendimin më Vete të Gjykatës së Barte, para. 10-18 (ku sugjerohet, ndër të tjera, se neni 44(4) i Ligjit mund të interpretohet se lejon zbatimin e atyre parimeve juridike themelore që janë pazgjydhshëmrisht të lidhura me shqiptimin e dënimeve, si bashkimi i krimeve, dhe që do të zbatoheshin në raste të ngjashme në gjykatat penale të Kosovës).

⁶⁸⁴ *Shih p.sh.*, *Čelebići Appeal Judgement*, para. 409, 412; *Kupreškić et al. Trial Judgement*, para. 681-687.

⁶⁸⁵ *Shih Blockburger Judgment*, para. 304.

⁶⁸⁶ Aktgjykimi, para. 167, ku i referohet *Čelebići Appeal Judgement*, paras 412-413; *Strugar Appeal Judgement*, paras 321-322; *Kordić and Čerkez Appeal Judgement*, paras 1032-1033; *Nahimana et al. Appeal Judgement*, para. 1019; *Ntagerura et al. Appeal Judgement*, para. 425; *Bemba Trial Judgment*, paras 746-748; *Katanga Trial Judgment*, para. 1695.

⁶⁸⁷ *Stuckenberg Cumulative Charges and Cumulative Convictions*, p. 840. *Shih gjithashtu Fernández-Pacheco Estrada The ICC and the Čelebići Test*, p. 712.

zbatuar në kontekstin e jurisprudencës ndërkombëtare do të ishte i përshtatshëm për të përcaktuar marrëdhënien e bashkimit të veprave penale në çështjen gjyqësore nën shqyrtim, që ka të bëjë me vepra penale të zakonshme sipas legjislacionit të Kosovës.

303. Shtetet me sistem juridik të bazuar në të drejtën civile, traditë së cilës i përket sistemi juridik i Kosovës, zakonisht e trajtojnë *concursum delictorum* (ose *concoure de qualifications ou d'infractions, concorso di reati, concurso/concurrencia de leyes/delitos, Konkurrenzlehre*) si aspekt të teorisë juridike ose si aspekt që përfshihet në parimet e përgjithshme të së drejtës penale.⁶⁸⁸ Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit gjykon se neni 76(1) i KPK-së, dhe pararendësi i tij neni 71(1) i KPPK-së, e njohin konceptin e bashkimit të veprave penale, sepse përcaktojnë se, në qoftë se një person kryen nëpërmjet një ose më shumë veprimeve disa vepra penale për të cilat gjykohej njëherazi, gjykata së pari shpall dënime për secilën vepër dhe më pas jep një dënim unik për të gjitha veprat.⁶⁸⁹ Megjithëse neni 76 i KPK-së nuk jep hollësi të mëtejshme se si duhet ta zbatojë gjykata konceptin e bashkimit të veprave penale, Paneli gjykon se kjo dispozitë tregon se bashkimi i veprave penale në KPK-në i ka rrënjët në traditën e së drejtës civile dhe se, ndryshe nga standardi i fajësisë së shumëfishtë, ai trajtohet si aspekt i parimeve të përgjithshme të së drejtës penale. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se duhet të orientohet nga të njëjtat arsyeime në rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore.⁶⁹⁰

304. Për sa u përket veprave penale të përcaktuara në nenin 401(1) dhe (2) të KPK-së në veçanti, Paneli vëren se Trupi Gjykoës konstatoi se të dyja ishin vërtetuar lidhur me të njëjtat veprime dhe, rrjedhimisht, ato nuk janë në marrëdhënie bashkimi real (*concoure réel, concurso real, Realkonkurrenz*), pra që ka të bëjë me kryerje të veprimeve penale të ndryshme, por në marrëdhënie bashkimi ideal (*concoure idéal, concurso ideal*,

⁶⁸⁸ *Stuckenberg Cumulative Charges and Cumulative Convictions*, p. 841.

⁶⁸⁹ *Shih p.sh.*, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, Kosovë, 23 tetor 2015, pjesa V(a), para. 8.

⁶⁹⁰ *Shih* Aktgjykimin, Mendimin më Vete të Gjykatësit Barte, para. 5.

Idealkonkurrenz), që nga ana e tij duhet të dallohet nga bashkimi në dukje (i rremë) (*concoures apparent, concurso aparente, Gesetzeskonkurrenz/-einheit*).⁶⁹¹ Rrjedhimisht, për të përcaktuar nëse verdikti i fajësisë mund të jepet për të dyja veprat penale apo vetëm për njëjërën prej tyre, është e rëndësishme të përcaktohet nëse bashkimi është real apo vetëm (bashkim) në dukje. Në rastin e parë, secila vepër penale duhet të ketë të paktën një element që nuk e përmban tjetra.⁶⁹² Në rastin e dytë, kur çdo element i veprës penale “më të madhe” është i domosdoshëm për të përmbushur kriteret e veprës tjetër penale “më të vogël” dhe kur për veprën penale “më të madhe” duhet të vërtetohen elemente shtesë që nuk kërkohet të vërtetohen për veprën penale “më të vogël”, verdikt fajësie mund të jepet vetëm për veprën penale “më të madhe”.⁶⁹³ Mund të dallohen tri forma bashkimi: të specialitetit (*lex specialis derogat legi generali*), konsumimit dhe subsidiaritetit.⁶⁹⁴

305. Gjykata e Apelit e Kosovës, në Aktgjykimin e Apelit, Kosovë, 28 maj 2014, iu referua “standardit Blockburger” dhe vuri në dukje zbatimin e shpeshtë të tij nga gjykatat e sistemit të së drejtës zakonore, por përfundimisht vendosi të bazohej në teorinë e bashkimit të veprave penale, meqë “në sistemet e sistemit civil – siç është Kosova – gjykatat synojnë ta zgjidhin të njëjtin problem duke zbatuar rregullat e teorisë së bashkimit.”⁶⁹⁵ Në vijim, Gjykata e Apelit e Kosovës bëri dallimin midis bashkimit real dhe ideal dhe formave të ndryshme të bashkimit (duke u shtuar formave të lartpërmendura të specialitetit, subsidiaritetit dhe konsumimit edhe atë të “alternativës”).⁶⁹⁶ Duke krahasuar “veprimet specifike të pengimit të kryera individualisht nga kryesi” sipas nenit 316(1) të KPPK-së (gjegjësi i nenit 401(1) të KPK-

⁶⁹¹ *Shih Ambos Treatise ICL II*, pp. 292-294.

⁶⁹² *Ambos Treatise ICL II*, f. 295-296. Paneli vëren se ky lloj bashkimi i afrohet standardit të fajësisë së shumëfishtë.

⁶⁹³ *Ambos Treatise ICL II*, pp. 294-295.

⁶⁹⁴ *Shih Ambos Treatise ICL II*, pp. 294-295; *Fernández-Pacheco Estrada The ICC and the Čelebići Test*, p. 706.

⁶⁹⁵ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Kosovë, 28 maj 2014, pjesa 6.3, f. 27.

⁶⁹⁶ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Kosovë, 28 maj 2014, pjesa 6.3, f. 27-28.

së) me situatën e “marrjes pjesë në një grup të personave që me veprime të përbashkëta [...]” sipas nenit 318(1) të KPPK-së (gjegjësi i nenit 401(2) të KPK-së), Gjykata e Apelit e Kosovës e arsyetoi dënimin minimal më të ulët në rastin e dytë me “faktin se pesha e veprës është më e ulët kur nuk [mund të] provohet se kryesi i ka kryer veprimet konkrete kundër organit publik”.⁶⁹⁷ Sa i takon bashkimit të veprave penale, Gjykata e Apelit e Kosovës konstatoi se janë “në raportin e bashkimit ideal në formën e subsidiaritetit të nënkuptuar [sipas të cilit] vepra më e lehtë [neni 318(1) i KPPK-së] është subsidiare në situatat kur nuk vërtetohet vepra më e rëndë [neni 316(1) i KPPK-së]”.⁶⁹⁸

306. Sa i takon Aktgjykimit të Apelit, Kosovë, 25 prill 2013, të cilit i referohet ZPS-ja, Paneli i Apelit vëren se, ndonëse pranon se standardi i fajësisë së shumëfishtë mund të zbatohet në lidhje me veprat penale përkatëse, në atë rast, Gjykata e Apelit e Kosovës në fund konstatoi se njëra vepër penale përfshihej në tjetrën.⁶⁹⁹ Rrjedhimisht, ajo zbatoi rregullat e bashkimit në dukje, në përputhje me doktrinën e bashkimit të veprave penale sipas së drejtës civile (*concursum delictorum*).⁷⁰⁰

307. Paneli rikujton se në KPK-në e tanishme, vepra penale e pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes forcës ose kërcënimit të rëndë dhe ajo e pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes veprimit të përbashkët të një grupi, përfshihen të dyja në të njëjtin nen (neni 401 i KPK-së), çka tregon se këto dispozita mbrojnë saktësisht të njëjtin interes ligjor, që është kryerja e papenguar e detyrave zyrtare. Sa u takon elementeve përkufizuese të tyre (veprimi i fajshëm), dallimi midis dy dispozitave qëndron në faktin se në bazë të paragrafit 1 të nenit 401 të KPK-së, kryesi e kryen veprimin e pengimit vetë (përmes forcës ose kërcënimit të rëndë), ndërsa sipas paragrafit 2, kryesi vepron në kuadër të një grupi

⁶⁹⁷ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Kosovë, 28 maj 2014, pjesa 6.3, f. 29.

⁶⁹⁸ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Kosovë, 28 maj 2014, pjesa 6.3, f. 29.

⁶⁹⁹ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Kosovë, 25 prill 2013, para. 28-29. *Shih* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 149.

⁷⁰⁰ *Shih gjithashtu më lart*, para. 303.

personash. Më tej, Paneli vëren se neni 401(2) i KPK-së parashikon një dënim minimal më të ulët (pra, me gjobë ose me burgim deri në tre vjet) krahasuar me paragrafin 1 të të njëjtit nen (që parashikon vetëm dënim me burgim prej tre muaj deri në tre vjet) dhe se të dyja dispozitat parashikojnë të njëjtin dënim maksimal. Paneli gjykon se ky dallim sa i përket dënimit minimal mund të shpjegohet me faktin se, në mënyrë të ngjashme me konstatimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, në Aktgjykimin e Apelit, Kosovë, 28 maj 2014, neni 401(1) i KPK-së kërkon veprime konkrete individuale të pengimit të kryera nga i akuzuari. Në dallim nga kjo, sipas nenit 401(2) të KPK-së, kryesit veprojnë si pjesë e një grupi, ku përgjithësisht nuk do të ishte e mundur të vërtetoheshin veprimet konkrete individuale të pengimit të kryera nga i akuzuari gjë që, nga ana e saj, mund të nënkuptojë shkallë të ndryshme rrezikshmërie.⁷⁰¹

308. Në lidhje me këtë Paneli konstaton, siç ka konstatuar në thelb edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, se në rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore raporti midis paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 401 të KPK-së ngërthehet më mirë nga rregulla e subsidiaritetit. Megjithëse kjo rregull, si çdo formë tjetër e bashkimit, nuk është “modalitet” i bashkimit ideal, por në fakt shpreh një situatë, siç e përcaktoi saktë Gjykata e Apelit e Kosovës, ku njëra dispozitë (neni 401(2) i KPK-së) “është e zbatueshme vetëm nëse nuk është e mundshme të zbatohet tjetra” (neni 401(1) i KPK-së).⁷⁰²

⁷⁰¹ *Shih* Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, 28 maj 2014, pjesa 6.3, f. 28-29. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin e Trupit Gjyqësor, Mendimin më Vete të Gjykatës së Apelit, Kosovë, 7 dhjetor 2017, para. 138-139 (ku Gjykata e Apelit e Kosovës u shpreh se vepra penale sipas nenit 401(2) të KPK-së është “një vepër penale autonome përtej konceptit të kufizuar ose klasik të bashkëpjesëmarrjes” duke pasur parasysh se një grup ka dinamikë të ndryshme vetvetiu, që e rrit rrezikshmërinë, dhe se veprimi i nevojshëm për të vërtetuar këtë vepër penale është pjesëmarrja në një grup personash, që është veprim individual). *Shih gjithashtu* Komentarin *Salihu dhe të tjerët*, nenin 409(2) të KPK-së të vitit 2012, komentet 1, 3, 6, f. 1167-1168 (ku autorët shprehin mendimin se “rrezikshmëri shoqërore të veprës penale [të parashikuar në nenin 401(2) të KPK-së] nuk paraqet veprimi i individit, por veprimi i përbashkët i shumë personave, te të cilët ekziston vetëdija për veprim të përbashkët, përkatësisht për shkaktimin e përbashkët të pasojës së ndaluar”).

⁷⁰² Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Kosovë, 28 maj 2014, pjesa 6.3, f. 27. Paneli rikujton se në këtë aktgjykim veprat penale në fjalë u trajtuan në bazë të KPPK-së. *Shih më lart*, para. 305. Paneli vëren gjithashtu se, duke pasur parasysh se Gjykata e Apelit e Kosovës ka bërë saktë dallimin midis bashkimit ideal dhe formave të bashkimit, *shih më lart* para. 305, është mjaft e mundshme që formulimi “modalitet i bashkimit ideal” të jetë gabim pa dashje.

309. Gjithsesi, në këtë çështje gjyqësore, në të cilën janë specifikuar veprimet individuale të të akuzuarve dhe të akuzuarit janë shpallur fajtorë sipas nenit 401(1) të KPK-së, një verdikt fajësie shtesë edhe sipas nenit 401(2) të KPK-së nuk është as i përligjur e as i nevojshëm. Me fjalë të tjera, në këtë rast, neni 401(1) i KPK-së e përfshin plotësisht keqbërjen penale të kryer nga të akuzuarit dhe, edhe i vetëm, është i mjaftueshëm për të vërtetuar fajësinë e tyre lidhur me pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare. Rrjedhimisht, sipas mendimit të Panelit, shpallja fajtorë për të dyja veprat penale do të çonte në një kriminalizim të tepruar të sjelljes së tyre.

310. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit miraton Pikën 16 të Apelit të Gucatit dhe këtë pjesë të Pikës 3 të Apelit të Haradinajt.⁷⁰³ Rrjedhimisht, Paneli vendos se të akuzuarit mund të shpallen fajtorë vetëm në bazë të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së, prapëson fajësinë për të akuzuarit në bazë të nenit 401(2) dhe (5) të KPK-së dhe fajësinë për Gucatin në bazë të nenit 401(3) të KPK-së, dhe i shpall ata të pafajshëm në lidhje me Pikën 2 të Aktakuzës.⁷⁰⁴ Ndikimi i këtij konstatimi, nëse ka, në dënimin e të akuzuarve do të trajtohet në Pjesën H më poshtë.

2. Pretendimet për gabime lidhur me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal sipas nenit 401(2) të KPK-së (Pikat 14, 15 të Apelit të Gucatit)

311. Paneli konstaton se, bazuar në konstatimin më lart lidhur me raportin e bashkimit të veprave penale të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 401 të KPK-së, nuk është e nevojshme të trajtohen pretendimet e Gucatit për gabime lidhur me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal në kuadër të nenit 401(2) të KPK-së. Rrjedhimisht, Pikat 14 dhe 15 të Apelit të Gucatit rrëzohen sepse janë të tejkaluara.

⁷⁰³ Kundërshtimin e Haradinajt të paraqitur në Pikën 3 të Apelit të Haradinajt lidhur me faktin që Trupi Gjyqësor u bazua në the *Hartmann* Trial Judgment, Paneli e ka trajtuar nën Pikën 5 të Apelit. *Shih më lart*, para. 121-124.

⁷⁰⁴ Neni 401(3) i KPK-së përbën një formë të rëndë të nenit 401(2) të KPK-së.

G. PRETENDIMET PËR GABIME LIDHUR ME ARGUMENTET MBROJTËSE

312. Sikurse u theksua nga Trupi Gjykses, në gjykim, të akuzuarit paraqitën një numër argumentesh mbrojtëse/arsyesh për përjashtimin e përgjegjësisë penale për sjelljen e tyre.⁷⁰⁵ Sidoqoftë, Trupi Gjykses konstatoi se përgjegjësia penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohet mbi bazën e asnjë prej argumenteve mbrojtëse/arsyeve për përjashtimin e përgjegjësisë të paraqitura prej tyre.⁷⁰⁶

313. Në apelet e tyre, Gucati dhe/ose Haradinaj kundërshtojnë konstatimet e Trupit Gjykses që hodhën poshtë argumentet e paraqitura prej tyre në lidhje me: (i) interesin publik;⁷⁰⁷ (ii) sinjalizimin;⁷⁰⁸ (iii) shtytjen për kryerje të veprës penale;⁷⁰⁹ (iv) nevojën ekstreme;⁷¹⁰ dhe (v) veprat e rëndësisë së vogël.⁷¹¹ ZPS-ja përgjigjet se apelet e të akuzuarve për këto aspekte duhen rrëzuar.⁷¹²

314. Paneli vëren se Pikat 11 deri 15 të Apelit të Haradinajt lidhur me argumentet mbrojtëse kanë disa mangësi dhe mangësi procedurale të cilat përlligjin rrëzimin e menjëhershëm të tyre.⁷¹³ Disa prej argumenteve të Haradinajt, megjithëse të mangëta,

⁷⁰⁵ Aktgjykimi, para. 795. Trupi Gjykses përdor termin “arsye” por duke pasur parasysh kuptimin konkret të këtij termi në vendet e së drejtës civile dhe më gjerë, Paneli i Apelit parapëlqen të përdorë termat më të përgjithshëm “argumente mbrojtëse”/“arsye për përjashtim të përgjegjësisë”. Lidhur me kuptimin e këtyre termave, *shih gjithashtu më poshtë*, para. 323.

⁷⁰⁶ Aktgjykimi, para. 927.

⁷⁰⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 190-202; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 48; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 34(b), 108-114; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 27-29.

⁷⁰⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 206-212; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 78. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 34(b), 136.

⁷⁰⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 332-392; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 135-144. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen e Gucatit, para. 72-75, 79-87; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 34-36.

⁷¹⁰ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 127, 129-134; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 32-33.

⁷¹¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 145-155; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 39.

⁷¹² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 87-88, 116-154.

⁷¹³ Argumentin mbrojtës të veprës së rëndësisë së vogël (në Pikat 14 dhe 15 të Apelit) dhe argumentin mbrojtës të nevojës ekstreme (në Pikën 11 të Apelit) Haradinaj i ngre për herë të parë në apel. *Shih* Dosjen Paraprake të Haradinajt, para. 277, ku Haradinaj informoi se “në këtë fazë jep njoftim se synon të paraqesë argumentet mbrojtëse “aktive” të mëposhtme kundër pretendimeve të Aktakuzës”, gjegjësisht argumentet e shtytjes për kryerje të veprës penale, gabimit juridik, gabimit faktik dhe argumentin mbrojtës të interesit publik. Paneli vëren gjithashtu se temat e Pikave 12-14 të Njoftimit për Apel të Haradinajt nuk kanë aspak lidhje me temat e pikave gjegjëse të Dosjes së Apelit të Haradinajt.

do të trajtohen nga Paneli më poshtë, në kuadër të vlerësimit të Apelit të Gucatit. Kurse sa u takon argumenteve të Haradinajt që nuk janë të njëjta me ato të paraqitura nga Gucati, Paneli mundi të shqyrtonte, aq sa ishte e mundur, vetëm argumentet që ishin artikuluar siç duhet.⁷¹⁴ Paneli vendosi të vepronte kështu për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit.

1. Pretendimet për gabime lidhur me argumentin mbrojtës të interesit publik (Pika 4(G) dhe Pika 4(H), pjesërisht, e Apelit të Gucatit; Pika 1, pjesërisht, dhe Pika 9 e Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

315. Gucati parashtron se Trupi Gjykues bëri gabim juridik që konstatoi se ZPS-ja nuk ishte e detyruar të vërtetonte jashtë dyshimit të arsyeshëm se nuk kishte bazë ligjore për zbulimin e informacionit në fjalë, dhe se nxjerrja e tij nuk ishte në interesin publik.⁷¹⁵ Gucati parashtron gjithashtu se nxjerrja e informacionit konfidencial, kur ky

Krahaso Pikën 12 të Haradinajt në Njoftimin për Apel në para. 16 (sinjalizimi) me Pikën 12 të Haradinajt në Apel në para. 135 (shtytja për kryerje të veprës penale/nxitje për kryerje të veprës penale). *Shih* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 34 (ku Haradinaj deklaroi se “për shkak të një gabimi administrativ në dorëzimin e [Dosjes së Apelit], aty nuk janë përfshirë parashtrimet që lidhen me Pikën 12”). *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 81 (ku Haradinaj argumenton se mangësitë e Pikës 12 “nuk janë aq të rënda”). Sa i takon Pikës 13 të Haradinajt, titulli i pikës së apelit është i njëjtë si në Njoftimin për Apel të Haradinajt, para. 17 ashtu edhe në Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 136 (sinjalizimi). Mirëpo, thelbi i argumenteve të paraqitura në këtë pikë të apelit ka të bëjë kryesisht me shtytjen për kryerje të veprës penale. Sa i takon Pikës 14 të Njoftimit për Apel të Haradinajt, para. 18, megjithëse i referohet sinjalizimit, thelbi i argumenteve gjithashtu ka të bëjë kryesisht me shtytjen për kryerje të veprës penale. Po kështu, Paneli nuk u bind nga argumenti i paraqitur me gojë nga Haradinaj se aspektet e trajtuara në Pikat 12-13 të Dosjes së Apelit përmendeshin paraprakisht në Pikën 16 të Njoftimit për Apel të tij dhe, rrjedhimisht, nuk duhen rrëzuar pa u shqyrtuar; *Shih* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 81-83. Paneli vëren gjithashtu se Pika 14 e Apelit të Haradinajt, para. 145-148 ka të bëjë me “veprën e rëndësisë së vogël” dhe se në Dosjen e Kundërpërgjigjes së tij, para. 37, Haradinaj parashtron se “sa i takon Pikës 14, moskryerjen e hetimeve për veprimet e papërshtatshme gjatë hetimeve të ZPS-së, [ai] nuk e përfshiu më si nëntitull më vete në apel, sepse ajo është një temë e përsëritur që përshkon të gjithë çështjen gjyqësore”. *Shih gjithashtu* Njoftimin për Apel të Haradinajt, para. 15-19; Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 127-155; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 32-39.

⁷¹⁴ *Shih më lart*, para. 29-32.

⁷¹⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 192, 195-198. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 48.

interes ka më shumë peshë se interesi individual për mosnxjerrjen e tij, lejohet me ligj dhe për rrjedhojë nuk është kryer asnjë vepër penale.⁷¹⁶

316. Gucati parashtron gjithashtu se Trupi Gjykses bëri gabim juridik që konstatoi se nuk kishte bazë të besueshme për të arritur në përfundimin se informacioni i nxjerrë kishte tregues për veprime të papërshtatshme që mund t'i atribuoheshin TFHS-së/ZPS-së.⁷¹⁷ Ai argumenton se Trupit Gjykses nuk iu dorëzua asnjëherë përmbajtja e plotë e Paketave, dhe ajo as nuk u shqyrtua më tej. Për këtë arsye, ai parashtron se konstatimi se nuk kishte bazë për përfundimin se informacioni i zbuluar nga të akuzuarit përmbante veprime të papërshtatshme përbënte “përmbysje të detyrimit të vërtetimit”.⁷¹⁸

317. Haradinaj parashtron se Trupi Gjykses gaboi në konstatimin se argumenti mbrojtës i interesit publik nuk ekziston në legjislacionin e Kosovës dhe që nuk mori parasysh përfshirjen e “burimeve serbe të TFHS-së/ZPS-së” në “regjimin kriminal të Millosheviqit që u dënua nga e gjithë bota” apo “qëndrimin që ka mbajtur Serbia në vite ndaj Kosovës”.⁷¹⁹ Ai argumenton se, duke mos e lejuar që të përmendte këtë informacion publik që ishte thelbësor për qëndrimin e tij, Trupi Gjykses dëmtoi mbrojtjen e tij.⁷²⁰ Ai parashtron gjithashtu se veprimet që janë në përputhje me të drejtën e lirisë së shprehjes të garantuar nga Kushtetuta e Kosovës dhe nga KEDNJ-ja nuk mund të konsiderohen “kriminale”.⁷²¹

318. ZPS-ja i përgjigjet Gucatit se Trupi Gjykses shpjegoi qartë se neni 392(1) i KPK-së nuk përfshin asnjë lloj interesi publik që të shërbejë si bazë për autorizimin e

⁷¹⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 191-194, 202.

⁷¹⁷ Njoftimi për Apel i Gucatit, f. 9.

⁷¹⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 200-202.

⁷¹⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 108, 113-114. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 75-76; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 201, 209-210.

⁷²⁰ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 34(b).

⁷²¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 110.

zbulimit të informacionit “sekret”.⁷²² ZPS-ja rikujton gjithashtu konstatimet e Trupit Gjykses se nuk kishte asnjë bazë për përfundimin se ka pasur veprime të papërshtatshme për sa i përket bashkëpunimit të TFHS-së/ZPS-së me Serbinë, dhe parashtron se në këtë aspekt nuk mund të identifikohet asnjë gabim, sepse pretendimet e Gucatit janë “të palogjikshme dhe nuk mbështeten nga provat”.⁷²³

319. ZPS-ja parashtron gjithashtu se Pika 9 e Apelit të Haradinajt mbi argumentin mbrojtës të interesit publik duhet “rrëzuar *in limine* sepse është e pabazë”.⁷²⁴ ZPS-ja përgjigjet gjithashtu se nuk mund të ketë asnjë gabim sa i takon “mosmarrjes parasysh” nga Trupi Gjykses të argumenteve mbrojtëse që kanë të bëjnë me autoritetet serbe, sepse Trupi Gjykses faktikisht i mori parasysh ato.⁷²⁵ ZPS-ja argumenton gjithashtu se Haradinaj nuk jep asnjë arsye përse Trupi Gjykses duhej të kishte marrë parasysh “qëndrimin që ka mbajtur Serbia në vite ndaj Kosovës”, e as nuk e shpjegon se çfarë do të thotë kjo.⁷²⁶ Rrjedhimisht, ZPS-ja parashtron se Haradinaj vetëm sa përsërit argumentet e parashtruara dhe të rrëzuara në gjykim dhe nuk vërteton asnjë gabim.⁷²⁷

320. Haradinaj kundërpërgjigjet se argumentet e paraqitura në Apelin e tij janë faktikisht të bazuara.⁷²⁸ Ai parashtron gjithashtu se Trupi Gjykses u përqendrua vetëm te “lidhjet e kontakteve serbe të TFHS-së/ZPS-së me regjimet e mëparshme” por nuk “pasqyroi kontekstin më të gjerë të armiqësisë së thellë dhe të kahershme serbe ndaj Kosovës dhe varësinë tejet të madhe të hetimeve të TFHS-së/ZPS-së nga burimet serbe”.⁷²⁹

⁷²² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 87.

⁷²³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 88. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 126, 138, 156.

⁷²⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 133-134. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 131.

⁷²⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 135.

⁷²⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 136.

⁷²⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 137.

⁷²⁸ Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 27-28.

⁷²⁹ Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 29.

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

321. Paneli vëren paraprakisht se si Gucati, ashtu edhe Haradinaj, argumentojnë se, nëse zbulimi i informacionit të mbrojtur lejohet me ligj, ose është në përputhje me të drejtën e lirisë së shprehjes, atëherë sjellja në fjalë nuk mund të konsiderohet kriminale dhe nuk është kryer vepër penale.⁷³⁰

322. Në përgjigje të argumenteve të ngjashme të ngritura nga Mbrojtja gjatë gjykimit, Trupi Gjykues nënvizoi se:

Së pari, as neni 392(1) i KPK-së, as ndonjë dispozitë tjetër e atij kodi nuk përmban shprehimisht ndonjë arsye mbi të cilën mund të autorizohet zbulimi i informacionit. Së dyti, në pajtim me nenin 200(2) dhe (4) të KPK-së, në qoftë se vërtetohet në lidhje me këtë vepër penale, interesi publik do të përjashtonte përgjegjësinë penale, por nuk do të ndryshonte apo hidhte poshtë veprimin e fajshëm të veprës penale.⁷³¹

323. Paneli pajtohet me këtë koment dhe përgjithësisht vëren se argumentet mbrojtëse, të marra në kuptimin e gjerë, funksionojnë ose si arsye materiale për përjashtimin e përgjegjësisë penale individuale, ose si pengesa ose ndalime procedurale ndaj ndjekjes penale,⁷³² dhe përfshijnë “të gjitha bazat që, për një arsye a një tjetër, pengojnë sanksionimin e një vepre penale – pavarësisht nga fakti se vepra penale i ka përmbushur të gjitha elementet përkufizuese të krimit”.⁷³³ Rrjedhimisht,

⁷³⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 190; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 110; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 46; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 27. Paneli vëren se Gucati parashtron se argumenti mbrojtës i interesit publik vlen në lidhje me Pikën 5 të Aktakuzës. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 190-202. Haradinaj bën një parashtrim më të përgjithshëm; në Pikën 6 të Apelit të tij ai pretendon se nxjerrja e materialit të kundërshtuar ishte e përligjur për shkak të interesit publik për informacione që lidhen me “atë që ai e quan metodë pune diskriminuese, të motivuar politikisht dhe jo të pavarur të ZPS-së/[Dhomave të Specializuara]”. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 73. Ai argumenton gjithashtu se në veprimet e tij ishte nisur nga konsiderata të interesit publik dhe se, rrjedhimisht, “shpallja fajtor e apeluesit për Pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6 të Aktakuzës duhej prapësuar”. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 114.

⁷³¹ Aktgjykimi, para. 487. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 73, 486, 797.

⁷³² *Ambos* Treatise ICL I, pp. 408-409. *Shih gjithashtu Ambos* Treatise ICL I, pp. 410-414 për dallimin e mëtejshëm midis përligjeve dhe justifikimeve si pjesë e argumenteve mbrojtëse materiale.

⁷³³ *Eser* Defences in War Crime Trials, p. 251.

ekzistenca e arsyeve që përjashtojnë përgjegjësinë penale, pra e një argumenti mbrojtës material, nuk do të thotë se nuk është kryer veprë penale në rrethanat kur janë vërtetuar si veprimi i fajshëm ashtu edhe synimi kriminal. Ajo do të thotë vetëm se, ndonëse veprimi i fajshëm i veprës penale është kryer, i akuzuari nuk mban përgjegjësi penale për të sepse përgjegjësia penale e tij është përjashtuar mbi bazën e arsyeve përkatëse.

324. Sipas Trupit Gjykses, as rregulla 95(5) e Rregullores, e as ndonjë dispozitë tjetër e Ligjit ose Rregullores, nuk e përfshijnë interesin publik si arsye për përjashtimin e përgjegjësisë penale.⁷³⁴ Gjithsesi ai vendosi ta trajtonte këtë pretendim “në kontekstin e lirisë së shprehjes së të akuzuarve dhe si një përlligje të mundshme që mund të ndikojë në përgjegjësinë penale individuale të tyre”.⁷³⁵ Trupi Gjykses e përkufizoi si vijon nocionin e interesit publik në kontekstin e bashkëpunimit të TFHS-së/ZPS-së me Serbinë:

Interesi publik në fjalë në lidhje me të cilin mund të nxirren prova të rëndësishme është i kufizuar vetëm në provat që do të sugjeronin se një pjesë e materialit që pretendohet të jetë nxjerrë nga të akuzuarit përmban tregues të veprimeve të papërshtatshme që kanë ndodhur në kontekst të bashkëpunimit midis Republikës së Serbisë (ose zyrtarëve të saj) dhe TFHS-së/ZPS-së, që do të kishte ndikuar në

⁷³⁴ Aktgjykimi, para. 800, 806.

⁷³⁵ Aktgjykimi, para. 806. Trupi Gjykses rikujtoi se “si Ligji ashtu dhe Kushtetuta kërkojnë që [Dhomat e Specializuara] të respektojnë dhe zbatojnë standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë dhe ato të përcaktuara në KEDNJ”, dhe në lidhje me këtë iu referua nenit 40 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 10 të KEDNJ-së që garantojnë lirinë e shprehjes. Trupi Gjykses iu referua edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, që ka vendosur se ushtrimi i lirisë së shprehjes në funksion të interesit publik përllig mbrojtje të veçantë. *Shih* Aktgjykimin, para. 806, poshtëshënimi 1687, ku i referohet *Von Hannover (No. 2) Judgment*, para. 109; *Leempoel Judgment*, para. 68; *Standard Verlags (No. 2) Judgment*, para. 46; *Von Hannover Judgment*, para. 60; *Satakunnan Markkinapörssi Oy and Satamedia Oy Judgment*, para. 171; *Castells Judgment*, para. 43. Paneli vëren se, në balancimin e së drejtës së lirisë së shprehjes me të drejtat dhe detyrimet e tjera (siç është e drejta për respektim të privatësisë apo nevoja për të parandaluar nxjerrjen e informacionit konfidencial), GJEDNJ-ja përdori kriteret e interesit të përgjithshëm, apo të interesit publik. Në këtë aspekt, [GJEDNJ-ja] konstatoi se, ndonëse përkufizimi se çfarë është objekt i interesit të përgjithshëm varet nga rrethanat e çështjes (*Von Hannover (No. 2) Judgment*, para. 109), ky interes publik është përkufizuar si “autoriteti dhe paanësia e gjyqësorit, efektiviteti i hetimeve penale, dhe e drejta e të akuzuarit për t’u prezumuar i pafajshëm dhe për mbrojtje të privatësisë së tij” (*Bédat Judgment*, para. 55).

pavarësinë, paanësinë ose integritetin e hetimeve të TFHS-së/ZPS-së.⁷³⁶

325. Trupi Gjykses vërejt i më tej se ky konstatim nuk u kundërshtua nga palët.⁷³⁷ Në fund të vlerësimit, Trupi Gjykses konstatoi se nuk kishte arsye të besueshme për të arritur në përfundimin se në informacionin e mbrojtur që zbuluan të akuzuarit kishte tregues të veprimeve të papërshtatshme që mund t'i atribuoheshin TFHS-së/ZPS-së.⁷³⁸

326. Gucati argumenton se ZPS-ja duhej të vërtetonte jashtë dyshimit të arsyeshëm se nxjerrja e informacionit nuk ishte në interesin publik.⁷³⁹ Ai parashtron gjithashtu se konstatimi se nuk kishte tregues të veprimeve të papërshtatshme që mund t'i atribuohen TFHS-së/ZPS-së përbënte përmbyse të detyrimit të vërtetimit.⁷⁴⁰

327. Paneli pranon se një numër i argumenteve të Gucatit kanë të bëjnë me standardin dhe detyrimin e vërtetimit për arsyet e përjashtimit të përgjegjësisë penale dhe se ky standard konkret kërkon vëmendje të veçantë. Sipas Panelit, jurisprudenca e GJPN-së shërben si udhëzuese në këtë drejtim.

328. Në Aktgjykimin e Apelit *Ongwen*, Dhoma e Apelit e GJPN-së u shpreh se në mungesë të një dispozite konkrete në Statutin e Romës që rregullon standardin e vërtetimit lidhur me arsyet që përjashtojnë përgjegjësinë penale, zbatohen dispozitat e përgjithshme të nenit 66 të Statutit [të Romës].⁷⁴¹ I njëjti vëzhgim vlen edhe në Dhomat e Specializuara, ku neni 21(3) i Ligjit, si dhe rregulla 140(1) e Rregullores,

⁷³⁶ Aktgjykimi, para. 808. *Shih gjithashtu* Vendimin në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 61.

⁷³⁷ *Shih* Aktgjykimin, para. 809.

⁷³⁸ Aktgjykimi, para. 817.

⁷³⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 192, 195-196. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 47. Në Dosjen e Kundërpërgjigjes së tij, Gucati pretendon se rreziku që një i akuzuar fajtor të shpallet i pafajshëm nëse ZPS-ja nuk e vërteton fajësinë jashtë dyshimit të arsyeshëm është "pjesë e vetvetishme" e standardit të vërtetimit para Dhomave të Specializuara, siç përcaktohet në nenin 21(3) të Ligjit. *Shih* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 48.

⁷⁴⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 202.

⁷⁴¹ *Ongwen Appeal Judgment*, para. 337.

kërkojnë që fajësia të vërtetohet “jashtë dyshimit të arsyeshëm”. Kjo do të thotë se detyrimi i vërtetimit të fajësisë së të akuzuarve (detyrimi për të bindur) i takon ZPS-së, përfshirë edhe lidhur me arsyet për përjashtimin e përgjegjesisë penale, kur paraqiten të tilla.⁷⁴²

329. Siç konfirmoi Dhoma e Apelit e GJPN-së në Aktgjykimin e Apelit *Ongwen*:

Ky detyrim dhe standard i vërtetimit kërkon që faktet e domosdoshme për shpalljen e fajësisë, gjegjësisht ato që përbëjnë elementet e veprës ose veprave penale për të cilat ngrihen akuzat (siç janë elementet mendore ose subjektive) dhe forma ose format e përgjegjesisë penale që pretendohet se kanë të akuzuarit, duhet të vërtetohen jashtë dyshimit të arsyeshëm nga prokurori. Përgjithësisht, prokurori nuk ka detyrimin për të “hedhur poshtë çdo element” të një arsyeje që përjashton përgjegjësinë penale të të akuzuarit. Megjithatë, ai duhet të vërtetojë fajësinë e të akuzuarit jashtë dyshimit të arsyeshëm, edhe kur paraqitet një arsye për përjashtimin e përgjegjesisë penale.⁷⁴³

330. Në Aktgjykimin e Apelit *Ongwen*, Dhoma e Apelit e GJPN-së sqaroi dallimin midis detyrimit të Prokurorisë për të vërtetuar fajësinë e të akuzuarit jashtë dyshimit të arsyeshëm (detyrimi për të bindur) dhe përgjegjesisë së Mbrojtjes për të paraqitur prova në mbështetje të arsyeve që përjashtojnë përgjegjësinë penale (detyrimi i paraqitjes së provave ose detyrimi i provave),⁷⁴⁴ duke theksuar lidhur me këtë të fundit se “nuk mjafton që thjesht të jepet njoftim për këtë synim.”⁷⁴⁵ Siç theksoi më tej Dhoma e Apelit e GJPN-së:

Ky i ashtuquajtur “detyrim i provave” nga ana e Mbrojtjes nuk do të thotë përmbysje e detyrimit të vërtetimit, sepse prokurori nuk lirohet nga detyrimi për të vërtetuar elementet e veprës penale (përfshirë elementin mendor) dhe format e përgjegjesisë jashtë dyshimit të arsyeshëm. Dhoma Gjyqësore duhet që pas kësaj të

⁷⁴² *Shih gjithashtu Ambos Treatise ICL I*, pp. 414-415 dhe referencat e cituara aty. *Shih gjithashtu Kokott Burden of Proof*, p. 9.

⁷⁴³ *Ongwen Appeal Judgment*, para. 338 (poshtëshënimi nuk është përfshirë).

⁷⁴⁴ *Shih Roberts Criminal Evidence*, pp. 243-245 lidhur me dallimin klasik midis detyrimit të vërtetimit (detyrimit për të bindur) dhe detyrimit të paraqitjes së provave /detyrimit të provave.

⁷⁴⁵ *Ongwen Appeal Judgment*, para. 340.

vendosë nëse ekziston një arsye për përjashtimin e përgjegjesisë penale të të akuzuarit, në bazë të të gjitha provave të paraqitura nga palët dhe nga pjesëmarrësi.⁷⁴⁶

331. Kjo përgjegjësi e Mbrojtjes për të paraqitur prova mbështetëse pasqyrohet edhe në rregullën 104(1)(b) të Rregullores sipas së cilës Mbrojtja duhet ta informojë ZPS-në për “emrat dhe të dhënat e përditësuara për kontaktimin e dëshmitarëve, dhe çdo provë tjetër tek e cila i akuzuari synon të mbështetet” për vërtetimin e arsyeve për përjashtimin e përgjegjesisë penale.

332. Paneli është bindur se, kur Trupi Gjykes vlerësoi nëse ekzistonte një arsye për përjashtimin e përgjegjesisë penale të të akuzuarve – siç është interesi publik – e bëri këtë në bazë të të gjitha provave të paraqitura nga palët. Trupi Gjykes mori në shqyrtim dhe i trajtoi argumentet e Mbrojtjes në mbështetje të pretendimit të saj të interesit publik, si për shembull, pretendimin e Mbrojtjes se fakti që TFHS-ja/ZPS-ja u mbështet dhe bashkëpunoi me disa zyrtarë të caktuar serbë ishte provë e veprimeve të papërshtatshme, duke qenë se Mbrojtja i konsideronte këta individë përgjegjës për krime lufte ose vegla të regjimit të Millosheviqit; pretendimin se deklaratat e marra nga TFHS-ja dhe/ose ZPS-ja mund të jenë marrë nëpërmjet shtrëngimit ose dhunës; dhe pretendimin se dëshmitarët kishin dhënë deklarata të rreme gjatë hetimit me qëllim që të siguronin të drejtën e banimit ose azilit.⁷⁴⁷

333. Mirëpo, Trupi Gjykes arriti në përfundimin se pretendimet e ngritura nga Mbrojtja nuk përbënin bazë të besueshme për të arritur në përfundimin se në informacionin e mbrojtur që zbuluan të akuzuarit kishte tregues të veprimeve të papërshtatshme që mund t'i atribuoheshin TFHS-së/ZPS-së.⁷⁴⁸ Në apel Gucati nuk ngre pretendime se Trupi Gjykes shpërfilli pa të drejtë ndonjë provë mbështetëse që

⁷⁴⁶ *Ongwen Appeal Judgment*, para. 340 (pa poshtëshënimin).

⁷⁴⁷ Aktgjykimi, para. 811-816. Gjatë gjykimit, Mbrojtja e Gucati nuk pretendoi se interesi publik do të shërbente si argument mbrojtës, por sugjeroi se përmbushja e interesit publik do të ishte relevante për vlerësimin e ligjshmërisë së sjelljes së të akuzuarve. *Shih* Aktgjykimin, para. 801 dhe referencat e cituara aty.

⁷⁴⁸ *Shih* Aktgjykimin, para. 817.

mund të jetë paraqitur prej tij në lidhje me argumentin mbrojtës të interesit publik. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se Gucati nuk ka vërtetuar se me konstatimin e tij Trupi Gjykses përmbysi detyrimin e vërtetimit.

334. Gjithashtu, në kundërshtim me argumentin e Haradinajt se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se argumenti mbrojtës i interesit publik nuk ekziston në legjislacionin e Kosovës,⁷⁴⁹ Trupi Gjykses shprehimisht e shqyrtoi nocionin e interesit publik sipas nenit 200 të KPK-së, i cili kërkon, në bazë të nenit 200(2) të KPK-së, që interesi publik të ketë më shumë peshë se interesi i mosnxjerrjes së informacionit konfidencial. Trupi Gjykses konstatoi se përkufizimi i dhënë në nenin 200(4) të KPK-së nuk ndryshonte në përmbajtje nga nocioni i interesit publik i pranuar nga GJEDNJ-ja.⁷⁵⁰ Trupi Gjykses i vlerësoi pretendimet e të akuzuarve brenda kornizës normative të vendosur nga Kushtetuta e Kosovës, legjislacionit përkatës kosovar dhe nenit 10 të KEDNJ-së.⁷⁵¹

335. Për sa i përket zbatimit në procese penale, GJEDNJ-ja⁷⁵² dhe tribunalë ndërkombëtarë si TPNJ-ja dhe TSL-ja, kanë theksuar, sidomos në kuadër të gjykimeve të personave për mosbindje ndaj gjykatës,⁷⁵³ nevojën për të balancuar mbrojtjen e informacionit konfidencial që lidhet me procese gjyqësore me të drejtën e lirisë së shprehjes.

336. Paneli vëren gjithashtu se, në peshimin e interesave publikë në fjalë, këta tribunalë kanë pranuar se të drejtës për liri të shprehjes mund t'i vihen kufizime, me kusht që shkalla e kufizimit të jetë proporcionale me vlerën që shërben për të mbrojtur

⁷⁴⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 108.

⁷⁵⁰ *Shih* Aktgjykimin, para. 807. *Shih gjithashtu* Vendimin në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes, para. 54 dhe jurisprudencën e cituar aty.

⁷⁵¹ Aktgjykimi, para. 807.

⁷⁵² *Shih, p.sh., Dupuis and Others Judgment*, para. 43; *Stoll Judgment*, para. 102. *Shih gjithashtu* *Bladet Tromsø and Stensaas Judgment*, para. 65; *Monnat Judgment*, para. 66; *July and SARL Libération Judgment*, para. 69; *Campos Dâmaso Judgment*, paras 34-35; *Bédât Judgment*, para. 55.

⁷⁵³ *Shih Hartmann Trial Judgment*, paras 69-74; *Hartmann Appeal Judgment*, paras 158-164. *Shih gjithashtu* *Akhbar and Al Amin Trial Judgment*, paras 157-160.

atë kufizim.⁷⁵⁴ Duke ndjekur këtë qasje, në kontekstin e një çështjeje për mosbindje ndaj gjykatës që kishte të bënte me nxjerrje të informacionit konfidencial, Dhoma Gjyqësore në TPNJ u shpreh:

Dhoma gjykon se, me publikimin e informacionit konfidencial, e akuzuara krijoi një rrezik real pengimi të aftësisë së Tribunalit për të ushtruar kompetencën e vet për të proceduar dhe ndëshkuar shkelje të rënda të së drejtës humanitare. Nxjerrja e informacionit të mbrojtur [...] shërben për të minuar besimin ndërkombëtar në aftësinë e Tribunalit për të garantuar konfidencialitetin e informacioneve të caktuara dhe mund të frenojë bashkëpunimin në një nivel që është jetik për administrimin e drejtësisë penale ndërkombëtare. Në këto rrethana, Dhoma është bindur se procesi i gjyqimit për mosbindje ndaj gjykatës është proporcional me pretendimet dhe nuk bie ndesh me përmbajtjen dhe frymën e nenit 10(2) të KEDNJ-së.⁷⁵⁵

337. Paneli i Apelit gjykon se Trupi Gjyqësor vlerësoi si duhej nëse interesi publik i pretenduar në këtë çështje gjyqësore do të kishte më shumë peshë se mosnxjerrja e informacionit konfidencial. Duke mbajtur parasysh rëndësinë që kanë dëshmitarët për hetimet penale si dhe shkallën, llojin dhe qëllimin e pretenduar të informacionit të zbuluar, Trupi Gjyqësor u bind se kufizimi ishte i domosdoshëm në një shoqëri demokratike, me qëllim që të mbrohej një nevojë sociale urgjente, dhe se ishte proporcional me qëllimet legjitime të synuara.⁷⁵⁶ Paneli konstaton se Mbrojtja nuk ka arritur të vërtetojë se vlerësimi i Trupit Gjyqësor ishte i gabuar.

338. Bazuar në këtë konstatim, nuk është e nevojshme që Paneli të trajtojë argumentet e tjera të paraqitura nga Mbrojtja, sidomos argumentet përgjithësisht të pambështetura të Haradinajt se: Trupi Gjyqësor nuk mori parasysh “përfshirjen e burimeve serbe të TFHS-së/ZPS-së” në “regjimin e Millosheviqit”; “qëndrimin që ka

⁷⁵⁴ *Shih, p.sh., Akhbar and Al Amin Trial Judgement*, para. 158, ku i referohet *Morais v. Angola*, para. 6.8.

⁷⁵⁵ *Hartmann Trial Judgement*, para. 74 (poshtëshënimi nuk është përfshirë).

⁷⁵⁶ Aktgjykimi, para. 821. *Shih gjithashtu Aktgjykimin*, para. 810-820, 822-824.

mbajtur Serbia në vite ndaj Kosovës”; apo varësinë e hetimeve të TFHS-së/ZPS-së nga burimet serbe.⁷⁵⁷

339. Megjithatë, Paneli rikujton se përkufizimi i përdorur nga Trupi Gjykes për nocionin e interesit publik në kuadër të bashkëpunimit të TFHS-së/ZPS-së me Serbinë nuk u kundërshtua nga palët.⁷⁵⁸ Në qoftë se Haradinaj do të kishte dashur që ky përkufizim të përfshinte edhe faktorë të tjerë, si ata të përmendur më lart, ai duhej ta kishte kundërshtuar këtë gjatë gjykimit. Megjithëse në apel ai argumenton se Trupi Gjykes i ka shkaktuar dëm lidhur me këtë aspekt mbrojtjeje, ai nuk jep prova në mbështetje të pretendimit të tij.⁷⁵⁹

340. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Gucati dhe Haradinaj nuk arrijnë të provojnë se Trupi Gjykes gaboi që rrëzoi argumentin mbrojtës të interesit publik. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 4(G) të Apelit të Gucatit, pjesën tjetër të Pikës 4(H) të Apelit të Gucatit,⁷⁶⁰ Pikën 9 të Apelit të Haradinajt dhe pjesën tjetër të Pikës 1 të Apelit të Haradinajt.⁷⁶¹

2. Pretendimet për gabime lidhur me argumentin mbrojtës të sinjalizimit (Pika 5 e Apelit të Gucatit)

(a) Parashtrimet e palëve

341. Krahas argumenteve që përkojnë me ato të interesit publik që u trajtuan tashmë më lart nga Paneli,⁷⁶² Gucati argumenton se, megjithëse i akuzuari nuk ishte në

⁷⁵⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 108, 113-114; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 29. *Shih më lart*, para. 29, 31-32.

⁷⁵⁸ Aktgjykimi, para. 809. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 808.

⁷⁵⁹ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 34(b). Në mbështetje të pretendimit të tij, Haradinaj argumenton vetëm se gjatë gjykimit Mbrojtja u pengua në mënyrë të përsëritur që të përmendte emrat e disa individëve në seancë publike.

⁷⁶⁰ Paneli e ka trajtuar pjesën tjetër të kundërshtimeve të paraqitura në Pikën 4(H) të Apelit të Gucatit në pjesën mbi nxjerrjen e informacionit. *Shih më lart*, para. 65-73.

⁷⁶¹ Paneli e ka trajtuar pjesën tjetër të kundërshtimeve të paraqitura në Pikën 1 të Apelit të Haradinajt në pjesën mbi gjykimin e drejtë dhe aspekte të provave. *Shih më lart*, para. 50-53, 56-58, 65-73, 93-97.

⁷⁶² *Shih* argumentet e Gucatit se kur zbulimi i informacionit lejohet me ligj, si në rastin e zbulimit të informacionit nga sinjalizuesi, ai është i autorizuar dhe nuk kryhet vepër penale. Dosja e Apelit të

marrëdhënie pune apo punësimi me ZPS-në apo Serbinë, Trupi Gjykses pranoi se një person i tillë ka të drejtën e mbrojtjes si sinjalizues nëse ndihmon “nxjerrjen e mëtejshme” nga një burim sinjalizues që është në marrëdhënie pune ose punësimi me subjektin nga ku mund të ketë ardhur materiali, edhe nëse ndihmuesi nuk e njeh sinjalizuesin.⁷⁶³

342. Gucati parashtron se Trupi Gjykses e përmbysi detyrimin e vërtetimit dhe gaboi që konstatoi se nuk kishte asnjë provë se rrjedhja e informacionit ishte pasojë e veprimeve të një sinjalizuesi nga ZPS-ja apo autoritetet serbe.⁷⁶⁴ Në mbështetje të kësaj, Gucati parashtron se Trupi Gjykses “dëgjoi dëshmi” se një zyrtar i identifikuar i ZPS-së ishte implikuar si burim i rrjedhjes së dokumenteve; në dy artikuj në media thuhej se informacioni erdhi nga ZPS-ja; dhe se në informacionin që përmbante Paketa 3 sugjerohej se të paktën njëri prej tri grupeve të dokumenteve duhej të kishte ardhur nga ZPS-ja.⁷⁶⁵

343. Gjithashtu, Gucati parashtron se ZPS-ja paraqiti për pranim si prova vetëm një pjesë të vogël të informacionit të rrjedhur dhe se, në këtë mënyrë, procesi balancues i kryer nga Trupi Gjykses u bë i pavlefshëm nga fakti se Trupi Gjykses nuk kishte dijeni për përmbajtjen e plotë të Paketave.⁷⁶⁶ Mbështetur në këtë, Gucati parashtron se kjo i bën të pavlefshme konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm të Pikës 5 të Aktakuzës.⁷⁶⁷

Gucati, para. 205. *Shih gjithashtu* pretendimin e Gucatis se ZPS-ja duhej të provonte se burimi i rrjedhjes nuk ishte sinjalizues dhe se fakti që Trupi Gjykses nuk i kërkoi ZPS-së të paraqiste prova për këtë përbënte përmbysje të detyrimit të vërtetimit. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatis, para. 208, 212.

⁷⁶³ Dosja e Apelit të Gucatis, para. 206. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 187-188.

⁷⁶⁴ Dosja e Apelit të Gucatis, para. 212.

⁷⁶⁵ Dosja e Apelit të Gucatis, para. 207.

⁷⁶⁶ Dosja e Apelit të Gucatis, para. 209, 211. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatis, para. 78. Paneli rikujton se i ka trajtuar gjetkë kundërshtimet e Gucatis lidhur me burimin e informacionit të rrjedhur dhe shkallën e nxjerrjes së Paketave nga ZPS-ja. *Shih më lart*, para. 65-73; *shih më poshtë*, para. 361-374.

⁷⁶⁷ Paneli supozon se kjo është pika e Aktakuzës për të cilën e ka fjalën Gucati, sepse në fakt pika konkrete nuk përmendet. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatis, para. 212.

344. ZPS-ja përgjigjet se Gucati shtrembëron dispozitat ligjore të zbatueshme, keqinterpreton provat⁷⁶⁸ dhe se pretendimi i tij që ZPS-ja duhej të vërtetonte se burimi i rrjedhjes nuk ishte sinjalizues është “i pabazë dhe absurd”.⁷⁶⁹ ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses i shqyrtoi posaçërisht provat e përmendura nga Gucati dhe konstatoi se nuk ishte identifikuar asnjë arsye për përfundimin se ZPS-ja ishte përfshirë në rrjedhjen e informacionit.⁷⁷⁰

345. ZPS-ja përgjigjet gjithashtu se, në kundërshtim me çfarë pretendon Gucati, Trupi Gjykses nuk pranoi se individët që kanë lidhje me një sinjalizues mbrohen edhe kur ndihmuesi në nxjerrjen e informacionit nuk e njeh sinjalizuesin.⁷⁷¹ ZPS-ja parashtron gjithashtu se argumenti i Gucatit se Trupi Gjykses dëgjoi dëshmi që një dëshmitar kishte implikuar një zyrtar të identifikuar të ZPS-së si burim të rrjedhjes, është i gabuar.⁷⁷²

346. Gucati kundërpërgjigjet se Trupi Gjykses pranoi se, në rrethana të caktuara, mund të ketë mbrojtje edhe një person “që ka lidhje” me sinjalizuesin.⁷⁷³ Gucati kundërpërgjigjet gjithashtu se z. Jukiq konfirmoi se një dëshmitar tjetër, në dy raste të ndryshme, kishte implikuar me emër një zyrtar të ZPS-së si burim të rrjedhjes së dokumenteve.⁷⁷⁴

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

347. Trupi Gjykses theksoi se në bazë të jurisprudencës së GJEDNJ-së, sinjalizuesit gëzojnë mbrojtje të posaçme të lirisë së shprehjes, të garantuar nga neni 10 i KEDNJ-

⁷⁶⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 116.

⁷⁶⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 117, ku i referohet Dosjes së Apelit të Gucatit, para. 208.

⁷⁷⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 120.

⁷⁷¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 118, ku i referohet Dosjes së Apelit të Gucatit, para. 206.

⁷⁷² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 119. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 121-122 ku ZPS-ja rikujton konstatimet e Trupit Gjykses. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 156.

⁷⁷³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 71.

⁷⁷⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 72-73. Gucati argumenton gjithashtu se kjo dëshmi nuk u përjashtua, por se Trupi Gjykses konstatoi se ishte “tejet hamendësuese dhe ishte kundërshtuar në mënyrë të besueshme”. *Shih* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 75.

së.⁷⁷⁵ Trupi Gjykues rikujtoi dhe përdori përkufizimin e GJEDNJ-së për sinjalizuesit, sipas të cilit mbrojtje i jepet vetëm personit që ka nxjerrë, nisur nga motive të ndershme, informacion në kontekstin e marrëdhënies së punësimit.⁷⁷⁶

348. Trupi Gjykues pranoi edhe sugjerimin e ekspertes së Mbrojtjes, znj. Majers, se, ndryshe nga sinjalizuesi, nuk është e nevojshme që personi “që ka lidhje” me sinjalizuesin të jetë në marrëdhënie pune ose punësimi me personin ose subjektin praktikat e të cilit po denoncohen. Mirëpo, sipas Trupit Gjykues, të akuzuarit nuk mund të konsiderohen se përfitojnë nga mbrojtja për sinjalizuesit si individë “që kanë lidhje” me një sinjalizues.⁷⁷⁷ Në fund, Trupi Gjykues konstatoi se, edhe nëse të akuzuarit do të përmbushnin kriteret për t’u konsideruar sinjalizues:

[...] ndërhyrja në lirinë e shprehjes së tyre si pasojë e arrestimit, hetimit dhe ndjekjes penale ishte e parashikuar me ligj, ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale me qëllimet e mbrojtjes së dëshmitarëve nga dëmtimi, duke i mundësuar ZPS-së të përmbushte mandatin e vet në mënyrë të efektshme dhe duke ruajtur besimin e publikut në integritetin e proceseve [të Dhomave të Specializuara].⁷⁷⁸

349. Paneli i Apelit konstaton se nuk ka asgjë në argumentet e Gucatit që të vërë në dyshim ose minojë konstatimin e Trupit Gjykues se *edhe nëse të akuzuarit do të përmbushnin kriteret për t’u konsideruar sinjalizues*, ndërhyrja në lirinë e shprehjes së tyre ishte e parashikuar me ligj, e nevojshme dhe proporcionale.⁷⁷⁹ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se argumentet e Gucatit nuk kanë potencialin për ta cenuar këtë konstatim.⁷⁸⁰ Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikën 5 të Apelit të Gucatit.

⁷⁷⁵ Aktgjykimi, para. 825.

⁷⁷⁶ Aktgjykimi, para. 828 dhe referencat e cituara aty.

⁷⁷⁷ Aktgjykimi, para. 830.

⁷⁷⁸ Aktgjykimi, para. 831.

⁷⁷⁹ *Shih* Aktgjykimin, para. 831.

⁷⁸⁰ *Shih më lart*, para. 31.

3. Pretendimet për gabime lidhur me argumentin mbrojtës të shtytjes nga ZPS-ja për kryerje të veprës penale (Pikat 17, 18, 19 të Apelit të Gucatit; Pikat 12, 13 të Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

350. Gucati parashtron se gabimet e Trupit Gjykues në trajtimin e argumentit të tij për shtytje për kryerje të veprës penale ishin një “përmbysje e palejueshme e detyrimit dhe standardit të vërtetimit”, dhe mbi këtë bazë Paneli duhet t’i prapësojë verdiktet e fajësisë së tij për të gjitha Pikat e Aktakuzës dhe ta shpallë të pafajshëm.⁷⁸¹

351. Gucati argumenton se, për sa i përket argumentit mbrojtës të shtytjes për kryerje të veprës penale, kriteri i vetëm që duhet të përmbushë Mbrojtja është që pretendimi i ngritur prej saj të mos jetë tërësisht i pagjasë.⁷⁸² Gucati nënvizon se ky standard është shumë i ulët dhe nuk përmban detyrimin e vërtetimit dhe thotë se, pas ngritjes së këtij pretendimi nga Mbrojtja, i takonte ZPS-së të provonte të kundërtën, gjë që nuk e bëri, siç u pranua në mënyrë të nënkuptuar edhe nga Trupi Gjykues dhe kjo duhej të kishte rezultuar në përjashtimin e provave.⁷⁸³ Gucati argumenton se Trupi Gjykues gaboi që zbatoi një standard të papërshtatshëm dhe që i kërkoi Mbrojtjes të paraqiste prova *prima facie* të shtytjes për kryerje të veprës penale.⁷⁸⁴

⁷⁸¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 340, 351, 353, 363, 365, 369, 371, 378, 380, 389, 391; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 108-109. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 87.

⁷⁸² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 332-333, 335, 337; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 107. Gucati gjithashtu parashtron se pretendimi i tij lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale u paraqit qartë para dhe gjatë gjykimit, dhe argumenton se Trupi Gjykues e kuptoi shumë mirë se ai pretendonte se ishte shtyrë nga zyrtarë të Dhomave të Specializuara/ZPS-së për të kryer vepër penale. Dosja e Apelit të Gucatit, para. 341-343, 350; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 107-108. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 84.

⁷⁸³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 332-333, 335, 338-339; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 105-107; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 185. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 352, 364, 370, 379, 390, 392.

⁷⁸⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 334, 336; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 80; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 106-107, 109. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 79; Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 87, 107, 109; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 185.

352. Gucati parashtron gjithashtu se “në fakt, veprime nxitjeje ndodhën” dhe se “veprat penale nuk do të mund të ishin kryer në qoftë se nuk do të ishte vënë në dispozicion mjete [domethënë, dorëzimi i Paketave të akuzuarve].”⁷⁸⁵ Sipas mendimit të Gucatit, i vetmi aspekt faktik [për t’u përcaktuar] ishte nëse zyrtari ose zyrtarët e ZPS-së apo agjentë të jashtëm që vepruan nën udhëzimet e tyre apo në bashkërendim me ta u përfshinë në nxitjen e të akuzuarve, duke qenë se: (i) ishte e qartë që veprat penale nuk do të kishin ndodhur pa dorëzimet e dokumenteve dhe nxitjen për publikimin e tyre; (ii) nuk ka kriter ligjor sipas të cilit të akuzuarit duhej të ishin detyruar ose shtrënguar ta kryenin veprën penale; (iii) predispozita e të akuzuarve nuk është relevante.⁷⁸⁶ Ndonëse Gucati nuk mund të jepte prova për pretendimin se një zyrtar i ZPS-së ishte përfshirë në shtytjen e tij për kryerjen e veprës penale, ai argumenton se, gjithsesi, detyrimi i vërtetimit i takonte ZPS-së, jo atij.⁷⁸⁷

353. Sa i takon përfshirjes së pretenduar të një zyrtari të ZPS-së, Gucati argumenton se, kur ka tregues se tri grupet e dokumenteve erdhën nga ZPS-ja, i takon kësaj të fundit të vërtetojë se nuk erdhën nga ZPS-ja ose të vërtetojë se nuk kishte një plan të qëllimshëm për t’i shtyrë të akuzuarit të kryenin vepër penale.⁷⁸⁸ Ai vë në dukje provat të cilat, sipas tij, tregojnë se grupi i parë dhe i dytë i dokumenteve, për nga vetë lloji i tyre, linin të kuptohej se vinin nga TFHS-ja/ZPS-ja, dhe parashtron gjithashtu se Trupi Gjykses pranoi se grupi i tretë i dokumenteve “duhej” të kishte ardhur nga ZPS-ja.⁷⁸⁹

354. Krahas këtyre, Gucati argumenton se Trupi Gjykses dëgjoi dëshmi se një dëshmitar kishte përmendur emrin e një zyrtari që punonte për ZPS-në si burim të rrjedhjes së dokumenteve.⁷⁹⁰ Sipas Gucatit, Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se kjo

⁷⁸⁵ Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 108.

⁷⁸⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 344-347; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 81-82; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 107-108; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 180-181.

⁷⁸⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 348-349; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 108.

⁷⁸⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 362-363. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 366-367.

⁷⁸⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 354-359, 361. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, 366-367.

⁷⁹⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 360(a), 381, 384-385, 387; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 72-74.

dëshmi ishte “tejet hamendësuese dhe është kundërshtuar në mënyrë të besueshme”, megjithëse ajo u dha dy herë dhe nuk u kundërshtua nga ZPS-ja.⁷⁹¹ Gucati argumenton gjithashtu se dy artikuj në media të pranuar si prova i referoheshin marrjes së informacionit të ngjashëm me informacionin në fjalë nga “një burim në ZPS në Hagë”.⁷⁹² Sidoqoftë, ai parashtron se ZPS-ja – që e dinte identitetin e gazetarit që i ngriti këto pretendime – nuk paraqiti prova për t’i kundërshtuar apo për t’i hedhur poshtë ato pretendime.⁷⁹³

355. Gjithashtu, Gucati parashtron se Trupi Gjykues gaboi që përmbysi detyrimin e vërtetimit duke hamendësuar se ZPS-ja nuk kishte mundur të parandalonte dorëzime të mëtejshme të materialeve dhe argumenton se fakti që ZPS-ja nuk ndërmori hapa parandalues është tregues se ajo dëshironte që të bëheshin dorëzimet ose koordinoi kryerjen e tyre.⁷⁹⁴

356. Pavarësisht nga mangësitë që Paneli i Apelit evidentoi më lart në lidhje me Pikat 12 dhe 13 të Apelit të Haradinajt,⁷⁹⁵ Paneli kupton se Haradinaj argumenton që Trupi Gjykues gaboi që nuk hetoi burimin e rrjedhjes nga ZPS-ja, duke ia kaluar kështu Mbrojtjes detyrimin për të mbështetur me prova “pretendimet e tyre, *prima facie* të besueshme, për shtytje për kryerje të veprës penale”, si dhe gaboi që shpërfilli ose nuk pranoi prova të cilat tregonin se burimi i rrjedhjes ishte ZPS-ja.⁷⁹⁶ Haradinaj thotë gjithashtu se, sipas mendimit të tij, ai e përmbushi standardin “jo tërësisht i pagjasë” që zbatohet për pretendimet e shtytjes për kryerje të veprës penale.⁷⁹⁷

⁷⁹¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 382-385, 387-388, ku i referohet Aktgjykimit, para. 878; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 74-75, 85.

⁷⁹² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 360(b), 368; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 76, 86.

⁷⁹³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 368.

⁷⁹⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 372-378.

⁷⁹⁵ *Shih më lart*, para. 314.

⁷⁹⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 135-144. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 82-86; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 197-198.

⁷⁹⁷ Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 86-89.

357. ZPS-ja përgjigjet se Gucati nuk arrin të vërtetojë se Trupi Gjykses bëri gabim juridik për shkak të zbatimit të standardit të gabuar gjatë përcaktimit nëse ishte respektuar neni 6 i KEDNJ-së lidhur me pretendimin e tij të shtytjes për kryerje të veprës penale.⁷⁹⁸

358. ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses i shqyrtoi me hollësi të gjitha argumentet që kishin të bënin me pretendimin e shtytjes për kryerje të veprës penale dhe në fund konstatoi se ky pretendim ishte tërësisht i pagjasë dhe se Gucati nuk arrin të vërtetojë asnjë gabim në këtë konstatim.⁷⁹⁹

359. ZPS-ja kundërshton gjithashtu pretendimin e Gucatit lidhur me provat që tregojnë se një dëshmitar implikoi një zyrtar të ZPS-së si burim të rrjedhjes.⁸⁰⁰ ZPS-ja parashtron gjithashtu se Gucati i shtrembëron “dy artikujt e lajmeve” të cilëve u referohet dhe se, sidoqoftë, gjatë gjykimit ai nuk bëri asnjë orvatje për verifikuar bazat e pretendimeve që përmbanin ato.⁸⁰¹ Krahas kësaj, ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses nuk bëri asnjë konstatim konkret se ZPS-ja nuk kishte mundur të parandalonte dorëzime të mëtejshme.⁸⁰²

360. ZPS-ja përgjigjet edhe se Pikat 12 dhe 13 të Apelit të Haradinajt duhen rrëzuar *in limine*, duke qenë se Haradinaj nuk përmbushi një numër kriteresh procedurale që zbatohen në apel.⁸⁰³ Sa i takon themelësisë, ZPS-ja përgjigjet se Haradinaj i kishte të gjitha mundësitë t'i paraqiste argumentet në mbështetje të pretendimit të tij të shtytjes për kryerje të veprës penale gjatë gjykimit, dhe se nuk ka pasur përmbysje të detyrimit

⁷⁹⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 124, 132; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 128-131, 154-156.

⁷⁹⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 125, 128; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 122, 126-127, 129-131, 154. Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Gucati i shtrembëron disa prej konstatimeve të Trupit Gjykses dhe shpërfill disa të tjera, sidomos ato që tregojnë se ai dha dëshmi mospërputhëse në lidhje me pretendimin e tij të shtytjes për kryerje të veprës penale. *Shih* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 126.

⁸⁰⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 129; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 127.

⁸⁰¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 130.

⁸⁰² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 131.

⁸⁰³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 141-143.

të vërtetimit.⁸⁰⁴ ZPS-ja përgjigjet gjithashtu se Haradinaj i shtrembëron provat dhe formulimin e Aktgjykimit të Trupit Gjykses dhe se kërkesat e tij për nxjerrje të materialeve u shqyrtuan me kujdes nga Trupi Gjykses.⁸⁰⁵

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

361. Siç theksoi Trupi Gjykses, në Dhomat e Specializuara “shtytja për kryerjen e veprës penale nuk përbën argument mbrojtës formal ndaj akuzave, por përcakton kriteret procedurale që duhet të zbatohen nga gjykatat dhe autoritetet prokuroriale për të garantuar drejtësinë e procesit në një çështje gjyqësore që përfshin një pretendim të shtytjes për kryerjen e veprës penale”.⁸⁰⁶ Sidoqoftë, Paneli i Apelit do ta trajtojë pretendimin e shtytjes për kryerje të veprës penale në pjesën që ka të bëjë me argumentet mbrojtëse, në përputhje me strukturën e Aktgjykimit të Trupit Gjykses.

362. Trupi Gjykses konstatoi se pretendimi i të akuzuarve për shtytje për kryerje të veprës penale ishte “tërësisht i pagjasë dhe i pabazuar”, pasi ishte “bindur se nuk kishte bazë të arsyeshme për të arritur në përfundimin se secili nga të akuzuarit ishte shtyrë të kryejë vepër penale nga zyrtarët e ZPS-së ose nga ndonjë individ që vepronte sipas udhëzimeve ose ishte nën kontrollin e ZPS-së”.⁸⁰⁷

363. Paneli thekson se Trupi Gjykses me të drejtë konstatoi se “i takon prokurorisë të provojë se nuk ka pasur shtytje për kryerjen e veprës penale, përveç nëse pretendimet e të akuzuarve janë tërësisht të pagjasa”.⁸⁰⁸ Trupi Gjykses gjithashtu identifikoi saktësisht detyrimin e gjykatës që të “shqyrtojë faktet e çështjes dhe të ndër marrë hapat e nevojshëm për të zbuluar nëse ka pasur shtytje për kryerjen e veprës penale”, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së.⁸⁰⁹ Megjithatë, Paneli i

⁸⁰⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 145-146.

⁸⁰⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 147-149.

⁸⁰⁶ Aktgjykimi, para. 839.

⁸⁰⁷ Aktgjykimi, para. 889-890.

⁸⁰⁸ Aktgjykimi, para. 837.

⁸⁰⁹ Aktgjykimi, para. 837.

Apelit pajtohet me argumentin e Gucatit se kriteri i përcaktuar nga Trupi Gjykues për paraqitjen nga Mbrojtja të provave *prima facie* lidhur me pretendimin e shtytjes për kryerje të veprës penale nuk mbështetet nga dy aktgjykimet e GJEDNJ-së të cituara nga Trupi Gjykues.⁸¹⁰

364. Gjithsesi, ky kriter pasqyrohet në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ndonëse në aktgjykime të tjera, jo në ato të cituara nga Trupi Gjykues. Për shembull, në Aktgjykimin e çështjes *Matanović*, GJEDNJ-ja shprehet se:

Nga jurisprudenca e Gjykatës rrjedh se, gjatë vlerësimit të një ankese për shtytje, një faktor paraprak që shqyrtohet lidhet me ekzistencën e një ankese të argumentueshme është se parashtruesi i ankesës ka qenë objekt i shtytjes nga autoritetet shtetërore. Në lidhje me këtë, për të vazhduar më tej me vlerësimin, Gjykata duhet të bindet se situata nën shqyrtim përfshihet në pamje të parë në kategorinë e “rasteve të shtytjes për kryerje të veprës penale”. [...] Nëse Gjykata bindet se ankesa e parashtruesit duhet të shqyrtohet në kuadrin e kategorisë së “rasteve të shtytjes për kryerje të veprës penale”, ajo, si hap i parë, do të vijojë me vlerësimin në bazë të standardit material të zbatueshëm për shtytjen.⁸¹¹

365. Në këtë aktgjykim, GJEDNJ-ja konfirmoi gjithashtu parimet e përgjithshme lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale, të përcaktuara në Aktgjykimin *Ramanauskas*, tek i cili u mbështet Gucati gjatë seancës së apelit.⁸¹² Gjykata ritheksoi se “i takon prokurorisë të provojë se nuk ka pasur shtytje, me kusht që pretendimet e të pandehurve ‘të mos jenë tërësisht të pagjasa’”.⁸¹³ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit

⁸¹⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 332-338; Aktgjykimi, para. 837, poshtëshënimi 1748, ku citohet *Bannikova* Judgment, para. 57 dhe *Ramanauskas* Judgment, para. 70. Paneli thekson se në jurisprudencën e cituar në fakt thuhet: “me kush që pretendimet e të pandehurve të mos jenë tërësisht të pagjasa, i takon prokurorisë të provojë se nuk ka pasur shtytje. Në mungesë të provave të tilla, është detyrë e autoriteteve gjyqësore që të shqyrtojnë faktet e çështjes dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të zbuluar nëse ka pasur shtytje”. *Shih Ramanauskas* Judgment, para. 70. *Shih gjithashtu Bannikova*, Judgment, para. 57. *Shih gjithashtu*, Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 105-109; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 185.

⁸¹¹ *Matanović* Judgment, para. 131-132 me referenca të mëtejshme të cituara në të.

⁸¹² *Matanović* Judgment, para. 121; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 185, që i referohet Aktgjykimit *Ramanauskas*, para. 70, sipas të cilit: “i takon prokurorisë të provojë se nuk ka pasur shtytje për kryerje të veprës penale, por vetëm në qoftë se pretendimi nuk është tërësisht i pagjasë”.

⁸¹³ *Matanović* Judgment, para. 130.

konstaton se argumentet e Gucatit nuk provojnë se konstatimi i Trupi Gjykues vendosi një “standard të papërshtatshëm” për vlerësimin e pretendimit të shtytjes për kryerje të veprës penale.⁸¹⁴

366. Paneli i Apelit në vijim konstaton se Mbrojtja e keqinterpretonte standardin e zbatueshëm nga jurisprudenca e lartpërmendur e GJEDNJ-së, kur argumenton se standardi “jo tërësisht i pagjasë” është aq i ulët saqë përjashton çdo detyrim për paraqitje të provave, madje edhe në rastin kur është në diskutim përfshirja në çfarëdo mënyre e ZPS-së në kryerjen e veprave penale, dhe se thjesht pretendimi i shtytjes për kryerje të veprës penale, pa u mbështetur me prova, kërkon që ZPS-ja ose të vërtetojë se nuk ka pasur përfshirje nga ana e saj, ose, nëse ka pasur një të tillë, të vërtetojë se nuk kishte synimin që t’i shtynte të akuzuarit të kryenin vepër penale.⁸¹⁵

367. Edhe pse vepra penale mund të mos kishte ndodhur në rast se të akuzuarve nuk do t’u ishin dhënë tri grupet e dokumenteve, Paneli rikujton se sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale, duhet që në kryerjen e veprës penale të jenë të përfshirë punonjësit e rendit dhe të ligjit (ose persona që veprojnë sipas udhëzimeve të tyre) – si parakusht ekzistues për diskutimet e Panelit. Me fjalë të tjera, dhe në dallim nga çështja aktuale ku ZPS-ja mohoi çdo lloj përfshirje, në ato çështje gjyqësore nuk u kontestua asnjëherë fakti që punonjësit e rendit dhe të ligjit (ose ata që veprojnë sipas udhëzimeve të tyre) ishin përfshirë në kryerjen e veprës penale; ajo që u debatua ishte shkalla dhe lloji i përfshirjes. Kjo pasqyrohet edhe në vetë përkufizimin e GJEDNJ-së lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale që zakonisht, ndër të tjera, quhet edhe “nxitje nga policia”, konkretisht:

⁸¹⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 336. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 107-109 ku argumentohet se Trupi Gjykues “zbatoi një detyrim dhe standard vërtetimi të kundërt dhe të papërshtatshëm [...] për të akuzuarin, që ai të vërtetonte, më së paku *prima facie*, se u shty të kryente vepër penale, çka nuk është në përputhje me praktikën gjyqësore dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale.” *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 185. *Shih gjithashtu* udhëzimet në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, para. 251.

⁸¹⁵ Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 105-109; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 185.

Nxitja nga policia ndodh kur zyrtarët e përfshirë – qoftë anëtarë të forcave të sigurisë ose persona që veprojnë sipas udhëzimeve të tyre – nuk kufizohen në hetimin e veprimtarisë kriminale në një mënyrë në thelb pasive, por ushtrojnë mbi subjektin një ndikim të tillë që nxit kryerjen e një veprë penale që përndryshe nuk do të ishte kryer, me qëllim që të bëhet i mundur vërtetimi i veprës penale, domethënë, për sigurimin e provave dhe nisjen e ndjekjes penale [...].⁸¹⁶

368. Për këtë arsye, është e qartë që pyetjen nëse punonjësit e rendit dhe të ligjit (ose ata që vepronin sipas udhëzimeve të tyre) ishin të përfshirë në ndonjë mënyrë në kryerjen e veprës penale, GJEDNJ-ja me qëllim e trajtoi në kuadër të standardit “jo tërësisht i pagjasë”.

369. Rrjedhimisht, Paneli e gjykon të pathemeltë argumentin e Gucatit dhe Haradinajt se konstatimet e Trupit Gjykues sipas të cilave të akuzuarit duhej të paraqisnin prova *prima facie* për përfshirjen në ndonjë mënyrë të ZPS-së në kryerjen e veprave penale, ishte përmbysje e gabuar e detyrimit për vërtetimin e shtytjes për kryerje të veprës penale.⁸¹⁷ Gjithashtu, për të njëjtat arsye, Paneli i Apelit rrëzon argumentin e Gucatit sipas të cilit Trupi Gjykues gaboi që “i vendosi atij detyrime” që të paraqiste prova të cilat domosdoshmërisht të çonin në përfundimin se ai ishte shtytur të kryente vepër penale, ose të krijonte bazë të arsyeshme mbi të cilën të arrihej përfundimi ose të deduktohej se kishte ndodhur shtytje për kryerjen e veprës penale.⁸¹⁸

370. Më tej, sa u takon kundërshtimeve të Gucatit ndaj konstatimeve faktike të Trupit Gjykues, Paneli i Apelit vëren se ai kundërshton konstatimin e Trupit Gjykues se dëshmia që implikon një punonjës të ZPS-së të përmendur me emër si burim të rrjedhjes së dokumenteve ishte tejet hamendësuese dhe se u kundërshtua në mënyrë të besueshme nga ZPS-ja.⁸¹⁹

⁸¹⁶ *Akbay and Others Judgment*, para. 112; *Ramanauskas Judgment*, para. 55.

⁸¹⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 351; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 142-144.

⁸¹⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 336.

⁸¹⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 381-389, që i referohet paragrafit 878 të Aktgjykimit.

371. Duke pasur parasysh përparësinë e madhe që u jepet në apel konstatimeve faktike të Trupit Gjykses dhe faktin që nuk është e nevojshme që Trupi Gjykses të shpjegojë me hollësi çdo hap të arsyetimit të vet,⁸²⁰ Paneli i Apelit konstaton se Gucati nuk ka arritur të demonstrojë që asnjë gjykses i arsyeshëm faktesh nuk do të konstatonte se dëshmia që pretendohet se implikon një punonjës të ZPS-së të përmendur me emër si burim i rrjedhjes së dokumenteve ishte tejet hamendësuese dhe se u kundërshtua në mënyrë të besueshme. Gjithashtu, Paneli nuk konstaton ndonjë gabim në faktin që Trupi Gjykses u dha pak peshë dy artikujve të medias të pranuar si prova, ku pretendohet se informacioni i publikuar prej tyre vinte nga një burim brenda ZPS-së.⁸²¹

372. Për më tepër, siç thekson ZPS-ja, në këtë çështje Mbrojtjes iu dha mundësia të njihej me shënimin zyrtar ku dokumentohej çfarë kishte thënë dëshmitari që implikoi punonjësën e ZPS-së të përmendur me emër, megjithatë ajo nuk kërkoi pranimin e tij si provë, nuk e thirri këtë dëshmitar për të dëshmuar në gjyq, dhe as nuk thirri punonjësën e ZPS-së të përmendur me emër për të dëshmuar në gjyq.⁸²²

373. Së fundi, Paneli vëren se Gucati kundërshton përdorimin e fjalës “paaftësi” nga Trupi Gjykses, kur vlerësoi parandalimin (mungesën e parandalimit) nga ZPS-ja të dorëzimeve të mëtejshme të dokumenteve, pas dorëzimit të parë dhe të dytë nga tri dorëzimet, me argumentin se ky konstatim është hamendësues.⁸²³ Paneli gjykon se Gucati i keqinterpretonte konstatimet e Trupit Gjykses. Është e qartë se formulimi i kundërshtuar nuk u bë si konstatim se ZPS-ja nuk mund t’i kishte parandaluar dorëzimet e tjera (në kuptimin që kishte prova të cilat tregonin se ajo në fakt ishte përpjekur ta bënte këtë por kishte qenë e pasuksesshme, siç sugjeron Gucati). Në vend

⁸²⁰ *Shih më lart*, para. 33.

⁸²¹ Aktgjykimi, para. 861.

⁸²² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 129. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses theksoi se Mbrojtja nuk kërkoi që ta intervistonte apo ta thërriste këtë person si dëshmitar. *Shih* Aktgjykimin, para. 878.

⁸²³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 372-378, që i referohet paragrafit 871 të Aktgjykimit.

të kësaj, formulimi i përdorur në Aktgjykim duhet kuptuar se do të thotë që, ndonëse ZPS-ja nuk i parandaloi dorëzimet e tjera, ky fakt nuk tregonte se dorëzimet u koordinuan nga ZPS-ja.⁸²⁴ Rrjedhimisht, Paneli nuk është bindur se Trupi Gjykes bëri një “supozim në dobi të ZPS-së”, siç argumenton Gucati.⁸²⁵

374. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Gucati dhe Haradinaj nuk arrijnë të provojnë gabim në konstatimin e Trupit Gjykes se pretendimi i shtytjes për kryerje të veprës penale i ngritur nga të akuzuarit ishte tërësisht i pagjasë dhe i pabazuar. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Pikat 17, 18 dhe 19 të Apelit të Gucatit dhe Pikat 12 dhe 13 të Apelit të Haradinajt.

4. Pretendimet për gabime në lidhje me argumentin mbrojtës të nevojës ekstreme (Pika 11 e Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

375. Haradinaj parashtron se Trupi Gjykes bëri gabim juridik dhe faktik që nuk mori parasysh “bashkëpunimin për qëllime të paligjshme” të ZPS-së me autoritetet serbe në kontekstin e “natyrës njëetnike” të Dhomave të Specializuara, kur konstatoi se përgjegjësia penale e të akuzuarit nuk mund të përjashtohet mbi bazën e argumentit mbrojtës të nevojës ekstreme, brenda kuptimit të nenit 13 të Kodit Penal të Kosovës.⁸²⁶ Haradinaj në vijim argumenton se rreziku i ndjekjes penale bazuar në “drejtësinë e njëanshme” ishte i atëçastëm dhe i paprovokuar, që kërkonte veprime të menjëhershme dhe të prera për ta parandaluar.⁸²⁷ Sipas Haradinajt, demaskimi i “situatës në thelb të padrejtë” ka më shumë rëndësi se “shkalla relativisht e vogël e dëmit” që u shkaktua si pasojë e nxjerrjes së informacionit që pretendohet se ishte i mbrojtur.⁸²⁸

⁸²⁴ Aktgjykimi, para. 871.

⁸²⁵ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 376.

⁸²⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 127-130, 134.

⁸²⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 131-132.

⁸²⁸ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 133.

376. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykses i shqyrtoi argumentet e Mbrojtjes në lidhje me pretendimet për veprime të papërshtatshme në bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe në kontekstin e çështjes gjyqësore në shqyrtim.⁸²⁹ ZPS-ja gjithashtu argumenton se faktorët që e bënë Trupin Gjykses të rrezonte pretendimin e nevojës ekstreme në lidhje me ndjekjet penale keqdashëse dhe të paprovokuara, vlejné edhe për argumentin e ri të Haradinajt se rreziku i ndjekjes penale bazuar në një “drejtësi të njëanshme” ishte rrezik i atëçastëm dhe i paprovokuar.⁸³⁰ ZPS-ja gjithashtu parashtron se Haradinaj “e nënvlerëson jashtë mase” dëmin që kanë shkaktuar krimet e tij.⁸³¹

377. Haradinaj kundërpërgjigjet se konstatimet e Trupit Gjykses të cilave u referohet ZPS-ja nuk u referohen argumenteve të tij për natyrën njëetnike të Dhomave të Specializuara.⁸³² Ai gjithashtu argumenton se ZPS-ja e keqinterpretton sqarimin e tij për natyrën e “rrezikut të atëçastëm dhe të paprovokuar” dhe se ai thjesht kishte deklaruar se *nuk po pengonte ndonjë ndjekje penale konkrete që do të ndodhte së afërmi, por një rrezik të atëçastëm dhe të paprovokuar për ndjekje të tilla penale.*⁸³³

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

378. Paneli rikujton se, në bazë të nenit 13(2) të KPK-së, “nevoja ekstreme ekziston nëse personi e kryen veprën për të zmbursur prej vetes ose tjetrit rrezikun e atëçastshëm e të paprovokuar, i cili nuk mund të evitohet në mënyrë tjetër, me kusht që e keqja e shkaktuar të mos jetë më e madhe se e keqja që është kanosur”. Trupi Gjykses konstatoi se: (i) nuk mori asnjë provë në mbështetje të pretendimit të “nevojës

⁸²⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 138.

⁸³⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 140. Sipas ZPS-së, argumenti i Haradinajt se ndjekjet penale keqdashëse dhe të paprovokuara nuk ishin domosdoshmërisht të afërta, mbështet konstatimet e Trupit Gjykses. *Shih* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 139.

⁸³¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 140.

⁸³² Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 32.

⁸³³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 33.

ekstreme”;⁸³⁴ dhe (ii) edhe nëse do të kishte ekzistuar rreziku i ndjekjes penale keqdashëse, nuk ka asnjë bazë për të pretenduar se nxjerrja e dokumenteve do të kishte ndihmuar efektivisht në shmangien e rrezikut të një ndjekjeje të tillë penale dhe se dëmi i shkaktuar si pasojë nuk do të ishte më i madh se dëmi i kërcënuar.⁸³⁵

379. Ndryshe nga pretendimi i Haradinajt, në vlerësimin e argumentit mbrojtës të nevojës ekstreme, Trupi Gjykses mori parasysh edhe aspektin që lidhet me të, nëse informacioni i zbuluar nga të akuzuarit përmbante tregues të veprimeve të papërshtatshme në bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe, dhe nuk konstatoi asnjë të tillë.⁸³⁶ Trupi Gjykses, në disa raste mori parasysh edhe pretendimet e të akuzuarit se Dhomat e Specializuara ishin gjykatë “njëetnike” dhe e “njëanshme”, kur e gjykoi këtë relevante⁸³⁷. Përpjekja e Haradinajt për të sqaruar se ajo që po përpiqej ai të parandalonte ishte rreziku i ndjekjeve penale e jo një ndjekje penale konkrete, nuk ndikon në konstatimet e Aktgjykimit, pasi Trupi Gjykses i mori parasysh këto argumente⁸³⁸ dhe Haradinaj nuk arrin të provojë gabim në këtë aspekt.

380. Sidoqoftë, për vërtetimin e argumentit mbrojtës të nevojës ekstreme sipas nenit 13(2) të KPK-së, krahas ekzistencës së një rreziku të atëçastëm dhe të paprovokuar, i cili shmanget prej vetes ose një personi tjetër, duhet të plotësohen edhe dy kushte të tjera, konkretisht që: (i) të mos ekzistojë asnjë mundësi tjetër për të shmangur rrezikun, që do të thotë se rreziku nuk mund të mënjanohet pa u dëmtuar e mira juridike përkatëse;⁸³⁹ dhe (ii) e keqja e shkaktuar të mos jetë më e madhe se e keqja që

⁸³⁴ Aktgjykimi, para. 910, 912.

⁸³⁵ Aktgjykimi, para. 911.

⁸³⁶ Aktgjykimi, para. 910. *Shih gjithashtu* para. 811-817. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 127, 129-130, 134.

⁸³⁷ *Shih p.sh.*, Aktgjykimin, para. 270, 272, 289-290, 665, 667, 822, 918. Paneli thekson se argumentet lidhur me natyrën njëetnike të Dhomave të Specializuara nuk u bënë në gjykim në kuadër të argumentit mbrojtës të nevojës ekstreme. *Shih* Dosjen Paraprake të Gucatit, para. 35(b); Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të Gucatit, para. 94, që citohet në Aktgjykim, para. 908.

⁸³⁸ Aktgjykimi, para. 911. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 131; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 33.

⁸³⁹ *Shih* Komentarin *Salihu dhe të tjerët*, nenin 13 të KPK-së të vitit 2012, komentin 10(b)(1), f. 57-58.

kërkohet të shmanget e keqja e kanosur⁸⁴⁰ ose – anasjelltas – dëmi që kërkohet të shmanget duhet të jetë më i madh se dëmi i shkaktuar (standardi i proporcionalitetit ose drejtpeshimit objektiv).⁸⁴¹ Rrjedhimisht, kur rreziku mund të ishte shmangur duke i shkaktuar më pak dëm interesit juridik të mbrojtur, i akuzuari ka dalë jashtë argumentit mbrojtës të nevojës ekstreme.⁸⁴²

381. Në lidhje me kushtin e parë shtesë, për Panelin e Apelit është e qartë se rreziku i perceptuar, edhe nëse është i vërtetë, mund të ishte shmangur me mjete të tjera më të vogla, që nuk përfshinin nxjerrjen e informacionit të mbrojtur. Në fakt, siç ka konstatuar Trupi Gjykes me të drejtë, nuk ka asnjë bazë për të pretenduar se zbulimi i informacionit të mbrojtur do të kishte ndihmuar efektivisht në shmangien e rrezikut të ndjekjes penale.⁸⁴³

382. Në lidhje me kushtin e dytë shtesë, Paneli i Apelit merr parasysh konstatimin e Trupit Gjykes se të akuzuarit u lejuan të ushtronin lirinë e fjalës, ndër të tjera, kur vunë në dyshim legjitimitetin e Dhomave të Specializuara, kritikuan veprimet e saj, kundërshtuan bashkëpunimin ndërmjet TFHS-së/ZPS-së dhe Serbisë dhe pretenduan se Dhomat e Specializuara ishin etnikisht të njëanshme, por se veprimet e të akuzuarve shkuan shumë përtej ushtrimit legjitim të lirisë së fjalës kur ata ndërhyjnë rëndë në interesa të tjera legjitime publike të mbrojtura me ligj.⁸⁴⁴ Paneli i Apelit pajtohet me këtë vlerësim dhe, rrjedhimisht gjykon, se edhe nëse do të kishte ekzistuar rreziku i ndjekjeve penale të bazuara në “drejtësi të njëanshme”, dëmi që shkaktuan veprimet e tyre përmes zbulimit të emrave dhe të dhënave personale të dëshmitarëve

⁸⁴⁰ *Shih* Komentarin *Salihu dhe të tjerët*, nenin 13 të KPK-së të vitit 2012, komenti 10(b)(3), f. 58-59.

⁸⁴¹ *Shih* Eser, A., and Ambos, K., in *Ambos Rome Statute Commentary*, Article 31, mn. 57. Kjo përkon me qasjen klasike të zgjedhjes së të keqes më të vogël siç njihet në kontekstin e argumentit mbrojtës të domosdoshmërisë.

⁸⁴² *Shih* Komentarin *Salihu dhe të tjerët*, nenin 13 të KPK-së të vitit 2012, komenti 10(c), f. 59-60.

⁸⁴³ Aktgjykimi, para. 911.

⁸⁴⁴ Aktgjykimi, para. 822. *Shih gjithashtu*, Aktgjykimin, para. 821.

dhe dëshmitarëve të mundshëm, ishte qartësisht më i madh se dëmi që ata pretenduan se po përpiqeshin të shmangnin.⁸⁴⁵

383. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Haradinaj nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykses gaboi kur rrëzoi argumentin mbrojtës të nevojës ekstreme. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 11 të Apelit të Haradinajt.

5. Pretendimet për gabime në lidhje me argumentin mbrojtës për vepra të rëndësishme të vogël (Pikat 14, 15 të Apelit të Haradinajt)

(a) Parashtrimet e palëve

384. Haradinaj parashtron se Trupi Gjykses, kur nxori përfundimin në lidhje nënin 11 të KPK-së⁸⁴⁶, nuk mori parasysh faktin se informacioni i nxjerrë nga të akuzuarit tashmë ishte në sferën publike, pas rrjedhjes së tij nga ZPS-ja.

385. Haradinaj argumenton se Trupi Gjykses gaboi, ndër të tjera, që: (i) nuk mori parasysh si duhet faktin se një numër personash që thuhej se ishin të mbrojtur dhe, për rrjedhojë “u ekspozuan” nga të akuzuarit, në fakt njiheshin publikisht në Kosovë si dëshmitarë ose dëshmitarë të mundshëm;⁸⁴⁷ (ii) konstatoi se të akuzuarit nxorën të dhënat e qindra dëshmitarëve, megjithëse Trupi Gjykses nuk kishte si të ishte i sigurt për numrin faktik, statusin ose cenueshmërinë e atyre që pretendohet se u “ekspozuan” nga të akuzuarit;⁸⁴⁸ (iii) konstatoi se të akuzuarit e nxorën informacionin “pa dallim”;⁸⁴⁹ (iv) u përqendrua më shumë në peshën e dënimeve përkatëse me heqje

⁸⁴⁵ *Shih* Aktgjykimin, para. 911. *Shih gjithashtu* Komentari Salihu dhe të tjerët, nenin 13 të KPK-së të vitit 2012, komenti 10(b)(3), f. 59 (aty ku autorët e komentarit shprehen se, në përgjithësi, të mirat juridike të natyrës personale janë më të vlefshme se të mirat e tjera juridike).

⁸⁴⁶ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 145-155. Në Dosjen e Kundërpërgjigjes, Haradinaj vë në dukje se “sa i takon Pikën 14, moskryerjen e hetimeve për veprimet e papërshtatshme gjatë hetimeve të ZPS-së [ai] nuk e përfshiu më si nëntitull më vete në apel, sepse ajo është një temë e përsëritur që përshkon të gjithë çështjen gjyqësore”. Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 37.

⁸⁴⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 147(a).

⁸⁴⁸ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 147(c).

⁸⁴⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 147(d).

lirie se sa në peshën e veprimeve të të akuzuarve;⁸⁵⁰ dhe (v) nuk përmendi ndikimin më të madh që pati në besimin e publikut rrjedhja e dokumenteve nga ZPS-ja.⁸⁵¹

386. Haradinaj argumenton gjithashtu se, edhe nëse të akuzuarit do ta kishin kryer veprën penale për të cilën u shpallën fajtorë në bazë të nenit 392(1) të KPK-së, kjo vepër penale gjithsesi do të ishte e një rëndësie të vogël sepse fshehtësia e informacionit të mbrojtur ishte shkelur para se ky informacion t'u jepej atyre dhe se, për rrjedhojë, veprimet e të akuzuarit shkaktuan një dëm të shkallës së vogël.⁸⁵²

387. ZPS-ja përgjigjet se, duke marrë parasysh ndryshimin ndërmjet Njoftimit për Apel të Haradinajt dhe Dosjes së Apelit të Haradinajt, ajo vlerëson se Haradinaj ka vendosur të mos i ndjekë temat që ngriti fillimisht në Pikën 14 të Njoftimit për Apel dhe se ato mund të rrëzohen *in limine*.⁸⁵³ Në lidhje me përmbajtjen, ZPS-ja parashton se: (i) Trupi Gjykses e rrëzoi argumentin mbrojtës të veprave të rëndësisë së vogël në bazë të disa faktorëve relevantë, të cilët Haradinaj i kundërshton pa dhënë asnjë arsye;⁸⁵⁴ dhe (ii) Haradinaj nuk citon asnjë provë për të mbështetur pretendimin e tij se “një numër personash që thuhej se ishin të mbrojtur dhe të cilët, për rrjedhojë, ‘u ekspozuan’ nga nxjerrja e dokumenteve prej parashtruesit të apelit, në fakt njihen nga publiku” dhe ZPS-ja asnjëherë nuk ka konfirmuar nëse ndonjë person ishte apo nuk ishte dëshmitar në hetimet e saj.⁸⁵⁵

⁸⁵⁰ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 147(b).

⁸⁵¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 147(e).

⁸⁵² Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 151-155; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 39.

⁸⁵³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 150-151. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 156-157.

⁸⁵⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 152, 154, që i referohet Aktgjykimit, para. 924-925. Paneli mban parasysh edhe argumentin e ZPS-së se Haradinaj kërkon të mbështetet në mënyrë të palejueshme në një material që nuk u pranua si provë. *Shih* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 154, që i referohet Dosjes së Apelit të Haradinajt, poshtëshënimi 141.

⁸⁵⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 153.

(c) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

388. Paneli thekson se Pika 15 e Njoftimit për Apel të Haradinajt kufizohet në argumentimin se ajo pjesë e informacionit në atë kohë ishte në sferën publike, pas rrjedhjes nga ZPS-ja.⁸⁵⁶ Sidoqoftë, ky argument është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme me parashtrime të mëtejshme në Pikat 14 dhe 15 të Apelit të Haradinajt. Paneli rikujton se të akuzuarit nuk janë të lirë të bëjnë ndryshime në njoftimet e tyre për apel pa lejen paraprake të Panelit të Apelit.⁸⁵⁷ Siç është shpjeguar tashmë,⁸⁵⁸ për të qenë i drejtë me të akuzuarit, Paneli vendosi t'i merrte parasysh parashtrimet e Haradinajt, për aq sa ishte e mundshme, kurdo që ato janë artikuluar në mënyrën e duhur.⁸⁵⁹

389. Trupi Gjykues konstatoi se, duke pasur parasysh rëndësinë e veprimeve dhe të deklaratave të të akuzuarve, rreziku i shkaktuar nga sjellja e tyre nuk mund të konsiderohej i parëndësishëm⁸⁶⁰ dhe, rrjedhimisht, përgjegjësia penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohej në bazë të argumentit mbrojtës të veprës me rëndësi të vogël brenda kuptimit të nenit 11 të KPK-së.⁸⁶¹ Paneli vëren se Trupi Gjykues shqyrtoi dhe rrëzoi qartazi pretendimin e Mbrojtjes se informacioni i nxjerrë nga të akuzuarit në kohën kur ndodhën ngjarjet ishte në atë kohë në sferën publike, pas rrjedhjes së pretenduar nga ZPS-ja. Në veçanti, Trupi Gjykues konstatoi se “nuk i është paraqitur asnjë provë se ndonjë pjesë e tri grupeve të dokumenteve, përveç dokumenteve

⁸⁵⁶ Njoftimi për Apel i Haradinajt, para. 19.

⁸⁵⁷ *Shih më lart*, para. 30.

⁸⁵⁸ *Shih më lart*, para. 314.

⁸⁵⁹ Paneli i referohet pretendimit të Haradinajt se Trupi Gjykues gaboi që u përqendrua në peshën e dënimeve me heqje lirie të dhëna dhe jo në peshën e veprimeve të të akuzuarit. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 147(b). Paneli nuk pajtohet me këtë pretendim dhe i referohet kompetencës së vet për të rrëzuar argumentet e paqarta dhe të pabazuara. *Shih më lart*, para. 29, 32. Paneli në vijim i referohet pretendimit të Haradinajt se Trupi Gjykues gaboi që nuk përmendi ndikimin më të madh që pati në besimin e publikut rrjedhja e dokumenteve nga ZPS-ja. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 147(e). Paneli i referohet kompetencës së vet për të rrëzuar argumentet të cilat nuk kanë gjasa të çojnë në prapësimin e vendimit të apeluar. *Shih më lart*, para. 31.

⁸⁶⁰ Aktgjykimi, para. 925.

⁸⁶¹ Aktgjykimi, para. 926.

publike të [paketës së dytë, nga tri grupet e dokumenteve] ishte tashmë në sferën publike”.⁸⁶²

390. Në lidhje me argumentin e Haradinajt se një numër personash ishin të njohur publikisht në Kosovë si dëshmitarë ose dëshmitarë të mundshëm në kohën që lidhet me akuzat,⁸⁶³ Paneli konstaton se kjo në vetvete nuk e bënte të qenësishme veprën penale të kryer nga i akuzuari. Mosbindja ndaj gjykatës është një vepër e rëndë penale, që përbën një sfidë të drejtpërdrejtë ndaj integritetit të procesit gjyqësor,⁸⁶⁴ veçanërisht në rrethanat aktuale, ku u konstatua se Haradinaj kishte zbuluar qindra dokumente që përmbanin informacion të mbrojtur, produkte të punës së brendshme të ZPS-së, si dhe emra dhe të dhëna personale të qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.⁸⁶⁵

391. Sa i takon argumentit të Haradinajt se Trupi Gjyqësor nuk mund të ishte i sigurt për numrin faktik, statusin ose cenueshmërinë e atyre që pretendohet se u “eksponuan” nga nxjerrja e dokumenteve prej të akuzuarve, Paneli thekson se Haradinaj nuk e shtjellon këtë argument por vetëm i referohet Pikës 8 të Dosjes së Apelit të tij.⁸⁶⁶ Edhe vetëm kjo do të përlligjte hedhjen poshtë menjëherë të këtij argumenti. Gjithsesi, argumenti i Haradinajt është i pathemeltë pasi, sipas Panelit, edhe nxjerrja e emrit të një dëshmitari ose dëshmitari të mundshëm do t’i bënte “të qenësishme” pasojat e veprimit të Haradinajt sipas nenit 11 të KPK-së.

392. Lidhur me argumentin e Haradinajt se Trupi Gjyqësor gaboi që konstatoi se ai e kishte nxjerrë informacionin pa dallim, kurse ai në fakt u përpoq t’i paralajmëronte gazetarët që të mos i publikonin emrat e dëshmitarëve,⁸⁶⁷ Paneli vëren se ky argument

⁸⁶² Aktgjykimi, para. 488.

⁸⁶³ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 147(a).

⁸⁶⁴ *Nzabonimpa et al.* Trial Judgement, para. 397.

⁸⁶⁵ *Shih p.sh.*, Aktgjykimin, para. 989. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 335-355.

⁸⁶⁶ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 147(c).

⁸⁶⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 147(d).

bazohet në mënyrë të pasaktë në një material që nuk është pranuar si provë,⁸⁶⁸ dhe pajtohet me konstatimin e Trupit Gjykses se gazetarët ose shtypi janë anëtarë të publikut sipas nenit 392(1) të KPK-së, që trajton shkeljen e fshehtësisë së procedurës.⁸⁶⁹

393. Paneli në vijim rrëzon argumentin e pabazuar të Haradinajt se shkelja e mëhershme e konfidencialitetit të informacionit të mbrojtur bënte që veprimet e të akuzuarve të kishin rëndësi më të vogël, për arsyet e mëposhtme: (i) argumenti i Haradinajt është hipotetik; dhe (ii) që të dy të akuzuarit i kanë përshkruar vazhdimisht dokumentet si konfidenciale.⁸⁷⁰

394. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Haradinaj nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykses gaboi që rrëzoi argumentin mbrojtës të veprës së rëndësishme së vogël. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikat 14 dhe 15 të Apelit të Haradinajt.

H. PRETENDIMET PËR GABIME NË LIDHJE ME PËRCAKTIMIN E DËNIMIT (PIKA 20 E APELIT TË GUCATIT; PIKA 24 E APELIT TË HARADINAJT)

395. Në përcaktimin e dënimit për të akuzuarit, Trupi Gjykses vuri në dukje se zbatoi dispozitat e nenit 44(4)-(5) të Ligjit dhe të rregullave 163 dhe 165 të Rregullores, dhe “u mbështet edhe në dispozita të tjera përkatëse të legjislacionit të Kosovës si dhe në jurisprudencën e gjykatave/tribunalëve ndërkombëtarë”.⁸⁷¹ Trupi Gjykses më tej theksoi se shqyrtoi të gjithë faktorët relevantë dhe e përshtati secilin dënim për të pasqyruar peshën e veprave penale të paraqitura në Aktakuzë, llojin dhe shkallën e

⁸⁶⁸ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 147(d), poshtëshënimi 141.

⁸⁶⁹ Aktgjykimi, para. 484. Trupi Gjykses në vijim konstatoi se “të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për ta zbuluar pa autorizim informacionin e mbrojtur” dhe se “zbulimi i këtij informacioni kryesisht në mediat profesioniste nuk ndikon aspak në këtë konstatim”. *Shih* Aktgjykimin, para. 499.

⁸⁷⁰ Aktgjykimi, para. 488. Gjithashtu, Paneli vëren se Haradinaj keqinterpretonte konstatimet e Trupit Gjykses, i cili askund në Aktgjykim nuk pranon se veprimet e të akuzuarve “në pjesën më të madhe, shkaktojnë dëm në masë të vogël”. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 154, që i referohet Pikës 11 të Apelit, e cila u referohet paragrafëve 547 dhe 551 të Aktgjykimit.

⁸⁷¹ Aktgjykimi, para. 942. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 941, 943-959.

përfshirjes të secilit prej të akuzuarve, si dhe rrethanat individuale të secilit prej të akuzuarve, përfshirë disa faktorë lehtësues.⁸⁷²

396. Mbi këtë bazë, dhe duke marrë parasysh dënimet e zbatueshme për secilën pikë të Aktakuzës, Trupi Gjykses dha dënimet e mëposhtme për secilin të akuzuar, për secilën pikë të Aktakuzës:

- (i) Për Pikën 1 (sipas nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së, tentativë kryerje dhe duke marrë parasysh formën e rëndë) – një vit burgim;
- (ii) Për Pikën 2 (për Gucatin, sipas nenit 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së, tentativë kryerjeje dhe duke marrë parasysh të dyja format e rënda; për Haradinajn, sipas nenit 401(2) dhe (5) të KPK-së, tentativë kryerjeje dhe duke marrë parasysh një formë të rëndë) – një vit burgim;
- (iii) Për Pikën 3 (sipas nenit 387 të KPK-së) –gjobë prej 100 eurosh dhe katër vjet burgim;
- (iv) Për Pikën 5 (sipas nenit 392(1) të KPK-së) – një vit burgim; dhe
- (v) Për Pikën 6 (sipas nenit 392(2)-(3) të KPK-së, përfshirë formën e rëndë) – dy vjet burgim.⁸⁷³

397. Bazuar në këto dënime individuale dhe në pajtim me rregullën 163(4) të Rregullores, Trupi Gjykses më pas përcaktoi një dënim të njësuar për secilin nga të akuzuarit, që duhet të pasqyrojë tërësinë e sjelljes kriminale por gjithsesi nuk duhet të jetë më pak i rëndë se dënimi më i rëndë individual i përcaktuar për secilën akuzë.⁸⁷⁴ Në përcaktimin e dënimit të njësuar, Trupi Gjykses mori gjithashtu parasysh faktin se të akuzuarit “u shpallën fajtorë për të dy [Pikat 1 dhe 2] të Aktakuzës dhe se [ata]

⁸⁷² *Shih* Aktgjykimin, para. 960-980, 987-1005.

⁸⁷³ *Shih* Aktgjykimin, para. 980-982, 1005-1008.

⁸⁷⁴ *Shih* Aktgjykimin, para. 956.

mund të ishin shpallur fajtorë vetëm për një nga këto pika sipas një sistemi të ndryshëm për fajësinë e shumëfishtë”.⁸⁷⁵ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses dënoi Gucatin dhe Haradinajn me një dënim të njësuar prej katër vjetësh e gjysmë burgim secilin, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një gjobë prej 100 eurosh.⁸⁷⁶

398. Gucati dhe Haradinaj kundërshtojnë konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me dënimin.⁸⁷⁷ ZPS-ja përgjigjet se të akuzuarit nuk arrijnë të provojnë ndonjë gabim në dënimet e dhëna dhe se apelet e tyre duhet të rrëzohen.⁸⁷⁸

1. Pretendimet për gabime në lidhje me vlerësimin e peshës së veprave penale dhe faktorëve të tjerë në përcaktimin e dënimit

(a) Parashtrimet e palëve

399. Së pari, Gucati parashtron se Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e peshës së krimeve gjatë përcaktimit të dënimit.⁸⁷⁹ Konkretisht, ai argumenton se Trupi Gjykses nuk konstatoi se Gucati përdori “kërcënimin e rëndë për përdorim të forcës”,⁸⁸⁰ as se ai synoi t’i shkaktonte dëm real ndonjë dëshmitari ose dëshmitari të mundshëm.⁸⁸¹ Gucati në vijim argumenton se në dënim duhej të ishin pasqyruar konstatimet e Trupit Gjykses se (i) Gucati “e zbuloi informacionin kryesisht vetëm në mediat

⁸⁷⁵ Aktgjykimi, para. 983, 1008. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 165-170.

⁸⁷⁶ Aktgjykimi, para. 982, 984-985, 1008-1010. Trupi Gjykses vuri në dukje se në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës, neni 387 i KPK-së kërkon vendosjen e një gjobe dhe se “duke mbajtur parasysh se efekti ndëshkues apo parandalues i gjobës në këtë çështje do të ishte i vogël, Trupi Gjykses është i mendimit se një shumë simbolike prej **100 eurosh** është e përshtatshme”. *Shih* Aktgjykimin, para. 982, 1008.

⁸⁷⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 393-427; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 209-235; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 88-95; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 58-59.

⁸⁷⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 162-190.

⁸⁷⁹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 393; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 61, 68. *Shih gjithashtu* Njoftimin për Apel të Gucatit, Pika 20, f. 19-20.

⁸⁸⁰ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 394, ku Gucati argumenton se nga konstatimet e Trupit Gjykses nuk del se ka pasur kërcënim të rëndë për përdorim të forcës, pasi në këto konstatime thuhet vetëm se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarit përbënin “kërcënim të rëndë”. *Shih* Aktgjykimin, para. 585. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 61-62.

⁸⁸¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 395; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 61-62.

profesioniste” dhe se (ii) ai nuk synonte të pengonte ndonjë gjykatës të Dhomave të Specializuara.⁸⁸²

400. Gjithashtu, Gucati parashtron se, duke qenë se dëmi është tregues kryesor i peshës së krimeve, Trupi Gjykues nuk i dha peshë të mjaftueshme në përcaktimin e dënimit, konstatimit të vet se hetimeve nuk u ishte shkaktuar ndonjë dëm faktik.⁸⁸³ Konkretisht, Gucati argumenton se Trupi Gjykues konstatoi se vetëm pak persona kishin pasur faktikisht pasoja që përbënin “cenim thelbësor”.⁸⁸⁴ Megjithatë, sipas tij, fakti që personi i identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit e bëri publik bashkëpunimin e tij me prokurorët ishte faktor lehtësues, të cilin Trupi Gjykues nuk e mori parasysh.⁸⁸⁵ Gucati gjithashtu argumenton se Trupi Gjykues gaboi në lidhje me Pikën 2(A)(a) dhe (b) të Apelit të tij, sepse nuk përjashtoi provat lidhur me përmbajtjen e paketave dhe se ishte e padrejtë që Trupi Gjykues ta dënonte atë mbi bazën se ishin zbuluar emrat dhe të dhënat personale të “qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm”, ndërkohë që “në prova identifikoheshin në fakt vetëm gjashtë ‘dëshmitarë’”.⁸⁸⁶

401. Gjithashtu, sipas Gucatit, Trupi Gjykues bëri një gabim të dallueshëm në përcaktimin e dënimit, sepse nuk pasqyrooi në të rolet përkatëse të dy të akuzuarve në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës.⁸⁸⁷ Gucati argumenton se, duke pasur parasysh konstatimet e Trupit Gjykues se Gucati, në dallim nga Haradinaj, nuk përmendi

⁸⁸² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 396-397; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 93; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 61-62.

⁸⁸³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 400-402. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 398-399; Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 61-63.

⁸⁸⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 404. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 403, 405; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 94; Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 64-65. Gucati i referohet: (i) personit të identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit; (ii) dy personave të zhvendosur; dhe (iii) “rreth 20-30 personave që ishin objekt i masave të tjera të sigurisë”. *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 404. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 538.

⁸⁸⁵ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 406; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 94-95; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 64.

⁸⁸⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 407-410. *Shih më lart*, para. 60-61, 231-233.

⁸⁸⁷ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 411.

publikisht me emër ndonjë dëshmitar dhe mori pjesë në më pak paraqitje në media se Haradinaj, Trupi Gjykses gaboi që dha të njëjtën masë dënimi për të dy të akuzuarit në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës.⁸⁸⁸

402. Haradinaj argumenton se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se në kohën për të cilën u ngritën akuzat kundër të akuzuarve, në Kosovë ekzistonte një “atmosferë e frikësimit të dëshmitarëve”, dhe që e përdori këtë si faktor rëndues për t’ia shtuar dënimin, kur nuk u paraqit asnjë provë që vërtetonte ekzistencën e një atmosfere të tillë.⁸⁸⁹ Gjithashtu, Haradinaj pretendon se Trupi Gjykses gaboi që nuk bëri dallimin midis çfarë konsideronte “kriminale” dhe rasteve kur Haradinaj kishte “ushtruar të drejtën e tij legjitime të lirisë së fjalës dhe të shprehjes”, dhe u duk se i përdori këto raste si faktorë rëndues në përcaktimin e dënimit për të.⁸⁹⁰

403. Konkretisht, Haradinaj argumenton se Trupi Gjykses gaboi që nuk mori parasysh në përcaktimin e dënimit faktin se ZPS-ja e shprehu qartë qëndrimin e vet se as z. Berisha, e as ndonjë gazetar tjetër nuk kishte kryer vepër penale me publikimin e dokumenteve, që lë të kuptohet se ZPS-ja nuk e konsideronte të fshehtë informacionin që përmbanin ato.⁸⁹¹

404. ZPS-ja përgjigjet se të dy të akuzuarit përgjithësisht nuk arrijnë të shpjegojnë se si ndikojnë këto gabime të pretenduara në dënimin e dhënë dhe as nuk demonstron se si ka dalë Trupi Gjykses jashtë kuadrit të “kompetencave diskrecionale” në dhënien e dënimit.⁸⁹² Lidhur me kundërshtimet e të akuzuarve ndaj vlerësimit prej Trupit Gjykses të peshës së krimeve, ZPS-ja parashtron se Trupi Gjykses mori parasysh

⁸⁸⁸ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 412-419.

⁸⁸⁹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 209-216.

⁸⁹⁰ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 209, 217-222. Haradinaj argumenton se, në fakt, Trupi Gjykses konstatoi se të akuzuarit u lejuan të ushtronin lirinë e fjalës dhe, rrjedhimisht, paraqitjet e tij në media nuk duhej të konsideroheshin kriminale ose të përdreshin si faktorë rëndues. *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 220, që i referohet paragrafit 822 të Aktgjykimit.

⁸⁹¹ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 209, 232.

⁸⁹² Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 164; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 167-168, 170. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 162-163.

faktorët relevantë, ndër të cilët, llojin, vëllimin dhe shkallën e informacionit të nxjerrë nga të akuzuarit, dhe konstatoi se krimet e kryera ishin të rënda.⁸⁹³ Sipas ZPS-së, Gucati shpërfill konstatimet e Trupit Gjykses për nivelin e synimit të tij, si dhe sasinë e informacionit që zbuloi Gucati pa dallim dhe pa autorizim, që ishte “në sasi të madhe” dhe “i shpërndarë gjerësisht”.⁸⁹⁴ Lidhur me argumentin e Gucatit se fakti që personi i identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit bëri publik bashkëpunimin e tij me ZPS-në duhej të ishte marrë parasysh për zbutjen e dënimit, ZPS-ja përgjigjet se ky argument duhet të rrëzohet *in limine* pasi nuk u trajtua në gjykim dhe, sidoqoftë, kjo nuk do t'i kishte hequr mbrojtjen atij personi.⁸⁹⁵

405. Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Gucati nuk arrin të provojë gabim në dënimin e përcaktuar nga Trupit Gjykses në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës dhe se argumenti i Gucatit se Trupi Gjykses u përqendrua te sjellja e Haradinajt, por i dënoi të dy të akuzuarit mbi atë bazë, është i pasaktë dhe keqinterpreton konstatimet përkatëse.⁸⁹⁶ Sipas ZPS-së, Trupi Gjykses shqiptoi dënime të arsyetuara mirë si për Gucatin ashtu edhe për Haradinajn, të cilat pasqyrojnë tërësinë e sjelljes së tyre kriminale.⁸⁹⁷

406. ZPS-ja përgjigjet gjithashtu se Haradinaj nuk arrin të provojë se Trupi Gjykses gaboi që mori parasysh atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë gjatë periudhës përkatëse,⁸⁹⁸ dhe saktëson se Trupi Gjykses nuk e konsideroi atë si faktor rëndues, por e vuri në dukje në kontekstin e vlerësimit të peshës së veprave penale.⁸⁹⁹ Lidhur me argumentin e Haradinajt se Trupi Gjykses gaboi që në dhënien e dënimit u mbështet në shembujt e ushtrimit nga Haradinaj të së drejtës së tij legjitime të lirisë

⁸⁹³ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 179-180; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 168-170.

⁸⁹⁴ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 181-183. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 169-170.

⁸⁹⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 184.

⁸⁹⁶ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 186-187. *Shih gjithashtu*, Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 170.

⁸⁹⁷ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 188, 190. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 189.

⁸⁹⁸ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 165-166. *Shih gjithashtu*, Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 170.

⁸⁹⁹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 167.

së fjalës dhe të shprehjes, ZPS-ja parashtron se Haradinaj nuk përmend as edhe një rast të vetëm të kësaj mbështetjeje të pretenduar të Trupit Gjykses dhe se në Aktgjykim nuk ka asgjë që të sugjerojë se paraqitjet e Haradinajt në programet në media ishin në vetvete kriminale, ose se atyre iu dha peshë e veçantë në përcaktimin e dënimit.⁹⁰⁰

407. Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se Haradinaj nuk artikulon arsyet e as nuk vërteton se është bërë gabim lidhur me faktin se në këtë çështje nuk u akuzuan persona të tjerë, ndër të cilët z. Berisha.⁹⁰¹

408. Gucati kundërpërgjigjet se asnjë nga pjesët e Aktgjykimit që përmend ZPS-ja nuk është në kundërshtim me pretendimin e tij që Trupi Gjykses nuk konstatoi se ai synonte t'i shkaktohej dëm konkret ndonjë dëshmitari.⁹⁰² Së fundi, Gucati kundërpërgjigjet se në kohën kur "ai duhej të bënte parashtrime lidhur me zbutjen e dënimit", ai nuk e dinte se Trupi Gjykses do të konstatonte se personi i identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit ishte frikësuar ngaqë ishte përmendur publikisht me emër.⁹⁰³

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

409. Në bazë të nenit 44(4) të Ligjit, dënimi i shqiptuar kundër personave të shpallur fajtorë për krimet sipas nenit 15(2) të Ligjit duhet të jetë në përputhje me dënimet për krimet e përcaktuara në Kodin Penal të Kosovës. Sipas nenit 44(5) të Ligjit, në dhënien e dënimit, Dhomat e Specializuara marrin parasysh faktorët rëndues dhe lehtësues, përfshirë peshën e krimit dhe pasojat e tij, si dhe rrethanat individuale të personit të

⁹⁰⁰ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 168-169.

⁹⁰¹ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 177-178.

⁹⁰² Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 92, që i referohet paragrafit 395 të Dosjes së Apelit të Gucatit, para. 395; Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, poshtëshënimi 442.

⁹⁰³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 95. *Shih* Aktgjykimin, para. 538.

dënuar. Gjithashtu, rregulla 163(1) e Rregullores përcakton se Trupi Gjykses balancon faktorët rëndues dhe lehtësues të përmendur në nenin 44(5) të Ligjit.

410. Paneli i Apelit rikujton se, sipas jurisprudencës penale ndërkombëtare, qëllimet parësore të dënimit janë parandalimi dhe ndëshkimi dhe rehabilitimi është i rëndësishëm, por nuk duhet të luajë rol mbizotërues.⁹⁰⁴ Paneli gjithashtu thekson se “peshë e veprës penale është faktori kryesor [...] në përcaktimin e dënimit”⁹⁰⁵ dhe “një dënim proporcional me peshën e sjelljes kriminale përmban pashmangshmërisht në vetvete edhe ndëshkimin dhe parandalimin e duhur”.⁹⁰⁶ Gjithashtu, Paneli thekson se neni 38(1) i KPK-së, i cili përqendrohet më tepër në rehabilitimin dhe parandalimin, dhe jo shprehimisht në ndëshkimin, përcakton se:

Qëllimet e dënimit janë:

1.1. të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij;

1.2. të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale;

1.3. të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe

1.4. të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.⁹⁰⁷

411. Në këtë aspekt, Paneli thekson se, për arritjen e synimit të parandalimit, masa e dënimit duhet të jetë e tillë që të shkurajojë përsëritjen e krimit nga personi i dënuar (parandalimi individual), si dhe të synojë të shkurajojë kryes të tjerë të mundshëm nga

⁹⁰⁴ *Stakić* Appeal Judgement, para. 402; *Deronjić* Sentencing Appeal Judgement, para. 136; *Kordić and Čerkez* Appeal Judgement, para. 1079; *Čelebići* Appeal Judgement, paras 805-806. *Shih gjithashtu Bemba et al.* Sentencing Appeal Judgment, para. 205; Fife, R. E., in *Ambos Rome Statute Commentary*, Article 77, mn 3.

⁹⁰⁵ *Hadžihasanović and Kubura* Appeal Judgement, para. 321, ku citohet *Musema* Appeal Judgement, para. 382; *Nahimana et al.* Appeal Judgement, para. 1038, dhe jurisprudencën e cituar në të; *Rutaganda* Appeal Judgement, para. 591; *Bemba* Sentencing Decision, para. 15. *Shih gjithashtu Kordić and Čerkez* Appeal Judgement, para. 1079.

⁹⁰⁶ *Krajišnik* Appeal Judgement, para. 777. *Shih gjithashtu Stakić* Appeal Judgement, para. 402; *Deronjić* Sentencing Appeal Judgement, para. 136; *Čelebići* Appeal Judgement, paras 805-806.

⁹⁰⁷ *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 938.

kryerja e krimeve të njëjta apo të ngjashme (parandalimi i përgjithshëm).⁹⁰⁸ Ndëshkimi duhet kuptuar si imponim i dënimit të duhur që pasqyron fajësinë e personit të dënuar, por nuk duhet të shprehë hakmarrje apo shpagim.⁹⁰⁹ Rehabilitimi përqendrohet në riintegrimin e personit të dënuar në shoqëri.⁹¹⁰

412. Trupi Gjykses mbajti parasysh se “qëllimi parësor i përcaktimit të dënimit është të sigurojë që dënimi përfundimtar të pasqyrojë tërësinë e sjelljes kriminale dhe tërësinë e fajësisë së personit të shpallur fajtor”.⁹¹¹

413. Paneli i Apelit thekson se apelet kundër dënimit janë apele *stricto sensu*, që do të thotë se ato janë korrigjuese.⁹¹² Paneli i Apelit rikujton se trupat gjykses kanë kompetenca diskrecionale në përcaktimin e dënimit të duhur, ndër të tjera, edhe në përshtatjen e dënimit me qëllim që të pasqyrojë peshën e krimeve, shkallën e përfshirjes së të akuzuarve në kryerjen e veprave penale, si dhe rrethanat e tyre individuale.⁹¹³

414. Paneli i Apelit nuk e zëvendëson dënimin e dhënë nga Trupi Gjykses me një dënim të vetin, përveç nëse pala apeluese demonstroi se Trupi Gjykses ka kryer një gabim të dallueshëm në ushtrimin e diskrecionit, ose nuk ka respektuar dispozitat

⁹⁰⁸ *Shih p.sh., Krajišnik Appeal Judgement*, paras 776, 805; *Bemba Sentencing Decision*, para. 11. *Shih gjithashtu Aktgjykimin*, para. 938.

⁹⁰⁹ *Kordić and Čerkez Appeal Judgement*, para. 1075; *Bemba Sentencing Decision*, para. 11. *Shih gjithashtu Aktgjykimin*, para. 938.

⁹¹⁰ *Murray Judgment*, para. 102. *Shih* nenin 10(3) të KNDCP-së. *Shih gjithashtu Aktgjykimin*, para. 938-939, ku Trupi Gjykses thekson se pavarësisht se rehabilitimi luan rol të kufizuar në dënimet e shqiptuara në gjykatat dhe tribunalët ndërkombëtarë, [Trupi Gjykses] e konsideron rehabilitimin faktor relevant për dënimin, pasi të akuzuarit akuzohen për vepra penale sipas legjisllacionit të Kosovës. *Shih gjithashtu p.sh., Bemba et al. Sentencing Appeal Judgment*, para. 205.

⁹¹¹ *Shih Aktgjykimin*, para. 939, që i referohet *Stanišić and Simatović Trial Judgment*, para. 611; *Mladić Appeal Judgment*, para. 545; *Martić Appeal Judgment*, para. 350; *Čelebići Appeal Judgment*, para. 430.

⁹¹² *Shih p.sh., Šešelj Sentencing Appeal Judgment*, para. 17; *Rašić Appeal Judgment*, para. 9.

⁹¹³ *Shih p.sh., Lubanga Sentencing Appeal Judgment*, paras 34, 40; *Krajišnik Appeal Judgment*, para. 734; *Šešelj Sentencing Appeal Judgment*, para. 17; *Rašić Appeal Judgment*, para. 9. *Shih gjithashtu Aktgjykimin*, para. 956.

ligjore përkatëse.⁹¹⁴ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit ndërhyr në ushtrimin e kompetencës diskrecionale të Trupit Gjykes vetëm kur dënimi i shqiptuar: (i) është bazuar në një interpretim të pasaktë të ligjit në fuqi; (ii) është bazuar në një përfundim faktik qartësisht të pasaktë; ose (iii) është kaq i padrejtë apo i paarsyeshëm sa që përbën shpërdorim të kompetencës diskrecionale. Në këtë aspekt, Paneli i Apelit gjithashtu do të shqyrtojë nëse, gjatë marrjes së vendimit për dënimin, Trupi Gjykes u ka dhënë peshë aspekteve të jashtme ose jorelevante, ose nuk u ka dhënë peshë apo u ka dhënë peshë të pamjaftueshme faktorëve relevantë.⁹¹⁵

415. Fillimisht, Paneli do të trajtojë kundërshtimet e Gucatit për sa i përket vlerësimit që Trupit Gjykes i bëri peshës së veprave penale në konstatimet e tij në lidhje me dënimin. Paneli vëren se Trupi Gjykes, “kur vlerësoi peshën e veprave penale kundër administrimit të drejtësisë”, shqyrtoi llojin dhe kuadrin e veprave penale dhe rrethana të tjera relevante për çështjen.⁹¹⁶ Trupi Gjykes konstatoi se veprat penale të kryera nga të akuzuarit përfshinin, ndër të tjera, shpërndarjen “në mënyrë flagrante në shkallë të gjerë” të qindra dokumenteve që përmbanin informacion të mbrojtur, ndër të cilat dhe dokumente ku përmendeshin emrat dhe/ose të dhënat e qindra dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm, në një mënyrë të tillë që pasojat përfundimtare apo shkalla e shpërndarjes së tyre është e panjohur.⁹¹⁷ Gjithashtu, në përcaktimin e dënimit Trupi Gjykes mori parasysh se zbulimi i informacionit të

⁹¹⁴ *Shih Šešelj Sentencing Appeal Judgement*, para. 17; *Rašić Appeal Judgement*, para. 9. Lidhur me gabimet e pretenduara në ushtrimin e diskrecionit, *shih* Vendimin e Apelit mbi Arrestimin dhe Paraburgimin e Gucatit, para. 14.

⁹¹⁵ *Shih* Vendimin e Apelit mbi Arrestimin dhe Paraburgimin e Gucatit, para. 14. *Shih gjithashtu Šešelj Sentencing Appeal Judgement*, para. 18; *Rašić Appeal Judgement*, para. 10; *Fatuma et al. Appeal Judgement*, para. 63, ku citohet *Mladić Appeal Judgement*, para. 539; *Karadžić Appeal Judgement*, para. 749; *Ngirabatware Appeal Judgement*, para. 255; *Bemba et al. Sentencing Appeal Judgment*, para. 22, ku citohet *Kenyatta Appeal Decision on Non-Compliance*, paras 22-25.

⁹¹⁶ *Shih* Aktgjykimin, para. 951, 962-969, 973, 987-994, 998.

⁹¹⁷ Aktgjykimi, para. 963-966, 979, 988-991, 1004. Trupi Gjykes konstatoi se fakti që zbulimi i informacionit të mbrojtur u diskutua në mënyrë të përsëritur në paraqitjet televizive apo në mediat në internet dhe në postime në *Facebook*, e shtoi më tej numrin e personave të panjohur të cilët u shpërndanë informacioni, dhe konstatoi se kjo rrëzonte argumentin e të akuzuarve se informacioni iu zbulua vetëm gazetarëve dhe mediave profesionale. *Shih* Aktgjykimin, para. 967, 992.

mbrojtur u krye përmes përdorimit të një “platforme organizative” dhe paraqitjesh për median, ku u demonstrua “sjellje e përsëritur dhe betime të vazhdueshme se do të kryenin përsëri të njëjtat vepra penale”, “shoqëruar me komente nënçmuese ndaj dëshmitarëve në një atmosferë të frikësimit të dëshmitarëve”.⁹¹⁸

416. Në lidhje me peshën e veprave penale, Trupi Gjykses mori parasysht edhe se “shkalla e lartë dhe shtrirja e zbulimit të informacionit të mbrojtur mund të shkurajonte angazhimin apo vazhdimin e angazhimit të dëshmitarëve në hetimet apo proceset gjyqësore të ZPS-së [Dhomave të Specializuara]”, si edhe mund të pengonte përmbushjen e mandatit të tyre.⁹¹⁹ Gjithashtu, në kuadër të vlerësimit të peshës së veprave penale, Trupi Gjykses analizoi edhe peshën e ndikimit të veprimeve të të akuzuarve mbi viktimat e krimeve nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe mundësinë që atyre t’u mohohet e drejta për të ditur të vërtetën dhe e drejta për qasje në drejtësi, dhe vuri në dukje në veçanti se këto veprime “u kryen në një atmosferë mbizotëruese dhe afatgjatë të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë”.⁹²⁰

417. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit vlerëson se Trupi Gjykses nuk gaboi në konstatimet e veta lidhur me peshën e veprave penale dhe shkallën e kryerjes së tyre nga i akuzuari. Konkretisht, në lidhje me argumentin se në vlerësimin e peshës së veprave penale, Trupi Gjykses nuk mori parasysht se “nuk pati asnjë konstatim se [Gucati] përdori kërcënimin e rëndë për të përdorur forcë”,⁹²¹ Paneli i Apelit fillimisht rikujton konstatimin e vet më sipër se termi “kërcënim i rëndë” përfshin jo vetëm kërcënimin për të përdorur forcën, por edhe çdo kërcënim për veprim të dëmshëm, dhe se Trupi Gjykses nuk gaboi në konstatimet e veta lidhur me këtë aspekt.⁹²² Paneli i Apelit në vijim thekson se, në përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykses e mori parasysht

⁹¹⁸ Aktgjykimi, para. 979, 1004.

⁹¹⁹ Aktgjykimi, para. 968, 993.

⁹²⁰ Aktgjykimi, para. 968, 993.

⁹²¹ *Shih* Dosjen e Apelit të Guccatit, para. 394.

⁹²² *Shih më lart*, para. 224-226, 278-280.

faktin se i akuzuari nuk bëri asnjë kërcënim të drejtpërdrejtë me vdekje apo lëndim të rëndë.⁹²³ Paneli gjykon se Trupi Gjykses e vlerësoi drejt peshën e sjelljes së të akuzuarit në këtë aspekt.⁹²⁴ Rrjedhimisht, Paneli gjykon se Trupi Gjykses nuk bëri asnjë gabim të dallueshëm në vlerësimin e peshës së veprave penale në lidhje me këtë konstatim.

418. Paneli do të trajtojë në vijim argumentet e Gucatit se, në vlerësimin e peshës së veprave penale, Trupi Gjykses nuk mori parasysh faktin se Gucati e zbuloi informacionin e mbrojtur “kryesisht në mediat profesioniste”, që sipas tij e zvogëlonte rrezikun,⁹²⁵ dhe se ai nuk kishte synimin të pengonte asnjë gjykatës të Dhomave të Specializuara.⁹²⁶ Në lidhje me argumentin e parë, Paneli thekson se, në vlerësimin e peshës së veprave penale, Trupi Gjykses mori parasysh se “provat për shpërndarjen e gjerë të këtij informacioni përmes platformave televizive ose në internet rrëzojnë argumentin e të akuzuarit se informacioni iu zbulua vetëm gazetarëve dhe mediave profesioniste”,⁹²⁷ dhe me tej konstatoi se “zbulimi i kësaj sasive të madhe informacioni u bë pa dallim, pa marrë kurrfarë mase paraprake të efektshme, si për shembull, redaktimi i emrave ose përzgjedhja e informacionit që do të zbulohet, si dhe me një shpërfillje të plotë për pasojat që mund të kishin këto veprime”.⁹²⁸ Paneli i Apelit vlerëson se zbulimi i informacionit të mbrojtur për mediat ishte faktikisht një mënyrë për ta shpërndarë më tej informacionin dhe, përkundrazi, nuk e zvogëloi rrezikun dhe as e bëri sjelljen e të akuzuarit më pak të rëndë. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se, në vlerësimin e peshës së veprave penale në kuadër të përcaktimit të dënimit, Trupi Gjykses nuk gaboi në lidhje me këtë faktor.

⁹²³ *Shih* Aktgjykimin, para. 973, 998.

⁹²⁴ *Shih më poshtë*, para. 432.

⁹²⁵ *Shih* Aktgjykimin, para. 499; Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 396; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 93.

⁹²⁶ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 397 (ku argumenton se, në përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykses nuk mori parasysh se Gucati “nuk kërcënoi drejtpërdrejt asnjë zyrtar të ZPS-së”).

⁹²⁷ Aktgjykimi, para. 967.

⁹²⁸ Aktgjykimi, para. 964.

419. Në lidhje me argumentin e Gucatit se ai nuk synoi të pengonte asnjë gjykatës të Dhomave të Specializuara, Paneli vëren se në vlerësimin e dënimit – lidhur me llojin dhe shkallën e përfshirjes së Gucatit – Trupi Gjykses mbajti parasysh faktin se Gucati nuk bëri kërcënim të drejtpërdrejtë me vdekje apo lëndim të rëndë ndaj dëshmitarëve dhe se ai nuk “kërcënoi drejtpërdrejt asnjë zyrtar të ZPS-së dhe ishte bashkëpunues gjatë sekuestimeve që kreu ZPS-ja”, në përputhje me urdhrat e Gjykatës të Vetëm dhe të ZPS-së.⁹²⁹ Trupi Gjykses konstatoi se “të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për t’i penguar zyrtarët e [Dhomave të Specializuara/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së [Dhomave të Specializuara/ZPS-së]”.⁹³⁰ Paneli vlerëson se Trupi Gjykses e mori parasysh masën e synimit të vërtetuar të Gucatit në përcaktimin e dënimit. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi që nuk mori parasysh në mënyrë konkrete synimin e pretenduar të Gucatit për të mos penguar asnjë gjykatës të Dhomave të Specializuara, kur bëri vlerësimin e peshës së veprave penale.

420. Sa u takon argumenteve të Gucatit në lidhje me Pikën 2(A) të Apelit të tij, përkatësisht, se Trupi Gjykses gaboi që nuk i përjashtoi provat lidhur me përmbajtjen e paketave dhe se ishte e padrejtë që Trupi Gjykses ta dënonte atë mbi atë bazë,⁹³¹ Paneli i Apelit rikujton konstatimin e vet më sipër se Trupi Gjykses nuk gaboi që nuk i përjashtoi provat lidhur me përmbajtjen e Paketave.⁹³² Rrjedhimisht, Paneli i Apelit gjykon se në përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykses i vlerësoi siç duhet faktorët relevantë mbi bazën e provave që iu paraqitën dhe nuk konstaton gabim për sa i takon kundërshtimit të Gucatit.

421. Së fundi, lidhur me argumentin e Gucatit se në përcaktimin e dënimit nuk iu dha peshë e mjaftueshme konstatimit të Trupit Gjykses se hetimeve nuk iu shkaktua

⁹²⁹ Aktgjykimi, para. 973.

⁹³⁰ Aktgjykimi, para. 671. *Shih gjithashtu më lart*, para. 290-291.

⁹³¹ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 407-410.

⁹³² *Shih me lart*, para. 73.

faktikisht dëm,⁹³³ Paneli vëren se Trupi Gjykses, duke marrë parasysh peshën e veprave penale, konstatoi se i kishte peshuar këta faktorë “përkitazi me konstatimin e vet se, në fund të fundit, ZPS-ja nuk arriti të vërtetonte që u pengua faktikisht t’i hetonte apo ndiqte penalisht krimet në mënyrë efektive”.⁹³⁴ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses, sikurse theksohet qartë në arsyetimin e tij, e mori parasysh këtë konstatim në përcaktimin e dënimit të të akuzuarit.

422. Sa i takon parashtrimin të Gucatit se bashkëpunimi publik me ZPS-në i personit të identifikuar në versionin konfidencial të Aktgjykimit duhej të ishte marrë parasysh për zbutjen e dënimit,⁹³⁵ Paneli pajtohet me ZPS-në se, duke qenë se ky argument nuk u ngrit në gjykim, ai duhet të rrëzohet *in limine*.⁹³⁶ Lidhur me këtë, Paneli i Apelit rikujton konstatimin e vet më sipër në pjesën lidhur me Pikën 6 të Aktakuzës, se megjithëse Trupi Gjykses gaboi në konstatimin e vet lidhur me këtë person, gabimi i Trupit Gjykses nuk ka asnjë ndikim në konstatimin e përgjithshëm se në këtë çështje është vërtetuar veprimi i fajshëm sipas nenit 392(3) të KPK-së.⁹³⁷ Paneli gjykon se ky gabim nuk ka ndikim në përcaktimin e dënimit.

423. Në vijim, Paneli do të trajtojë argumentin e Gucatit sipas të cilit Trupi Gjykses gaboi që, në përcaktimin e dënimit, nuk e pasqyroj si duhej rolin konkret të Gucatit, krahasuar me atë të Haradinajt, në kuadër të Pikës 3 të Aktakuzës.⁹³⁸ Së pari, Paneli vëren se në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës, Trupi Gjykses konstatoi, ndër të tjera, se dy të akuzuarit zbuluan identitetet dhe/ose të dhënat personale të “qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm” që përmbante informacioni i mbrojtur, “bënë komente të përsëritura poshtëruese dhe nënçmuese” për dëshmitarët,

⁹³³ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 400-402.

⁹³⁴ Aktgjykimi, para. 969, 994.

⁹³⁵ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 406. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 538.

⁹³⁶ *Shih* Vendimin e Apelit në lidhje me Mocionet Paraprake, para. 15. *Shih gjithashtu* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 184.

⁹³⁷ *Shih më lart*, para. 206.

⁹³⁸ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 411, 413-419.

u betuan në mënyrë të përsëritur se do të bënin publike çfarëdo dokumentesh të tjera të Dhomave të Specializuara/ZPS-së që do të merrnin, dhe nuk morën asnjë masë për të kufizuar shpërndarjen e emrave.⁹³⁹ Paneli gjithashtu vëren se Trupi Gjykses pranoi se, gjatë veprimeve të përsëritura të shpërndarjes së materialit të mbrojtur, Gucati “nuk përmendi në mënyrë publike emrin e asnjë dëshmitari” dhe “mori pjesë në më pak paraqitje në media se z. Haradinaj”.⁹⁴⁰ Trupi Gjykses megjithatë konstatoi se “provat tregojnë se, pavarësisht nga urdhrat për t’i ndaluar ato veprime, z. Gucati i përsëriti ato me vendosmëri të konsiderueshme dhe vazhdimisht u betua se do të vijonte të publikonte materialet e marra prej Dhomave të Specializuara/ZPS-së”.⁹⁴¹ Paneli gjykon se Trupi Gjykses i vlerësoi me kujdes provat dhe të gjithë faktorët relevantë për përcaktimin e dënimit, si edhe rolin e Gucatit në kryerjen e veprave penale, krahasuar me rolin e Haradinajt.⁹⁴² Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Gucati nuk arrin të provojë gabim në përcaktimin e dënimit të tij nga Trupi Gjykses në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës.

424. Sa i takon argumentit të Haradinajt se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se ekzistonte një “atmosferë e frikësimit të dëshmitarëve” në Kosovë dhe se ky ishte faktor rëndues në përcaktimin e dënimit,⁹⁴³ Paneli thekson se Trupi Gjykses nuk e konsideroi atë si faktor rëndues në përcaktimin e dënimit të Haradinajt; përkundrazi, ai ishte vetëm një ndër shumë faktorë që u morën parasysh në vlerësimin e peshës së veprave penale për të cilat Haradinaj u shpall fajtor.⁹⁴⁴ Po kështu, Trupi Gjykses shqyrtoi një numër të madh provash për arritjen e këtij konstatimi në Aktgjykim.⁹⁴⁵ Gjithashtu, Mbrojtja bëri parashtrime konkrete në gjykim lidhur me aspektin nëse kjo

⁹³⁹ *Shih* Aktgjykimin, para. 559, 562, 590. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 561, 563-570; Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 186-187.

⁹⁴⁰ Aktgjykimi, para. 971.

⁹⁴¹ Aktgjykimi, para. 971.

⁹⁴² *Shih* Aktgjykimin, para. 559, 562, 566, 569-575, 590, 971. *Contra* Dosja e Apelit të Gucatit, para. 411, 413.

⁹⁴³ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 209-216.

⁹⁴⁴ *Shih* Aktgjykimin, para. 993. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 987-992.

⁹⁴⁵ *Shih p.sh.*, Aktgjykimin, para. 576-581.

atmosferë ekzistonte dhe Trupi Gjykes konstatoi se këto prova i “hedh[in] poshtë” ato argumente.⁹⁴⁶ Paneli gjykon se Haradinaj nuk provon gabim në konstatimin e Trupit Gjykes dhe, rrjedhimisht, kundërshtimi i tij në lidhje me këtë konstatim rrëzohet.

425. Në vijim, Paneli thekson se Haradinaj nuk citon ndonjë konstatim të Trupit Gjykes në mbështetje të argumentit të tij se Trupi Gjykes gaboi që i konsideroi rastet e ushtrimit prej tij të së drejtës së lirisë së fjalës si faktorë rëndues në përcaktimin e dënimit.⁹⁴⁷ Në mungesë të argumenteve të bazuara dhe konkrete, Paneli nuk do të vijojë më tej me vlerësimin e tyre në apel.⁹⁴⁸ Sidoqoftë, sikurse u konstatua më lart, Paneli pajtohet me vlerësimin e Trupit Gjykes se, ndër të tjera, ndonëse të akuzuarit u lejuan të ushtronin lirinë e fjalës, veprimet e tyre shkuan shumë përtej ushtrimit legjitim të kësaj të drejte kur ata ndërhyjnë rëndë në interesa të tjera legjitime publike të mbrojtura me ligj.⁹⁴⁹

426. Lidhur me parashtrimin e Haradinajt se, në përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykes nuk mori parasysh se ZPS-ja nuk ngriti akuza në këtë çështje kundër z. Berisha apo gazetarëve të tjerë për publikimin e dokumenteve,⁹⁵⁰ Paneli gjykon se ky nuk është pretendim për gabim të bërë nga Trupi Gjykes, por një kundërshtim i nënkuptuar ndaj ushtrimit të diskrecionit prokurorial nga ZPS-ja në këtë çështje, që del jashtë kuadrit të këtij apeli.

⁹⁴⁶ *Shih* Aktgjykimin, para. 579, poshtëshënimi 1228.

⁹⁴⁷ Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 209, 217-222.

⁹⁴⁸ *Shih më lart*, para. 29.

⁹⁴⁹ *Shih më lart*, para. 382, që i referohet paragrafit 822 të Aktgjykimit.

⁹⁵⁰ *Shih* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 209, 232.

2. Pretendimet për gabime lidhur me mosmarrjen parasysh prej Trupit Gjykses të jurisprudencës përkatëse në përcaktimin e dënimit

(a) Parashtrimet e palëve

427. Gucati dhe Haradinaj argumentojnë se përputhshmëria e dënimeve është e rëndësishme dhe se Trupi Gjykses gaboi që refuzoi të merrte parasysh jurisprudencën përkatëse, përfshirë dënimet minimale dhe maksimale të dhëna ndaj personave të shpallur fajtorë për vepra penale të ngjashme, ndonëse të ndryshme, në gjykatat dhe tribunalët penalë ndërkombëtarë.⁹⁵¹ Në veçanti, Gucati parashtron se dënimi me katër vjet e gjysmë burgim ishte në kufirin e sipërm të shkallëzimit të dënimit të paraparë për rastet e “ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve”,⁹⁵² dhe ishte “tejet shproporcional dhe i papërligjshëm.”⁹⁵³

428. Gucati dhe Haradinaj kërkojnë që në rast se apelet kundër dënimeve për një ose më shumë pika të Aktakuzës do të jenë të suksesshme, dënimet të ulen për ta pasqyruar këtë.⁹⁵⁴

⁹⁵¹ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 420-423, që i referohet *Strugar Appeal Judgement*, paras 348-349; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 223-231, që i referohet, ndër të tjera, *Lubanga Sentencing Decision*, para. 12; *Marijačić and Rebić Trial Judgement*; *Jović Trial Judgement*, para. 26; *Al Khayat Sentencing Judgment*. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 63, 65-68, 98-102, ku të akuzuarit u referohen, ndër të tjera, çështjeve gjyqësore *Fatuma et al.*, *Šešelji, Rašić, Bemba et al.*, *Marijačić and Rebić*, *Jović*, *Akhbar and Al Amin*, *Al Jadeed and Al Khayat*. Haradinaj gjithashtu argumenton se dënimet e dhëna në këto çështje ishin ndër dënimet e ulëta të parashikuara për secilin rast. *Shih* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 101-102. Gjithashtu, të akuzuarit argumentojnë se në çështjen në fjalë nuk ekziston asnjë nga rrethanat rënduese të atyre çështjeve. *Shih* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 66, 103. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 425 dhe burimet ligjore të renditura aty, ku Gucati evidenton tiparet dalluese të atyre çështjeve që nuk janë në çështjen aktuale.

⁹⁵² Dosja e Apelit të Gucatit, para. 424, që i referohet *Fatuma et al. Appeal Judgement*, Partially Dissenting Opinion of Judge Orić; Shtojca 3 e Apelit të Gucatit. *Shih gjithashtu* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 63, 65-68, ku Gucati parashtron se dënimet në çështje gjyqësore të mëhershme shkojnë nga dënimi më i ulët, gjoba, deri te dënimi më i lartë me dy vjet burgim.

⁹⁵³ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 425-426; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 91; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 68; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 195. Haradinaj gjithashtu argumenton se dënimi është “qartësisht i tepruar”. *Shih* Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 98, 103-104. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 209.

⁹⁵⁴ Dosja e Apelit të Gucatit, para. 427; Dosja e Apelit të Haradinajt, para. 234-235; Dosja e Kundërpërgjigjes së Haradinajt, para. 59; Transkripti, 1 dhjetor 2022, f. 69, 98; Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 194, 201.

429. ZPS-ja përgjigjet se në përcaktimin e dënimeve individuale për secilin të akuzuar, Trupi Gjykses nuk gaboi që mori parasysh faktet dhe rrethanat konkrete të kësaj çështjeje në përcaktimin e dënimeve individuale për secilin të akuzuar, pasi nuk ka asnjë çështje tjetër drejtpërdrejt të krahasueshme me të.⁹⁵⁵ Në këtë aspekt, ZPS-ja argumenton se, ndonëse përputhshmëria e dënimeve është e rëndësishme dhe arsyetimi i Trupit Gjykses e përmend gjerësisht jurisprudencën ndërkombëtare dhe është në përputhje me të, Trupi Gjykses nuk ishte i detyruar t'i përmbahej asaj jurisprudence dhe diskrecioni i tij kufizohej nga shkallëzimi i dënimeve të zbatueshme në këtë çështje.⁹⁵⁶ Së fundi, ZPS-ja argumenton se parimi i përputhshmërisë së dënimeve nuk nënkupton se praktika e dënimeve nuk mund të evoluojë me kalimin e kohës në përputhje me evoluimin e interpretimit të peshës së disa veprave penale.⁹⁵⁷

430. Gucati kundërpërgjigjet se duke argumentuar se nuk ka asnjë çështje tjetër drejtpërdrejt të krahasueshme me këtë çështje për sa i përket dhënies së dënimit, ZPS-ja shpërfill çështjet gjyqësore të evidentuara prej tij në Shtojcën 3 të Dosjes së Apelit të Gucatit, në të cilat janë dhënë "dënime në kufirin e sipërm të shkallëzimit të dënimeve".⁹⁵⁸ Gjithashtu, ai argumenton se ZPS-ja gabon kur sugjeron se Trupi Gjykses duhej të kishte devijuar nga dënimet e përcaktuara në ato çështje për shkak se faktet e tyre kanë disa dallime nga ato të çështjes aktuale, ose për shkak të kalimit të kohës, dhe parashtron se këto dallime nuk mund të arsyetojnë dallimet në dënime dhe se disa nga ato dënime janë dhënë vitet e fundit.⁹⁵⁹

⁹⁵⁵ Dosja e Përgjigjes së ZPS-së, para. 170-171, 174. *Shih gjithashtu*, Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 165-166 dhe burimet ligjore të cituara aty; Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, para. 170-176, 184 dhe burimet ligjore të cituara aty.

⁹⁵⁶ Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 166-168, 172-175.

⁹⁵⁷ Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 172-176.

⁹⁵⁸ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 90. *Shih gjithashtu* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 88-89.

⁹⁵⁹ Transkripti, 2 dhjetor 2022, f. 185-194. Këtë argument e përdor edhe Haradinaj. *Shih* Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 201.

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

431. Paneli i Apelit do të trajtojë aspektin nëse, gjatë përcaktimit të dënimeve të përshtatshme për të akuzuarit, Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se praktikat e dënimit në çështjet gjyqësore në gjykatat dhe tribunalët penalë ndërkombëtarë nuk ishin drejtpërdrejt të krahasueshme.⁹⁶⁰ Paneli fillimisht do të shqyrtojë nëse dënimet e dhëna nga Trupi Gjykses ishin proporcionale në raport me dënimet e parapara në KPK, duke iu përmbajtur në të njëjtën kohë dispozitave përkatëse të Ligjit dhe Rregullores.

432. Fillimisht, Paneli thekson se, megjithëse Mbrojtja argumenton se dënimi i njësuar me katër vjet e gjysmë burgim është “tejet shproporcional dhe i papërligjshëm”,⁹⁶¹ në fakt Trupi Gjykses i përdori përgjithësisht me kursim shkallëzimet e dënimeve të përcaktuara në dispozitat përkatëse të KPK-së për secilën Pikë të Aktakuzës për të cilën dha vendim fajësie. Konkretisht, ndonëse për Pikën 5 të Aktakuzës, Trupi Gjykses faktikisht dha dënimin *maksimal* me një vit burgim, për Pikat 1 dhe 2 ai dha dënimet *minimale* me një vit burgim, për Pikën 3 dha dënim me katër vjet burgim, që përkon me një të katërtën e shkallëzimit të dënimeve të

⁹⁶⁰ *Shih p.sh.*, Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 420-423; Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 223-231. *Shih gjithashtu* Shtojcën 3 të Dosjes së Apelit të Gucatit. Paneli thekson se ZPS-ja kërkon që të mos pranohet Shtojca 3 e Dosjes së Apelit të Gucatit si “një përpjekje e qartë për të anashkaluar numrin e lejuar të fjalëve”. *Shih* Dosjen e Përgjigjes së ZPS-së, poshtëshënimi 415. Paneli vë në dukje se në Shtojcën 3, Gucati bën një përmbledhje të historikut procedural dhe dënimeve të ndryshme të dhëna në 16 çështje gjyqësore për mosbindje ndaj gjykatës në gjykatat dhe tribunalët ndërkombëtarë. Ndonëse Gucati u referohet këtyre çështjeve gjyqësore në argumentet përkatëse të tij në Dosjen e Apelit (*Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 425), Paneli nuk i konsideron këto përmbledhje të përfshira në Shtojcën 3 si pjesë të argumenteve të tij dhe është i mendimit se i ngajnë më shumë një liste çështjesh gjyqësore që jepen për referencë. Për më tepër, shumë prej çështjeve të renditura në Shtojcën 3 u diskutuan nga të dyja palët gjatë seancës së apelit. Rrjedhimisht, Paneli nuk do ta refuzojë Shtojcën 3 të Dosjes së Apelit të Gucatit.

⁹⁶¹ *Shih* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 425-426; Dosjen e Apelit të Haradinajt, para. 209; Dosjen e Kundërpërgjigjes së Gucatit, para. 91; Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 68, 98, 103-104; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 195.

parapara,⁹⁶² dhe për Pikën 6 dha dënim me dy vjet burgim, që është një e treta e shkallëzimit të dënimeve të parapara.⁹⁶³

433. Paneli rikujton se, sipas rregullës 163(4) të Rregullores, për të pasqyruar tërësinë e veprimtarisë kriminale të të akuzuarit për të gjitha Pikat e Aktakuzës, dënimi i njësuar nuk duhet të jetë më i ulët se dënimi maksimal individual i përcaktuar për cilëndo akuzë, që në këtë rast është dënimi i dhënë për Pikën 3 të Aktakuzës për të dy të akuzuarit.⁹⁶⁴ Në këtë aspekt, Paneli thekson se vendimi i Trupit Gjykses për dënimin e njësuar prej katër vjetësh e gjysmë burgim, është gjashtë muaj më shumë se dënimi “minimal” i mundshëm prej katër vjetësh burgim sipas Rregullores.

434. Lidhur me përcaktimin e përgjithshëm të dënimit, Paneli i Apelit pajtohet me Trupin Gjykses se “përcaktimi i dënimit të duhur varet shumë nga rrethanat individuale të secilës çështje konkrete”⁹⁶⁵ dhe se praktika e mëparshme e dënimeve është një faktor që duhet marrë parasysh gjatë përcaktimit të dënimit.⁹⁶⁶ Ky konstatim është në përputhje me jurisprudencën penale ndërkombëtare për caktimin e dënimeve, sipas së cilës ndonëse një trup gjykses mund të mbështetet në praktikat e

⁹⁶² Paneli vë në dukje se Trupi Gjykses gjithashtu shqiptoi për secilin të akuzuar dënimin me një gjobë “simbolike” prej 100 eurosh për Pikën 3 të Aktakuzës, nga shuma maksimale prej 125.000 eurosh. Sidoqoftë, Paneli nuk do ta trajtojë më me hollësi këtë gjobë, pasi ajo nuk është kundërshtuar nga Mbrojtja. *Shih* Aktgjykimin, para. 980, 982, 1005, 1008.

⁹⁶³ *Shih* Aktgjykimin, para. 980-981, 1005-1006. Paneli thekson se shkallëzimet e zbatueshme të dënimeve janë si në vijim: (i) për Pikën 1 – një deri në pesë vjet burgim (sipas nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së); (ii) për Pikën 2 – një deri në pesë vjet burgim (për të dy të akuzuarit, sipas nenit 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së për Gucatin dhe sipas nenit 401(2) dhe (5) të KPK-së për Haradinajn); (iii) për Pikën 3 – gjobë deri në 125.000 euro dhe dy deri në dhjetë vjet burgim (sipas nenit 387 të KPK-së); (iv) për Pikën 5 – gjobë ose deri në një vit burgim (sipas nenit 392(1) të KPK-së); dhe (v) për Pikën 6 – gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim (sipas nenit 392(2)-(3) të KPK-së). *Shih gjithashtu më lart*, para. 396.

⁹⁶⁴ *Shih* Aktgjykimin, para. 984, 1009. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 956.

⁹⁶⁵ *Shih* Aktgjykimin, para. 957. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 979, 1004.

⁹⁶⁶ *Shih Strugar Appeal Judgment*, para. 349; *Lubanga Sentencing Appeal Judgment*, para. 76. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 957, 979, 1004.

dënimit në çështje të mëparshme, shpesh nuk është i mundur që dënimi të “zhvendoset” ose “deduktohet” nga një çështje te një tjetër.⁹⁶⁷

435. Sidoqoftë, Paneli thekson se, siç u diskutua më tej edhe gjatë seancës së apelit, përputhshmëria e dënimeve – veçanërisht në çështje gjyqësore të ngjashme – është e rëndësishme, por duhet të lejojë, ndër të tjera, edhe mundësinë e ushtrimit të kompetencës diskrecionale për të pasqyruar faktet e çështjes konkrete.⁹⁶⁸ Rrjedhimisht, Paneli është i mendimit se për të vlerësuar përdorimin e kompetencës diskrecionale nga Trupi Gjykes në përcaktimin e dënimit të të akuzuarve, krahas marrjes parasysh të shkallëzimeve të dënimeve të përcaktuara në KPK, me rëndësi janë edhe praktika e përcaktimit të dënimeve prej gjykatave të Kosovës për të njëjtat vepra apo për vepra penale të ngjashme, si edhe praktika e gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë.

436. Së pari, Paneli i Apelit evidentoi një sërë çështjesh gjyqësore relevante në Kosovë lidhur me veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Pika 1), së bashku me akuza të tjera që nuk kanë lidhje me këtë çështje. Paneli vëren se dënimet individuale të shqiptuara në ato çështje ishin ose të barabarta me dënimin minimal, ose paksa më të larta se dënimi minimal i zbatueshëm.⁹⁶⁹ Siç u përmend më lart, në kuadër të verdikteve të fajësisë për Pikën 1,

⁹⁶⁷ *Shih Lubanga Sentencing Appeal Judgment*, paras 76-77; *Strugar Appeal Judgment*, para. 348. *Shih gjithashtu Aktgjykimin*, para. 957, 979, 1004.

⁹⁶⁸ *Shih Transkriptin*, 2 dhjetor 2022, f. 167-168, 172-176, 188-194. *Shih gjithashtu Ambos Treatise ICL II*, pp. 334-335, 347-348.

⁹⁶⁹ *Shih Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë*, 15 shtator 2016; *Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, Kosovë*, 29 shkurt 2016; *Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, Kosovë*, 23 tetor 2015; *Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë*, 28 maj 2014 (Paneli vëren se në këtë çështje, në kundërshtim me nenin 316(3) të KPPK-së që parashikonte një dënim nga tre muaj deri në pesë vjet burgim, Z.Ç. u dënua, ndër të tjera, me dy muaj burgim për akuzën e pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (forma e rëndë e veprës penale)). Paneli thekson se përveç veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Pika 1), jurisprudenca e evidentuar nga Paneli i Apelit lidhej, ndër të tjera, edhe me veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi (Pika 2), për të cilën të akuzuarit nuk janë më fajtorë, bazuar në konstatimet e mësipërme të Panelit të Apelit lidhur me bashkimin e veprave penale (*shih më lart*, para. 310). Sidoqoftë, Paneli e konsideron informuese praktikën e përcaktimit të

Trupi Gjykses dha dënimin minimal të zbatueshëm, dhe, rrjedhimisht, duket se u tregua më i përmbajtur në përcaktimin e dënimit se sa panelet në çështjet gjyqësore të Kosovës. Paneli nuk mundi të identifikonte praktika të përcaktimit të dënimeve nga jurisprudenca e Kosovës për veprat e tjera penale për të cilat u shpallën fajtorë të akuzuarit,⁹⁷⁰ as palët nuk sollën në vëmendje të Panelit ndonjë praktikë të tillë.

437. Paneli i Apelit vëren më tej se Trupi Gjykses mori parasysh shkallëzimin e dënimeve të shqiptuara për personat e shpallur fajtorë për vepra penale të ngjashme në gjykata dhe tribunale ndërkombëtare.⁹⁷¹ Paneli i Apelit ka shqyrtuar gjithashtu çështje gjyqësore relevante të gjykuara në gjykatat dhe tribunale ndërkombëtare, që u paraqitën nga palët gjatë seancës së apelit si dhe përmes parashtrimeve me shkrim.⁹⁷² Paneli është i vetëdijshëm se dënimet e dhëna janë të ndryshme – disa mjaft të ndryshme – krahasuar me dënimet e dhëna në këtë çështje.⁹⁷³ Sidoqoftë, Paneli i Apelit nuk mund të shpërfillë faktet konkrete të kësaj çështjeje gjyqësore, të marra në kontekstin e kornizës ligjore në fuqi të Kosovës dhe të shkallëzimit të dënimeve në Kodin Penal të Kosovës, si edhe konstatimet që mori parasysh Trupi Gjykses kur vlerësoi faktorët relevantë për dënimin, si p.sh., shpërndarja në shkallë të gjerë e

dënimin lidhur me veprën penale sipas Pikës 2 të Aktakuzës, në kuadër të analizës së vetë mbi proporcionalitetin e dënimeve individuale të shqiptuara nga Trupi Gjykses në këtë çështje. Paneli vëren se dënimet e shqiptuara në ato çështje gjyqësore ishin paksa ose mjaft *më të larta* se dënimi më i ulët i zbatueshëm. *Shih* Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, 7 dhjetor 2017; Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, 4 gusht 2016; Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kosovë, 28 maj 2014.

⁹⁷⁰ Konkretisht, Pika 3 e Aktakuzës (frikësim gjatë procedurës penale), Pika 5 (shkelje e fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedurë zyrtare) dhe Pika 6 (shkelje e fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur). *Shih* Aktgjykimin, para. 1012, 1015.

⁹⁷¹ *Shih* Aktgjykimin, para. 979, 1004, që i referohet *Marijačić and Rebić Trial Judgement*, para. 53; *Jović Trial Judgement*, para. 27; *Akhbar and Al Amin Sentencing Judgment*, p. 8; *Al Khayat Sentencing Judgment*, para. 23; *Nzabonimpa et al. Trial Judgement*, paras 407-408.

⁹⁷² *Shih p.sh.*, *Margetić Trial Judgement*; *Bemba et al. Sentencing Decision*; *Bemba et al. Re-Sentencing Decision*. *Shih gjithashtu* Dosjen e Apelit të Gucatit, para. 225; Transkriptin, 1 dhjetor 2022, f. 67-68, 102-103; Transkriptin, 2 dhjetor 2022, f. 165-166, 185-186.

⁹⁷³ *Shih p.sh.*, Aktgjykimin *Haraqija dhe Morina*, para. 122; *Margetić Trial Judgement*, para. 94; *Jović Trial Judgement*, para. 45; *Marijačić and Rebić Trial Judgement*, para. 53; *Bemba et al. Sentencing Decision*, pp. 98-99; *Bemba et al. Re-Sentencing Decision*, pp. 50-51. *Shih gjithashtu Ambos Treatise ICL II*, pp. 311-315, 334-335, 347-349.

informacionit të mbrojtur nga të akuzuarit, veprimet e përsëritura dhe betimet e vazhdueshme për të kryer përsëri të njëjtat vepra penale, shoqëruar me “komente nënçmuese ndaj dëshmitarëve në një atmosferë të frikësimit të dëshmitarëve”.⁹⁷⁴ Duke pasur parasysh theksin që i vihet parandalimit në nenin 38 të KPK-së dhe peshën e veprave penale të të akuzuarve, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi në përcaktimin e dënimeve të të akuzuarve mbi bazën e fajësisë së shpallur për pikat përkatëse të Aktakuzës.

438. Paneli i Apelit përsërit atë çka Trupi Gjykses vuri në dukje gjatë shpalljes së Aktgjykimit se:

Kjo çështje është e rëndësishme, sepse pasqyron vetë arsyen pse u krijuan Dhomat e Specializuara. Kjo çështje ka të bëjë me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe sigurinë e proceseve gjyqësore dhe, çka është më e rëndësishme, sigurinë, mirëqenien dhe çlirimin nga frika të qindra personave, të cilët janë paraqitur për të përmbushur detyrën e tyre qytetare si dëshmitarë. Mbrojtja e tyre nga frikësimi dhe dëmtimi qëndron në themelin e çdo sistemi të drejtësisë penale, qoftë ai vendor apo ndërkombëtar. Pa dëshmitarë, nuk mund të ketë drejtësi për viktimat apo për shoqërinë në përgjithësi. Veprimet dhe sjellja e të akuzuarve sfiduan pikërisht këtë themel.⁹⁷⁵

439. Paneli i Apelit pajtohet me Trupin Gjykses se krimet e kryera nga të akuzuarit ishin të rënda dhe me peshë të veçantë. Rrjedhimisht, dhe duke marrë parasysh edhe

⁹⁷⁴ *Shih më lart*, para. 415. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin, para. 979 (në lidhje me Gucatin) (*shih edhe* para. 1004, ku Trupi Gjykses bëri vërejtje shumë të ngjashme në lidhje me Haradinajn, me dallimet përkatëse të bazuara në fakte), ku, pasi konstatoi se dënimet e dhëna për të akuzuarit duhet të marrin parasysh vetëm faktet e kësaj çështjeje, Trupi Gjykses theksoi se veprat penale për të cilat u shpallën fajtorë të akuzuarit:

përfshijnë zbulimin e më së paku njëqind kërkesave të TFHS-së, disa përgjigjeve të PSKL-së, të gjitha të trajtuara si konfidenciale prej ZPS-së, të një produkti tejet të ndjeshëm të punës së brendshme të ZPS-së, si dhe të emrave të *qindra* dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm. Veprat penale përfshijnë: (i) shpërndarjen e informacionit në shkallë të gjerë; (ii) përmes përdorimit të një platforme organizative dhe një numri paraqitjesh të transmetuara në media; (iii) përmes sjelljes së përsëritur dhe betimeve të vazhdueshme se do t'i kryenin përsëri të njëjtat vepra penale; (iv) shoqëruar me komente nënçmuese ndaj dëshmitarëve në një atmosferë të frikësimit të dëshmitarëve; dhe (v) me pasojën e mundshme që informacioni i mbrojtur të ishte i disponueshëm për një numër të madh personash dhe për një kohë të gjatë.

⁹⁷⁵ *Shih* KSC-BC-2020-07, Transkripti, 18 maj 2022, f. 3858-3859.

faktorët e shtjelluar më lart në lidhje me shkallëzimet e dënimeve dhe praktikën e përcaktimit të dënimeve në Kosovë dhe në gjykatat dhe tribunalët penale ndërkombëtarë, Paneli i Apelit arrin në përfundimin se nuk ka bazë për pretendimin e të akuzuarve se dënimet e tyre ishin “tejet shproporcionale dhe të papërligjshme”, bazuar në shpalljen e tyre fajtorë për pikat përkatëse të Aktakuzës.

440. Sidoqoftë, Paneli i Apelit rikujton konstatimet e veta të mëhershme për Pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës, konkretisht se të akuzuarit mund të shpallen fajtorë vetëm në bazë të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së, ku prapësoi verdiktet e fajësisë së të akuzuarve në bazë të nenit 401(2) dhe (5) të KPK-së dhe verdiktin e fajësisë së Gucatit në bazë të nenit 401(3) të KPK-së, dhe i shpalli të pafajshëm të dy të akuzuarit për Pikën 2 të Aktakuzës.⁹⁷⁶ Mbi bazën e konstatimit të Panelit të Apelit për prapësimin e verdikteve të fajësisë të të akuzuarve për Pikën 2 të Aktakuzës, Paneli gjykon se dënimet e njësuara të dhëna nga Trupi Gjykses, duhet të ulen. Duke marrë parasysh proporcionalitetin si edhe dënimin minimal të njësuar që lejon rregulla 163(4) e Rregullores – katër vjet burgim bazuar në konstatimin e Trupit Gjykses mbi dënimet e të akuzuarve lidhur me Pikën 3 të Aktakuzës⁹⁷⁷ – Paneli i Apelit, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Ambos,⁹⁷⁸ vendos që dënimet e njësuara për Gucatin dhe Haradinajn të ulen me tre muaj, në një dënim të njësuar me katër vjet e tre muaj burgim.

441. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit miraton pjesën përkatëse të Pikës 20 të Apelit të Gucatit dhe pjesën përkatëse të Pikës 24 të Apelit të Haradinajt dhe rrëzon pjesën tjetër të këtyre pikave.

⁹⁷⁶ *Shih më lart*, para. 310.

⁹⁷⁷ *Shih më lart*, para. 433.

⁹⁷⁸ Gjykatësi Ambos nuk u pajtua me një aspekt të interpretimit prej shumicës të veprimit të fajshëm sipas nenit 401(1) të KPK-së që çoi në shpalljen të pafajshëm të Gucatit dhe Haradinajt për Pikën 1 të Aktakuzës. Sipas gjykatësit Ambos dënimi i njësuar për Gucatin dhe Haradinajn duhet të ulet me gjashtë muaj, në një dënim të njësuar me katër vjet burgim, që është edhe dënimi më i ulët i njësuar që lejon rregulla 163(4) e Rregullores bazuar në konstatimin e Trupit Gjykses mbi dënimet e të akuzuarve për Pikën 3 të Aktakuzës. *Shih* pjesën VI, para. 17-19.

V. VENDIM

442. Për këto arsye, duke marrë parasysh të gjitha argumentet e paraqitura nga palët, Paneli i Gjykatës së Apelit, në bazë të nenit 46 të Ligjit dhe rregullave 182 dhe 183 të Rregullores:

MIRATON Pikat 11, 16 dhe pjesën përkatëse të Pikës 20 të Apelit të Gucatit dhe pjesën përkatëse të Pikës 3 dhe pjesën përkatëse të Pikës 24 të Apelit të Haradinajt;

RRËZON të gjitha aspektet e tjera të Apeleve të Gucatit dhe Haradinajt;

PRAPËSON verdiktin e fajësisë së Gucatit dhe Haradinajt për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi sipas Pikës 2 të Aktakuzës;

LË NË FUQI verdiktin e fajësisë së Gucatit dhe Haradinajt për frikësim gjatë procedurës penale sipas Pikës 3 të Aktakuzës, shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedurë zyrtare sipas Pikës 5 të Aktakuzës, dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur sipas Pikës 6 të Aktakuzës dhe **LË NË FUQI GJITHASHTU**, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Ambos, verdiktin e fajësisë së Gucatit dhe Haradinajt për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë sipas Pikës 1 të Aktakuzës;

ANULON dënimin e njësuar prej katër vjetësh e gjysmë burgim për Gucatin dhe Haradinajn dhe **CAKTON**, me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Ambos, një dënim të njësuar me katër vjet e tre muaj burgim për Gucatin, duke llogaritur edhe kohën e paraburgimit, dhe një dënim të njësuar me katër vjet e tre muaj për Haradinajn, duke llogaritur edhe kohën e paraburgimit;

LË NË FUQI dënimin shtesë për Gucatin dhe Haradinajn me një gjobë prej njëqind eurosh (100 EUR);

VENDOS që ky Aktgjykim të zbatohet me efekt të menjëhershëm në bazë të rregullës 185(1) të Rregullores; dhe

URDHËRON që, në pajtim me nenin 50(1) të Ligjit dhe rregullën 166(3) të Rregullores, Gucati dhe Haradinaj të mbeten në paraburgim të Dhomave të Specializuara deri në finalizimin e masave për transferimin e tyre në shtetin ku do të vuajnë dënimin.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse**

/nënshkrimi/

Gjykatës Kai Ambos

/nënshkrimi/

Gjykatëse Nina Jorgensen

E enjte, 2 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë

VI. MENDIMI PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYKATËSIT KAI AMBOS

1. Pajtohem me arsyetimin dhe konstatimet e Panelit të Apelit për konfirmimin e shpalljes fajtor të z. Gucati dhe z. Haradinaj (bashkërisht “të akuzuarit”) në bazë të neneve 387 dhe 392(1)-(3) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (“KPK”) (konkretisht, Pikat 3, 5 dhe 6 të Aktakuzës). Në lidhje me këtë, vë në dukje peshën e sjelljes mbi të cilat u bazuan këto verdikte fajësie. Faktikisht, kjo sjellje ndikon shumë në integritetin e procesit penal si dhe në sigurinë, mirëqenien, privatësinë dhe dinjitetin e dëshmitarëve (të mundshëm) ose të familjeve të tyre. Unë gjithashtu pajtohem me arsyetimin e Panelit të Apelit lidhur me raportin e bashkimit të veprave penale të paragrafit (1) dhe paragrafit (2) të nenit 401 të KPK-së (përkatësisht, Pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës). Megjithatë, për arsytet e përshkruara më poshtë (shih më poshtë, pjesën A), për fat të keq nuk mund të pajtohem me interpretimin prej shumicës të veprimit të fajshëm sipas nenit 401(1) të KPK-së dhe do t’i kisha shpallur të akuzuarit të pafajshëm në atë aspekt. Për të njëjtat arsye, nuk do ta lija në fuqi fajësinë për veprën penale sipas nenit 401(2) të KPK-së. Rrjedhimisht, si pasojë e këtyre konstatimeve, unë do ta kisha ulur dënimin e njësuar në katër (4) vjet (shih më poshtë, pjesën B).

A. PARIMI I LIGJSHMËRISË, VEÇANËRISHT *LEX STRICTA*, DHE NENI 401(1) I KPK-SË

2. Neni 401(1) i KPK-së, në pjesën përkatëse, dënon personin i cili “me forcë apo me kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë *personin zyrtar* në kryerjen e detyrave zyrtare [...]” (theksimi i shtuar). Trupi Gjykses konstatoi se nuk ka prova që të akuzuarit të kenë “kërcënuar drejtpërdrejt ndonjë zyrtar të [Dhomave të Specializuara]/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së [Dhomave të Specializuara]/ZPS-së” dhe vlerësoi se neni 401(1) i KPK-së “nuk kërkon që kërcënim i rëndë të jetë drejtuar vetëm kundër personit zyrtar” por “mund të jetë i drejtuar edhe kundër një personi tjetër [...]”.¹ Trupi Gjykses konstatoi se “në formulimin e nenit 401 të KPK-së nuk

¹ KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit, 18 maj 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 18 maj 2022) (“Aktgjykimi”), para. 639.

kërkohet që forca ose kërcënimi i rëndë të drejtohet vetëm ndaj personit zyrtar”.² Sipas Trupit Gjykses, kufizimi i kësaj vepre penale vetëm në veprimet e drejtuara ndaj personave zyrtarë “do të ishte në kundërshtim me bazën logjike të dispozitës për veprën penale – që synon të garantojë që detyrat zyrtare të mos pengohen, drejtpërdrejt apo tërthorazi – dhe do të përfshinte në tekst një kufizim që ligjvënësi nuk e ka parashikuar”.³ Kjo është në përputhje edhe me vendimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake.⁴ Kolegjet e mi pajtohen me këto konstatime dhe përsërisin pjesërisht arsyetimin mbështetës. Ata vlerësojnë, ndër të tjera, se “në formulimin e kësaj dispozite nuk kërkohet që kërcënimi i rëndë të drejtohet konkretisht vetëm kundër personit zyrtar në fjalë”; përndryshe dispozita “do të ishte formuluar në një mënyrë” që e parashikon shprehimisht këtë.⁵ Ata në vijim i referohen “bazës logjike të dispozitës për veprën penale, që synon të garantojë që detyrat zyrtare të mos pengohen, drejtpërdrejt apo tërthorazi”, konkretisht, faktit që kjo dispozitë është hartuar për të mbrojtur personat zyrtarë “në kryerjen e papenguar të detyrave të tyre zyrtare”, dhe arrijnë në përfundimin se mjafton që “veprimi i të akuzuarit të ketë pasur kapacitetin për të penguar persona zyrtarë”.⁶

3. Unë shpreh me respekt mospajtimin tim me këtë interpretim të nenit 401(1) të KPK-së. Për mendimin tim, ky është një interpretim tepër i gjerë që shkel elementin *lex stricta* të parimit të ligjshmërisë (ndalimi i analogjisë *in malam partem*). Ky parim

² Aktgjykimi, para. 146.

³ Aktgjykimi, para. 146.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00074/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, 22 dhjetor 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 11 dhjetor 2020, u riklasifikua si rreptësisht konfidencial më 22 dhjetor 2020, u riklasifikua si konfidencial më 24 shkurt 2021, para. 68: “[...] neni 401(1) i KPK-së nuk kërkon që forca apo kërcënimi i rëndë të ushtrohet drejtpërdrejt ndaj personit zyrtar. Përkundrazi, forca apo kërcënimi i rëndë mund të drejtohen ndaj një a më shumë personave, për sa kohë që rezultojnë në pengimin faktik ose në (tentativën) për pengim të një personi zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.”

⁵ Aktgjykimi i Apelit, para. 282.

⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 282.

përmendet shprehimisht në nenin 33 të Kushtetutës së Kosovës⁷ si edhe, në një formë më të shtjelluar, në nenin 2 të KPK-së. Në nenin 2(3) të KPK-së, jepet përkufizimi konkret i elementit *lex stricta* si më poshtë:

Përkufizimi i një veprë penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale.

4. Në traditën juridike të Kosovës, parimi i ligjshmërisë është i përfshirë në juridiksionin e të drejtës civile, sikurse ishte edhe në legjislacionin e ish-Jugosllavisë.⁸ Në përputhje me këtë traditë, ky parim shpesh shprehet me maksimën latine *nullum crimen, nulla poena sine lege* dhe ka si përbërës bazë kriteret *lex praevia* (ndalimi i penalizimit prapaveprues), *lex certa* (siguria juridike lidhur me elementët e veprës penale), *lex stricta* (interpretimi i ngushtë dhe ndalimi i interpretimit me analogji *in malam partem*) dhe *lex scripta* (legjislacioni i kodifikuar).⁹ Ndonëse ndalimi i

⁷ Kushtetuta e Kosovës e vitit 2008 zëvendësoi të gjitha kushtetutat që zbatoheshin më parë në territorin e Kosovës dhe Dhomat e Specializuara kanë detyrimin të respektojnë vetëm të drejtat e sanksionuara në të. *Shih* KSC-BC-2020-06, IA009/F00030, Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 23 dhjetor 2021 (“Vendimi mbi Apelet në lidhje me Juridiksionin në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*”), para. 26; KSC-BC-2020-04, IA002/F00010, Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 11 shkurt 2022 (“Vendimi i Apelit në lidhje me Juridiksionin në Çështjen *Shala*”), para. 20; KSC-CC-2022-16, F00004, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me të Drejtat Themelore të Garantuara nga Neni 33 i Kushtetutës së Kosovës dhe Neni 7 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 6 korrik 2022, para. 22, 64.

⁸ *Shih* Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1974), neni 181; Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, (1976), neni 36. *Shih gjithashtu* Munda, A., “*Das Strafrecht Jugoslawiens*”, in Mezger, E., Schönke, A., Jescheck, H. H. (eds.), *Das ausländische Strafrecht der Gegenwart Vol. I*, Duncker & Humblot 1955, pp. 382-383.

⁹ Formulimet në latinishte u krijuan nga teoricieni gjerman i së drejtës penale Johann Paul Anselm Feuerbach në traktatin e tij për të drejtën penale të vitit 1801 (*Lehrbuch des gemeinen in Deutschland gültigen Peinlichen Rechts*, Giessen: Heyer 1801, para. 24, p. 20) por ky parim gjendet edhe në *Magna Carta Libertatum* të Anglisë, 15 qershor 1215, neni 39, dhe, natyrisht në *Déclaration des Droits de l’Homme et du Citoyen* të Francës, 1789, nenet 7, 8. Në lidhje me historikun, më lejoni të citoj një nga veprat e mia: Ambos, K., “*Nulla Poena Sine Lege in International Criminal Law*”, në Haveman, R. dhe Olusanya, O. (eds), *Sentencing and Sanctioning in Supranational Criminal Law*, Antwerp: Intersentia 2006 (“*Ambos Nulla Poena Sine Lege in ICL*”), pp. 17 et seq. *Shih për krahasim*, Pradel, J., *Droit Pénal Comparé* (Fourth Edition), Dalloz 2016, p. 59; Dubber, M. dhe Hörnle, T., *Criminal Law: A Comparative Approach*, Oxford University Press 2014 (“Dubber dhe Hörnle”), pp. 73-74.

penalizimit përmes efektit prapaveprues dhe kriteri i sigurisë juridike njihen edhe në juridiksionet që zbatojnë të drejtën zakonore – në formën e ndalimit të ligjeve *ex post facto* dhe doktrinës së pavlefshmërisë së ligjit në rast të paqartësisë së tij¹⁰ – dhe ndonëse aty mund të hasësh edhe parimin *lex stricta*, të paktën në formën e kriterit të interpretimit të ngushtë ose më të butë (kriteri i interpretimit më të favorshëm për të pandehurin),¹¹ kriteri i legjislacionit të kodifikuar nuk njihet në qasjen tradicionale të së drejtës zakonore lidhur me krimet (e pakodifikuara) që trajtohen sipas të drejtës zakonore.

5. Parimi i ligjshmërisë njihet edhe në të drejtën ndërkombëtare, veçanërisht në nenin 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”),¹² dhe zbatimimi i tij nga Dhomat e Specializuara është i detyrueshëm, në bazë të nenit 3(2)(e) të Ligjit.¹³ Megjithatë, vetëm në nenet 22-24 të Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“Statuti i Romës”) trajtohet forma e shtjelluar e parimit *nullum crimen sine lege*,¹⁴ ku neni 22(2) i Statutit të Romës e përkufizon shprehimisht *lex stricta* në të

¹⁰ *Shih p.sh.*, Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, neni I, pjesa 9, para. 3 (“Ndalohet miratimi i akteve për heqjen e të drejtave civile dhe i ligjeve *ex post facto*”) dhe, në lidhje me ndalimin e paqartësisë juridike, *shih* garancitë për proces ligjor të rregullt në amendamentin e pestë dhe të katërbëdhjetë. *Shih gjithashtu* Dubber dhe Hörnle, pp. 74 et seq, pp. 85 et seq. Është me interes të përmendet se marrëdhënia e këtij parimi me procesin ligjor të rregullt gjendet në përkthimin përkatës të veprës së famshme të Sir Edward Coke, *The Second Part of the Institutes of the Laws of England* (Fourth Edition), 1671, pp. 51-55.

¹¹ Hall, J., *General Principles of Criminal Law* (Second Edition), Bobbs-Merrill 1960, pp. 38 et seq.; Horder, J., *Ashworth’s Principles of Criminal Law* (Tenth Edition), Oxford University Press 2022 (“Horder”), p. 91; Dubber and Hörnle, p. 73.

¹² *Shih gjithashtu* Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 11(2); Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 15(1); Konventën Amerikane për të Drejtat e Njeriut, neni 9.

¹³ *Shih gjithashtu* Kushtetutën e Kosovës, neni 22; Vendimin e Apelit në lidhje me Juridiksionin në Çështjen Shala, para. 26.

¹⁴ *Krahaso* Broomhall, B., in Ambos, K. (ed.), *The Rome Statute of the International Criminal Court: Article-by-Article Commentary* (Fourth Edition), C. H. Beck, Hart, Nomos 2022 (“*Ambos Rome Statute Commentary*”), Article 22, mns 29 et seq.; Schabas, W. A. and Ambos, K., in *Ambos Rome Statute Commentary*, Article 23, mns 5 et seq.; Halling, M., in *Ambos Rome Statute Commentary*, Article 24, mns 19 et seq. *Shih gjithashtu* Ambos, K., *Treatise on International Criminal Law: Volume I: Foundations and General Part* (Second Edition), Oxford University Press 2021 (“*Ambos Treatise ICL I*”), pp. 145-146.

njëjtën mënyrë siç përkufizohet edhe në nenin 2(3) të KPK-së.¹⁵ Kjo shpjegon pse jurisprudenca për të drejtat e njeriut, veçanërisht ajo e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GJEDNJ”), ndjek atë që është quajtur qasje “minimaliste”,¹⁶ e cila mundëson qartësimin gradual të rregullave mbi përgjegjësinë penale përmes interpretimit gjyqësor¹⁷ dhe përqendrohet në kriteret e disponueshmërisë dhe parashikueshmërisë (njoftimit të mjaftueshëm) në lidhje me kriminalitetin e një sjelljeje të caktuar.¹⁸

6. Një arsye tjetër për qasjen më elastike të jurisprudencës në fushën e të drejtave të njeriut është objekti i saj i referencës - shkeljet (e rënda) të të drejtave të njeriut – çka bën shpesh që balanca midis kuptimit (të normativizuar) të ngushtë dhe atij elastik të ligjshmërisë të anojë në favor të këtij të fundit, që i jep përparësi ndjekjes penale kundrejt interpretimit shumë të ngushtë (formalist) të ligjshmërisë.¹⁹ Kjo qasje elastike shprehet më qartë në nenin 7(2) të KEDNJ-së – klauzola e famshme (apo famëkeqe) e Nurembergut – që lejon gjykimin dhe dënimin për sjellje që përbën “krim sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës”, pra, për vepra penale *mala in se* krahasuar me *mala prohibita*.²⁰ Sidoqoftë, kjo jurisprudencë e të drejtave të njeriut – mbi të cilën u

¹⁵ Në nenin 22(2) të Statutit të Romës thuhet: “Përkufizimi i krimit duhet të interpretohet ngushtë dhe nuk duhet të zgjerohet me analogji. Në rast të paqartësisë, përkufizimi duhet të interpretohet në dobi të personit që merret në pyetje, ndiqet penalisht apo shpallet fajtor.”

¹⁶ ECtHR, *Ilseher v. Germany*, nos 10211/12 and 27505/14, Judgment, Dissenting Opinion of Judge Pinto de Albuquerque Joined by Judge Dedov, 4 December 2018 (“Judge Pinto de Albuquerque Dissenting Opinion”), paras 90 et seq. Lidhur me qasjen minimaliste krahasuar me atë maksimaliste, *shih gjithashtu Ambos Nulla Poena Sine Lege* in ICL, pp. 28 et seq.

¹⁷ ECtHR, *Drėlingas v. Lithuania*, no. 28859/16, Judgment, 12 March 2019 (“*Drėlingas* Judgment”), para. 96; ECtHR, *Vasiliauskas v. Lithuania*, no. 35343/05, Judgment, 20 October 2015 (“*Vasiliauskas* Judgment”), para. 155; ECtHR, *Streletz, Kessler and Krenz v. Germany*, nos 34044/96, 35532/97 and 44801/98, Judgment, 22 March 2001 (“*Streletz et al.* Judgment”), para. 82; ECtHR, *S.W. v. The United Kingdom*, no. 20166/92, Judgment, 22 November 1995, para. 36; ECtHR, *C.R. v. The United Kingdom*, no. 20190/92, Judgment, 22 November 1995, para. 34.

¹⁸ *Drėlingas* Judgment, para. 96; ECtHR, *G.I.E.M. S.R.L. and Others v. Italy*, nos. 1828/06, 34163/07, 19029/11, Judgment, 28 June 2018, para. 242; *Vasiliauskas* Judgment, para. 155.

¹⁹ Në lidhje me përfshirjen si normë të parimit *nullum crimen sine lege* në të drejtën penale ndërkombëtare në këtë kontekst *shih Ambos*, Treatise ICL I, pp. 145-146.

²⁰ Në lidhje me këtë dallim, *shih* veprën mjaft udhëzuese të Schmitt, C., “*Das internationalrechtliche Verbrechen des Angriffskriegs und der Grundsatz “Nullum crimen, nulla poena sine lege”*”, Legal Brief 1945, edited by H. Quaritsch, Duncker & Humblot 1994, pp. 21-22 (ku citohet, ndër të tjera, përkufizimi mjaft i

mbështet Paneli i Apelit me një përbërje tjetër²¹ – ka shumë pak, për të mos thënë aspak, lidhje me kontekstin e çështjes në fjalë, sepse ajo ose nuk merret aspak me kriterin *lex stricta*, ose e ngatërron atë me kriterin *lex certa*, dhe më e shumta përjashton interpretimet krejtësisht të paarsyeshme për papajtueshmërinë e tyre me thelbin e veprës penale përkatëse dhe me standardin e parashikueshmërisë.²² Përveç kësaj, jurisprudenca e të drejtave të njeriut rrallë trajton kriminalitetin e rëndomtë që shprehet në veprat penale të zakonshme të parashikuara në kodet penale vendore.

7. Në ndryshim nga kriteret *leges praeviae, certae* dhe *scriptae* që i drejtohen ligjvënësit, kriteri *lex stricta* i drejtohet gjykatësit dhe, rrjedhimisht, funksionon si parim i interpretimit dhe zbatimit (të ligjit).²³ Për këtë arsye, ky kriter është shumë relevant për juridiksionet që zbatojnë të drejtën civile, siç është rasti i Kosovës. Të shohim për ilustrim disa juridiksione të tjera të ngjashme. Në Francë, neni 111-4 i Kodit Penal (*Code Pénal*) shprehimisht përcakton se “*loi pénale*” është objekt i “*interprétation stricte*” dhe jurisprudenca e zbaton këtë rregull për të bërë interpretim

njohur i H. R. Brill nga Enciklopedia e së Drejtës Penale e vitit 1922: “Veprat penale *mala in se* përfshijnë të gjitha shkeljet e qetësisë ose rendit publik, lëndimet që u shkaktohen personave ose dëmtimet e pronës, aktet që dhunojnë normat publike të sjelljes ose moralit të shëndoshë dhe shkeljet e qëllimshme dhe korruptuese të detyrës zyrtare.”).

²¹ Vendimi mbi Apelet në lidhje me Juridiksionin në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 142, 211, 214; *shih gjithashtu* Vendimin mbi Apelin e Shalës në lidhje me Juridiksionin, para. 27 (parashikueshmëria duhet të vlerësohet rast pas rasti).

²² Një nga rastet e pakta ku përmendet *lex stricta* është ai i çështjes gjyqësore të GJEDNJ-së, *Kokkinakis v. Greece*, no. 14307/88, Judgment, 25 May 1993, para. 52 (“interpretimi i së drejtës penale nuk duhet të zgjerohet në dëm të të akuzuarit, për shembull, përmes analogjisë”) por më pas ai ngatërrohet me *lex certa* (“[...] vepra penale duhet të përkufizohet qartë në ligj”) dhe reduktohet në parashikueshmëri subjektive (“[...] ky kusht përmbushet kur një individ mund ta dijë nga formulimi i dispozitës përkatëse dhe, nëse është nevoja, me ndihmën e interpretimit të gjykatave, se cilat veprime dhe mosveprime e bëjnë atë përgjegjës penalisht.”) Një shembull më tipik i rrëzimit të kundërshtimeve lidhur me ligjshmërinë gjendet në *Streletz et. Al. Judgment*, para. 50 dhe në çështjen e GJEDNJ-së, *Radio France and Others v. France*, no. 53984/00, Judgment, 30 March 2004, para. 20 (ku në të dy këto aktgjykime rrëzohet pretendimi për shkeljen e nenit 7 të KEDNJ-së, sepse ai nen nuk ndalon “qartësimin gradual të rregullave mbi përgjegjësinë penale përmes interpretimit gjyqësor nga çështja në çështje, ‘me kusht që interpretimi i ri që rezulton të jetë në përputhje me thelbin e veprës penale dhe mund të parashikohej në mënyrë të arsyeshme”). *Shih gjithashtu* Judge Pinto de Albuquerque Dissenting Opinion, para. 92.

²³ *Shih* Broomhall, B., në *Ambos Rome Statute Commentary*, Article 22, mns 10-11; *shih gjithashtu* Horder, p. 91 (ku theksohet lidhja e këtij kriteri me “detyrën e ‘gjykatave’ për interpretimin e legjislacionit”).

të ngushtë të veprave penale.²⁴ Në Gjermani, parimi i ligjshmërisë ka status kushtetues²⁵ dhe Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë ka theksuar kriterin *lex certa* në disa vendime, duke përjashtuar “çdo interpretim të veprës penale që zgjeron përmbajtjen [...] dhe rrjedhimisht e bën të ndëshkueshme një sjellje që nuk përmban elemente të veprës penale në përputhje me kuptimin e mundshëm tekstual të saj”.²⁶ Gjykata ka theksuar vazhdimisht se “kuptimi i mundshëm tekstual i ligjit shënon kufirin e jashtëm të interpretimit të lejueshëm gjyqësor”²⁷ ose, me fjalë të tjera, “i vendos interpretimit gjyqësor një kufi, i cili është i pakapërcyeshëm”.²⁸ Në Itali, ashtu si në Gjermani, parimi i ligjshmërisë është i mishëruar në Kushtetutë²⁹ dhe neni 12(1)

²⁴ Shih Gjykatën e Kasacionit, Francë (*Cour de Cassation*), Plenary Assembly, 99-85.973, 29 June 2001 (ku në këtë “arrêt de principe” theksohet se “le principe de légalité [...] qui impose une interprétation stricte de la loi pénale, s’oppose à ce que l’incrimination prévue par l’article 221-6 du Code pénal, réprimant l’homicide involontaire d’autrui, soit étendue au cas de l’enfant à naître dont le régime juridique relève de textes particuliers sur l’embryon ou le fœtus”). Shih gjithashtu Gjykatën Kushtetuese, Francë (*Conseil Constitutionnel*), 96-377 DC, Decision, 16 July 1996, para. 11 (“[...] le principe de légalité impose d’interpréter strictement la loi pénale, de se prononcer sans que son appréciation puisse encourir la critique d’arbitraire”).

²⁵ Shih Kushtetutën e Gjermanisë (*Grundgesetz für die Bundesrepublik Deutschland*), 23 May 1949 (hyrë në fuqi më 25 maj 1949, ndryshuar për herë të fundit më 19 dhjetor 2022), neni 103(2); shih gjithashtu German, Criminal Code (*Strafgesetzbuch*), 15 May 1871 (ndryshuar për herë të fundit më 4 dhjetor 2022), § 1.

²⁶ Gjykata Kushtetuese Federale, Gjermani (*Bundesverfassungsgericht*), 1 BvR 388/05, Decision, 7 March 2011 (“Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë i 7 marsit 2011”), para. 21 (me referenca të mëtejshme): “Ausgeschlossen ist jede Auslegung einer Strafbestimmung, die den Inhalt der gesetzlichen Sanktionsnorm erweitert und damit Verhaltensweisen in die Strafbarkeit einbezieht, die die Tatbestandsmerkmale der Norm nach deren möglichem Wortsinn nicht erfüllen”.

²⁷ Gjykata Kushtetuese Federale, Gjermani (*Bundesverfassungsgericht*), 2 BvR 568/04, Decision, 1 July 2004, para. 4.

²⁸ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë të 7 marsit 2011, para. 21: “Der mögliche Wortsinn des Gesetzes zieht der richterlichen Auslegung eine Grenze, die unübersteigbar ist.”

²⁹ Shih Kushtetutën e Italisë (*Costituzione della Repubblica Italiana*), 22 December 1947 (hyrë në fuqi më 1 janar 1948, ndryshuar për herë të fundit më 7 nëntor 2022), neni 25(2) dhe (3); shih gjithashtu Kodin Penal të Italisë (*Codice Penale*), Royal Decree no. 1398, 19 October 1930 (ndryshuar për herë të fundit në vitin 2022), nenet 1 dhe 2.

i të ashtuquajturve *Preleggi*³⁰ përcakton kriterin e interpretimit të ngushtë.³¹ Gjykata Kushtetuese e Italisë, ashtu si ajo e Gjermanisë (së cilës i referohet shprehimisht), ka konstatuar vazhdimisht se kriteri *lex stricta* është “kufi i pakapërcyeshëm” në interpretimin gjyqësor të një “teksti legjislativ”, sepse është ky tekst, dhe jo interpretimi i mëpasshëm i tij, që duhet t’u japë shtetasve “një paralajmërim të qartë”, ndërkohë që dikush nuk mund të ndëshkohet për sjellje “për të cilat formulimi i zakonshëm gjuhësor nuk mundëson që të bëhet lidhja me kuptimin tekstual të shprehjeve të përdorura nga ligjvënësi”.³² Së fundi, por po aq e rëndësishme, edhe në Spanjë, parimi i ligjshmërisë njihet në Kushtetutë³³ dhe Gjykata Kushtetuese e Spanjës ka theksuar vazhdimisht kufijtë e interpretimit gjyqësor, duke kërkuar nga gjykatësit zbatimin “e rreptë” të kuptimit tekstual të ligjit dhe duke ndaluar çdo formë analogjie ose ushtrimi të diskrecionit (gjyqësor).³⁴

³⁰ The *Preleggi* (“dispozitat paraprake” ose “paraligjet”) janë dispozita paraprake të Kodit Civil, që përmbajnë parimet e përgjithshme mbi zbatimin dhe interpretimin e ligjit që, ndër të tjera, synojnë të plotësojnë zbrazëtitë në legjislacionin ekzistues. *Shih Disposizioni sulla legge in generale or Preleggi*, Royal Decree no. 262, 16 March 1942.

³¹ Në nenin 12(1) të *Preleggi* thuhet: “Nell’applicare la legge non si può ad essa attribuire altro senso che quello fatto palese dal significato proprio delle parole secondo la connessione di esse, e dalla intenzione del legislatore.” (theksimi i shtuar).

³² Gjykata Kushtetuese, Itali (*Corte Costituzionale*), no. 98, Judgment, 28 April 2021, *Considerato in diritto*, para. 2.4. (“[...] costituisce così un limite insuperabile rispetto alle opzioni interpretative a disposizione del giudice di fronte al testo legislativo. E ciò in quanto, nella prospettiva culturale nel cui seno è germogliato lo stesso principio di legalità in materia penale, è il testo della legge – non già la sua successiva interpretazione ad opera della giurisprudenza – che deve fornire al consociato un chiaro avvertimento circa le conseguenze sanzionatorie delle proprie condotte; sicché non è tollerabile che la sanzione possa colpirlo per fatti che il linguaggio comune non consente di ricondurre al significato letterale delle espressioni utilizzate dal legislatore.”). Në këtë aktgjykim, Gjykata Kushtetuese e Italisë i referohet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë. *Shih gjithashtu* Gjykatën Penale të Kasacionit, Itali (*Corte di Cassazione Penale*), section II, no. 40860, Judgment, 20 September 2022, p. 4, para. 2 (“è necessario in primo luogo tenere conto nella interpretazione delle norme del significato lessicale delle parole utilizzate dal legislatore”); Gjykatën Penale të Kasacionit, Itali (*Corte di Cassazione Penale*), section VI, no. 49657, Judgment, 8 July 2022, p. 5, para. 5.1 (ku theksohet se nuk duhet t’i jepet “altro senso che quello fatto palese dal significato proprio delle parole, secondo la connessione di esse, e dalla intenzione del legislatore”).

³³ *Shih* Kushtetutën e Spanjës (*Constitución Española*), 6 December 1978 (hyrë në fuqi më 29 dhjetor 1978), neni 25(1).

³⁴ *Shih* Gjykatën Kushtetuese, Spanjë (*Tribunal Constitucional*), Plenary, 133/1987, Judgment, 21 July 1987, *Fundamento Jurídico* 4 (“[...] que la ley describa un supuesto de hecho estrictamente determinado (*lex certa*); lo que significa un rechazo de la analogía como fuente creadora de delitos [...] [y la] prohibición

8. Në përputhje të plotë me këtë jurisprudencë dhe me një frymë shumë më konkrete dhe kërkuese se GJEDNJ-ja, Dhoma Gjyqësore e GJPN-së, në çështjen gjyqësore *Katanga*, konstatoi si vijon:

Në zbatimin e parimit të interpretimit të ngushtë, dispozitat e Statutit në lidhje me veprat penale nuk duhet të [...] përkufizohen me analogji apo të zbatohen në situata që nuk përcaktohen shprehimisht në formulimin faktik të dispozitave statutore. Për rrjedhojë, Dhoma nuk mund të zbatojë një metodë interpretimi që mund të zgjerojë përkufizimin e veprave penale, por është e detyruar të zbatojë rreptësisht dispozitat që ndalojnë posaçërisht vetëm ato sjellje të cilat hartuesit e tyre synonin t'i përkufizonin shprehimisht si vepra penale.³⁵

9. Në mënyrë të ngjashme, në jurisprudencën e Kosovës theksohet rëndësia e parimit të ligshmërisë, përfshirë përbërësin *lex stricta* të tij. Kështu, Gjykata e Apelit e Kosovës ka konstatuar se gjykatësi nuk duhet të plotësojë një zbrazëti në legjislacionin penal duke e zbatuar ligjin përtej formulimit të tij, apo duke e zgjeruar një precedent përmes krijimit të një vepre penale të re të pakodifikuar; çdo ndryshim i ligjit duhet t'i lihet ligjvënësit; interpretimi përmes analogjisë është i ndaluar dhe çdo dispozitë duhet të interpretohet ngushtë.³⁶ Më konkretisht, gjykatësi i EULEX-it Timo Vuojolathi e ka interpretuar ngushtë veprën penale të "dhënies së ndihmës kryerësit

*de extensión analógica del Derecho penal, al resolver sobre los límites de la interpretación de los textos legales [...]) and Fundamento Jurídico 5 ("[...] el principio de legalidad penal garantiza, por un lado, el estricto sometimiento del Juez a la ley penal, vedando todo margen de arbitrio o de discrecionalidad en su aplicación así como una interpretación analógica de la misma [...]") (theksimi është shtuar)). Shih gjithashtu Gjykatën Kushtetuese, Spanjë (Tribunal Constitucional), 142/1999, Judgment, 22 July 1999, Fundamento Jurídico 3 (ku theksohet se gjykatësi vepron në rrethanat e një "sujeción estricta a la ley penal" dhe duhet të përdorë një "interpretación extensiva y la analogía in malam partem"). Në lidhje me këtë, vërej kalimthi se Gjykata Kushtetuese e Spanjës nuk e përmend shprehimisht kriterin *lex stricta* por duket se e përfshin atë në kriterin *lex certa*. Shih, megjithatë, një vendim të kohëve të fundit të Gjykatës Supreme të Spanjës (Tribunal Supremo) ku kriteri *lex stricta* të paktën është përmendur. Shih Gjykatën Supreme, Spanjë (Tribunal Supremo), 4323/2020, Judgment, 26 November 2020, pp. 5, 7.*

³⁵ ICC, *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07-3436-tENG, Judgment pursuant to article 74 of the Statute, 7 March 2014, para. 52.

³⁶ Shih Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, PN1 2486/14, Kosovë, 19 dhjetor 2014.

për t'iu shmangur zbulimit", me qëllim që të shmangej shkelja e parimit të ligjshmërisë.³⁷

10. Nga e gjitha kjo rrjedh se kriteri *lex stricta* duhet të merret shumë seriozisht nga Dhomat e Specializuara dhe legjislacioni penal në fuqi nuk duhet të interpretohet lehtë në kuptimin e gjerë ose në mënyrë të zgjeruar në dëm të të akuzuarit; çdo mëdyshje lidhur me kuptimin e një dispozite ligjore, përfshirë elementet objektive të saj (veprimi i fajshëm), duhet të zgjidhet në favor të të akuzuarit.³⁸ Sa i përket nenit 401(1) të KPK-së, kjo do të thotë se formulimi i tij – aty ku flitet për përdorim të “forcës ose kërcënimit të rëndë” kundër “një personi zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare”, logjikisht nuk mund të interpretohet se përfshin kërcënime të drejtuara kundër personave privatë, për shembull kundër dëshmitarëve. Për këtë arsye, jam disi i befasuar nga argumenti i Trupit Gjyqësor dhe i shumicës së Panelit të Apelit se “në formulimin e kësaj dispozite nuk kërkohet që kërcënimi i rëndë të drejtohet vetëm ndaj personit zyrtar”.³⁹ Unë do të kisha thënë të kundërtën: në tekstin e nenit 401(1) të KPK-së përcaktohet pa mëdyshje se kërcënimi duhet të drejtohet kundër një personi zyrtar dhe aty nuk thuhet se ai mund të drejtohet edhe kundër personave privatë.

11. Veç kësaj, argumenti i tipit “në formulimin e kësaj dispozite nuk kërkohet”, i paraqitur nga shumica,⁴⁰ për mendimin tim, është t'i bësh gjërat së prapthi. Kjo sepse parimi i ligjshmërisë kërkon që ligjvënësi t'i përcaktojë qartë elementet e veprës penale që përbëjnë bazën e ndëshkueshmërisë së sjelljes përkatëse. Sa i përket nenit 401(1) të KPK-së, kjo do të thotë se, nëse kjo dispozitë do të mbulonte sjellje që drejtohen kundër personave privatë, atëherë kjo duhej të ishte thënë shprehimisht në dispozitë duke i përmendur aty personat privatë. Në përputhje me kriterin *lex stricta*, sikurse u shpjegua dhe tregua më sipër, nuk i takon gjykatësit që të interpretojë se dispozita

³⁷ Gjykata e Apelit, *E.K. et al.*, PAKR 271/13, Aktgjykim, Mendim Pjesërisht i Ndarë i Gjyqtarit Timo Vuojolahti, Kosovë, 30 janar 2014, f. 22-23.

³⁸ *Shih gjithashtu* Horder, p. 91.

³⁹ Aktgjykimi i Apelit, para. 282, që i referohet Aktgjykimit, para. 146, 639.

⁴⁰ *Shih më lart*, para. 2.

përmban elemente në dëm të të akuzuarit të cilët nuk janë shprehur aty; në vend të kësaj, gjykatësi duhet të pranojë vendimin legjislativ, të mos trajtojë elementet që mungojnë, dhe ta zbatojë dispozitën ligjore sipas kuptimit të saj tekstual.

12. Mund të argumentohet se rasti kur një person përdor forcë ose kërcënim të rëndë ndaj një personi që ka lidhje familjare ose është i afërt me një person zyrtar, për shembull ndaj një anëtari të familjes së një zyrtari të ZPS-së, i afrohet formulimit të nenit 401(1) të KPK-së. Ndonëse ky skenar hipotetik, që është një prej atyre të përmendur në Komentarin *Salihu dhe të tjerët*,⁴¹ mund të lihet pa u zgjidhur këtu, vlen të përmendet se në çështjen në fjalë kërcënimet u drejtuan kundër personave privatë që nuk kishin lidhje me zyrtarë të ZPS-së dhe, rrjedhimisht, sipas mendimit tim, në këtë çështje kemi të bëjmë me një situatë që qartazi nuk përfshihet në formulimin e dispozitës.

13. Kjo zbrazëti e dukshme në formulimin e nenit 401(1) të KPK-së nuk mund të ndreqet me anë të një interpretimi të qëllimshëm, që fokusohet në interesin ligjor të mbrojtur. Kjo do të mund të bëhej vetëm nëse formulimi i kësaj dispozite nuk do të ishte i qartë dhe, për rrjedhojë, për të arritur një interpretim të arsyeshëm të saj do të duhej të trajtohej qëllimi i pretenduar.⁴² Në fakt, përparësia absolute e interpretimit tekstual është një nga rrjedhojat e zbatimit të rreptë të kriterit *lex stricta*, në përputhje

⁴¹ *Shih* Komentarin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës *Salihu, I. dhe të tjerët*, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH 2014, nenin 409(1) të KPK-së të vitit 2012, komenti 3, f. 1165, ku kjo situatë përmendet si një situatë që ndodh më shpesh kur vihen në shënjestër persona që nuk janë persona zyrtarë, por trajtohet njësoj si përdorimi i forcës/kërcënimit të rëndë kundër një personi tjetër (privat) vetëm nëse kjo sjellje “shkakton pengimin e personit zyrtar në kryerjen e veprimit zyrtar ose ndërprerjen e kryerjes së veprimit zyrtar [...]”. Për arsyet e përmendura më lart, unë nuk pajtohem me këtë interpretim të gjerë.

⁴² Theksoj kalimthi se Paneli i Apelit paraqet të njëjtin argument për sa i përket marrëdhënies midis interpretimit tekstual dhe sistematik, *Shih* Aktgjykimin e Apelit, para. 279: “Një interpretim sistematik i tillë, duke marrë parasysh kategorinë ombrellë të veprave penale, sikurse sugjeron Mbrotjtja, mund të jetë relevant vetëm në qoftë se nuk është i qartë kuptimi tekstual i disa termave”.

me parimin *in claris non fit interpretatio* (gjërat e qarta nuk kanë nevojë për interpretim).⁴³

14. Bazuar përsëri në kriterin *lex stricta*, është po aq e papranueshme që të zgjidhet një interpretim i gjerë që shkon përtej formulimit të dispozitës, për të kompensuar mangësitë e provave, duke pasur parasysh formulimin e ngushtë të dispozitës përkatëse. Konkretisht, nëse si në rastin e kësaj çështjeje, me provat e disponueshme nuk mund të demonstrohet se janë kërcënuar persona zyrtarë,⁴⁴ kjo mangësi e provave lidhur me veprimin e fajshëm sipas nenit 401(1) të KPK-së nuk mund të ndreqet duke bërë, në dëm të të akuzuarve, një interpretim të zgjeruar të dispozitës që shkon përtej formulimit të saj. Në vend të kësaj, unë mendoj se mungesa e provave për kërcënimet ndaj personave zyrtarë duhet të çojë në shpalljen e pafajësisë për pikën përkatëse të Aktakuzës.

15. Interpretimi i ngushtë i diktuar nga *lex stricta* që po mbroj këtu nuk krijon hapësirë për mosndëshkim. Sjellja e të akuzuarve mbulohet në nenet 387 dhe 392(1)-(3) të KPK-së, dhe veçanërisht në nenin 387, ku trajtohet situata e kërcënimeve të drejtuara shprehimisht ndaj dëshmitarëve që janë persona privatë.

⁴³ Kjo është pranuar shprehimisht nga Gjykata Penale e Kasacionit të Italisë. *Shih* Gjykatën Penale të Kasacionit të Italisë (*Corte di cassazione penale*), United Sections (Sezioni Unite), no. 38810, Judgment, 13 June 2022, p. 15, para. 6.2 (“Rimane tuttavia fondamentale il canone ermeneutico *in claris non fit interpretatio*, il quale prescrive di attenersi, ove la lettera della legge non sia oscura, a una interpretazione fedele al tenore testuale della norma. [...] [L]’interpretazione letterale della legge è il canone ermeneutico prioritario per l’interprete, sicché l’ulteriore criterio dato dall’interpretazione logica e sistematica soccorre e integra il significato proprio delle parole, arricchendolo delle indicazioni derivanti dalla *ratio* della norma e dal suo inserimento nel sistema ma tale criterio non può servire a scavalcare o eludere quello letterale allorché la disposizione della quale occorra fare applicazione sia chiara e precisa.”). Përmend kalimthi se ky kriter zbatohet edhe nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë (“GJED”) në kontekstin e doktrinës *acte clair*, *shih p.sh.*, ECJ, *Abels/Bedrijfsvereniging voor de Metaalindustrie en de Electrotechnische Industrie*, Case 135/83, Judgment, 7 February 1985, paras. 11, 13 (që përdor metoda të tjera të interpretimit dhe jo interpretimin “tekstual” vetëm aty ku ka “divergjenca terminologjike” midis versioneve në gjuhë të ndryshme); ECJ, *Hamlin Electronics GmbH vs. Hauptzollamt Darmstadt*, Case C-338/90, Judgment, 31 March 1992, para. 12 (ku thuhet se vetëm “kur dispozita është e paqartë ajo duhet të interpretohet sipas skemës dhe qëllimit të përgjithshëm [...]”).

⁴⁴ Aktgjykimi, para. 639.

16. Rrjedhimisht, shpreh me respekt mendimin tim se në këtë çështje nuk është vërtetuar veprim i fajshëm sipas nenit 401(1) të KPK-së. Për të njëjtat arsye, nuk pajtohem as me shpalljen e fajësisë sipas nenit 401(2) të KPK-së, pasi edhe sipas kësaj dispozite duhet që veprimi të drejtohet kundër “një personi zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare”.

B. NDIKIMI NË PËRCAKTIMIN E DËNIMIT

17. Pajtohem me dënimet që Trupi Gjykses u dha të akuzuarve për secilën pikë të Aktakuzës, përfshirë dënimin me katër vjet burgim për Pikën 3 të Aktakuzës (neni 387 i KPK-së).⁴⁵ Duke pasur parasysh standardin e zbatueshëm në shqyrtimet për përcaktimin e dënimit, i cili kërkon që t’i jepet përparësi ushtrimit të kompetencës diskrecionale nga Trupi Gjykses dhe lejon ndërhyrjen e instancës së apelit vetëm në rast të keqpërdorimit të kësaj kompetence ose në rast të zbatimit të gabuar të ligjit,⁴⁶ si dhe duke marrë parasysh rrëzimin e kundërshtimeve konkrete të të akuzuarve lidhur me dënimet,⁴⁷ ndryshimi i dënimeve individuale të dhëna nga Trupi Gjykses për secilën pikë të Aktakuzës do të përbënte një ndërhyrje të palejueshme nga Paneli i Apelit. Rrjedhimisht, pajtohem plotësisht me konstatimin e Panelit të Apelit se “Trupi Gjykses nuk ka gabuar në përcaktimin e dënimeve të të akuzuarve mbi bazën e fajësisë së shpallur për pikat përkatëse të Aktakuzës”.⁴⁸

18. Në këtë aspekt, në fjalinë e dytë të rregullës 163(4) të Rregullores përcaktohet se dënimi i njësuar “nuk është më pak i rëndë” se dënimi më i rëndë individual i përcaktuar për cilëndo akuzë, që, në këtë rast, është dënimi me katër vjet burgim i dhënë nga Trupi Gjykses për Pikën 3. Ndonëse vërej kalimthi se kjo rregull e detyrueshme për dënimet e njësuara, që duket se është hartuar në bazë të fjalisë së

⁴⁵ Aktgjykimi, para. 981, 1006. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin e Apelit, para. 437, 439-440.

⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 413-414, 435.

⁴⁷ Aktgjykimi i Apelit, para. 415-426, 431-439.

⁴⁸ Aktgjykimi i Apelit, para. 437.

dytë të nenit 78(3) të Statutit të Romës,⁴⁹ presupozon një renditje të caktuar në përcaktimin e dënimeve,⁵⁰ paneli ose gjykatësi nuk ka kompetencë të devijojë prej saj, për shkak të vetë karakterit detyrues të saj (“nuk është”).

19. Si pasojë e këtyre faktorëve, për sa i përket dënimit, mendoj se shpallja e të akuzuarve të pafajshëm për Pikën 1 të Aktakuzës duhet të shoqërohet me një ulje të mëtejshme me tre muaj të dënimit të dhënë nga shumica. Rrjedhimisht, unë do të kisha dhënë një dënim të njësuar me katër (4) vjet burgim, që pasqyron tërësinë e sjelljes kriminale të të akuzuarve.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Kai Ambos

E enjte, 2 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë

⁴⁹ Në lidhje me këtë dispozitë, *shih* Khan, K. A. A., and Ellis, A., in *Ambos Rome Statute Commentary*, Article 78, mn. 21.

⁵⁰ Rregulla 163(4) e Rregullores, ashtu si dhe neni 78(3) i Statutit të Romës, kërkon që, *së pari*, dënimet individuale duhet të përcaktohen (“në lidhje me çdo akuzë të aktakuzës [...]”) dhe, *së dyti*, Trupi Gjykues të përcaktojë dënimin e njësuar përfundimtar (“ [...] jep dënim të njësuar [...]”). Në lidhje me nenin 78(3) të Statutit të Romës, *shih* Khan, K. A. A., and Ellis, A., in *Ambos Rome Statute Commentary*, Article 78, mn. 9 (“ [...] për secilën vepër penale shqiptohet dënim i veçantë, por personit të shpallur fajtor i jepet dënim i njësuar”). Sipas mendimit tim, nëse gjykatësit do të përcaktonin në fillim dënimin e njësuar përfundimtar, kjo do të cenonte integritetin e secilit dënim të veçantë dhe do të ishte *contra legem*. Procesi i dhënies së dënimeve një nga një garanton që palët ta kenë të qartë dënimin e përshtatshëm për secilën pikë/akuzë dhe që dënimi i gjithsejtë të mos jetë thjesht shumë e dënimeve individuale.